



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.145

dhjetor

2006

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i KM
nr.860, datë 20.12.2006

Për miratimin e planit kombëtar të veprimit për heqjen nga
përdorimi dhe eliminimin e ndotësve organikë, të qëndrueshëm.. 5723

VENDIM
Nr.860, datë 20.12.2006

PËR MIRATIMIN E PLANIT KOMBËTAR TË VEPRIMIT PËR HEQJEN NGA PËRDORIMI DHE ELIMINIMIN E NDOTËSVE ORGANIKË, TË QËNDRUESHËM

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 8 të ligjit nr.8934, datë 5.9.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit”, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e planit kombëtar të veprimit për heqjen nga përdorimi dhe eliminimin e ndotësve organikë, të qëndrueshëm, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe të gjitha ministratë e institucionet e përcaktuara në planin kombëtar të veprimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

PLANI KOMBËTAR I VEPRIMIT PËR HEQJEN NGA PËRDORIMI DHE ELIMINIMIN E NDOTËSVE ORGANIKË TË QËNDRUESHËM

Përmbledhje Ekzekutive

Hyrje

Ndotësit Organikë të Qëndrueshëm (NOQ) janë lëndë kimike të qëndrueshme në mjedis, që bio-akumulohen nëpërmjet zinxhirit ushqimor dhe paraqesin rrezik sepse kanë efekte të dëmshme për shëndetin e njerëzve dhe mjedisin. Duke pasur parasysh bartjen e këtyre lëndëve në largësi të mëdha, deri në vende ku nuk janë përdorur ose prodhuar ndonjëherë, si dhe kërcënimin më pas për mjedisin e tërë rruzullit tokësor, bashkësia ndërkombëtare ka bërë thirrje për masa të ngutshme, me synimin që të pakësohet dhe të eliminohet shkarkimi i këtyre lëndëve në mjedis.

Kur u bë e qartë se NOQ-të ishin shumë të rrezikshme dhe se duheshin ndërmarrë masa të ngutshme në të gjithë botën, UNEP-i ndërmori hapat e duhur për të përgatitur një instrument ligjor ndërkombëtar, me efekt detyrues, i cili do të “përcaktonte rrugën për një të ardhme pa NOQ të rrezikshme”. Rezultat i këtyre përpjekjeve është Konventa e Stokholmit për Heqjen nga Përdorimi dhe Eliminimin e Ndotësve Organikë të Qëndrueshëm. Kjo Konventë është një traktat global për mbrojtjen e shëndetit të njerëzve dhe të mjedisit nga ndotësit organikë të qëndrueshëm. Ajo u miratua më 22 maj 2001 në Konferencën e Palëve në Stokholm dhe hyri në fuqi më 17 maj 2004, sipas Nenit 26 të po kësaj konvente. Bashkimi Evropian, i cili është palë në këtë Konventë, ka miratuar Politikën e vet në lidhje me administrimin e NOQ-ve, politikë që do të jetë e detyrueshme edhe për vendet e reja që do të hyjnë në BE. Shqipëria e ka nënshkruar Konventën më 5 dhjetor 2001 dhe e ka ratifikuar atë më 4 tetor 2004.

Konventa e NOQ-ve parashikon një varg detyrimesh që duhet apo nxiten të ndërmarrin Palët, ndër të cilat janë përcaktimi i pikave fokale kombëtare, kujdesi për shkëmbimin e informacionit, dhënia e ndihmës teknike, zhvillimi dhe lehtësimi i ndërgjegjësimit dhe pjesëmarrjes së publikut, konsultimi dhe arsimimi, nxitja e kërkimit shkencor dhe e monitorimit, si edhe raportimi “në intervale kohorë periodikë”.

Projekti i PKV për NOQ-të

Në detyrimet që rrjedhin nga qenia palë në Konventën e Stokholmit (neni 7 i Konventës), bën pjesë edhe përgatitja e zhvillimi i një Planit Kombëtar të Veprimit (PKV), ku të përcaktohet sesi do të vihen në jetë detyrimet që shtrun Konventa. PKV ka si qëllim të përcaktojë kuadrin ligjor dhe institucional dhe veprimet që duhet të programohen e të zbatohen për heqjen nga përdorimi dhe eliminimin e NOQ-ve. Planet e veprimit duhet t'i paraqiten Konferencës së Palëve brenda dy vjetëve që nga hyrja në fuqi e Konventës.

Në vitin 2002 Ministria e Mjedisit i kërkoi GEF-it, nëpërmjet UNDP-së, përkrahje financiare për projektin që do të mundësonte hartimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Heqjen nga Përdorimi dhe Eliminimin e NOQ-ve. Kontributi i GEF-it për këtë qëllim ishte 347,000 USD, ndërsa Qeveria Shqiptare kontribuoi me 31,400 USD. Agjenci Ekzekutuese e projektit është Ministria e Mjedisit, ndërsa Agjenci zbatuese është UNDP-ja.

PKV synon të nxisë, të ndihmojë dhe të mbështesë autoritetet qendrore e vendore, subjektet shtetërore e private, për të trajtuar siç duhet dhe në përputhje me kërkesat e konventës NOQ-të, pajisjet ku mbahen ato, si dhe territoret e ndotura prej tyre.

Politika për NOQ-të, pjesë integrale e politikës për administrimin e kimikateve të rrezikshme, kërkon zbatimin me konsekuencë të masave mbrojtëse e parandaluese për ruajtjen e shëndetit të njeriut dhe të mjedisit në Republikën e Shqipërisë, mbi bazën e një kuadri të plotë ligjor dhe institucional, të harmonizuar me kërkesat e Konventës së Stokholmit dhe me Direktivat e Bashkimit Evropian.

Në këtë kontekst përgatitja e PKV-së është në përputhje me objektivat e Planit Kombëtar të Veprimit për Mbrojtjen e Mjedisit, të miratuar nga Qeveria Shqiptare më 2002, njëri prej synimeve të të cilit është "zbutja dhe parandalimi i problemeve mjedisore".

Procesi i përgatitjes së PKV-së, është mbështetur në Udhëzimet e Fondit Global për Mjedisin për Konventën e Stokholmit dhe ka kaluar nëpër pesë kategori kryesore veprimtarish:

- 1: Përcaktimi i mekanizmit të bashkërendimit dhe organizimi i procesit;
- 2: Hartimi i inventarit të NOQ-ve dhe vlerësimi i infrastrukturës dhe i kapaciteteve kombëtare;
- 3: Vendosja e përparësive dhe caktimi i objektivave;
- 4: Formulimi i Planit Kombëtar të Veprimit dhe i Planeve të veçanta të veprimit për NOQ-të;
- 5: Miratimi i PKV-së nga palët që lidhen me administrimin e NOQ-ve.

Për realizimin e aktiviteteve të parashikuara në udhëzimet përkatëse të GEF-it, u ngritën disa Grupe Pune sipas problematikave përkatëse.

Grupet e Punës realizuan për herë të parë inventarin paraprak të NOQ-ve në nivel vendi dhe, mbi këtë bazë, identifikuan problemet që do të trajtoheshin dhe duheshin zgjidhur në kuadrin e PKV, në përputhje me politikën e Qeverisë Shqiptare për mbrojtjen e mjedisit, si dhe me kërkesat e Konventës së Stokholmit e të Bashkimit Evropian për heqjen nga përdorimi dhe eliminimin e NOQ-ve.

PKV duhet të jetë një dokument dinamik që kërkon jo vetëm angazhimin në procesin e zbatimit të tij të institucioneve e organizatave qendrore dhe vendore, publike dhe private, por edhe një monitorim e vlerësim të kujdesshëm dhe, mbi këtë bazë, përditësimin e tij, për të qenë vazhdimisht koherent me zhvillimet ekonomiko-sociale-mjedisore të vendit dhe, në një kontekst, më të gjerë me zhvillimet ndërkombëtare që kanë në qendër të vëmendjes mbrojtjen e mjedisit e të shëndetit të njerëzve.

Profili i Shqipërisë

Shqipëria ndodhet në pjesën perëndimore të Gadishullit të Ballkanit, në brigjet lindore të deteve Adriatik dhe Jon, në zonën e klimës sub-tropikale Mesdhetare, që është shumë e përshtatshme për aktivitetet jetësore dhe socio-ekonomike. Vendi është i pasur me burime minerare, ujëra, florë dhe faunë, etj. Kjo e fundit është dëmtuar shumë nga gjuetia pa kriter, shpyllëzimet, tharja e ligatinave dhe kënetave, përdorimi i kimikateve në bujqësi, ndotja e tokës, ajrit dhe ujit, etj.

Shqipëria është Republikë Parlamentare. Popullsia e saj në vitin 2001 ishte rreth 3,069,275 banorë. Gjatë periudhës 1989-2001 kanë emigruar rreth 0.6 milion shqiptarë. Më shumë se një e dyta e popullsisë është përqendruar në ultësirën bregdetare. Mosha mesatare e popullsisë është më e reja në Evropë, kurse jetëgjatësia është e krahasueshme me atë të popullsisë së vendeve të zhvilluara. Shqiptaret zënë 98% të strukturës etnike të popullsisë.

Industritë që punojnë tani në Shqipëri përfshijnë agro-industrinë, industrinë tekstile, të veshmbathjes, drurit, naftës, çimentos, industrinë kimike, minerare dhe të përpunimit të metaleve, dhe industrinë hidro-energjetike. Bashkimi Europian është partneri tregtar kryesor i Shqipërisë. Eksportet kryesore të vendit janë në sektorët e tekstileve, këpucëve, metaleve dhe mineraleve, naftës bruto, perimeve, frutave dhe duhanit. Importet kryesore përfshijnë produkte industriale dhe shumë produkte të tjera të përpunuara.

Sektori industrial është ende i dobët. Kontributi i sektorit të bujqësisë në PBB-në e vendit ka pasur një rënie të konsiderueshme gjatë 5 viteve të fundit. Ka përfunduar privatizimi i ndërmarrjeve të vogla e të mesme, ndërsa privatizimi i ndërmarrjeve të mëdha ka qenë më i ngadaltë. Sistemi energjetik është akoma i dobët dhe kriza energjetike nuk është zgjidhur ende. Sektori i telekomunikacioneve është përmirësuar, por akoma ka probleme në zonat e thella. Numri i përdoruesve të celularëve është rritur mjaft, ndërsa mbeten të kufizuara mundësia e lidhjes me internet dhe përdorimi i tij. Në sektorin e transportit prioritet kryesor mbetet përfundimi i korridoreve Lindje-Perëndim dhe Veri-Jug.

Shqipëria ka trashëguar shumë probleme mjedisore nga e kaluara, të cilat janë thelluar gjatë tranzicionit. Prioritetet kryesore mjedisore mbulojnë erozionin e tokës, shpyllëzimet, humbjen e biodiversitetit, mbetjet urbane, ndotjen e ajrit në zonat qytetëse dhe industriale, ndotjen e tokës prej mbetjeve të rrezikshme nga industritë e vjetra, etj. Janë trashëguar edhe probleme të tjera në nivelin e institucioneve, legjislacionit, kulturës dhe edukatës mjedisore, etj. Megjithatë gjatë tranzicionit janë bërë përparime, sidomos në fushën e institucioneve, politikave, legjislacionit, ndërgjegjësimit, etj. mbetet akoma shumë për të bërë. Investimet në infrastrukturën mjedisore vlerësohen si një masë e rëndësishme për zbatimin e legjislacionit dhe respektimin e standardeve Europiane.

Që nga viti 2000 Shqipëria është anëtare në OBT dhe zbaton të gjitha marrëveshjet e tregtisë së lirë në kuadër të Paktit të Stabilitetit.

Më 12 qershor 2006 Shqipëria nënshkroi Marrëveshjen e Stabilizim Asocimit me Komisionin Evropian, e cila parashtrohet detyra të rëndësishme për mjedisin dhe zhvillimin e qëndrueshëm.

Vlerësimi i Çështjeve dhe Plani i Veprimit lidhur me NOQ-të në Shqipëri

Forcimi i Kuadrit Ligjor dhe Rregullator

Në lidhje me kuadrin rregullator ekzistues në Shqipëri janë evidentuar këto çështje :

- Në legjislacionin kombëtar nuk ekziston asnjë ligj i veçantë ose akt tjetër nën-ligjor, i cili të jetë në kundërshtim me dispozitat e Konventës së Stokholmit;
- Deri më tani nuk ka asnjë akt specifik ligjor që të trajtojë NOQ-të;

- Në disa ligje dhe akte nënligjore, si edhe në disa dokumente të tjera shtetërore për mjedisin, ekzistojnë hapësira për trajtimin e ardhshëm të NOQ-ve në përputhje me kërkesat e Konventës;
- Përgatitja e kuadrit ligjor specifik për të bërë të mundur zbatimin e kërkesave të Konventës si pjesë e përpjekjeve të përgjithshme për të transpozuar dhe harmonizuar legjislacionin kombëtar me atë evropian në fushën e mbrojtjes së shëndetit të njeriut e të mjedisit;
- Hartimi dhe miratimi i çdonjërit prej akteve që do të përbëjnë paketën ligjore për NOQ-të, duhet të realizohet në përputhje me një program të detajuar të miratuar, i cili duhet të jetë afat-shkurtër, afat-mesëm dhe afat -gjatë;
- Me qëllim që të përgatitën akte specifike, duhet të ngrihen grupet përkatëse të punës, në përbërje të të cilave duhet të ketë juristë mjedisorë, teknikienë dhe anëtarë të OJF-ve të specializuara e të shoqatave të biznesit;

Rrjeti Institucional

Në lidhje me kuadrin institucional në Shqipëri, janë identifikuar si aktuale çështjet e mëposhtme:

- Vlerësimi kritik i organizmave dhe strukturave ekzistuese, si kapaciteti veprues më i rëndësishëm, për të gjetur lidhjen e secilës prej tyre me detyrimet që rrjedhin nga Konventa e Stokholmit;
- Rivlerësimi i detyrimeve konkrete që kanë institucionet përkatëse në lidhje me administrimin e NOQ-ve, në funksion të detyrave, kompetencave dhe përgjegjësisë të tyre kryesore;
- Hartimi i skemës së re institucionale, e cila të përfshijë të gjitha strukturat dhe organet në qendër dhe në nivel lokal, përcaktimi i roleve, funksioneve, përgjegjësisë, kompetencave dhe detyrave të çdonjërit prej tyre, i lidhjeve të ndërmjetme dhe i rregullave të funksionimit të sistemit në tërësi;
- Përcaktimi i pikave të kontaktit dhe i pikave fokale në nivel kombëtar, lokal dhe/ose sektorial, të cilët, të gjithë së bashku, do të përbëjnë Rrjetin Kombëtar të NOQ-ve;
- Pikat e kontaktit dhe pikat fokale do të ndërtojnë skemën e komunikimit midis tyre, si edhe do të përgatisin programet operative për zbatimin e detyrave përkatëse;

Problemët përparësore

- Nevoja e plotësimit dhe zbatimit të legjislacionit për kimikatet;
- Legjislacioni aktual nuk është tërësisht i harmonizuar me atë evropian;
- Nevoja për të rregulluar çështjet që lidhen me përdorimin e PCB-ve në sisteme të mbyllura, nxjerrjen e tyre nga përdorimi dhe asgjësimin e sigurt nga pikëpamja mjedisore;
- Zbatim i pamjaftueshëm i legjislacionit ekzistues;
- Nevoja për të ngritur një strukturë kombëtare për zbatimin e Konventës së Stokholmit (rrjet të pikave të kontaktit, pikave fokale).

Objektivat

- Plotësimi dhe harmonizimi i legjislacionit mjedisor me atë evropian;
- Përmirësimi i rrjetit institucional dhe ngritja e kapaciteteve në nivel qendror dhe vendor.

- **Plani i Veprimit**

1. Përfshirja e monitorimit të NOQ-ve dhe në veçanti të PCB-ve si pjesë e Programit Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit;
2. Regjistrimi i pajisjeve dhe vajrave që përmbajnë PCB në sektorin e energjisë elektrike;
3. Përafrimi i legjislacionit vendas me atë Evropian;
4. Ngritja e strukturës kombëtare për zbatimin e Konventës së Stokholmit

Pesticidet NOQ

Nga dymbëdhjetë NOQ-të e renditura në Konventën e Stokholmit, nëntë janë pesticide që i përkasin grupit të NOQ-ve: aldrin, dieldrin, DDT, endrin, mireks, toksafen, klordan, heksaklorbenzen dhe heptaklor.

Fillimisht, në vendin tonë janë importuar dhe, më vonë, janë formuluar në Ndërmarrjen Kimike, Durrës, pesticidet DDT, heptaklor, aldrin, dieldrin, toksafen (melipaks), klordan, heksakloran dhe lindan, i cili gjithashtu është prodhuar në këtë ndërmarrje. Edhe pse prodhimi i pesticideve është ndërprerë në vitin 1990, rreziku i rrjedhur prej tyre ka qenë i dukshëm.

Nga inventari i bërë në vitin 2005 në kuadrin e Projektit të NOQ-ve ka rezultuar se në Shqipëri nuk ka pesticide të këtij grupi. Një sasi prej rreth 3 ton DDT dhe heksakloran/lindan, e cila kanë qenë ruajtur në depot e Ministrisë së Shëndetësisë, është riambalazhuar dhe larguar nga Shqipëria në muajin korrik 2006, në kuadrin e projektit të MMPAU: “Ripaketimi dhe largimi nga Shqipëria i pesticideve dhe i kimikateve të tjera nga Bishti i Pallës”, financuar nga qeveria holandeze. Problem është përcaktimi i kostos së ndotjeve eventuale nga përdorimi i mëparshëm i pesticideve NOQ.

Ekzistojnë vetëm disa studime sporadike lidhur me ndikimin e pesticideve NOQ në mjedis. Këto studime janë kryer në vendet që konsiderohen si pika të nxehta mjedisore dhe nuk ka ndonjë studim të plotë për tërë situatën në vend në lidhje me ndotjet e tokës apo ujit nga pesticidet NOQ. Në këtë kontekst, sugjerohet të planifikohet monitorimi i këtyre pesticideve kryesisht në ish – depot, hapësirën tokësore apo ujore rreth e rrotull dhe, në raste të veçanta, te kafshët shtëpiake dhe njerëzit.

Problemet përparësore

- Përshtatja e legjislacionit në fuqi për përdorimin e pesticideve;
- Informacion jo sistematik rreth përdorimit në të kaluarën i DDT (dokumente rreth sasive të importuara dhe të përdorura të DDT në sektorin e shëndetësisë);
- Mungesa studimit për nivelin aktual të ndotjeve në ish depot e magazinimit të pesticideve, po kështu edhe në mjedisin rreth tyre;
- Autoritetet vendore kanë një informacion të pamjaftueshëm në lidhje me pesticidet NOQ (në veçanti në depot e vjetra);
- Stafit teknik ka një informacion të pamjaftueshëm në lidhje me pesticidet NOQ (mundësitë e ndotjes të depove të vjetra);
- Mungesa e informacionit specifik në lidhje me pesticidet te publiku në përgjithësi;
- Mungesa e një mbështetjeje financiare.

Objektivat

- Forcimi i kapacitetit të laboratorëve të IMB për monitorimin e pesticideve NOQ;
- Përcaktimi i ndotjeve eventuale nga pesticidet NOQ në ish depot dhe në hapësirën përreth tyre;

- Zhvillimi i planit të rehabilitimit për vendet e ndotura nga pesticidet NOQ;
- Rritja e ndërgjegjësimit rreth këtyre vendeve të ndotura në lidhje me rrezikun shëndetësor të njerëzit që jetojnë pranë tyre.

Plani i Veprimit

1. Përgatitja e një amendamenti të VKM për kryerjen e analizave të pesticideve NOQ.
2. Kryerja e analizave të niveleve të mbetjeve të pesticideve NOQ, në ish depot dhe vendet e kontaminuara, duke përfshirë edhe vlerësimin e ndikimit mjedisor të tyre;
3. Forcimi i kapacitetit njerëzor dhe teknik i laboratorit analitik në Institutin e Mbrojtjes së Bimëve;
4. Përgatitja e planit të veprimit për rehabilitimin e vendeve të kontaminuara nga pesticidet NOQ;
5. Rritja e ndërgjegjësimit të publikut në lidhje me rrezikun potencial të vendeve të kontaminuara me NOQ.DDT

DDT

DDT filloi të përdoret masivisht në Luftën e Dytë Botërore. Ky pesticid është përdorur për të luftuar sëmundjet që transmetohen me insekte dhe për të mbrojtur trupat. Ka qenë veçanërisht i efektshëm për mbrojtjen nga malaria, tifoja, ethet e verdha, verbimi i lumenjve dhe encefaliti.

Tashmë është praktikisht i ndaluar përdorimi i DDT në bujqësi pothuajse në të gjitha vendet, kurse një numër vendesh e ndalojnë përdorimin e DDT-së edhe në fushën e shëndetit publik. Sidoqoftë, në disa vende, ku vektori i malaries është ende i ndjeshëm, DDT përdoret për banesat, në mjediset e brendshme në trajtë aerosoli.

DDT-ja filloi të përdorej në Shqipëri në vitet 1946–1947 në luftën kundër vektorëve të malaries. Nga vitet 1946-1947 deri më 1959-1960, sasitë mesatare vjetore të DDT dhe HCH për spërkatjen e banesave në mënyrë manuale, si edhe me avionë në sipërfaqet ujore, ku përhapja e mushkonjave anofeles ka qenë mjaft e lartë, arritën 90-120 ton. DDT është përdorur edhe për luftimin e insekteve të tjera si morri, miza, pleshti, çimka, të cilat kishin pllakosur familjet e zonave të varfra të Shqipërisë të asaj kohe. Viti 1967 konsiderohet si viti i çrrënjësjes së malaries në Shqipëri, çka u çertifikua zyrtarisht nga OBSH-ja pas kërkesës së shtetit shqiptar. Sipas studiuesve dhe ekspertëve malariologë të vendit, DDT-ja nuk u përdor më pas vitit 1970, por duket se një rezervë prej 20-30 ton u mbajt në ruajtje nga Ministria e Shëndetësisë për luftimin e shpërthimeve eventuale të cilat mund të shkakttoheshin nga raste të importuara, si edhe pse mushkonjat kishin filluar të fitonin rezistencë ndaj DDT-së, pas një përdorimi prej mbi 20 vjetësh.

Sipas informacionit të mbledhur në disa rrethe, duket se DDT dhe lindani janë përdorur deri përpara 15 vjetësh. Lindani është përdorur kryesisht kundër zgjebes dhe parazitëve (morrave), gjatë viteve 1975 -1985. Më vonë ai u ndalua për shkak të rezistencës që kishin krijuar këta parazitë.

Ndonëse teorikisht ndikimi i pesticideve në shëndetin publik dhe në mjedis ka qenë i njohur, në Shqipëri nuk ka pasur ndonjë sistem monitorimi ose të mbledhjes së të dhënave për të përcaktuar këtë ndikim. Kohët e fundit janë bërë disa përpjekje nga ISHP për të studiuar mbetje të pesticideve në zinxhirin ushqimor.

Është vërtetuar prania e izomerëve të HCH (α , β , γ) në gjakun e disa personave që jetojnë në zonën e kontaminuar (në Porto Romano, pranë Durrësit) në një fabrikë të braktisur që përdorej për prodhimin e lindanit. Kështu, janë gjetur nivele të α - dhe β -izomerëve që variojnë deri në 0.0028 $\mu\text{g/ml}$ dhe nga 0.0005 $\mu\text{g/ml}$ në 0.0915 $\mu\text{g/ml}$. Nivelet më të larta u përkasën subjekteve që jetojnë në territorin e fabrikës së përmendur.

Dy mostra qumështi të marra në një zonë të ndotur pranë Porto-Romanos, në kuadrin e një studimit të kryer nga UNEP, si dhe në kuadër të një studimi të kryer nga ISHP, përmbanin nivele të larta të

HCH. Të dyja mostrat dëshmojnë për nivelet shumë të larta të HCH në qumështin e prodhuar në zonën e Porto Romanos, e cila është tregtuar edhe në zona të tjera të rrethit të Durrësit.

Përqendrimi i HCH i gjetur në qumësht është një tregues i qartë se nuk mund të përdoret për konsum mbasi përbën një rrezik serioz për shëndetin publik.

Gjatë inventarizimit të kryer në kuadër të projektit të NOQ-ve, situata në sektorin e shëndetësisë (Dhjetor 2005) paraqiten në tabelë.

Stoqe të DDT e të Lindanit në magazinat e MSH

Nr	Rrethi	Vendndodhja	Sasia DDT (kg)	Sasia LINDAN (kg)	Paketimi
1	Gjirokastrë	DKSHP	50 kg sol. 25 %	-	Fuçi
2	Durrës	DKSHP	200 kg sol. 25 %	24.2 kg (sol.10%)	Fuçi Shishe x 500 ml
3	Elbasan	DKSHP	100 kg sol. 25%	-	Fuçi
4	Lushnjë	DKSHP	1040 kg sol. 25%	200 (HCH)	Fuçi, thasë
5	Lezhë	DKSHP	-	704.6 (sol. 10%)	Shishe x 50 ml
6	Rezerva Shtetërore	Lundër	108 kg sol. 25%	212 (pluhur)	Fuçi
	Gjithsej	6 vende	1948 kg sol 25%	1140 kg	Fuçi, shishe, thasë

Sasitë e identifikuar të DDT dhe heksakloran/lindanit u hoqën nga Shqipëria në kuadër të projektit të MMPAU, "Ripaketimi dhe heqja nga Shqipëria e pesticideve dhe e kimikateve të tjera nga Bishti i Pallës" të financuar nga Qeveria Holandeze. Ky eliminim u përfundua në Korrik 2006.

Problemet përparësore.

- Mungese e kapaciteteve për studime analitike në lidhje me kontaminimin e ish-magazinave të DDT, si edhe të mjedisit rrethues;
- Mungesë e mbështetjes financiare.

Objektivat

- Forcimi i kapaciteteve të laboratorëve të IMB, ISHP, dhe LQU për monitorimin e DDT.
- Përcaktimi i kontaminimit eventual të ish magazinave dhe zonave për rreth tyre nga DDT;
- Përgatitja e Planit të Rehabilitimit për vendet e kontaminuara nga DDT.
- Rritja e ndërgjegjësimit për vendet e kontaminuara për sa u përket rreziqeve të mundshme shëndetin e popullatës që jeton në afërsi të këtyre vendeve.

PCB-të

PCB-të janë kimikate organike sintetike, me veti të larta dielektrike, të padjegshme, si dhe të qëndrueshme ndaj shpërbërjes termike e kimike. Pjesa më e madhe e transformatorëve dhe e kondensatorëve përdorin lëngje dielektrike me bazë bifenile të polikloruara (PCB-të) për shkak të vetive zjarrruduese dhe karakteristikave të tjera të mira të tyre në përdorimin e pajisjeve elektrike, por në të njëjtën kohë këto produkte kanë dhe mjaft disavantazhe. Këto disavantazhe lidhen me natyrën helmuese të PCB-ve dhe rrezikun që ato sjellin për shëndetin e njerëzve dhe mjedisin.

PCB-të janë subjekt i tri konventave ndërkombëtare që lidhen me trajtimin e mbeturinave të rrezikshme dhe konkretisht: Konventa e Bazelit, e Roterdamit dhe e Stokholmit. Këto konventa i trajtojnë problemet e PCB-ve duke iu referuar prodhimit, deklarimit, përdorimit, importimit, eksportimit, ruajtjes, transportit, monitorimit, nxjerrjes jashtë përdorimit dhe eliminimit të tyre.

Inventari i PCB-ve

Objekti i Inventarit të PCB-ve është identifikimi i të gjithë transformatorëve me PCB që janë në përdorim dhe/ose jashtë përdorimi, zbatimi i masave paraprake kryesisht në pajisjet me PCB në përdorim (ato që vazhdojnë të përdoren, që janë jashtë pune, që presin të asgjësohen), për të siguruar monitorimin e përputhjes teknike të gjitha pajisjeve me PCB që janë në përdorim, si dhe për të siguruar ndjekjen e pajisjeve me PCB deri në fund të jetës së tyre.

Sipas Konventës së Stokholmit duhet të identifikohen, etiketohen dhe të hiqen nga përdorimi pajisjet që përmbajnë më shumë se 10 % PCB dhe vëllim më të madh se 5 litra, të identifikohen, etiketohen dhe të hiqen nga përdorimi pajisjet që përmbajnë më shumë se 0.05 % PCB (500 ppm) dhe vëllim më të madh se 5 litra, si dhe të bëhen përpjekje që të identifikohen dhe të hiqen nga përdorimi pajisjet që përmbajnë më shumë se 0.005 % PCB (50 ppm) dhe vëllim më të madh se 0.05 litra.

PCB-të nuk janë prodhuar kurrë në Shqipëri. Vaji i transformatorëve është importuar gjithmonë nga shtete të tjera të Evropës ose Azisë. Deri tani nuk ka pasur ndonjë kontroll për përmbajtjen e PCB-ve në pajisje dhe vajra minerale në Dogana dhe në Magazinën Qendrore në Shkozë, Durrës, në lidhje me sasinë e vajit dhe praninë e PCB-ve në të.

Në Objektet e KESH-it janë në përdorim shumë transformatorë të vjetër të prodhuar para vitit 1970, të cilët kanë krijuar ndotje të mjedisit, veçanërisht në tokë dhe në ujërat nëntokësore për shkak të rrjedhjeve të vajit dhe të pikimeve gjatë procesit të mirëmbajtjes ose për shkak të vjetërsisë së transformatorëve. Pjesa më e madhe e transformatorëve janë vendosur në tokë ose mbi një bazament por nuk kanë rezervuar dytësor poshtë tyre. Mund të vihet re me lehtësi toka e ndotur poshtë transformatorëve, prandaj kërkohet ndjekja e problemit të ndotjes së tokës dhe ujërave nëntokësore.

Në kuadrin e projektit për përgatitjen e PKV për NOQ janë inspektuar rreth 57 objekte energjetike dhe janë analizuar rreth 169 mostra vaji; rezultatet tregojnë se 5,3% e sasisë së analizuar mund të konsiderohen si të dyshuara për PCB (PCB>50 ppm).

Në qoftë se marrim rezultatet e arritura në transformatorët e analizuar dhe i aplikojmë për të gjithë sasinë e transformatorëve të prodhuar përpara vitit 1990, atëherë sasia e transformatorëve të ndotur me PCB mund të jetë si më poshtë:

Numri i transformatorëve të prodhuar para vitit 1990	6 000 copë
Pesha mesatare e transformatorëve të shpërndarjes	1,5 ton
Përqindja e transformatorëve që priten të jenë të ndotur	5,3 %
Numri i transformatorëve që priten të jenë të ndotur	rreth 320
Pesha e përgjithshme e transformatorëve	1100 ton
Pesha e përgjithshme e vajit	300 ton
Pesha e përgjithshme e transformatorëve të zbrazur	800 ton

Rreth 10% e transformatorëve e kanë raportin e peshës së vajit ndaj peshës së transformatorit më të lartë se 30% dhe nga testimi me test-kite nuk kanë rezultuar me densitet pozitiv: këta transformatorë mund të konsiderohen si të rimbushur dhe dyshohet se përmbajnë PCB.

Inventari Paraprak i PCB-ve nxori në pah mos-ekzistencën më parë të standardeve (limiteve) dhe metodave për analizat e PCB-ve, nivelin e ulët të informimit dhe të ndërgjegjësimit mbi PCB-të në të gjithë grupet e popullsisë, mungesën e informimit dhe të ndërgjegjësimit të popullsisë në përgjithësi mbi rrezikun potencial të PCB-ve (të vajrave të transformatorëve), nivelin e kufizuar të ndërgjegjësimit të punonjësve nëpërmjet administrimit të përgjegjësive në sektorin publik dhe privat, ndërgjegjësimin

e ulët të punonjësve të ekspozuar potencialisht ndaj PCB-ve, mungesën e monitorimit të ndotjeve me PCB në matrica të ndryshme dhe në ajër, tokë dhe ujëra tokësore e nëntokësore që mund të jenë ndotur me vaj që përmban PCB.

Numri i kondensatorëve në Objektet e KESH/OST është i kufizuar. Ata janë vendosur në N/Stacionin 220 kV në Fier (2x25 MVAR), në N/Stacionet 110 kV në Lushnje dhe në Ballsh, (secili prej tyre është 25 MVAR). Kondensatorët përmbajnë sasi të vogël vaji dhe në trupin e tyre ka pak pika lidhëse, kështu që ata nuk kanë krijuar ndotje mjedisi përreth tyre. Sidoqoftë, këta kondensatorë duhen konsideruar si burime të mundshme ndotjeje dhe duhet pasur kujdes në marrjen e masave parandaluese për ndikimin e tyre në mjedis.

Plani i Veprimit

1. Të hartohet dhe të zbatohet një rregullore në lidhje me administrimin, trajtimin, monitorimin, heqjen nga përdorimi dhe eliminimin e vajit e të pajisjeve të ndotura me PCB;
2. Të hartohet dhe të zbatohet një udhëzues i brendshëm i KESH-it për administrimin, trajtimin dhe heqjen nga përdorimi të transformatorëve të ndotur me PCB;
3. Të trajnohen punonjësit përgjegjës për trajtimin dhe mirëmbajtjen e transformatorëve;
4. Krijimi i kapaciteteve laboratorike për kryerjen e analizave për praninë e PCB-ve në vajrat e transformatorëve;
5. Zbatimi i veprimtarive për rritjen e ndërgjegjësimit të publikut, puna e të cilëve lidhet me praninë e PCB-ve;
6. Rehabilitimi gradual i vendeve të ndotura me PCB;
7. Eliminimi i vajit mineral të ndotur me PCB
8. Hartimi dhe zbatimi i një programi kombëtar për monitorimin e PCB-ve.

NOQ-të e Prodhuara Jo-Qëllimisht

NOQ-të e prodhuar në mënyrë të paqëllimshme, siç përcaktohet në Konventën e Stokholmit, janë dibenzofuranet e polikloruara (PCDF) dhe dibenzo-p-dioksinat e polikloruara (PCDD), si dhe bifenilet e polikloruara (PCB), ku PCB-të janë formuar si nënprodukte. Dibenzofuranet e polikloruara (PCDF) dhe dibenzo-p-dioksinat e polikloruara (PCDD) janë ndotësit mjedisor të zbuluar në pothuajse të gjithë komponentët e ekosistemit të globit në sasi gjurmësh. Përbërës të kësaj klase në veçanti kanë shkaktuar probleme kryesore mjedisore.

Dioksinat janë ndër kimikatat më toksike të njohura nga njeriu. Helmime akute shkaktohen rrallëherë, por dioksinat, janë të qëndrueshme dhe bio-akumulojnë te njeriu. Si pasojë, efektet kronike janë problemi kryesor. 90% e PCDD dhe PCDF merren nga njeriu nëpërmjet zinxhirit ushqimor. Rrugë të tjera të rëndësishme të ekspozimit mund të jenë thithja nëpërmjet frymëmarrjes ose gëlltita e grimcave të ndotura.

Shkarkimi i PCDD/PCDF në Shqipëri për vitin 2004

Kategoritë e burimeve	Shkarkimi vjetor, g TEQ/vit				
	Ajri	Uji	Toka	Produkte	Mbetje
Djegia e mbeturinave spitalore	14	0	0	0	0.070
Prodhimi i metaleve ferore dhe jo ferore	0.935	0	2.91	0	0
Prodhimi i energjisë dhe ngrohja	0.000563	0	0	0	0.000111
Prodhimi i mineraleve	0.2577	0	0.150	0	0.00045
Transporti	0.3304245	0	0	0	0
Proceset e pakontrolluara të djegies	43.154463	0	0.0065204	0	0
Kimikate dhe materiale për konsum	0	0	0	0	0
Të ndryshme	0	0	0	0	0
Vend-depozitimet e mbeturinave	0	57.52910	0	0	0
Gjithsej	58.6781505	57.5291	3.0665204	0	0.070561

PCDD/PCDF, në krahasim me kimikatet e tjera NOQ, si pesticidet e polikloruara, (p.sh. DDT), asnjëherë nuk prodhohen në mënyrë të qëllimshme. NOQ-të aksidentale, formohen nga nënproduktet e aktiviteteve të shumta industriale dhe më shumë nga proceset e djegies.

Të gjitha format e djegies, industriale dhe shtëpiake, mund të çlirojnë dioksina në qoftë se klori është i pranishëm, qoftë edhe në sasi të vogla (gjurmë).

Inventari i parë i NOQ-ve të prodhuara në mënyrë të paqëllimshme në Shqipëri është bërë në kuadrin e projektit të NOQ-ve dhe në përputhje me Manualin e UNEP për identifikimin dhe vlerësimin sasior të dioksinave dhe furaneve.

Sipas inventarit, janë 9 kategori burimeve të NOQ-ve të paqëllimshme. Në tabelë jepen sasi të PCDD/PCDF-ve të çliuara në Shqipëri nga secila kategori burimesh, për vitin 2004. Vihet re se djegia e pakontrolluar e plehrave qytetëse është burimi kryesor i shkarkimeve në ajër duke zënë rreth 73.54% të totalit. Djegia e mbeturinave spitalore, është burimi tjetër i madh i shkarkimeve, duke kontribuar me rreth 23.8% të totalit kombëtar. Kontributi i kategorive të tjera mbetet i parëndësishëm.

Kategoria e proceseve të djegieve të pakontrolluara të plehrave qytetëse, në mënyrë spontane ose të qëllimshme, në mjedis të hapur është edhe kontribuesi kryesor për shkarkimet në ujë të PCDD/PCDF, duke zënë pothuajse 100 % të shkarkimeve. Gjatë vitit 2004, në Shqipëri mesatarja e prodhimit të mbeturinave urbane në Shqipëri ishte 410.922 ton, nga të cilat rreth 43.000 ton janë djegur.

Sistemi i administrimit të mbeturinave urbane në Shqipëri është i dobët dhe jo i financuar sa duhet për të realizuar një administrim të mirë mjedisor të tyre. Sistemet e grumbullimit, transportit dhe depozitimit nuk kanë burime financiare të mjaftueshme dhe nuk janë ngritur ende vend-depozitime sanitare. Mbeturinat urbane shkarkohen në damba të hapura, të papërshtatshme për një administrim mjedisor.

Mbeturinat nuk ndahen në grupe të ndryshme përpara depozitimit përfundimtar. Për më tepër, grumbullimi i pjesshëm i tyre, ka çuar në djegien e mbeturinave në oborret e shtëpive dhe në rrugë (madje edhe në kazanë) me qëllim zvogëlimin e vëllimit. Gjithashtu, djegiet e pakontrolluara bëhen për të mbledhur më lehtë mbeturina që gjejnë treg shitjeje, si p.sh. mbetjet metalike. Veprime të tilla kryhen edhe në sheshet e depozitimit të mbeturinave (që janë vend-depozitime të pakontrolluara).

Janë ndërmarrë disa hapa të parë për të rregulluar situatën, në kuadrin e Strategjisë së Administrimit të Mbeturinave të Ngurta Urbane në Shqipëri, 1997. Kjo strategji përfshin edhe një Plan Veprimi i cili trajton forcimin e kapaciteteve institucionale, legjislacionin, investimet dhe aktivitete të tjera ndërgjegjëse. Një nga rezultatet është miratimi i ligjit për largimin publik të mbeturinave dhe i ligjit për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta. Gjithashtu, në vitin 2005 filluan disa iniciativa të vogla për riciklimin dhe përzgjedhjen e mbeturinave urbane. Aktualisht riciklohen 4% e metaleve, 2% e plastikave dhe 1% letrës.

Problemet përparësore

- Kuadri ligjor dhe institucional i pamjaftueshëm për të kontrolluar në mënyrë të efektshme çlirimin e NOQ-ve të prodhuar në mënyrë të paqëllimshme;
- Sistem i dobët i administrimit të mbeturinave (sistem administrimi i papërshtatshëm dhe djegie e pakontrolluar e mbeturinave)
- Depozitimi i papërshtatshëm i mbeturinave spitalore.
- Nivel i ulët ndërgjegjësimi për rrezikshmërinë lidhur me çlirimin e paqëllimshëm nga aktorët kryesorë dhe publiku në përgjithësi.

Objektivat

- Përmirësimi i legjislacionit për parandalimin e ndotjes industriale, e cili duhet harmonizuar plotësisht me legjislacionin e Bashkimit European;
- Sigurimi i efektshmërisë së ligjit dhe të rregullave që lidhen me parandalimin e ndotjes industriale dhe administrimin e mbeturinave;
- Forcimi i kapaciteteve teknike dhe institucionale si dhe i infrastrukturës mjedisore për administrimin e mbeturinave, duke përfshirë dhe ato spitalore;
- Zbatimi i efektshëm i strategjisë së monitorimit dhe vlerësimit për parandalimin dhe reduktimin e shkarkimeve që prodhojnë aksidentalisht nënprodukte NOQ;
- Zbatimi i një programi të efektshëm ndërgjegjëses për një administrim mjedisor të shëndetshëm të mbeturinave.

Plani i Veprimit

- 1 Kompletimi i legjislacionit dhe i akteve normative që lidhen me kontrollin dhe parandalimin e ndotjeve industriale, si dhe me administrimin e mbeturinave;
- 2 Forcimi i kapaciteteve (njerëzore dhe teknike) për institucionet përgjegjëse për administrimin e mbeturinave (në veçanti administrimi i vend-depozitimeve dhe parandalimi i djegies në mjedis të hapur);
- 3 Zhvillimi politikave dhe veprimeve zbatuese për pakësimin e shkarkimeve të dioksinave nga administrimi i mbeturinave;
- 4 Futja e TMM & PMM në sektorin industrial;
- 5 Zhvillimi dhe implementimi në shkallë të gjerë, në të gjithë vendin, i administrimit të mbeturinave mjekësore duke minimizuar kështu shkarkimet e paqëllimshme të NOQ-ve;
- 6 Rritja e ndërgjegjësimit të publikut të gjerë për praktikën e pastrës së administrimit të mbeturinave.
- 7 Riverifikim i rregullt i inventarit të shkarkimeve.

Stoqet e Mbeturinave të NOQ-ve dhe Vendet e Ndotura me to (SMVN)

Vendet e mbuluara nga kjo kategori (që mund të konsiderohen edhe si hot-spote) ndryshojnë nga nëntë kategoritë e tjera sepse përbëjnë një mundësi burim-ndotjeje për të ardhmen. Sipas përcaktimit, SMVN -të mund të jenë vende të prodhimit të mëparshëm ose të tanishëm të produkteve që shkaktojnë ndotje me dioksina (PCDD) dhe furane (PCDF). Ndotja mund të vijë nga depozitimi i produkteve, depozitimi i mbeturinave ose përdorimi i produktit a produkteve për një kohë të gjatë. Megjithëse përqendrimet e dioksinave dhe të furaneve në SMVN -të mund të jenë shumë të larta, sot shkarkimet prej tyre mund të jenë të vogla ose edhe të papërfillshme.

Klasifikimi dhe vlerësimi i SMVN -ve është bërë nisur pikërisht nga përcaktimi i mësipërm. Kështu janë inventarizuar si SMVN vendmagazinimet e kimikateve NOQ si dhe vendgrumbullimet dhe vend-depozitimet ku mund të gjenerohen NOQ si nënprodukte, siç mund të jenë vendet ku depozitohen mbetjet industriale dhe ato urbane. Po kështu janë inventarizuar si SMVN (zona të ndotura me NOQ) vendet ku aktiviteti i mundshëm i NOQ-ve mund të jetë si pasojë e prodhimit industrial, aktivitetit bujqësor ose nga mungesa e kujdesit të duhur gjatë përdorimit dhe trajtimit të vend-depozitimeve të mbeturinave.

Në Shqipëri nuk ka stoqe të NOQ-ve, me përjashtim të, ndoshta, mbetjeve të katranit në uzinën e koksit në Elbasan. Ndër aktivitetet industriale me ndikim të konsiderueshëm në ndotjen me NOQ mund të përmendim disa. Një prej tyre është uzina e sodës kaustike dhe PVC-së në Vlorë (SMVN), e cila ka prodhuar një sërë kimikatesh, përfshi edhe PVC-në. Një tjetër burim i ndotjeve të natyrës organike dhe klororganike kanë qenë fabrikat e plastmasit në Durrës dhe Lushnje dhe veçanërisht ndërmarrja kimike në Durrës, të cilat gjithashtu u mbyllën në vitet e para pas ngjarjeve të viteve 90. Po kështu, në Tiranë ndodhen dy impiante që administrohen nga KESH dhe që kryejnë përkatësisht riparimin e transformatorëve dhe rigjenerimin e vajit të transformatorëve. Të dy impiantet kanë mbi 30 vjet pune dhe teknologjia e përdorur si dhe masat për mbrojtjen e mjedisit kanë lënë shteg për ndotjen me vajra, ku nuk përjashtohet edhe ndotja me PCB, të territorit pranë dhe përreth tyre.

Edhe në sektorin e bujqësisë, për shumë vjet, janë përdorur pesticide me përmbajtje të lartë të NOQ-ve (DDT). Vlerësimi i fundit i bërë nga specialistët shqiptarë tregoi se në vend nuk ka më stoqe me pesticide të tipit të DDT-së: në vitet 2000-2002, në kuadrin e projektit PHARE, të gjitha stoqet e pesticideve që ndodheshin në magazinat e sektorëve të bujqësisë janë larguar në Gjermani ku edhe janë eliminuar më pas. Megjithëkëtë, specialistët mendojnë se ndotja e magazinave vijon të përbëjë problem serioz. Mjedisi brenda këtyre objekteve është i ndotur dhe shumë prej tyre janë edhe të dëmtuara, ndërsa një pjesë është përdorur për qëllime të tjera, pa bërë asnjë përpjekje për pastrim ose rehabilitim.

Problemet përparësore

- Legjislacioni për parandalimin e ndotjes industriale dhe administrimin e vend-depozitimeve të mbeturinave nuk është i harmonizuar plotësisht me atë të BE;
- Administrimi në praktikë i vend-depozitimeve të mbeturinave nuk kryhet në përputhje me legjislacionin ekzistues përkatës;
- Zbatim i pamjaftueshëm i legjislacionit përkatës për mbrojtjen nga ndotja;
- Kapacitete të pamjaftueshme institucionale dhe teknike në dogana, në institucionet kërkimore dhe në autoritetet e inspektimit;
- Mungesa e ekspertëve të kualifikuar për monitorimin e NOQ-ve dhe trajtimin e mbeturinave industriale;
- Ndotja e tokës dhe e ujërave nëntokësore për shkak të djegies së mbeturinave në vend-depozitimet urbane;
- Mungesa e mjeteve (laboratorë dhe njësi kontrolli) për zbatimin e legjislacionit në lidhje me kontrollin dhe parandalimin e ndotjes dhe administrimin e mbeturinave duke respektuar kërkesat mjedisore;
- Ndotja e ajrit, tokës dhe mbase edhe e ujërave nëntokësore në rajonet e Porto Romanos dhe të ish-uzinës së sodës kaustike dhe PVC-së në Vlorë për shkak të gjendjes në ato rajone të depozitimeve dhe mbetjeve të përbërje të kloruara;

- Ndotja e ajrit, tokës dhe mbase edhe e ujërave nëntokësore në territorin pranë dhe përreth uzinës kokso-kimike të ish-kombinatit metalurgjik në Elbasan;
- Ndotja e ajrit, tokës dhe mbase edhe e ujërave nëntokësore në territorin e repartit të imprenjimit të lëndës drusore në ish-kombinatit të drurit në Elbasan;
- Ndotja e tokës dhe eventualisht e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore në uzinat e riparimit të transformatorëve dhe rigjenerimit të vajit të transformatorëve në Tiranë;
- Ndotja e tokës në mjediset rreth ish-magazinave të pesticideve që kanë punuar në sistemin e bujqësisë;
- Ndërgjegjësimi shumë i pakët në mjaft grupe të popullatës për rrezikun që mbart çlirimi në mjedis i NOQ-ve;

Objektivat

- Përmirësimi i praktikave shqiptare të administrimit të zonave të ndotura;
- Forcimi i kapaciteteve institucionale të autoriteteve vendore për administrimin e mbeturinave, duke respektuar kërkesat mjedisore;
- Rritja e kapaciteteve për depozitimin dhe monitorimin e mbeturinave industriale;
- Forcimi i kapaciteteve institucionale dhe teknike në dogana, në institucionet kërkimore dhe në autoritetet inspektuese;
- Studimi i nivelit të ndotjes me NOQ të zonave të ndotura;
- Rehabilitimi gradual i zonave të ndotura;
- Përgatitja dhe zbatimi i programeve efektive të sensibilizimit lidhur me administrimin e mbeturinave duke respektuar kërkesat mjedisore;

Plani i Veprimit

- 1 Forcimi i kapaciteteve për administrimin e NOQ-ve në:
 - (a) institucionet përgjegjëse qendrore dhe vendore (doganat, qendrat kërkimore, inspektorati i mjedisit dhe agjencitë rajonale të mjedisit),
 - (b) institucionet përgjegjëse për analizat e monitorimit dhe
 - (c) institucionet përgjegjëse për administrimin e mbeturinave duke respektuar kërkesat mjedisore;
- 2 Studimi i terrenit dhe zhvillimi i planeve rehabilituese për zonat potencialisht të ndotura me NOQ;
- 3 Studime në terren, marrje kampionësh dhe analizimi i tyre, përcaktimi i përparësive, përpunimi i të dhënave dhe vlerësimi i kostos për projektet e rehabilitimit të zonave të ndotura.

Ndërgjegjësimi dhe Informimi

Gjendja në Shqipëri

Grupe të veçanta të popullsisë në Shqipëri kanë nivele të ndryshme të informimit dhe ndërgjegjësimin për çështjen e NOQ-ve. Në përgjithësi, publiku e di se përdorimi i pesticideve shoqërohet me rreziqe, por nuk di pothuajse asgjë për ndikimet konkrete të grupit të kimikateve të NOQ-ve dhe të secilit kimikat në veçanti, dhe as se si veprojnë ato te organizmat e gjalla. Informimi dhe ndërgjegjësimi i publikut për NOQ-të është ende i mangët në këtë mënyrë. Ekziston një fushë e gjerë veprimi (përgatitja e fletëpalosjeve, filmave dokumentarë dhe publikimi i spoteve publicitar për NOQ-të), e cila do të kishte ndikim të fuqishëm te informimi/ndërgjegjësimi të publikut.

Problemet përparësore

- Nivel i ulët i informacionit dhe ndërgjegjësimit, të të gjithë grupet e popullatës për NOQ-të;
- Nivel i ulët ndërgjegjësimi për pasojat në shëndet dhe mjedis nga keqadministrimi i vend-depozitimeve të mbetjeve urbane;
- Nivel i ulët ndërgjegjësimi për NOQ-t të subjektet e interesuara të sektorëve publik dhe privat.

Objektivat

- Rritja e ndërgjegjësimit për NOQ-të të të gjithë subjektet e interesuara dhe publiku i gjerë.

Plani i Veprimit

- 1 Rritja e informimit dhe ndërgjegjësimit të komuniteteve që janë të prekur nga ndotja me NOQ, duke i informuar për efektin e tyre në shëndetin e njeriut dhe në mjedis;
- 2 Rritja e informimit dhe ndërgjegjësimit të publikut në përgjithësi lidhur me ndikimin e NOQ-ve në shëndetin e njerëzve dhe mjedisin;
- 3 Rritja e kapaciteteve të OJF-ve mjedisore, për ndërgjegjësimin e publikut dhe shpërndarjen e informacionit mjedisor për NOQ-të në media dhe me mjetet e tjera sensibilizuese;

Inventarizimi i shpërndarjes së NOQ-ve në Shqipëri ka treguar se këto kimikate janë të pranishme në një sasi të rrezikshme vetëm në disa zona të veçanta të vendit. Do të ishte mjaft i efektshëm një program fushatash publike për informimin dhe ndërgjegjësimin e publikut të veçantë të këtyre zonave.

Monitorimi, Raportimi, Shkëmbimi i Informacionit dhe Kërkimi shkencor

Në Programin e monitorimit të elementeve dhe faktorëve të mjedisit (VKM Nr. 103, dt. 31.3.2002) nuk është parashikuar monitorimi i NOQ-ve në përgjithësi ose i kimikateve të veçanta që bëjnë pjesë në grupin e NOQ-ve. Kërkesat e Konventës së Stokholmit dhe situata e konstatuar mbas kryerjes së inventarit paraprak të NOQ-ve në Shqipëri, diktojnë domosdoshmërinë e programimit të masave ligjore, institucionale dhe teknike për të realizuar monitorimin e NOQ-ve.

Në Planet e Veprimit për kategoritë e ndryshme të NOQ-ve janë parashikuar edhe masat përkatëse që lidhen me monitorimin, kryesisht në ato mjedise që konsiderohen të kontaminuara nga përdorimi ose depozitimi i NOQ-ve, siç janë: DDT, lindani, HCH, PCB, dioksinat dhe furanet. Ky monitorim do të mbulojë vendet ku janë depozituar këto kimikate, territoret pranë tyre, ujërat sipërfaqësore, nëntokësore dhe ajrin përreth, kafshët shtëpiake pranë këtyre territoreve të ndotura, si dhe komunitetet e njerëzve që jetojnë aty pranë. Shtrirja e zbatimit të programit të monitorimit për NOQ-të do të përditësohet duke shtuar ose hequr zona a mjedise dhe kimikate NOQ, në varësi të rezultateve të monitorimit.

Spektri i monitorimit është i gjerë dhe përfshin analiza kimike në mjedise dhe denduri të ndryshme. Një ndërmarrje e tillë, pa dyshim, kërkon kapacitetet e nevojshme profesionale si edhe bazë materiale, në përputhje me nivelin e cilësisë së analizave dhe të dyja së bashku kanë nevojë për mbështetjen e duhur financiare për sigurimin e aparaturave, trajnimin e stafëve përkatës dhe mbulimin e kostove që kërkon programi i monitorimit të NOQ-ve. Shqipëria ka mundësi të kufizuar financiare për t'i përmbushur me forcat e veta të gjitha kërkesat që do të kërkojë realizimi i programit të monitorimit, prandaj do të jetë e nevojshme edhe mbështetja e donatorëve.

Për ta bërë sa më të efektshëm përdorimin e burimeve njerëzore dhe financiare, në këtë fushë janë të domosdoshme studimet dhe kërkimet shkencore. Tani për tani, kapacitetet e kërkimit për të gjitha aspektet që lidhen me inventarët e shkarkime të NOQ-ve dhe teknologjitë për pakësimin ose eliminimin e tyre janë të kufizuara. Janë kryer vetëm disa studime sporadike në Fakultetin e

Shkencave të Natyrës në Universitetin e Tiranës, në Institutin e Shëndetit Publik pranë Ministrisë së Shëndetësisë, ECAT Tirana dhe UNEP lidhur me përmbajtjen e PCB-ve në Lagunën e Karavastasë dhe në territoret e ndotura të ish-uzinës ku prodhohej HCH/lindani përpara vitit 1990, si dhe në qumështin e gjirit të nënave në po këtë zonë.

Teknologjitë më të Mira të Disponueshme si dhe Praktikrat më të Mira Mjedisore, janë ende shumë pak të njohura në komunitet e ndër specialistët që punojnë në institutet kërkimore dhe ndërmarrjet prodhuese.

Në të ardhmen, mbi bazën e të dhënave të monitorimit dhe të inventarëve përkatës e të plotë të kimikateve NOQ, si dhe të zonave të ndotura, të cilat janë përshkruar në Planet e Veprimit të aktiviteteve përkatëse, do të planifikohen dhe kryhen studime e projekte për të eliminuar praninë e tyre në territorin e Shqipërisë dhe rehabilitimin e zonave të ndotura nga NOQ-të. Vënia në jetë e këtyre projekteve do të bëhet në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga Konventa e Stokholmit dhe ato që do të përcaktojë Plani Kombëtar për NOQ-të. Autoriteti qendror për mbrojtjen e mjedisit në Shqipëri në bashkëpunim me ministrinë përkatëse, do të duhet të bashkërendojnë edhe punën kërkimore dhe monitoruese në nivel vendi.

Qëllimi kryesor strategjik i shkëmbimit të informacionit është që të mundësojë shkëmbimin e informacionit për prodhimin, përdorimin dhe çlirimin e përbërjeve të NOQ-ve, duke përfshirë informacionin për vetitë e tyre të dëmshme dhe për kostot sociale e financiare që mund të sjellin.

Palët në Konventën e Stokholmit mund ta shkëmbejnë këtë informacion me kontakte të drejtpërdrejta mes tyre ose nëpërmjet Sekretariatit të Konventës. Për këtë qëllim duhet përcaktuar një pikë fokale kombëtare, e cila të veprojë si ndërlidhës ndërmjet Konventës dhe të gjitha palëve të interesuara, që do të marrin pjesë në shkëmbimin e informacionit në nivel ndërkombëtar dhe lokal.

Strategjia për shkëmbimin e informacionit do të mbështetet në:

- shkëmbimin e informacionit ndërkombëtar, dhe
- shkëmbimin e informacionit kombëtar.

Shkëmbimi i informacionit ndërkombëtar përmbledh informacionin ndërmjet shteteve palë të Konventës, organizatave ndërkombëtare dhe forumeve. Shkëmbimi i informacionit në nivel kombëtar do të bëhet në kohën e duhur ndërmjet të gjitha palëve të interesuara për problemet e NOQ-ve (ministrinë, agjencitë, OJF-të, shoqatat profesionale, etj.).

Pikë Fokale për Konventën e Stokholmit është Ministria e Mjedisit, e Pyjeve dhe e Administrimit të Ujërave. Ajo do të luajë rolin e pikës qendrore të aktivitetit për shkëmbimin e informacionit, si dhe do të jetë përgjegjëse për zbatimin e këtij programi, për çështjet administrative dhe problemet teknike. Për këtë qëllim, pranë kësaj ministrie do të ngrihet Zyra e Regjistrimit të Kimikateve, e cila do të mbulojë edhe problematikën e Ndotësve Organikë të Qëndrueshëm.

Veprimtaritë dhe mjetet e nevojshme financiare për realizimin e PKV-së

Buxheti total i nevojshëm për zbatimin e PKV parashikohet të jetë 2.367.005.000 lekë i ndarë si më poshtë:

1.329.095.000 lekë për periudhën afat-shkurtër 2007-2009

918.740.000 lekë për periudhën afat-mesme 2010-2015

119.170.000lekë për periudhën afat-gjatë 2016-2027

Në tabelën e mëposhtme jepet në mënyrë të përmbledhur buxheti i nevojshëm për veprimtaritë kryesore që parashikon Plani Kombëtar i Veprimit.

I.	Masat për Forcimin e Kuadrit Institucional dhe Rregullator	Buxheti afat-shkurter. 000/Lekë	Buxheti afat-mesem 000/Lekë	Buxheti afat-gjate 000/Lekë	Buxheti total 000/Lekë
	1. Përfshirja e monitorimit të NOQ-ve dhe në veçanti të PCB-ve si pjesë e Progrmit Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit	4.900	---	---	4.900
	2. Regjistrimi i pajisjeve dhe i vajrave me përmbajtje të PCB-ve në sektorin elektrik	2.000	---	---	2.000
	3. Përafrimi i legjislacionit me atë të BE-së	20.100	30.840	---	50.940
	4. Ngritja dhe funksionimi i strukturës kombëtare për zbatimin e Konventës së Stokholmit	4.150	3.900	7.150	15.200
	Totali I	31.150	34.740	7.150	73.040
II.	Pesticidet NOQ (përfshirë DDT-n)				
	1. Përgatitja e një amendamenti të VKM për monitorimin për shtrirjen e këtij të fundit edhe në pesticidet NOQ	---	---	---	Është përfshirë në I.1
	2. Kryerja e analizave për nivelet e pranishme të mbetjeve të pesticideve NOQ në ish depot dhe vendet e ndotura, duke përfshirë edhe vlerësimin e rrezikut	10.250	2.000	---	12.250
	3. Forcimi i kapacitetit njerëzor dhe teknik i laboratorit analitik në IMB	24.200	---	---	24.200
	4. Përgatitja e planit të veprimit për reabilitimin e vendeve të kontaminuara me pesticide NOQ	---	1.000	---	1.000
	Totali II	34.450	3.000	---	37.450
III.	PCB-të dhe Paisjet që Përmbajnë PCB				
	1. Të hartohet dhe të zbatohet një rregullore në lidhje me administrimin, trajtimin, monitorimin, heqjen nga përdorimi dhe eliminimin e vajit e të pajisjeve të ndotura me PCB	---	---	---	Është përfshirë në I.4
	2. Të hartohet dhe të zbatohet një udhëzues i brendshëm i KESH-it për administrimin, trajtimin dhe heqjen nga përdorimi të transformatorëve të ndotur me PCB	2.190	1.100	250	3.540
	3. Të trajnohen punonjësit përgjegjës për trajtimin dhe mirëmbajtjen e transformatorëve	1.330	780	---	2.110

	4. Krijimi i kapaciteteve laboratorike për kryerjen e analizave për praninë e PCB-ve në vajrat e transformatorëve	6.970	---	---	6.970
	5. Rehabilitimi gradual i vendeve të ndotura me PCB	12.640	73.960	55.180	141.780
	6. Eliminimi i vajit mineral të ndotur me PCB	7480	46.640	32.910	87.030
	7. Hartimi dhe zbatimi i një programi kombëtar për monitorimin e PCB-ve	1.145	6.710	6.650	14.505
	Totali III	31.755	129.190	94.990	255.935
IV.	Nënproduktet NOQ të Prodhuara në Mënyrë Jo të Qëllimshme				
	1. Kompletimi i legjislacionit dhe i rregulloreve që lidhen me kontrollin dhe parandalimin e ndotjeve industriale, si dhe me administrimin e mbeturinave	---	---	---	Është përfshirë në I.4
	2. Forcimi i kapaciteteve (njerëzore dhe teknike) për institucionet përgjegjëse për administrimin e mbeturinave (në veçanti administrimi i venddepozitimeve dhe parandalimi i djegies në mjedis të hapur mbetjeve të ngurta urbane)	33.500	---	---	33.500
	3. Zhvillimi politikave dhe veprimeve zbatuese për pakësimin e shkarkimeve të dioksinave nga administrimin i mbeturinave	985.000	427.500	---	1.412.500
	4. Futja e Teknikave Me të Mira (TMM) & Praktikave më të Mira Mjedisore (PMM) në sektorin industrial	38.000	50.000	---	88.000
	5. Zhvillimi dhe implementimi në shkallë të gjerë, në të gjithë vëndin, i administrimit mjdisor të mbeturinave mjekësore duke minimizuar kështu shkarkimet e paqëllimshme të NOQ-ve	67.000	220.000	---	287.000
	6. Përditësimi sistematik i inventarit të shkarkimeve	600	300	---	900
	Totali IV	1.124.100	697.800	---	1.821.900
V.	Mbeturinat dhe Zonat e Kontaminuara				
	1. Forcimi i kapaciteteve për administrimin e NOQ-ve	31.950	15.930	---	47.880
	2. Studimi i terrenit, përcaktimi i prioritetëve, hartimi i projekteve rehabilituese për zonat potencialisht të ndotura me NOQ	67.300	22.000	---	89.300
	Totali V	99.250	37.930	---	137.180

VI.	Ndërgjegjësimi Publik, Informimi, Shpërndarja e Informacionit, Trajnimi dhe Zhvillimi				
	1. Rritja e informimit dhe ndërgjegjësimin në komunitetet ku janë prezente NOQ-et, duke i sensibilizuar mbi efektet e tyre në shëndetin e njeriut dhe në mjedis	4.100	7.500	2.400	14.000
	2. Rritja e kapaciteteve të OJF-ve mjedisore, për ndërgjegjësimin e publikut dhe shpërndarjen e informacionit mjedisor	1.800	3.600	6.600	12.000
	3. Angazhimi i OJF-ve në shpërndarjen e informacionit, sensibilizimin dhe fushatat ndërgjegjëses	2.490	4.980	8.030	15.500
	Totali VI	8.390	16.080	17.030	41.500
	TOTALI I PËRGJITHSHËM	1.329.095	918.740	119.170	2.367.005

Lista shpjeguese e shkurtimeve

AKM	Agjencia Kombëtare e Mjedisit
AMQM	Administrim Mjedisor i Qëndrueshëm i Mbeturinave
AQM	Administrim i Qëndrueshëm Mjedisor
AQM	Administrim i Qëndrueshëm Mjedisor
ARM	Agjenci Rajonale e Mjedisit
BB	Banka Botërore
BSH	Buxheti Shtetit
BERZH	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
g TEQ/vit	gram toksik ekuivalent/vit
GEF/FMG	Fondi për Mjedisin Global
GK	Gas-Kromatografi
HC	Hidrocentral
HCB	Heksaklorbenzen
IM	Instituti i Mjedisit
IMB	Instituti i Mbrojtjes së Bimëve
INSTAT	Instituti i Statistikës
ISHM	Inspektorati Shtetëror i Mjedisit
ISHP	Instituti i Shëndetit Publik
IT	Instituti i Tokave
KD	Komiteti Drejtues
KEKBE/UNECE	Komisioni Ekonomik për Evropën e Kombeve të Bashkuara
KESH	Korporata Elektroenergjetike Shqiptare
KM	Komuniteti i Biznesit
KOF/VOC	Përbërje Organike Flurore
KP	Konferenca e Palëve
LQU	Laboratori Qendror i Ushtrisë
M&VN	Mbeturina dhe Vende të Ndotura

MB	Ministria e Brendshme
MBUMK	Ministria e Bujqësisë, e Ushqimit dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit
METE	Ministria e Ekonomisë, e Tregtisë dhe e Energjetikës
MF	Ministria e Financave
MM	Ministria e Mbrojtjes
MMPAU	Ministria e Mjedisit, e Pyjeve dhe e Administrimit të Ujërave
MPPTT	Ministria e Punëve Publike, e Transportit dhe e Telekomunikacionit
MSAA	Marrëveshja e Stabilizim-Asocimit me BE
MSH	Ministria e Shëndetësisë
MTKRS	Ministria e Turizmit, e Kulturës, e Rinisë dhe e Sporteve
NA	Nuk Aplikohet
NjAM/NjMM	Njësia e Administrimit Mjedisor
NjZP	Njësia e Zbatimit të Projektit
NKD	Ndërmarrja Kimike, Durrës
NOQ	Ndotës Organikë të Qëndrueshëm
PKPL	Plan Kombëtar i Përafrimit të Legjislacionit
NVM	Ndërmarrje të Vogla e të Mesme
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetësisë
OJQ	Organizata Jo-Qeveritare
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
OST	Operatori i Sistemit të Transmetimit
OUB	Organizata e Ushqimit dhe e Bujqësisë
PCB	Bifenile të Polikloruara
PCDD	Dibenzo-para-dioksina të Polikloruara
PCDF	Dibenzofurane të Polikloruara
PCP	Pentaklorfenol
PKBM/UNEP	Programi për Mjedisin e Kombeve të Bashkuara
UNDP	Programi për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara
PKIN/IPPC	Parandalimi dhe Kontrolli i Integruar i Ndotjes

PKV NOQ	Plani Kombëtar i Veprimit për NOQ-të
PKVM	Plani Kombëtar i Veprimit për Mjedisin i Shqipërisë
PNjP	Pëlqim i Njoftuar Paraprakisht
ppm	pjesë për milion
PV	Pushteti Vendor
QSH	Qeveria e Shqipërisë
SAM	Sisteme të Administrimit Mjedisor
SD	Spektori i Doganave
SP	Spektori Privat
SKZHES	Strategjia Kombëtare për Zhvillim Ekonomik dhe Social
SOTSH	Sistemi Operator i Transmetimit në Shqipëri
TEC	Termo-Central
TMD/BAT	Teknikat më të Mira të Disponueshme
TMM/BEP	Teknikat më të Mira Mjedisore
VNM	Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis

1. HYRJE

Ndotësit Organikë të Qëndrueshëm

Ndotësit Organikë të Qëndrueshëm (NOQ) janë lëndë kimike të qëndrueshme në mjedis, që bio-akumulojnë nëpërmjet zinxhirit ushqimor dhe paraqesin rrezik mbasi shkaktojnë efekte të dëmshme për shëndetin e njerëzve dhe për mjedisin. Duke pasur parasysh bartjen në largësi të mëdha të këtyre lëndëve, deri në vende ku nuk janë përdorur ose nuk janë prodhuar ndonjëherë, si dhe kërcënimin për mjedisin e tërë rruzullit tokësor, bashkësia ndërkombëtare ka bërë thirrje, në raste të ndryshme, për masa të ngutshme me synim pakësimin dhe eliminimin e shkarkimit të këtyre lëndëve.

Tabela 1: Lëndët NOQ kryesore sipas PKMB

1.	Aldrin Pesticid i përdorur për mbrojtjen e bimëve bujqësore nga insektet e tokës.
2.	Klordan Pesticid i përdorur për mbrojtjen e bimëve bujqësore nga termitet.
3.	DDT Pesticid i përdorur në kulturat bujqësore për të mbajtur nën kontroll sëmundjet vektoriale. Është përdorur në trupat ushtarake gjatë Luftës së Dytë Botërore për të luftuar malarien, tifon e sëmundje të tjera. Sipas vlerësimit të OBSH përdorimi i DDT ka shpëtuar jetën e 100 milion njerëzve.
4.	Dieldrin Pesticid i përdorur për të mbajtur nën kontroll insektet dhe vektorët e sëmundjeve.
5&6.	Dioksinat dhe furanet Nënprodukte industriale.
7.	Endrin Pesticid i përdorur për bimët e arave dhe për të mbajtur nën kontroll brejtësit. Është i ndaluar gjerësisht.
8.	Heksaklorbenzen (HCB) Pesticid dhe nënprodukt industrial që çlirohet gjatë prodhimit të lëndëve plastike.
9.	Heptaklor Pesticid i përdorur kundër insekteve të tokës dhe termiteve.
10.	Mireks Pesticid i përdorur kundër milingonave, termiteve, grerëzave e brumbujve të ndryshëm. Është përdorur gjithashtu si ngadalësues i zjarrit në lëndët plastike, gome, bojëra, letër e artikuj elektrikë.
11.	Bifenile të Polikloruara (PCB) Kimikat industrial i përdorur në lëngjet e shkëmbimit të nxehtësisë, përbërësit shtesë të bojërave, letrën kopjuese pa karbon, plastike dhe në zbatime të tjera të ndryshme industriale. Çlirohet si nënprodukt.
12.	Toksafen Pesticid i përdorur për pambukun, drithërat, frutat, arrat e perimet, si dhe për të mbajtur nën kontroll këpushat dhe akaricidet e imta në blegtori.

NOQ-të mund të gjenden kudo. Transformatorët elektrikë mund të përmbajnë PCB. Dioksinat, furanet dhe NOQ të tjera krijohen gjatë prodhimit të letrës, të lëndëve plastike vinilike që përdoren për lodra, veshje, thasë, gypa, veshje dyshemesh e anësore. Kur vinili shkrumbëzohet ose digjet me zjarr në vend të hapur, sërish formohen dioksina. Ato formohen edhe gjatë prodhimit të disa metaleve. Pesticidet NOQ janë përdorur kudo në botë. Megjithatë NOQ-të nuk shpërbëhen me lehtësi, si dhe mund të zhvendosen me mijëra kilometra (duke i bashkëngjitur lëndëve të ngurta të imëta, ose përmes zinxhirit ushqimor), ato mund të gjenden në tokë, liqene, lumenj, peshq, kafshë, si dhe njerëz, edhe shumë kohë pas përdorimit të tyre.

Ndotja e organizmit të njeriut me NOQ ka shkaktuar shfaqjen e disa prireve alarmuese për shëndetin e njerëzve gjatë këtyre dekadave të fundit. Ka pasur rritje të shpejtë të kancereve të gjoksit dhe shumë studime flasin për rritje të theksuar të çrregullimeve të organeve riprodhuese. Studime të tjera të shumta kanë konfirmuar toksicitetin e NOQ-ve të ndryshme për njerëzit. Po ashtu, shkencëtarët pranojnë se NOQ-të mund t'i shkaktojnë këto probleme shëndetësore të kafshët që përdoren zakonisht për të parashikuar risqet për njerëzit. Dioksina pranohet botërisht si një lëndë e njohur kancerogjene për njerëzit.

Programi Global i Veprimit për Mbrojtjen e Mjedisit Detar nga Veprimtaritë e zhvilluara në Tokë, i vitit 1995, si dhe Protokoli i NOQ-ve i vitit 1998 për Konventën e KEKBE lidhur me Ndotjen Ndër-kufitare në L largësi të Mëdha, janë miratuar në përgjigje të kësaj gjendjeje serioze. Ndër të parat që trajtoi administrimin e lëndëve toksike qe Konventa e Bazelit "Për kontrollin e lëvizjes ndër-kufitare të mbeturinave të rrezikshme dhe eliminimin e tyre", që më pas u plotësua nga Konventa e Roterdamit "Për pëlqimin e njoftuar paraprakisht (PNjP)".

Kur u bë e qartë se NOQ-të e përmendura ishin vdekjeprurëse dhe se duheshin marrë masa të ngutshme në të gjithë botën, Këshilli Ekzekutiv i PKBM krijoi një Komitet Negociues Ndër-qeveritar (KNN) që të përgatiste një instrument ligjor ndërkombëtar detyrues, i cili do të "përcaktonte rrugën për një të ardhme pa NOQ të rrezikshme". Rezultat i përpjekjeve të KNN-së është Konventa e Stokholmit "Për ndotësit organikë të qëndrueshëm".

Konventa e Stokholmit

Konventa e Stokholmit është një traktat global për mbrojtjen e shëndetit të njerëzve dhe të mjedisit nga ndotësit organikë të qëndrueshëm. Konventa u pranua më 22 maj 2001 në Konferencën e Plotfuqishme për Konventën e Stokholmit lidhur me Ndotësit Organikë të Qëndrueshëm, të mbajtur në Stokholm më 22-23 maj 2001. Konventa e Stokholmi për Ndotësit Organikë të Qëndrueshëm hyri në fuqi më 17 maj 2004, sipas Nenit 26 të saj.

Shqipëria e nënshkroi Konventën më 5 dhjetor 2001 dhe e ka ratifikuar atë më 4 tetor 2004.

Objekti i përgjithshëm i Konventës së Stokholmit është që të mbrojë shëndetin e njerëzve dhe mjedisin nga NOQ-të. Ajo i referohet në mënyrë të posaçme parimit të parandalimit, sikurse është parashtruar nga Deklarata e Rios për Mjedisin dhe Zhvillimin.

Konventa e Stokholmit u paraqet Palëve nënshkruese objektivat e saj, parimet dhe elementet që duhen përdorur për të përgatitur programe të gjithanshme dhe regjime kontrolli lidhur me NOQ-të. Ajo është e strukturuar për të trajtuar NOQ-të që: a) prodhohen qëllimisht, si p.sh. pesticidet dhe PCB-të; dhe b) prodhohen e shkarkohen jo-qëllimisht si rezultat i veprimtarive njerëzore, ku përfshihen dioksinat, furanet, PCB-të dhe HCB. Të nëntë kimikatet e renditura në Aneksin A të Konventës ndalohen të prodhohen e të përdoren, përveç rastit kur ka përjashtime të posaçme. Përveç kësaj, kufizohet rreptësisht prodhimi e përdorimi i DDT-së, një pesticid që ende përdoret në shumë vende në zhvillim, kundër malaries dhe për të mbajtur nën kontroll sëmundje të tjera vektoriale, sikurse parashtrohet në Aneksin B të Konventës. Importi dhe eksporti i të dhjetë NOQ-ve të prodhuara qëllimisht është i lejueshëm vetëm për qëllime të eliminimit të sigurt mjedisor në kushte të kufizuara.

Në Konventën e Stokholmit ka dispozita të veçanta për Palët, në lidhje me shqyrtimin e kimikateve ekzistuese për sa u përket karakteristikave të tyre si NOQ si dhe për të marrë masa rregullatore me synim që të parandalohet zhvillimi, prodhimi dhe marketingu i substancave të reja me karakteristika si NOQ.

Çlirimi i nënprodukteve të prodhuara jo-qëllimisht, të renditura në Aneksin C, është çështje minimizimi të vazhdueshëm, duke pasur si objektiv eliminimin përfundimtar të tyre atje ku është e mundur. Dispozita më të rrepta kontrolli lidhur me nënproduktet parashikojnë që Palët të nxitin dhe në përputhje me planet e tyre të veprimit të kërkojnë përdorimin e teknikave më të mira të mundshme (TMM) për minimizimin e shkarkimeve nga kategoritë kryesore të burimeve.

Konventa parasheh gjithashtu përcaktimin dhe administrimin e sigurt të stokeve që përmbajnë ose përbëhen nga NOQ-të.

Konventa e NOQ-ve u kërkon palëve që të hartojnë plane pune ku të përcaktohet si do të plotësojnë detyrimet që shtrihen Konventa. Planet e veprimit duhet t'i paraqiten Konferencës së Palëve brenda dy vjetëve pas hyrjes në fuqi të Konventës. Përveç kësaj, Konventa përmban një varg detyrimesh që Palët duhet ose nxiten të ndërmarrin, duke përfshirë përcaktimin e pikave fokale kombëtare, kujdesin për shkëmbimin e informacionit, dhënien e ndihmës teknike, zhvillimin dhe lehtësimin e ndërgjegjësimit të publikut e të pjesëmarrjes së tij, konsultimin dhe edukimin, nxitjen e kërkimit shkencor e të monitorimit, si edhe raportimin "në intervale periodikë".

Projekti i PKV për NOQ-të

Në detyrimet që rrjedhin nga qenia palë në Konventën e Stokholmit (neni 7 i Konventës), bën pjesë edhe përgatitja e Planit Kombëtar të Veprimit (PKV) për Heqjen nga Përdorimi dhe Eliminimin e NOQ-ve. PKV ka si qëllim të përcaktojë kuadrin ligjor dhe institucional dhe veprimet që duhet të programohen dhe zbatohen për heqjen nga përdorimi dhe eliminimin e NOQ-ve.

Në vitin 2002 Ministria e Mjedisit i kërkoi GEF-it, nëpërmjet UNDP, përkrahje financiare për projektin që do të mundësonte hartimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Heqjen nga Përdorimi dhe Eliminimin e NOQ-ve. Kontributi i GEF-it për këtë qëllim ishte 347,000 USD ndërsa Qeveria Shqiptare kontribuoi me 31,400 USD. Agjenci Ekzekutuese e projektit është MMPAU, ndërsa Agjenci zbatuese UNDP.

PKV synon të nxisë, të ndihmojë dhe të mbështesë autoritetet qendrore dhe vendore, subjektet shtetërore e private, për të trajtuar në mënyrë të përshtatshme dhe në përputhje me kërkesat e konventës; NOQ-të, pajisjet që i mbajnë ato, si dhe territoret e ndotura prej tyre.

Politika për NOQ-të, e cila është pjesë integrale e politikës për administrimin e kimikateve të rrezikshme, kërkon zbatimin me konsekuence të masave mbrojtëse e parandaluese për ruajtjen e shëndetit të njeriut dhe të mjedisit në Republikën e Shqipërisë, mbi bazën e një kuadri të plotë ligjor dhe institucional, të harmonizuar me kërkesat e Konventës së Stokholmit dhe me Direktivat e Bashkimit Evropian.

Në këtë kontekst përgatitja e PKV-së është në përputhje me objektivat e Planit Kombëtar të Veprimit për Mbrojtjen e Mjedisit të miratuar nga Këshilli i Ministrave në vitin 2002, një prej synimeve të të cilit është "zbutja dhe parandalimi i problemeve mjedisore"

Procesi i përgatitjes së PKV-së, është bazuar në Udhëzimet e Fondit për Mjedisin Global lidhur me Konventën e Stokholmit¹

Procesi i përgatitjes së PKV-së kalon nëpër pesë stade kryesore:

- Hapi 1: Përcaktimi i mekanizmit të koordinimit dhe organizimi i procesit;
- Hapi 2: Hartimi i inventarit të NOQ-ve dhe vlerësimi i infrastrukturës dhe i kapaciteteve kombëtare;
- Hapi 3: Vendosja e përparësive dhe caktimi i objektivave;
- Hapi 4: Formulimi i Planit Kombëtar të Veprimit dhe i Planeve të veçanta të veprimit për NOQ-të;
- Hapi 5: Miratimi i PKV nga palët e përfshira.

Për të ndjekur ecurinë e hartimit të PKV u ngrit Komiteti Drejtues i Projektit, i përbërë nga përfaqësues të sektorëve ekonomikë, veprimtaria e të cilëve është e lidhur me përdorimin ose shkarkimin në mjedis të NOQ-ve si dhe përfaqësues të OJF-ve. Komiteti Drejtues është drejtuar nga Ministri i Mjedisit, i Pyjeve dhe i Administrimit të Ujërave.

Realizimi i aktiviteteve të parashikuara në udhëzimet e GEF-it dhe që lidhen me përgatitjen e inventarit të NOQ-ve, vendosjen e përparësive, përcaktimin e objektivave dhe hartimin e

¹ Initial Guidelines for Enabling Activities for the Stockholm Convention on Persistent Organic Pollutants, May 2001

Planeve Sektoriale të Veprimit, kërkonte angazhimin e specialistëve të fushave përkatëse. Për këtë qëllim u ngritën Grupet e Punës sipas problematikës që shtronte procesi i përgatitjes së këtij plani:

- a. Kuadri ligjor dhe institucional
- b. Ndërgjegjësimi i publikut
- c. Zhvillimi social dhe ekonomik
- d. Pesticidet NOQ në sistemin e bujqësisë
- e. Pesticidet NOQ në sistemin e shëndetësisë
- f. NOQ në sistemin e mbrojtjes
- g. PCB-të në sistemin energjetik
- h. NOQ-të e paqëllimshme
- i. Zonat e ndotura dhe mbeturinat me përmbajtje NOQ

Grupet e Punës bënë për herë të parë inventarin paraprak të NOQ-ve në nivel vendi dhe mbi këtë bazë identifikuan problemet për t'u trajtuar dhe zgjidhur në kuadrin e PKV, në përputhje me politikën e Qeverisë Shqiptare për mbrojtjen e mjedisit si dhe me kërkesat e Konventës së Stokholmit e të Bashkimit Evropian për heqjen nga përdorimi dhe eliminimin e NOQ-ve.

PKV duhet të jetë një dokument dinamik, i cili kërkon jo vetëm angazhimin në procesin e zbatimit të tij të institucioneve e organizatave qendrore dhe vendore, publike dhe private, por edhe një monitorim e vlerësim të kujdesshëm dhe, mbi këtë bazë, përditësimin e tij, për të qenë vazhdimisht koherent me zhvillimet ekonomike, sociale dhe mjedisore të vendit dhe, në një kontekst më të gjerë, me zhvillimet ndërkombëtare që kanë në qendër të vëmendjes mbrojtjen e mjedisit e të shëndetit të njerëzve.

2. TË DHËNA BAZË TË VENDIT

2.1 Profili i Vendit

2.1.1 Pozita Gjeografia dhe Kushtet Natyrore

Shqipëria gjendet në pjesën perëndimore të Gadishullit të Ballkanit, në brigjet lindore të deteve Adriatik dhe Jon. Territori i saj ndodhet midis koordinatave 42°39' (*Vermosh*) e 39°38' (*Konispol*) të gjerësisë gjeografike veriore dhe 21°4' (*Vernik*) e 19°16' (*ishulli i Sazanit*) të gjatësisë gjeografike lindore. Brenda kufijve të sotëm politikë, të caktuar në Konferencën e Ambasadorëve të mbajtur në Londër në vitin 1913, Republika e Shqipërisë, me shtrirje 335 km nga veriu në jug dhe 150 km nga lindja në perëndim, ka një *sipërfaqe prej 28.748 km²*. Gjatësia e kufirit shtetëror të Shqipërisë është 1094 km, nga i cili 657 km janë kufij tokësorë, 316 km kufij detarë, 48 km kufij lumorë dhe 72 km kufij liqenorë. Në veri, Shqipëria ka kufij të përbashkët me Malin e Zi dhe Kosovën, në lindje me Maqedoninë, ndërsa në jug e juglindje kufizohet me Greqinë.

Shqipëria ndodhet në kryqëzim të rrugëve të rëndësishme tokësore, detare dhe ajrore që lidhin Perëndimin me Lindjen. Dalja e gjerë në detet Adriatik e Jon dhe, nëpërmjet tyre, në detin Mesdhe është një faktor shumë i rëndësishëm për lidhjet e gjithanshme me botën, të cilat ndihmojnë në zhvillimin ekonomik të vendit. Brigjet shqiptare të Adriatikut ndodhen vetëm 72 km larg atyre italiane. Pozita gjeografike mundëson përfshirjen e Shqipërisë në itinerare të rëndësishme turistike mesdhetare dhe europiane. Në aspektin *strategjik*, Shqipëria kontrollon kanalin e Otrantos, që është porta kryesore hyrëse në Adriatik.

Fig. 1. Harta e Shqipërisë



Territori i Shqipërisë bën pjesë në trevën mesdhetare me *reliev me kontraste të mëdha hipsometrike dhe shumë të copëtuar*, prandaj relievi përbën komponentin bazë të peizazhit gjeografik të saj. Amplituda hipsometrike është *mbi 2700m*. Sipas të dhënave të hartës *hipsometrike*, 6727 km² ose 23,4% e territorit të Shqipërisë gjenden në lartësinë deri në 200m mbi nivelin e detit; 24,6% në lartësinë 200,1-600m; 23,5 % në lartësitë 600,1-1000m. Në lartësitë 1000,1-1500m ndodhet rreth 20,4% e territorit; në lartësitë 1500-2000m ndodhet 7,1%; ndërsa vetëm 1% e territorit ndodhet në lartësitë mbi 2000m. Në Shqipëri mbizotërojnë lartësitë mesatare (600-1000 m), të cilat zënë 48,1% territorin. Relievi tepër i copëtuar dhe me pjerrësi të konsiderueshme të shpateve kanë kushtëzuar përhapjen e terreneve të degraduara. Relievi i Shqipërisë, në aspektin *morfografik* është i larmishëm. Në të dallohen qartë fushat (Ultësira Perëndimore, Fusha e Korçës, etj.), luginat e lumenjve, kodrat (në lindje të Ultësirës Perëndimore) dhe malet. Dinamika aktuale e modelimit të relievit (proceset erozivo-denuduese) është intensive. Shtresa mesatare e gërryer arrin në 0,7 mm në vit, ndërsa maksimalja 6-7 mm.

Shqipëria ndodhet pothuajse midis Ekuatorit dhe Polin të Veriut, në zonën me *klimë mesdhetare subtropikale*, shumë të përshtatshme për jetën dhe aktivitetin ekonomiko-shoqëror të njeriut. Në territorin e Shqipërisë dallohen qartësisht të katër stinët e vitit: pranvera relativisht e freskët dhe e lagësht, vera e nxehtë dhe shumë e thatë, vjeshta më e ngrohtë se pranvera dhe gjysma e parë e saj në përgjithësi e thatë, dimri i lagësht dhe i butë në perëndim e në pjesët e ulëta, ndërsa në brendësi e sidomos në lartësi i ftohtë. Pasuritë e mëdha klimaterike të Shqipërisë shprehen në larminë e theksuar, burimet termike dhe pluviometrike.

Temperatura mesatare vjetore lëkundet nga 7,5°C në veri, në 17-18°C në jug (*Rivierë*), Maksimumet absolute të temperaturës ndryshojnë nga rreth 30°C (*në rajonet e brendshme dhe të larta malore*) në 43,9°C (*në Kuçovë*). Minimumet absolute të

temperaturave lëkundën nga -2°C deri -3°C (në Rivierë) deri në $-25,8^{\circ}\text{C}$ në Sheqeras te Korçës. Ngrica janë të pranishme nga 2 ditë deri në rreth 140 ditë në vit.

Në Shqipëri bien mesatarisht 1480mm *reshje* në vit. Ato janë përqendruar kryesisht gjatë gjysmës së ftohtë të vitit (60-80% e sasisë), ndërsa gjatë verës bien 3-14% të reshjeve vjetore. *Thatësira* që përbën një dukuri të qëndrueshme të klimës, në Rivierë zgjat mbi 3 muaj. Karakteri "tekanjor" i klimës shfaqet si në regjimin termik edhe në atë pluviometrik. Në rajonet e brendshme më të larta të vendit *bora* është e pranishme mbi 100 ditë në vit. *Lagështira relative e ajrit* në Shqipëri gjatë muajit korrik merr vlerat nga rreth 40-50% (mesatarja në orën 14.00). Vlerat më të larta ajo i arrin gjatë muajit janar (60-75%).

Shqipëria ka *pasuri ujore* të mëdha, të cilat shprehen në dendësinë ($1,7 \text{ km/km}^2$) dhe gjatësinë (mbi 49.000 km) e rrjetit hidrografik, i cili çon në det çdo vit mesatarisht 41 km^3 ujë, d.m.th. rreth 1,4 milion m^3 për çdo km^2 dhe rreth 14 mijë m^3 për çdo banor. Por, krahas zonave shumë të pasura me ujë si: Alpet Shqiptare, Malësia Pukë-Mirditë etj., ka edhe zona me potencial më të ulët ujqor si: pellgu ujëmbledhës i Osumit dhe ai i Devollit, Dumreja, etj. Në Shqipëri ndodhen edhe shumë *liqene natyrore* (i Shkodrës, i Ohrit, i Prespës, etj.), që përbëjnë një rezervë të rëndësishme ujore. Një pjesë e ujërave të vendit, veçanërisht ato të lumenjve Shkumbin, Fan, Gjanicë, Lanë, etj., janë të ndotura për shkak të derdhjes në to të mbetjeve industriale. Megjithatë një pjesë e këtyre ujërave përdoret në sektorin e ekonomisë bujqësore, është e domosdoshme që përpara përdorimit të trajtohen në stacione të posaçme pastrimi.

Rreth 75% të territorit i zënë *tokat* e kafenjta dhe të hinjta kafe. Tokat moçalore shtrihen në ish-kënetat e ëmbla (Maliq, Tërbuf, etj.). Tokat e kripura shtrihen në ish-kënetat e kripura dhe gjatë brezit bregdetar. Reaksioni i tokave ndryshon, në përgjithësi, nga reaksioni acid në dy brezat e lartësive të mëdha, në neutral dhe në bazik në dy brezat e lartësive të vogla. Gjithashtu përmbajtja e humusit zvogëlohet nga tokat e lartësive (rreth 25%) në ato të zonave më të ulëta (3-6%).

Territori i Shqipërisë gjendet në brezin e bimëve mesdhetare dhe pjesërisht të Evropës së Mesme. Shqipëria ndodhet në jug të kufirit të rritjes së hardhisë, ndërsa një pjesë e mirë e territorit të saj përfshihet në zonën e rritjes së ullirit.


Shqipëria ka një mbulesë bimore mjaft të pasur dhe të përbërë nga lloje të shumta specimesh, që, të grupuara sipas vlerës së tyre mund të ndahen në: bimë për lëndë druri (*ahishtet, haloret, dushqet, etj.*); bimë për lëndë djegëse; për kullotë; bimë me rëndësi industriale; bimë medicinale, regjëse, mjaltëse, dekorative, etj. Shkurret mesdhetare mbulojnë 42% të sipërfaqes së vendit (*kryesisht në pjesën perëndimore dhe jugperëndimore*).

Fauna e Shqipërisë është e shumëllojshme dhe, në disa raste, origjinale dhe endemike. Nga *gjitarët* mishngrënës, më të përhapur janë ujku, dhelpra, çakalli dhe shqarshi, që gjenden në brezin e dushkut dhe të ahut; zardafi, kunadhja, ariu i murmë, macja e egër, nusja e lalës. Rëndësi kanë barngrënësit, si: kaprolli, dhia e egër, derri i egër, lepuri i egër, etj., që jetojnë kryesisht në pjesët e larta të vendit. *Bota e shpendëve* përbëhet nga rreth 350 lloje. Në ujërat bregdetare dhe të brendshme gjenden *shumë lloje peshqish* me rëndësi të madhe ekonomike. Gjuetia pa kriter, shpyllëzimet, tharja e kënetave dhe e lagunave, përdorimi i kimikateve në bujqësi, ndotja e tokës, ujit dhe ajrit nga mbetjet industriale, etj., e kanë dëmtuar botën shtazore të vendit.

2.1.2 Karakteristika të Përgjithshme të Popullsisë

Në vitin 1989 Shqipëria kishte 3.182.417 banorë, ndërsa në vitin 2001 rreth 3.069.275 banorë. Deri në vitin 1990, rritja e popullsisë ka qenë vetëm rezultat i shtimit natyror. Pas këtij viti në numrin e popullsisë dhe në proceset e tjera demografike ka ndikuar sidomos emigracioni. Rreth 0,6 milion persona (shumica meshkuj dhe në moshë të re) kanë emigruar nga Shqipëria gjatë periudhës 1989-2001.

Fig. 2: Dinamika e numrit të popullsisë në periudhën 1923-2001.



Lindshmëria në vitin 1990 ishte 25,1%, ndërsa në vitin 2000 ra në 16,5%. Vdekshmëria, duke filluar nga viti 1950, ka rënë nga 15% në 5,5% në vitin 2000. Vdekshmëria foshnjore është ende e lartë, krahasuar me pjesën tjetër të Europës (4,6 herë më e lartë se në Greqinë fqinje dhe 1,7 herë më e lartë se në Bullgari). Nëse ritmi i rritjes vjetore të popullsisë në shkallë vendi për 25 vitet e ardhshme do të jetë rreth 1,1% (në kushtet e pakësimit të ritmeve të emigracionit), në vitin 2025 Shqipëria do të ketë rreth 4,4 milionë banorë.

Gati 30% e popullsisë së vendit (v. 2001) është përqendruar në rrethet Tiranë, Durrës, Elbasan; më se 20,1% në rrethet Fier, Vlorë, Lushnjë dhe Berat; 6% në rrethin e Shkodrës dhe 4,6% në rrethin e Korçës. Në Ulëtisrën Perëndimore është përqendruar më shumë se gjysma e popullsisë së vendit (55,26%). Meqenëse lëvizjet e brendshme migruese në drejtim të këtij rajoni do të vazhdojnë, pritet që në vitin 2025 në zonën Tiranë-Durrës të përqendrohet rreth 25% e popullsisë së vendit (rreth 1,125,000 banorë), ndërsa në zonën bregdetare mbi 60% e popullsisë (rreth 2.7 milion banorë).

Popullsia e Shqipërisë ka moshën mesatare më të re në Europë (29 vjeç) dhe jetëgjatësi të krahasueshme me atë të popullsisë të vendeve të zhvilluara: 71,5 vjet për meshkujt dhe 78,1 vjet për femrat.

Popullsia e Shqipërisë është homogjene. Nga viti 1960 deri në vitin 1990 shqiptarët etnikë përbënin 97% të popullsisë, pjesën tjetër e përbënin grekët (1,85%), maqedonët (0,15%), malazezët, etj. Pas vitit 1990 struktura etnike e Shqipërisë ka ndryshuar paksa pasi një pjesë e madhe e të huajve (sidomos pakica greke) është kthyer në vendet e origjinës. Kështu, në vitin 2001, struktura etnike e Shqipërisë ishte: 98% shqiptarë, 1,8% grekë, 0,1% maqedonë, 0,1% të tjerë (INSTAT, Tiranë 2004).

Gjuhë zyrtare në Shqipëri është shqipja, por në zonat ku jetojnë pakicat etnike mësohen dhe fliten edhe gjuhët përkatëse (greqisht dhe maqedonisht).

Shqipëria ka një sistem arsimor të plotë. Arsimi tetëvjeçar (nëntëvjeçar, duke filluar nga viti shkollor 2004-2005) është i detyrueshëm. Rreth 80% e fëmijëve që mbarojnë shkollën tetëvjeçare ndjekin shkollat e mesme të përgjithshme ose profesionale, ndërsa numri i studenteve që mund të vazhdojnë universitetet është i paracaktuar dhe pranimi bëhet me konkurs. Në universitetet dhe në shkollat e larta të vendit përgatiten specialistë në rreth 75 fusha. Gjithashtu funksionon sistemi i kualifikimit dhe i specializimit pasuniversitar.

Tabela 2: Treguesit kryesorë të arsimit sipas regjistrimit të vitit 2001

	NUMRI			PËRQINDJA	
	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra
Popullsia banuese 6 vjeç e lart	2,737,614	1,358,924	1,378,690	49.6	50.4
Të diplomuar në universitete	134,110	78,947	55,163	58.9	41.1
Të diplomuar në shko. e mesme	594,913	318,229	276,684	53.5	46.5
Të dip. në shk. e mesme të ulëta	1,050,714	514,821	535,893	49.0	51.0
Të dip. në shk. tetëvjeçare	509,825	246,489	263,336	48.3	51.7
Dinë vetëm shkrim e këndim	404,561	183,509	221,052	45.4	54.6
Analfabetë	43,491	16,929	26,562	38.9	61.1
Përqindja e analfabetizmit	1.6	1.2	1.9		

Burimi: INSTAT, Regjistrimi i popullsisë dhe i banesave, 2001.

Përveç shkollës tetëvjeçare, për të gjitha nivelet e tjera të shkollimit, numri i meshkujve që ka mbaruar shkollën paraqitet pak më i lartë se i femrave. Në vitin 2001 analfabetë kishte më pak se 2%.

Në vitin 2001, rezulton 63,2% e popullsisë së vendit në moshë pune (15-64 vjeç). Popullsia aktive përbën 44% të popullsisë gjithsej të Shqipërisë.

Shkalla e papunësisë në vitin 2001 ishte 22,7% e krahut të punës gjithsej. Papunësia paraqitet më e lartë në personat që kanë përfunduar shkollën e mesme (26,4%) në krahasim me ata që kanë kryer shkollën tetëvjeçare (22,4%). Nga personat me diplomë universitare të papunë janë vetëm 9,5%. Në vitin 2001, 77,3% e krahut të punës rezulton e zënë me punë. Meshkujt vazhdojnë të kenë pjesëmarrje më të gjerë në punë se femrat.

Shumica e popullsisë së zënë me punë është ende e përqendruar në bujqësi: 50,5% të të punësuarve gjithsej. Në ndërtim dhe transport është punësuar 12,7%, në tregti 11,6%, ndërsa në industria 7,1%.

Tabela 3: Gjendja ekonomike e popullsisë në moshë pune në vitin 1989 dhe 2001

Popullsia Aktive					Popullsia Jo-Aktive
Gjithsej	Krahë pune	Të punësuar	Të punësuar	% e popullsisë	
1989	1,599,766	1,443,167	156,599	9.8	517,254
2001	1,347,281	1,041,775	305,506	22.7	823,156

Burimi: INSTAT, Regjistrimi i popullsisë dhe i banesave, 2001.

2.1.3 Organizimi Politik dhe Administrativ

Ndryshimet në formën e qeverisjes të bëra në vitin 1991 i dhanë jetë një Republike Parlamentare. Sipas Kushtetutës së vitit 1998, pushteti legjislativ i takon Kuvendit Popullor (Parlamentit) me 140 deputetë të zgjedhur për 4 vjet. Ky organ zgjedh presidentin e Republikës që ka mandat 5 vjeçar dhe të drejtë rizgjedhjeje edhe për një mandat tjetër.

Në Kushtetutën e vitit 1998, qeverisja vendore është konceptuar si vetëqeverisje. Ky parim u jep mundësi organeve të vetëqeverisjes vendore që të rregullojnë e menaxhojnë vetë, sipas kompetencave e përgjegjësi të tyre, çështjet më të rëndësishme publike, në interes të popullsisë dhe të subjekteve të zonës përkatëse.

Sipas ligjit “Mbi funksionimin dhe organizimin e qeverisjes vendore” (2000), organet e pushtetit vendor e ushtrojnë aktivitetin e tyre në përputhje me parimin e autonomisë, duke mbajtur lidhje me pushtetin qendror. Autonomia e organeve të qeverisjes vendore është politike, legjislative, administrative e financiare.

Organet e pushtetit vendor janë persona juridikë, që synojnë vazhdimësinë e qeverisjes nëpërmjet komunave, bashkive dhe qarqeve (prefekturave).


Organi përfaqësues i komunës ose bashkisë është këshilli komunal ose bashkiak. Organi ekzekutiv i komunës dhe bashkisë është kryetari i komunës dhe i bashkisë. Organ përfaqësues i qarkut është këshilli i qarkut. Funksionet ekzekutive në qark kryhen nga kryetari dhe kryesia e këshillit të qarkut.

Shqipëria përbëhet nga 12 prefektura (Berat, Dibër, Durrës, Elbasan, Fier, Gjirokastrë, Korçë, Kukës, Lezhë, Shkodër, Tiranë, Vlorë), 36 rrethe, 65 bashki dhe 309 komuna. Prefekturat përbëhen nga disa komuna e bashki, që kanë lidhje gjeografike, tradite (historike), ekonomike dhe sociale, si dhe interesa të përbashkëta. Nën-ndarjet e prefekturave (qarqeve) janë rrethet. Çdo rreth përbëhet nga 1 deri në 2 bashki (zakonisht qytetet kryesore) dhe mesatarisht 8 deri në 9 komuna. Çdo komunë përbëhet nga mesatarisht 9 fshatra (rrallë herë në përbërje të komunave ka edhe qytete të vogla, me më pak se 5.000 banorë). Fshatrat që ndodhen pranë qyteteve, në disa raste, janë përfshirë në përbërje të bashkive. Në bashkitë që kanë më shumë se 15.000 banorë krijohen nën-ndarjet e bashkive ose njësitë bashkiake (shih Fig. 3 Harta administrative e RSh).

Sipas ligjit të lartpërmendur, disa nga kompetencat e Këshillit të çdo komune (bashkie) janë:

- të marrë masa për mbrojtjen e ripërtëritjen e mjedisit, monumenteve me vlera historike dhe kulturore, si dhe të qarqeve dhe pasurive natyrore,
- të vendosë sipas ligjit për krijimin e shoqërive të përbashkëta me komunat e bashkitë e tjera si dhe me firmat e brendshme e të jashtme për kryerjen e veprimtarive me interes reciprok,
- të vendosë për nënshkrimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit me organe homologe të huaja, etj.

Fig. 3: Harta administrative e Republikës së Shqipërisë



2.1.4 Profilët e Sektorëve të Ekonomisë

Industritë që punojnë aktualisht në Shqipëri janë: industria agro-ushqimore, tekstile dhe e veshjeve, e drurit, e naftës, e çimentos, kimike, minerare dhe e përpunimit të metaleve, dhe ajo hidro-energjetike.

Eksportet kryesore të vendit janë në fushat e tekstileve dhe këpucëve, metaleve dhe mineraleve, naftës bruto, perimeve, frutave dhe duhanit. Bashkimi Evropian (BE) është partneri tregtar kryesor i Shqipërisë. Ai përfaqëson rreth 75% të importeve të përgjithshme të Shqipërisë (në vitin 2003, këto importe kapën vlerën 1.11 MEUR) dhe rreth 90% të eksporteve të saj të përgjithshme (në vitin 2003, 368 MEUR). Importet përfshijnë makineri dhe pajisje, ushqime, tekstile dhe kimikate. Në nivel sektorësh, BE-ja importon nga Shqipëria kryesisht prodhime të përpunuara. Tekstilet përllogariten në afërsisht 29% të importeve tregtare, ndërsa prodhimet bujqësore në rreth 12%. Eksportet kryesore të BE-së drejt Shqipërisë janë produkte industriale dhe prodhime të tjera të përpunuara. Prodhimet bujqësore zënë rreth 20% të shumës së eksporteve të BE-së.

Spektori industrial në Shqipëri vazhdon të jetë i dobët. Kontributi i tij në shtimin e përgjithshëm të PPB-së në vitin 2000 ishte 26%, i pasuar nga shërbimet me 23%. Gjatë vitit 2003 kontributi i industrisë ishte i përafërt me atë të vitit 2002 (rreth 12%-13%). Në vitin 2004, industria dhe ndërtimi zinin 20% të PPB-se kurse shërbimet u rritën në 55%. Industria vazhdon të jetë përgjithësisht e vjetruar dhe me fuqi të ulët konkurruese ndaj industrisë evropiane.

Në vitin 2003 në Shqipëri kishte 56.490 ndërmarrje të vogla dhe të mesme (SME). Sipas këtyre të dhënave, në 82,5% të këtyre ndërmarrjeve ishte i punësuar vetëm një person. Pothuaj 52% e SME-ve operojnë në sektorin e tregtisë ku pengesat e hyrjes dhe kërkesat për kapitalin investues janë të vogla. Vetëm 10% operojnë në sektorin industrial. 15% e SME-ve vazhdojnë të operojnë me administrim shtetëror. Në realitet, SME-të me administrim shtetëror zënë rreth 41% të krahut të punës të punësuar në sektorin e SME-ve. Vetëm 0,2% e SME-ve punësojnë më shumë se 100 punonjës. Që prej fillimit të tranzicionit, Shqipëria ka njohur një rritje kryesisht të vazhdueshme të numrit të SME-ve, të cilat janë bërë pjesë e rëndësishme të ekonomisë së saj. Në vitin 2003, u nënshkrua Karta Evropiane e Ndërmarrjeve të Vogla dhe një sërë aktesh normative për zhvillimin e SME-ve. Në tetor 2002 u krijua Agjencia e Nxitjes dhe Zhvillimit të Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme.

Ristrukturimi i ndërmarrjeve dhe privatizimi. Ndërsa privatizimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme ka përfunduar, privatizimi i ndërmarrjeve të mëdha ka qenë më i ngadaltë për shkak të pasigurisë politike dhe shkallës së ulët të interesit nga investitorët strategjikë.

Politika e përgjithshme e Shqipërisë është, fillimisht të rristrukturojë dhe, vetëm më pas, të privatizojë kompanitë shtetërore. Kompania elektro-energjetike KESH është ende në fazë rristrukturimi dhe një hap i parë është bërë tashmë me ndarjen e kompanisë në tri ente përgjegjëse për shpërndarjen, prodhimin dhe transmetimin. Në sektorin e naftës procesi i privatizimit të Albpetrolit (prodhimi), Armo-s (përpunimi) dhe Servkom-it (shpërndarja) është me i avancuar.

Gjatë vitit 2003, në Shqipëri janë bërë hapa drejt përmirësimit të mjedisit dhe klimës së biznesit. Agjencia Shqiptare për Nxitjen e Biznesit dhe Investimeve synon krijimin e lehtësive për investitorët, afaristët dhe informacion rreth kreditimit, nxitjen e interesave të biznesit dhe lehtësimin e dialogut mes tij dhe administratës, gjetjen e tregjeve të shpërndarjes, etj.

Shqipëria është bërë vend anëtar i OBT-së që në vitin 2000. Planet e saj lidhur me OBT-në parashikojnë liberalizim gradual të tregtisë deri në vitin 2007. Shqipëria ka nënshkruar dhe po zbaton të gjitha Marrëveshjet e Tregtisë së Lirë të parashikuara në Paktin e Stabilitetit për tregtinë.

Bujqësia

Pesha e prodhimit bujqësor në PBB ka ardhur në rënie të vazhdueshme dhe të ndjeshme nga viti 2000 (51%), në vitin 2003 (28%) kurse në vitin 2004, kontributi i sektorit në PBB ra në nivelin 25%. Më shumë se një e dyta e popullsisë në Shqipëri jeton dhe punon në fshat. Ndonëse që prej vitit 1998 tokat e kultivuara janë pakësuar, në vitin 2003 prodhimi bujqësor u rrit me afro 2 %.

Krahas investimeve publike në sistemin e ujitjes dhe të kullimit, janë rritur edhe investimet private për serat, vreshtat dhe pemët frutore. Megjithatë, të ardhurat nga bujqësia mbeten shumë të ulëta krahasuar me ato që vijnë nga punëtorët e pakualifikuar të qytetit, gjë që ka stimuluar lënien e tokës të pakultivuar dhe braktisjen e bujqësisë nga një pjesë e mirë e fuqisë punëtore të saj.

Gjatë periudhës 2002-2003, u vunë re rritje në sektorë të veçantë të bujqësisë. Agro-industria u rrit me 6%, ndërsa pjesa e investimeve të sektorit bankar në këtë fushë u rrit me 22%.

Rritja në sektorin e bujqësisë vazhdon të mbetet prioritare në planin afatmesëm. Gjithsesi, arritja e këtij objekti varet shumë nga infrastruktura dhe rrjetet e dobëta të marketingut. Edhe tregu i tokës krijon vështirësi në krijimin e ekonomive të mëdha bujqësore. Kapërcimi i këtyre vështirësive kërkon ngritjen e një sistemi kreditimi të fermerëve, përmirësimin e infrastrukturës dhe furnizimin me energji, zgjidhjen e problemit të pronësisë së tokës si dhe formim dhe transferimin e njohurive tek bujqit.

Për sa i përket **transportit**, aktualisht prioritare mbetet përfundimi i korridoreve Lindje-Perëndim (Durrës-Varna, nëpërmjet Tiranës dhe Sofjes) dhe Veri-Jug (i cili lidh Greqinë me Malin e Zi). Përveç mbështetjes ndërkombëtare, qeveria shqiptare ka akorduar fonde të buxhetit të shtetit (rreth 40 MEUR nga buxheti i vitit 2003; rreth 50 MEUR nga buxheti i vitit 2004) për sektorin e transportit, veçanërisht për të mbuluar koston e shpronësimeve për ndërtimin e rrugëve dhe mirëmbajtjen e tyre, si edhe për të financuar disa rrugë në veri të vendit. Edhe bashkëpunimi rajonal po zgjerohet nëpërmjet zhvillimit të Rrjetit të Transportit Rajonal të Evropës Juglindore.

Me synim privatizimin e portit të Durrësit janë marrë disa masa, si përmirësimi gradual i infrastrukturave portuale, rikonstruksioni i kalatave, rehabilitimi i vinçave dhe ndërtimi i një terminali të ri për tragetet. Gjithashtu, janë në proces edhe masa për rehabilitimin e portit të Vlorës. Në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës, është ndërtuar një terminal i ri dhe janë marrë masa në drejtim të përmirësimit të kontrollit të hapësirës ajrore dhe rritjes së sigurisë së aeroportit.

Lidhur me **administrimin dhe infrastrukturën e ujërave**, në vitin 2003 u miratua Strategjia Kombëtare për Furnizimin dhe Pastrimin e Ujërave dhe Strategjia Rurale e Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve. Megjithatë, zbatimi i tyre akoma është në një fazë fillestare dhe rezultatet ende s'janë të dukshme. Furnizimi me ujë në të gjithë vendin është i pamjaftueshëm, ndonëse furnizimi me ujë të rrjedhshëm në banesa është përmirësuar (9 orë në ditë mesatarisht në fshat, dhe mbi 12 orë në ditë në qytet). Rreth 80 % e popullsisë që jeton në qytet është e lidhur me rrjetin e ujit, por në përgjithësi, sistemet e furnizimit dhe pastrimit të ujit janë të vjetruara. Cilësia e ujit është e dobët dhe humbjet dhe lidhjet e paligjshme në rrjet janë të shpeshta. Vetëm rreth 40 % e popullsisë në qytet është e lidhur me kanalizimet e ujërave të zeza dhe trajtimi i tyre, me gjithë masat e marra për financimin e një morie impiantesh trajtimi të ujërave të zeza në disa qytete, kryesisht bregdetare, vazhdon të jetë pothuaj inekzistent. Janë në proces decentralizimi dhe privatizimi në këtë sektor.

Në **sektorin e energjisë**, vazhdojnë përpjekjet për zbutjen graduale të efekteve të krizës energjetike. Si rezultat i një sërë faktorësh (kushtet më të mira atmosferike dhe situata më e favorshme hidrike, zbatimi me sukses i Planit të Veprimit 2002-2003 dhe angazhimit të qeverisë shqiptare dhe të donatorëve në drejtim të rehabilitimit të sistemit të shpërndarjes dhe transmetimit) në vitin 2003 u vu re një përmirësim relativ: sasia e energjisë së prodhuar u rrit me 56 % më shumë se në vitin 2002, kurse grumbullimi i detyrimeve u rrit nga rreth 57 MEUR në vitin 2000, në rreth 152 MEUR në 2003. Në vitin 2003 u miratua ligji i ri për integrimin e Shqipërisë në tregun rajonal të energjisë, u miratua Strategjia afatgjatë Kombëtare për Energjinë dhe Plani i Veprimit 2003-2005. Çmimet e energjisë elektrike u rritën me 10% në vit për konsumatorët familjarë dhe 5% për konsumatorët e tjerë. Këto rritje janë rezultat i përpjekjeve për t'i sjellë çmimet afër kostos, në bazë edhe të politikës së qeverisë.

Janë aktualisht në proces një numër investimesh për rehabilitimin e burimeve kryesore gjeneruese të vendit, përmirësimin e koneksionit të Shqipërisë me vendet fqinje dhe rindërtimin e rrjeteve të vjetruara dhe të mbingarkuara të transmetimit dhe shpërndarjes. Megjithatë, rezultatet në drejtim të përdorimit të burimeve energjetike alternative (për shembull gazi i lëngëzuar nga nafta) dhe promovimit të diversifikimit të energjisë mbeten akoma të kufizuara.

Në vitin 2003, Këshilli i Rregullimit të Territorit të Republikës së Shqipërisë (KRRTRSH) miratoi vendkalimin e propozuar të naftës-jellësit transballkanik ndërmjet Ambo Burgas (Bullgari) dhe Vlorës (Shqipëri). Shqipëria nënshkroi Memorandumin e Mirëkuptimit të Athinës të vitit 2003 dhe është angazhuar për ngritjen e një tregu konkurrues të energjisë në rajon.

Me gjithë përparimin e arritur gjatë vitit 2003, kriza në këtë sektor nuk është kapërcyer ende. Humbjet në rrjet (39 %) dhe lidhjet e paligjshme janë ende të mëdha, ndërsa niveli i mbledhjes së detyrimeve duhet rritur edhe më tej përmes zbatimit të planeve të veprimit dhe Strategjisë Kombëtare për Energjinë.

Spektori i telekomunikacioneve është përmirësuar, megjithëse zonat e largëta ende kanë probleme. Në fund të vitit 2003, numri i pajtimtarëve të Albtelekomit arriti në 222.000. Ndërkohë, rreth 25 operatorë privatë u ofrojnë shërbim rreth 12.000 përdoruesve në fshat. Numri i përdoruesve të celularëve u rrit nga 800.000 në vitin 2002, në 1.000.000 në vitin 2003. Sipas operatorëve celularë, nga ky shërbim mbulohet 80 % e territorit që përkon me 90 % të popullsisë .

Për shkak të kufizimeve të tanishme të rrjetit dhe çmimeve të larta, aksesit dhe përdorimi i internetit mbetet i ulët. Numri i pajtimtarëve të internetit është rreth 5.000, ndërsa numri i përdoruesve llogaritet në 30.000.

Spektori bankar shqiptar përbëhet aktualisht nga dy banka me kapital të përbashkët, 12 banka me kapital privat të huaj dhe dy banka private vendase. Vitet e fundit janë bere hapa për të ulur vëllimin e transaksioneve me para në dorë dhe për të nxitur përdorimin e sektorit bankar, për dhënien e pagave të nëpunësve publikë nëpërmjet bankave dhe inkurajimin për shlyerjen e faturave të energjisë elektrike dhe telefonit nëpërmjet sektorit bankar.

Vlera e PBB në vitin 2004 ishte 1,680 EUR për frymë, që përbën 8% të vlerës përkatëse në BE 25.

Rritja ekonomike e viteve te fundit ka qenë si vijon: 3.4% në 2002; 6.0 % në 2003; 6.0 % në 2004. Inflacioni ka pasur vlerën 2.4% në 2003 dhe 3.4% në 2004. Papunësia në vitin 2004 ka qenë në nivelin 14.6%.

Shqipëria ndjek Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit Ekonomik e Social, qe u prezantua në nëntor 2001. Kjo strategji synon të përmirësoje qeverisjen dhe të mbajë një ritëm të lartë rritje ekonomike, si dhe të përmirësojë situatën në arsim, shëndetësi, dhe infrastrukturë. SKZHES ka edhe një kapitull për mjedisin, ku prioritetet kryesore

janë frenimi i degradimit të mëtejshëm të mjedisit, rehabilitimi i zonave të nxehta dhe përdorimi i qëndrueshëm i burimeve. Në korrik 2002, Banka Botërore miratoi Strategjinë e Asistencës për Shqipërinë, që fokusohet në uljen e varfërisë përmes mbështetjes që i jepet vendit për zbatimin e SKZHES. Banka Botërore do të mbështesë përmirësimin e qeverisjes dhe forcimin e institucioneve, promovimin e rritjes së qëndrueshme të sektorit privat, ristrukturimin e sektorit të energjisë, përmirësimin e infrastrukturave bazë dhe nxitjen e zhvillimit njerëzor. Në kuadër të Strategjisë së re të Asistencës për Shqipërinë janë miratuar katër projekte (tre për kreditimin sektorial dhe një për Kreditim për Mbështetje për Uljen e Varfërisë) me një shumë të përgjithshme prej 61 milion dollarësh amerikanë (rreth 50 MEUR).

Sipas strategjisë për Shqipërinë të Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), fokusi i veprimtarisë së saj do të orientohet nga zhvillimi i sektorit privat dhe mbështetja për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme, si edhe pjesëmarrja në privatizimet strategjike, e veçanërisht në sektorët financiarë dhe të telekomunikacioneve, apo financimi dhe zhvillimi i infrastrukturave, sidomos në sektorët e energjisë dhe transporteve. Në fund të vitit 2003, BERZH-i i akordoi Shqipërisë financime me një vlerë më shumë se 155 MEUR.

Mbështetja e BE-së i vjen Shqipërisë kryesisht përmes programit CARDS. Asistenca e akorduar për periudhën 2001-2004 ishte 193.4 MEUR. Prioritetet kryesore të CARDS për Shqipërinë janë drejtësia dhe punët e brendshme, ngritja e kapaciteteve administrative, zhvillimi ekonomik e social, mjedisi dhe burimet natyrore (11.4 MEUR) dhe stabilizimi demokratik. Programi CARDS 2005-2006 ka akorduar 90 MEUR për Shqipërinë. Nga këto 8 MEUR do të shkojnë për mjedisin (rehabilitim fizik i mjedisit në zonat e nxehta, mbështetje për zbatimin e PKPL, etj.).

2.1.5 Vështrim Mjedisor

Shqipëria ka trashëguar nga e kaluara shumë probleme mjedisore, të cilat u thelluan më tej gjatë tranzicionit. Në Planin Kombëtar të Veprimit për Mjedisin (1994 dhe 2002) dhe në dokumente të tjera politike të vendit pasqyrohen përparësitë kryesore mjedisore të vendit që përfshijnë: erozionin e tokës, çpyllëzimet, humbjen e biodiversitetit, mbetjet urbane, ndotjen e ajrit në zonat qytetëse dhe industriale, ndotjen e tokës nga mbetjet e rrezikshme e toksike të industrisë së vjetër në të ashtuquajturat "Zona të nxehta mjedisore", etj. Këto të fundit janë trajtuar edhe në një studim të UNEP (2000) "Vlerësim mjedisor pas konfliktit". Harta në faqen vijuese tregon vendndodhjen e tyre.

Gjithashtu, janë trashëguar edhe një mori problemesh të karakterit institucional, ligjor e të edukatës dhe kulturës mjedisore. Institucionet mjedisore në Shqipëri janë të reja, të krijuara gjatë periudhës së tranzicionit. Kështu, Ministria e Mjedisit u krijua për herë të parë në shtator 2001. Pas zgjedhjeve të 3 Korrikut 2005 fokusi i saj u zgjerua dhe ajo u shndërrua në Ministri të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave. Edhe legjislati i mjedisit i takon periudhës së tranzicionit. Ligji i parë për mjedisin i përket vitit 1993. Gjatë periudhës 2001-2005 boshllëku i trashëguar ligjor është mbushur përmes një numri të konsiderueshëm aktesh ligjore dhe rregullatore, që mbështeten në modelet përkatëse të akteve të KE-së. Gjithsesi, pritet të bëhet një punë shumë e madhe në drejtim të përafrimit të legjislatit në periudhën 2005-2014. Edukata dhe kultura mjedisore e trashëguar nga periudha para viteve '90 ishte inekzistente. Gjatë 15 viteve të tranzicionit kjo situatë është kapërcyer. Ka një rritje të ndërgjegjësimit të publikut, një numër të madh OJF-sh mjedisore dhe problemet mjedisore janë gjithnjë e më të pranishme në të gjitha mjetet e komunikimit.



Fig. 4. Hartë e zonave të nxehta mjedisore në Shqipëri

Ndër dokumentet e rëndësishme politike që prekin edhe mjedisin janë:

Programi i Qeverisë 2005-2009, i cili ka një theks të veçantë mbi mjedisin. Ai deklaron se masa të shpejta do të ndërmerren për forcimin e disiplinës në zbatim të legjislacionit mjedisor. Do të zbatohet parimi "ndotësi paguan"; do të reformohet rrjeti institucional dhe do të vendosen penaltetet për ndotësit dhe këdo që dëmton mjedisin.

Një rëndësi e dorës së parë do t'i kushtohet disiplinimit të aktiviteteve ekonomike që shkaktojnë ndotje të ajrit në qytet, ndotje të ujërave bregdetare dhe të atyre sipërfaqësore si dhe atyre që dëmtojnë potencialin turistik, pyjet dhe shkaktojnë erozionin e tokës. Që gjatë periudhës 2005-2007 priten tregues të përmirësimit të cilësisë së mjedisit.

Ndotja e ajrit do të përgjysmohet në zonat e mëdha qytetëse. Standardet për shkarkimet në ajër do të përafrohen me ato europiane, sipas një programi ambicioz. Brenda vitit 2009 do të eliminohet ndotja e ujërave sipërfaqësore në zonën bregdetare.

Të gjitha zonat e nxehta të trashëguara nga industria e kaluar do të trajtohen me përparësi dhe do të pastrohen duke u shoqëruar edhe me zhvendosje të popullsisë së zbuluar ndaj rrezikut, kur kjo të gjykohej e nevojshme.

Ndërkohë që do të rritet dhe forcohet disiplina do të promovohen edhe shtysa për bizneset që kanë qëndrim miqësor ndaj mjedisit. Do të prezantohen stimuj fiskalë për uljen e ndotjes, që do të aplikohen për bizneset, konsumatorët, investimet në teknologjitë e pastra, ruajtjen e energjisë, përdorimin racional të burimeve dhe investimet në mjedis.

Do të përqafohet një qasje e re për sa i takon gjenerimit të fondeve për mjedisin. Do të ngrihet një Fond Mjedisit, i cili do t'i kushtohet tërësisht mbrojtjes së mjedisit.

- **Marrëveshja e Stabilizim Asocimit me BE-në**. Negociatat për këtë marrëveshje filluan zyrtarisht në janar të vitit 2003 dhe përfunduan në vitin 2006. Marrëveshja u nënshkrua më 12 qershor 2006. Raportet vjetore të KE-së për ecurinë e PSA, kërkojnë angazhim më të madh për luftimin e krimit të organizuar, trafikun e qenieve njerëzore, pastrimin e parave dhe korrupsionin. Në fushën e mjedisit ky raport thekson nevojën për rehabilitimin e zonave të nxehta, zbatimin e ligjit të mjedisit, sidomos të ligjit për VNM, forcimin dhe koordinimin e sistemit të monitorimit, zbatimin e Konventës së Aarhusit, etj.
- **Plani i Veprimit për Zbatimin e MSA** (2006), në të cilin, veç të tjerash, përcaktohen edhe hapat që duhen bërë gjatë periudhës 2006-2012 për transpozimin e legjislacionit të BE-së në legjislacionin mjedisor të vendit, zbatimin dhe zbatimin e tij në praktikë. Kapitulli për mjedisin në këtë dokument është strukturuar në nën-kapituj sipas modelit të *Acquis Communautaire*. Disa prej këtyre kapitujve, si ai mbi cilësinë e ajrit, mbetjet, kimikatet, ndotjen industriale, etj. janë me rëndësi të veçantë në fushën e menaxhimit të NOQ-ve. Ato janë marrë në konsideratë kur janë planifikuar masat për zbatimin e Konventës së Stokholmit në nivel kombëtar.

Ndërkohë gjatë periudhës 2000-2008 janë ndërmarrë ose janë planifikuar të merren një numër masash për rehabilitimin e zonave të nxehta:

- Me mbështetjen e Bankës Botërore është kryer një studim fizibiliteti në Porto-Romano (250,000 USD),
- Me mbështetjen e UNEP MAP është kryer një studim para-investues për zonën e nxehtë të Vlorës (300.000 USD),
- BE ka mbështetur dy projekte (2.5 MEUR) për eliminimin e solucionit të arsenikut në Fier, nga të cilët faza e parë (1 MEUR) ka konsistuar në stabilizimin e solucionit të arsenikut dhe shndërrimin e tij në mbetje të ngurtë që duhet trajtuar në një implant trajtimi mbetjesh të rrezikshme.

- Nga programi CARDS i BE-së janë siguruar dy projekte (2 MEUR) për pastrimin dhe përmirësimin mjedisor në Rafinerinë e naftës në Ballsh. Është në proces faza e parë (0.9 MEUR).
- Një projekt i dytë (0.5 MEUR) që synon të azhurnojë të dhënat për situatën mjedisore në fushën naftëmbajtëse të Patos-Marinzës do të fillojë së shpejti me mbështetjen e programit CARDS të BE-së, i cili do të pasojë “Studimin bazë për fushën naftëmbajtëse të Patos-Marinzës” që u krye në vitin 1996 me mbështetjen e programit të mëparshëm Phare të BE-së (0.15 MEUR).
- Me mbështetjen e programit CARDS të BE-së janë ndërmarrë studimi i fizibilitetit dhe projektimi inxhinierik (0.6 MEUR) për ndërtimin e një vend-depozitimi për mbeturinat e rrezikshme në Shqipëri. Edhe fazat pasuese të tij që kanë të bëjnë me ndërtimin e vend-depozitimit (3 MEUR) dhe transportin e mbeturinave të rrezikshme nga zonat e nxehta ose vendet ku ndodhen tani (3.5 MEUR) janë siguruar po nga programi CARDS i BE-së.
- Një projekt i Bankës Botërore “Administrimi i integruar i zonës bregdetare dhe programi i pastrimit”, që do të realizohet me bashkë-financimin e disa donatorëve, midis të tjerash trajton edhe situatën në Porto-Romano. Qeveria Holandeze është angazhuar për aktivitetet e pastrimit në Porto-Romano (3.66 milion USD).
- Me mbështetjen e Ambasadës së Mbretërisë së Holandës përfundoi në qershor 2006 ri-ambalazhimi i mbetjeve të kimikateve në magazinat e Bishtit të Pallës (2 milion USD). Projekti ka ndihmuar për largimin dhe eksportimin e 800 ton mbetje kimikatesh të rrezikshme nga magazinat e ish-Ndërmarrjes Kimike në Porto-Romano. Ky projekt u kujdes gjithashtu për eksportimin e 5.990 kg pesticide NOQ (DDT, lindan dhe heksakloran) që ishin raportuar si mbetje nga 6 rrethe (Lushnjë, Elbasan, Durrës, Lezhë, Gjirokastrë dhe Tiranë-Lundër). Këto pesticide ishin prodhuar nga ish-Ndërmarrja Kimike në Porto Romano për t’u përdorur në shëndetësi në kuadër të luftës kundër sëmundjeve të transmetueshme (vektoriale).
- UNDP në bashkëpunim me qeverinë e Republikës Çeke po mbështet projektin “Rehabilitimi biologjik i zonës së nxehtë të fushës naftëmbajtëse Patos-Marinzë, Shqipëri” (185,000 USD).
- Kooperimi Italian po mbështet përmirësimin e situatës në fushën e plehrave të Sharrës në Tiranë (6.4 MEUR).

2.2 Kuadri Institucional dhe Rregullator dhe kuadri i Politikave

2.2.1 Politikat për Mbrojtjen e Mjedisit / Zhvillimin e Qëndrueshëm dhe Kuadri i

Përgjithshëm Legjislativ

Gjatë 15 viteve të fundit, mjedisi dhe mbrojtja e tij i janë nënshtruar një procesi kompleks evoluimi. Deri më tani janë konkretizuar linjat kryesore të këtij procesi që kushtëzojnë edhe arritjet kryesorë, midis të cilave mund të përmenden dukuritë e mëposhtme, që kanë ndodhur për herë të parë në realitetin shqiptar:

- Formulimi i strategjive, planeve të veprimit dhe programeve për mbrojtjen e mjedisit;
- Dekretimi i një legjislacioni të ri mjedisor shqiptar;
- Krijimi dhe funksionimi i strukturave shtetërore të veçanta për mbrojtjen dhe menaxhimin e mjedisit;
- Përfshirja e shoqërisë civile në problemet mjedisore, kryesisht përmes aktivitetit të OJF-ve mjedisore;

- Përcaktimi i roleve dhe i përgjegjësi të aktorëve kryesorë në fushën e mjedisit: organeve shtetërore me strukturat përkatëse, shoqërisë civile me publikun e interesuar dhe OJF-të, biznesit dhe investitorëve të ndryshëm, etj.;
- Vendosja dhe funksionimi i një bashkërendimi në shkallë të gjerë me bashkësinë mjedisore ndërkombëtare, si me organizatat ndërkombëtare, ndërqeveritare, rajonale dhe globale dhe, në veçanti, me vendet fqinje ose ato të rajonit dhe më gjerë, etj.;
- Integrimi në nismat, planet dhe strategjitë botërore dhe rajonale, duke u bërë palë nënshkruese e konventave ndërkombëtarë mjedisore, si edhe e protokolleve apo marrëveshjeve të tjera në këtë fushë;
- Formulimi dhe zbatimi në mjedisin shqiptar i shumë projekteve të rëndësishme mjedisore të mbështetura nga donatorë të huaj, etj.;

Këto 15 vitet e fundit kanë qenë shumë produktive për Shqipërinë, sidomos për sa u takon ndryshimeve në kuadrin ligjor:

- Është miratuar kushtetuta e re;
- Janë miratuar ligje dhe kode të reja;
- Janë ratifikuar apo është aderuar në konventa të reja, me protokollet përkatëse të tyre;
- Është krijuar një bazë e gjerë zbatuese përmes akteve nënligjore, çka ka lehtësuar zbatimin e ligjeve të reja, konventave, protokolleve, direktivave të BE-së, etj.;
- Në veçanti, legjislacioni mjedisor është zgjeruar në një masë të konsiderueshme, kryesisht pas vitit 2002;
- Përmirësime të ndjeshme janë bërë në legjislacionet që rregullojnë fushat e lidhura ngushtësisht me mjedisin, si ato të bujqësisë, rregullimit të territorit, pyjeve, peshkimit, akuakulturës, etj.;
- Ka filluar të plotësohet legjislacioni për ushqimin dhe mbrojtjen e konsumatorit;
- Janë krijuar organet përkatëse përgjegjëse dhe rrjeti institucional për kontrollin e zbatueshmërisë së legjislacionit ekzistues;

Sa lidhet me legjislacionin kombëtar mjedisor, pas vitit 2002, është krijuar një bazë e fortë ligjore e cila synon mbrojtjen e shëndetit dhe të mjedisit. Tashmë janë në fuqi ligjet e mëposhtme:

- Për mbrojtjen e mjedisit;
- Për administrimin mjedisor të mbeturinave të ngurta;
- Për administrimin e mbeturinave të rrezikshme;
- Për substancat kimike dhe preparatet;
- Për mbrojtjen e bimëve;
- Për mbrojtjen e ajrit;
- Për mbrojtjen e mjedisit detar nga ndotja dhe dëmtimi;
- Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotur;
- Për vlerësimin e ndikimit në mjedis;
- Për zonat e mbrojtura;
- Për largimin publik të mbeturinave;
- Për shërbimin e kontrollit të pesticideve, etj.

Pas miratimit të akteve nënligjore në kuadër të ligjeve të sipërpërmendura, mund të pohohet që Shqipëria ka tashmë një bazë të plotë ligjore për zgjidhjen e problematikave që shtrihen nga Konventa e Stokholmit.

Legjislacioni i ri mjedisor ka synuar si më poshtë:

- Plotësimin e mangësive ligjore në fushën e mjedisit (deri në vitin 2002 ishte në fuqi vetëm ligji “Për mbrojtjen e mjedisit” i vitit 1993);
- Zhvillimin horizontal të legjislacionit mjedisor (komponentë të veçantë të mjedisit si ajri, urat, mjedisi detar, mbetjet urbane, mbetjet e rrezikshme, zonat e mbrojtura, etj., janë tashmë të mbuluara me legjislacion përkatës);
- Përfshirjen në ligjet e reja të kërkesave të konventave ndërkombëtare në të cilat është palë Republika e Shqipërisë, si edhe të direktivave europiane në fushën e mbrojtjes së mjedisit;
- Pajtueshmërinë e plotë të ligjeve për mbrojtjen e mjedisit me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, dhe harmonizimin e kërkesave të tyre me ato të ligjeve që mbulojnë fusha të lidhura me mjedisin;

Instrumentet e mëposhtme ligjore trajtojnë administrimin e NOQ-ve në Shqipëri, si pjesë e administrimit të kimikateve:

- **Ligji Nr. 8934, datë 05.09.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit”**

Kuadri kombëtar ligjor për mbrojtjen e mjedisit është zhvilluar nëpërmjet ligjit “Për mbrojtjen e mjedisit”. Ai trajton të gjitha çështjet mjedisore, të cilat karakterizojnë një akt modern europian. Në të jepen parimet kryesore, ndërsa hollësitë e tjera ligjore dhe teknike janë parashikuar përmes akteve nënligjore. Ky ligj hedh edhe bazat për zbatimin e legjislacionit të BE-së i cili kujdeset që publiku të ketë mundësi njohjeje të informacionit mjedisor, për vlerësimin e ndikimit në mjedis të strategjive, planeve dhe programeve të ndryshme të zhvillimit si edhe për vlerësimin e ndikimit në mjedis të projekteve të ndryshme. Përdorimi dhe mbrojtja e përbërësve të veçantë të mjedisit trajtohet në parim në kapitullin e tretë të ligjit, i cili merret më në hollësi me: mbrojtjen e tokës, mbrojtjen e shtresës së humusit, mbrojtjen e ujërave, mbrojtjen e ajrit, mbrojtjen e biodiversitetit, mbrojtjen e mjedisit të ndërtuar nga njeriu, administrimin e mbetjeve, detyrimet e personave juridikë për mbetjet, importimin e lëndëve dhe mbetjeve të rrezikshme, kalimin tranzit të mbetjeve, lëndët e rrezikshme dhe tarifatat dhe taksat mjedisore.

Gjithashtu, ligji përshkruan si duhet të bëhet kontrolli për zbatimin e legjislacionit për mbrojtjen e mjedisit, kush janë organet që ushtrojnë kontrollin mbi mjedisin, cilat janë detyrat dhe përgjegjësitë e organeve shtetërore të ngarkuara për mbrojtjen e mjedisit, si edhe cili është roli i publikut lidhur me mbrojtjen e mjedisit.

Legjislacioni dytësor është miratuar ose është në hartim e sipër për të gjithë përbërësit e veçantë të mjedisit të përmendur më lart.

- **Ligji Nr. 8990, datë 23.01.2003 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”**

Ky është ligji kryesor për problemet e vlerësimit të ndikimit në mjedis, i cili është trajtuar më me hollësi në aktet përkatëse nënligjore. Megjithatë është evidente një nevojë urgjente për të hartuar dhe miratuar metodikat dhe standardet konkrete në përputhje me ato europiane për subjektet, aktiviteti i të cilave sjell dëme në mjedis. Synimi në një periudhë afatmesme është të parandalohet ndotja e mjedisit përmes një procesi të kujdesshëm të vlerësimit të ndikimit në mjedis, auditimit mjedisor, ekspertizës profesionale dhe hartimit të raporteve të hollësishme mjedisore. Më konkretisht, në ligj jepen rregullat, procedurat, afatet, te drejtat dhe detyrat si më poshtë:

- Për të identifikuar, saktësuar dhe vlerësuar ndikimet e drejtpërdrejta dhe të tërthorta, të projekteve apo veprimtarive në mjedisin ku do të zbatohen;
- Për të krahasuar përparësitë dhe mangësitë e një projekti të propozuar me variante të tjera, të mundshme, që përmbajnë ndryshime;

- Për të siguruar shqyrtim cilësor teknik, profesional, juridik dhe administrativ të kërkesës dhe të marrjes së vendimit nga organet përkatëse.

Kuadri ligjor kombëtar për mbrojtjen e mjedisit është zhvilluar më tej përmes miratimit të ligjeve “Për mbrojtjen e ajrit”, “Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura”, “Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta”, “Për substancat dhe preparatet kimike” dhe ligjit “Për administrimin e mbetjeve të rrezikshme”.

- **Ligji Nr. 8897, datë 16.05.2002 “Për mbrojtjen e ajrit”**

Ky ligj identifikon burimet e ndotjes së ajrit (të palëvizshme: impiante industriale dhe energjetike; dhe të lëvizshme). Ligji kërkon edhe vendosjen e normave të lejuara (normat e cilësisë së ajrit, normat e shkarkimeve në ajër nga burimet e palëvizshme dhe të lëvizshme të ndotjes së ajrit, normat e përkohshme të shkarkimeve në ajër dhe përmbajtjen e lejuar të substancave të rrezikshme në ajër). Në mbështetje të ligjit është hartuar dhe miratuar një kuadër i plotë nënligjor. Pavarësisht nga hartimi i legjislacionit, është evident moszbatimi i tij për shkak të mungesës së pajisjeve dhe stafit teknik të specializuar për të kontrolluar normat e lejuara. Ekziston gjithashtu një nevojë e ngutshme për të trinuara subjektet ndotës të ajrit përmes projekteve pilot me qëllim që ato të mund të menaxhojnë regjistrat e shkarkimit dhe transferimit të ndotësve në ajër, të ngrenë dhe zbatojnë programet e monitorimit të ajrit, planet e emergjencës, etj. Në mënyrë më konkrete, ligji trajton:

- Burimet e ndotjes dhe klasifikimin e tyre;
- Treguesit e cilësisë së ajrit;
- Kufizimet lidhur me shkarkimet në ajër;
- Detyrimet për mbrojtjen e ajrit;
- Zonat me mbrojtje të veçantë;
- Lejet mjedisore për aktivitetet ndotëse të ajrit.

- **Ligji Nr. 9115, datë 24.07.2003 “Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura”**

Ky ligj është ligj kuadër që synon mbrojtjen e ujërave dhe kontrollin e ndotjes së tyre. Ligji është ndërtuar në mënyrë të tillë që të përcaktojë normat e përgjithshme dhe parimet e menaxhimit të ujërave në Republikën e Shqipërisë. Për më tepër, ligji është hartuar me qëllim që të kërkojë hartimin dhe miratimin e normave të lejuara të shkarkimeve në ujar dhe kriteret e zonimit të mjedisve ujore pritës. Pavarësisht nga miratimi i ligjit, ka mungesa të theksuara fondesh për ndërtimin e impianteve të trajtimit të ujërave të ndotur (si urbane ashtu edhe industriale). Nga ana tjetër, në sajë të faktit që Ministria e Mjedisit është shndërruar së fundmi në Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, ekziston një nevojë urgjente për të harmonizuar legjislacionin në fushën e burimeve ujore me atë të ujërave të ndotur dhe për më tepër për ta harmonizuar të tërën me direktivat përkatëse të BE-se në fushën e mbrojtjes së ujërave. Ligji trajton më në hollësi çështjet e mëposhtme:

- Detyrat e strukturave shtetërore për parandalimin e ndotjes së ujit dhe pakësimin e ujërave të ndotur;
- Detyrimet e personave fizikë dhe juridikë, veprimtaritë e të cilëve shkaktojnë ujar të ndotur;
- Detyrimet e subjekteve të angazhuara me veprimtarinë e trajtimit të ujërave të ndotur;
- Trajtimin e ujërave të ndotur në përputhje me llojin e tyre;
- Lejen mjedisore, monitorimin dhe kontrollin.

- **Ligji Nr. 9010, dt. 13.02.2003 “Për administrimin mjedisor të mbeturinave të ngurta”**

Ky ligj ka në qendër të vëmendjes institucionalizimin e instrumenteve që mbështesin zhvillimin e qëndrueshëm përmes promovimit të përdorimit racional të burimeve dhe parandalimit dhe eliminimit të rrezikut për shëndetin e njeriut dhe mjedisin nga mbetjet. Ligji siguron krijimin e një hierarkie detyrimesh parandaluese (minimizimi i mbetjeve që në burim deri tek asgjësimi i tyre në fazën përfundimtare). Ligji nxit parandalimin dhe pakësimin e krijimit të mbetjeve. Ai synon edhe të pakësojë efektet e rrezikshme të mbetjeve përmes futjes së teknologjive të pastra, zhvillimeve teknike dhe produkteve të reja në treg, të prodhuara nga riciklimi i mbetjeve.

Ligji u kushton vëmendje modaliteteve të administrimit mjedisor të mbetjeve në çdo fazë, ndër të cilave edhe gjatë krijimit, grumbullimit, ndarjes, ruajtjes, transportit, riciklimit, përpunimit dhe asgjësimit të tyre. Ligji trajton detyrimet e krijuesve të mbetjeve dhe zotëruesve të tyre. Është e domosdoshme që trajtimi i mbetjeve në çdo fazë të kryhet pa dëmtuar shëndetin e njeriut dhe mjedisin përreth. Ligji kërkon që administrimi i mbetjeve të kryhet në përputhje me kushtet e vëna në lejet mjedisore përkatëse dhe sipas planifikimit të përshkruar në raportet përkatëse të vlerësimit të ndikimit në mjedis. Ligji parashikon edhe detyrimin për mbajtjen e regjistrave dhe raportimin për çdo fazë të administrimit të mbetjeve të ngurta.

Sikurse edhe për ligjet e tjera specifike, ekziston një nevojë e ngutshme për të plotësuar kuadrin nënligjor përkatës. Në këtë kontekst, kohët e fundit, u përgatit dhe u miratua nga Kuvendi i Shqipërisë edhe Ligji “Për administrimin mjedisor të mbetjeve të rrezikshme”. Në vazhdim, pritet të ndërhyhet në të ardhmen e afërt për t’i shkrirë këto dy ligje me njëri tjetrin dhe për të krijuar një ligj organik për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta.

Ligji Nr. 9537, datë 18.05.2006. “Për administrimin mjedisor të mbeturinave të rrezikshme”

Ky është një ligj i ri, i cili synon mbrojtjen e shëndetit të njeriut dhe mjedisit nga ndotja dhe dëmi i shkaktuar nga mbeturinat e rrezikshme, nëpërmjet administrimit mjedisor të tyre në çdo fazë, përfshi krijimin, grumbullimin, ndarjen, ruajtjen, transportin, riciklimin, përpunimin dhe asgjësimin, të cilat çojnë në pakësimin e mbeturinave dhe zvogëlimin e ndikimeve të tyre të rrezikshme e të dëmshme. Ky është një ligj kuadër, i cili parashikon akte nënligjore specifike lidhur me mbeturinat e rrezikshme.

- **Ligji Nr. 9108, datë 17.07.2003 “Për substancat dhe preparatet kimike”**

Ligji synon rregullimin e administrimit të substancave dhe preparateve kimike për mbrojtjen e jetës, shëndetit të njerëzve e të kafshëve, si dhe për mbrojtjen e mjedisit nga rreziqet që mund të shkaktojnë lëndët e rrezikshme. Ligji përcakton të drejtat dhe detyrimet e personave fizikë dhe juridikë për përcaktimin e vetive dhe klasifikimin e substancave dhe të preparateve kimike për regjistrimin, inventarizimin, njoftimin, menaxhimin dhe tregtimin e tyre.

Veç kësaj, ligji ka në qendër të vëmendjes përcaktimin e kompetencave të zyrave të administratës për marrjen e masave për mbrojtjen e jetës dhe të shëndetit të njerëzve e të kafshëve, si dhe për mbrojtjen e mjedisit, kundër efekteve të dëmshme të substancave dhe preparateve kimike për jetën dhe shëndetin, si dhe të vendosë kompetencat e organeve eksperte të inspektimit, në përputhje me parashikimet e këtij ligji.

Duhet thënë, që veç ligjit kuadër, nuk janë ndërmarrë hapa të tjerë për hartimin e akteve nënligjore të cilat do të mundësonin zbatimin e dispozitave të këtij ligji.

- **Ligji Nr. 9362, date 24.03.2005 “Për shërbimin e mbrojtjes së bimëve”**

Ligji përcakton kërkesat ligjore për kontrollet fitosanitare në vend, mbikqyrjen kombëtare dhe inspektimet e importeve. Ai jep parimet e kontrollit fitosanitar të zbatueshëm për prodhuesit, importuesit dhe eksportuesit e bimëve dhe produkteve bimësi dhe aplikimin e masave fitosanitare kur zbulohet kontaminim nga organizmat e dëmshëm.

Nga analizat e kryera deri më tani rezulton se legjislacioni ekzistues në fushën e *biodiversitetit dhe mbrojtjes së natyrës* është një prej më të zhvilluarve. Megjithatë, puna vazhdon me hartimin dhe miratimin e kuadrit nënligjor, ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare në këtë fushë si edhe harmonizimin e direktivave përkatëse të BE-së, kryesisht të atyre që lidhen me mbrojtjen e biodiversitetit. Sikurse edhe për përbërësit e tjerë të mjedisit, edhe këtu problem mbetet zbatimi i legjislacionit.

Nga ana tjetër, përpjekjet për të zbatuar atë pjesë të legjislacionit mjedisor që lidhet me NOQ-të duhet të shkojnë paralelisht me ato që bëhen për harmonizimin e legjislacionit në fushën e kimikateve. Kohët e fundit, Qeveria Shqiptare ka miratuar Planin Kombëtar për Harmonizimin e Legjislacionit, i cili mbulon periudhat afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë, deri në vitin 2014. Tani ka përfunduar analiza e boshllëqeve, janë përcaktuar direktivat e BE-së që duhen transpozuar dhe janë krijuar programe konkrete për zbatimin e këtij plani. Kapitulli që trajton kimikatet është një prej më kryesorëve në këtë Plan Kombëtar.

2.2.2 Rolet dhe Përgjegjësitë

Në Republikën e Shqipërisë, drejtpërdrejt përgjegjëse për mbrojtjen e mjedisit dhe të shëndetit të njerëzve janë Ministria e Mjedisit, e Pyjeve dhe e Administrimit të Ujërave, Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Ministria e Shëndetësisë. Ndër detyrat e këtyre institucioneve qendrore përfshihen edhe administrimi i kimikateve toksike, i kimikateve që përdoren për mbrojtjen e bimëve dhe i mbetjeve të tyre, hartimi i legjislacionit përkatës, kontrolli dhe bashkëpunimi ndërkombëtar.

Komisioni Parlamentar i Shëndetësisë dhe Mjedisit shqyrton projekt-ligjet dhe marrëveshjet ndërkombëtare të paraqitura nga Qeveria dhe të përgatitura nga ministrinë përkatëse, përpara kalimit të tyre për miratim në Kuvend.

Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave harton strategjitë dhe politikat kombëtare në mbrojtje të mjedisit. Ajo bashkëpunon me ministrinë e linjës dhe merr në konsideratë mendimin e tyre përpara paraqitjes në qeveri për miratim të propozimeve të ndryshme. Zbatimi i legjislacionit dhe i standardeve mjedisore është detyrë e të gjithë aktorëve shtetërorë dhe joshtetërorë, si edhe e publikut. Monitorimi dhe detyrimi janë funksione të Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave.

Inspektorati i Mjedisit pranë Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave kontrollon zbatimin e legjislacionit mjedisor. Aktualisht, ky Inspektorat përbëhet nga 5 inspektorë në qendër dhe 12 inspektorë të vendosur pranë Agjencive Rajonale të Mjedisit, çka nxjerr në pah nevojën për ngritje kapacitetesh dhe shtim të personelit të kësaj strukture. Inspektorët mjedisorë kanë autoritet për të marrë dhe analizuar kampione si edhe për të kontrolluar proceset e punës, me qëllim që të sigurohen dhe kontrollojnë sa janë marrë masat në zbatim të legjislacionit për mbrojtjen e mjedisit. Ndërkohë, Inspektorati i Mjedisit ka nënshkruar një mori memorandumesh bashkëpunimi me inspektoratet e tjera në nivel kombëtar, nëpërmjet të cilave synohet fuqizimi dhe ngritja e kapaciteteve të tij gjatë ushtrimit të kontrolleve të aktiviteteve lidhur me zbatueshmërinë nga ana e tyre të legjislacionit mjedisor.

Ministria e Shëndetësisë është përgjegjëse për përgatitjen e rregulloreve për menaxhimin e lëndëve helmuese. Ajo merr pjesë edhe në menaxhimin e substancave për mbrojtjen e bimëve, në procedurat për klasifikimin e lëndëve (kimikateve të reja) që bëjnë pjesë në grupin e helmeve dhe në përfshirjen e tyre në listën e kimikateve të miratuara. Ministria e

Shëndetësisë merr pjesë edhe në kontrole përmes Inspektoratit Sanitar, ndërsa analizat kryhen nga Instituti i Shëndetit Publik, i cili është në varësi të kësaj ministrie.

Drejtorja e Përgjithshme e Doganave, në varësi të Ministrisë së Financave, është e ngarkuar me kontrollin e zbatueshmërisë së legjislacionit në fushën e tregtisë, eksportit dhe importit të mallrave. Ministria e Mjedisit, e Pyjeve dhe e Administrimit të Ujërave ka organizuar kohët e fundit një varg veprimtarish për të paraqitur legjislacionin e ri për mbrojtjen e mjedisit, seminare të cilët kanë rezultuar shumë të vlefshëm dhe me një frymë të mirë bashkëpunimi.

Për kontrollin e import/eksportit të ushqimeve, pesticideve dhe të produkteve për mbrojtjen e bimëve, janë të ngarkuar inspektorët përkatës të Inspektoratit të Ushqimit dhe të Drejtorisë së Mbrojtjes së Bimëve pranë Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit e të Mbrojtjes së Konsumatorit.

Pritet që të ngrihet së shpejti Zyra e Regjistrimit të Kimikateve, në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr. 9108, datë 17.07.2003 "Për substancat dhe preparatet kimike".

Të tjera institucione qendrore që veprojnë në fushën e kimikateve janë edhe:

- Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe e Energjetikës, e cila ka përgjegjësinë për rehabilitimin e "zonave të nxehta" mjedisore me origjinë mbetjet e rrezikshme dhe ndotjen e trashëguar nga sektorët e industrisë/energjetikës;
- Ministria e Mbrojtjes, e cila është përgjegjëse për administrimin dhe shkatërrimin e armëve kimike dhe/ose mbeturinave të krijuara prej tyre.

Në nivel lokal, veprojnë organet e qeverisjes vendore me inspektoratet përkatëse, pranë të cilave veprojnë edhe agjencitë rajonale të mjedisit dhe inspektorët e mjedisit, të cilët marrin masa për të shmangur dëmet në shëndet dhe në mjedis që mund të vijnë si pasojë e menaxhimit të kimikateve.

Bashkëpunimi ndërinstitucional organizohet përmes ngritjes dhe funksionimit të grupeve të posaçme të punës me përfaqësues të institucioneve të ndryshme për përgatitjen e projekt-ligjeve apo projekt-strategjive ose të komiteteve drejtues për projekte të tilla si Komiteti për zbatimin e Planit Kombëtar të Veprimit në Mjedis, Këshilli Kombëtar i Rregullimit të Territorit, Këshilli Kombëtar për Mbrojtjen e Natyrës dhe Biodiversitetit, Komiteti i Politikave për Turizmin, Komiteti Ndër-ministrior për Energjinë, Komisioni Shtetëror për Tokën, Grupi Koordinues për Kontrollin e Shkretëtirëzimit dhe Shkatërrimit të Tokës, etj. Një tjetër instrument për bashkëpunimin ndërinstitucional është edhe procesi i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis dhe Vlerësimi Strategjik Mjedisor. Raporte të ndryshme të Komisionit Europian kanë identifikuar nevojën për forcimin/përmirësimin e mëtejshëm të këtij bashkëpunimi/koordinimi. Zbatimi i Strategjisë Kombëtare të Mjedisit dhe qasja e re sipas Sistemit të Planifikimit të Integruar dhe të Planifikimit Afat-Mesëm pritet të sjellin rezultate më të mira në këtë drejtim.

2.2.3 Angazhimet dhe Detyrimet Përkatëse Ndërkombëtare

Tashmë është bërë e qartë se aderimi apo ratifikimi i akteve juridike ndërkombëtare ose i konventave mjedisore me protokollet shoqëruese, duhet të shoqërohet brenda një kohe të shkurtër me punën në vend për të gjetur zgjidhjet dhe mënyrat optimale për të mundësuar zbatimin e detyrimeve konkrete që lindin nga këto akte ndërkombëtare.

Një shembull i mirë është Konventa e Stokholmit për NOQ-të dhe mënyra e zgjedhur për zbatimin e detyrimeve të saj në nivel kombëtar përmes përgatitjes paraprake të Planit të Veprimit. Ky shembull dhe modeli i zgjedhur mund të përdoren edhe në rastin e konventave/protokolleve të tjera.

Ratifikimi i Konventës së Stokholmit për NOQ-të ka qenë një prej hapave në kuadër të përpjekjeve kombëtare për mbrojtjen e shëndetit dhe të mjedisit nga efektet negative të kimikateve dhe substancave të tjera si edhe i mbeturinave bashkë me mbetjet e

rrezikshme. Vendimi për të ratifikuar konventën ka ardhur pas një vlerësimi të kujdesshëm, në nivel kombëtar, i efektit pozitiv dhe mundësive që mund të hapen për vendin me zbatimin e detyrimeve të kësaj konvente. Miratimi dhe hyrja në fuqi e ligjeve si “Për mbrojtjen e mjedisit”, “Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta”, “Për substancat dhe preparatet kimike”, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, dhe të shumë akteve të tjera që bëjnë pjesë në nivelin nënligjor, kanë krijuar kuadrin e nevojshëm ligjor dhe institucional që lehtëson zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga qenia palë në këtë Konventë.

Më poshtë jepet një listë e marrëveshjeve ndërkombëtare ku është palë Republika e Shqipërisë:

Konventa e Stokholmit për Ndotësit Organikë të Qëndrueshëm, e ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë me Ligjin Nr.9263, datë 29.07.2004

Fillimisht vëmendja ndërkombëtare është përqendruar në kontrollin e vetëm 2 NOQ–ve. Këtu përfshihen pesticidet dhe kimikatet industriale të tilla si DDT dhe PCB-të, të cilat janë përdorur ose përdorën akoma edhe në Shqipëri.

Në parim Konventa kërkon:

- Të merren masa për të pakësuar/eliminuar shkarkimet nga NOQ-të e prodhuara qëllimisht ose jo;
- Regjistrimin e përjashtimeve të veçanta;
- Të merren masa për të pakësuar ose eliminuar shkarkimet nga vend-depozitimet e NOQ-ve apo edhe të mbetjeve;
- Plane zbatimi;
- Aktivitete kërkimore dhe monitorim;
- Shkëmbim eksperience dhe fushata për ndërgjegjësim dhe edukim;
- Sigurim të mjeteve financiarë dhe teknike;
- Raportim dhe vlerësim;
- Raportim të rasteve të mos-zbatimit dhe zgjidhjen e konflikteve.

Detyrimet e palëve:

Palët duhet të ndalojnë menjëherë përdorimin e pesticideve NOQ të mëposhtme: aldrin, klordan, dieldrin, endrin, heptaklor, heksaklorbenzen, mirex dhe toksafen, si edhe të kufizojnë reptësisht përdorimin e DDT. Shtojca 2 kërkon kufizimin e DDT-së sipas procedurave të përshkruara në Udhëzuesit përkatës të OBSH-së. Palët që përdorin apo prodhojnë DDT duhet të deklarohen dhe të nënshkruajnë Regjistrin përkatës të formuar për qëllime të Konventës. Për Palët e tjera, përdorimi dhe prodhimi duhet të shkojë në zero. Gjithsesi, të gjitha përjashtimet vlejnë për një kohë të caktuar e cila i nënshtrohet rishikimit;

Të kufizojnë përdorimin e PCB-ve në sisteme të mbyllura me synimin e nxjerrjes së tyre nga përdorimi dhe asgjësimin e sigurt nga pikëpamja e mjedisit brenda vitit 2025 (për pajisjet) dhe brenda vitit 2028 (për mbeturinat);

Të marrin masa për të eliminuar apo ulur shkarkimet nga NOQ-të e prodhuara vetvetiu (jo në mënyrë të qëllimshme);

Palët duhet të hartojnë planet e zbatimit të detyrimeve që rrjedhin nga qenia palë në Konventë;

Palët duhet të gjejnë mekanizmat e përshtatshëm dhe skemat funksionale për rritjen e ndërgjegjësimin dhe informimin e të interesuarve;

Palët duhet të nxisin kryerjen e studimeve kërkimore lidhur me eliminimin e sigurt të NOQ-ve dhe gjetjen e substancave alternative për zëvendësimin e tyre.

Konventa e Bazelit për Kontrollin e Lëvizjes Ndërkufitare të Mbeturinave të rrezikshme dhe asgjësimin e tyre dhe amendamenti III/1, të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë me Ligjin Nr. 9279, datë 28.10.2004

Konventa lidhet me lëvizjen ndërkufitare të mbeturinave të rrezikshme dhe asgjësimin e tyre. Konventa e Stokholmit u referohet dokumenteve udhëzuese të hartuar në kuadër të Konventës së Bazelit lidhur me asgjësimin e sigurt mjedisor të mbeturinave që përmbajnë NOQ ose janë të kontaminuara me to.

Konventa e Vjenës për Mbrojtjen e Shtresës së Ozonit dhe Protokollit shoqërues i Montrealit me katër amendamentet e tij

Instrumenti i Montrealit kontrollon shkarkimet e substancave që hollojnë shtresën e ozonit në atmosferë. Në këtë kuadër, deri tani ka përfunduar një studim lidhur me substancat që hollojnë shtresën e ozonit, i cili edhe identifikon llojin dhe sasinë e tyre, të përdorur, të shitur apo të grumbulluar brenda territorit të Shqipërisë. Gjithashtu, është hartuar dhe po zbatohet Plani Kombëtar për heqjen e tyre nga përdorimi deri në vitin 2010. Janë organizuar programe trajnimi me mekanikët dhe riparuesit e frigoriferëve të vjetër që punojnë me substanca ozonholluese. Programe trajnimi janë organizuar edhe me inspektorët e doganave lidhur me funksionimin e sistemit të identifikimit, monitorimit dhe kontrollit të importit të substancave ozonholluese dhe/apo pajisjeve që i përdorin ato.

Kohët e fundit, Shqipëria ka aderuar në amendamentet e Protokollit të Montrealit: Amendamenti i Londrës (ligji nr.9484, dt.2.3.2006), Amendamenti i Kopenhagës (ligji nr.9480, dt.16.2.2006), Amendamenti i Montrealit (ligji nr.9485, dt.6.3.2006) dhe Amendamenti i Pekinit (ligji nr.9486, dt.6.3.2006).

Shqipëria është palë edhe në:

Konventën për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis në Kontekst Ndërkufitar

Konventën e Aarhus-it për Marrjen e Informacionit, Pjesëmarrjen e Publikut në Vendimmarrje dhe e drejta për t'iu drejtuar Drejtësisë, si dhe dhe Protokollin e PRTR

Protokollin e Kievit për Vlerësimin Strategjik Mjedisor

Konventën për Diversitetin Biologjik

Konventën për Lagunat e Rëndësisë Ndërkombëtare, veçanërisht lidhur me Habitatet Ujorë

Konventën Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimaterike dhe Protokollin e Kiotos

Konventën për Ndotjen Ndërkufitare të Ajrit në Distanca të Largëta

Konventën për Mbrojtjen dhe Përdorimin e Ujërave Ndërkufitare dhe Liqeneve Ndërkombëtare, etj.

Së fundmi, është ndërmarrë një iniciativë e përbashkët midis Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për të ratifikuar në të ardhmen e afërt Konventën e Roterdamit për Procedurat e Miratuara Paraprakisht (PIC) për Tregtinë Ndërkombëtare të disa Kimikateve të Rrezikshme dhe Pesticideve.

Ka nisur një proces bashkëpunimi midis Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për të filluar në të ardhmen e afërt praktikatat lidhur me aderimin në Konventën e Roterdamit për Procedurat e Miratuara Paraprakisht (PIC) për Tregtinë Ndërkombëtare të disa Kimikateve të Rrezikshme dhe Pesticideve.

Objekti i kësaj konvente është të vendosë përgjegjësi të ndara për mbrojtjen e shëndetit të njeriut dhe të mjedisit midis vendeve eksportuese dhe importuese të kimikateve.

Kjo i mundëson botës monitorimin dhe kontrollin e tregtisë së kimikateve të rrezikshme. Konventa u jep vendeve importuese fuqinë për të vendosur se cilat nga këto kimikate të lejojnë dhe të përjashtojnë ato, të cilat nuk mund t'i menaxhojnë në mënyrë të sigurt. Nëse realizohet tregtimi,

kërkesat për etiketimin dhe informimin për efektet potenciale në shëndet dhe në mjedis garantojnë përdorimin e sigurtë të këtyre kimikateve.

Konventa mbulon pesticidet dhe kimikatet industriale të ndaluara (të nxjerra nga përdorimi), apo të kufizuara rreptësisht, për arsye që lidhen me mbrojtjen e shëndetit të njeriut dhe të mjedisit në vendet Palë të saj. Procedurat e vendosura nga Konventa duhet të zbatohen edhe për formulimet e pesticideve që paraqesin rreziqe në kushte të caktuara përdorimi në vendet në zhvillim apo me ekonomi në tranzicion, Palë të Konventës. Tani për tani, në listën PIC të Konventës ka 27 kimikate duke përfshirë edhe formulimet e pesticideve të rrezikshme.

Shqipëria është angazhuar edhe në marrëveshje mjedisore rajonale (programi REReP) dhe bilaterale me vendet fqinje. Së bashku me vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor, ajo është vend kandidat për tu anëtarësuar në Agjencinë Europiane të Mjedisit.

2.2.4 Parimet e Legjislacionit dhe të Rregulloreve ekzistuese në lidhje me NOQ-të

Mbështetur në Ligjin “Për substancat dhe preparatet kimike”:

Gjatë administrimit të substancave dhe preparateve të rrezikshme çdo person është i detyruar të ruajë shëndetin e njeriut dhe mjedisin, të vendosë shenjat paralajmëruese të rrezikut, me shprehjet që përshkruajnë rrezikun specifik dhe me udhëzimet e sigurimit teknik për menaxhimin e tyre.

Personat juridikë ose fizikë, të autorizuar për kryerjen e veprimtarisë tregtare, mund t'i administrojnë substancat dhe preparatet e rrezikshme, që kanë një apo me shumë veti të rrezikshme sipas ligjit “Për substancat dhe preparatet kimike” dhe t'i trajtojnë këto substanca nëse janë në sasi më të mëdha se 10 ton për një vit kalendarik vetëm me leje të ministrisë përkatëse.

Administrimi i substancave të rrezikshme bëhet pasi është marrë leja nga agjencia rajonale e mjedisit.

Personat fizikë dhe juridikë, të autorizuar për kryerjen e veprimtarisë tregtare, janë të detyruar të lejojnë personat e autorizuar nga zyrat e kontrollit dhe të inspektimit, të hyjnë në mjediset dhe ndërtesat, që përdoren për menaxhimin e substancave dhe të preparateve dhe të marrin të gjitha të dhënat e nevojshme për punën e tyre.

NOQ-të e prodhuara në mënyrë të paqëllimshme

Në përputhje me ligjin “Për administrimin mjedisor të mbeturinave të ngurta”, në territorin e Shqipërisë janë të ndaluara:

Braktisja, shkarkimi, hedhja në tokë ose në ujërat sipërfaqësore e mbetjeve që çojnë në degradimin e vetive të tokës ose të ujërave sipërfaqësore dhe shkaktjnë rrezik ose dëm për shëndetin dhe mjedisin;

Përpunimi dhe asgjësimi i mbetjeve jashtë zonave të përcaktuara nga organet e qeverisjes vendorë;

Përpunimi, depozitimi dhe asgjësimi i mbetjeve me teknika dhe teknologji të papërshtatshme dhe të pamiratuara nga Ministri i Mjedisit dhe ministrat përkatës;

Djegia në natyrë, përfshirë edhe vetëdjegien e mbetjeve dhe të hedhurinave që rezultojnë nga trajtimi i tyre.

Sipas të njëjtit ligj, përpunimi dhe eliminimi i mbeturinave urbane, industriale dhe spitalore duhet të bëhet në përputhje me rregullat e miratuara paraprakisht nga autoritetet përkatëse për administrimin e tyre. Autoritetet përkatëse duhet gjithashtu të miratojnë kriteret dhe rregulloret për instalimin dhe operimin e impianteve të përpunimit të mbeturinave dhe të inceneratorëve.

2.2.5 Problemet dhe Objektivat Përparësorë për Forcimin Institucional e Rregullator

Kuadri Ligjor

Pritet që fusha e legjislacionit të jetë e para ku do të fillohet puna për garantimin e zbatimit të kërkesave të Konventës së Stokholmit. Kjo vlen jo vetëm për ndryshimet dhe përmirësimet e nevojshme që lidhen drejtpërdrejt me formulimet ligjore, por edhe për ndryshimet e mundshme në kuadrin institucional të cilat duhet medoemos të mbështeten dhe të reflektohen në kuadrin ligjor përkatës.

Në lidhje me zbatimin e kërkesave të Konventës së NOQ-ve, mbështetur në nenin 122 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë “Çdo marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar bëhet pjesë e sistemit të brendshëm juridik pas botimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë. Ajo duhet të zbatohet direkt, përveç rasteve kur nuk është e mundur dhe zbatimi i saj kërkon hyrjen në fuqi të një ligji të posaçëm. Një marrëveshje ndërkombëtare, e ratifikuar nga Kuvendi, është superiore në raport me ligjet e vendit që nuk pajtohen me të”. Nga ky përcaktim i Kushtetutës, rrjedhin tri konkluzione të rëndësishme lidhur me Konventën e NOQ-ve:

- Konventa e Stokholmit është tashmë pjesë e sistemit të brendshëm juridik të Shqipërisë. Ratifikimi i Konventës së Stokholmit ka sjellë një pasurim të gjerë të legjislacionit kombëtar për NOQ-të, të cilat nuk kanë qenë mbuluar me parë me legjislacion specifik kombëtar, megjithëse, duke qenë relativisht i ri, legjislacioni mjedisor është në një masë të konsiderueshme i harmonizuar me direktivat përkatëse europiane.
- Konventa e Stokholmit është një akt juridik i detyrueshëm për zbatim: që nga dita e parë e hyrjes në fuqi, organet ekzekutuese shqiptare janë të detyruara të zbatojnë me rigorozitet çdo kërkesë të saj dhe të kërkojnë zbatimin e saj nga çdo subjekt i obliguar.
- Kërkesat e Konventës së Stokholmit janë superiore në raport me ato të legjislacionit kombëtar të cilat nuk pajtohen me të. Kjo ndihmon në rastet kur në legjislacionin kombëtar që ka hyrë në fuqi përpara ratifikimit të Konventës së NOQ-ve përcaktohen qëndrime të ndryshme.

Në këtë kontekst, janë identifikuar çështjet e mëposhtme për t'u marrë në konsideratë në lidhje me kuadrin rregullator ekzistues në Shqipëri:

- Në legjislacionin kombëtar nuk ekziston asnjë ligj i veçantë apo akt tjetër nën-ligjor, i cili të jetë në kundërshtim me dispozitat e Konventës së Stokholmit;
- Deri më tani nuk ka asnjë akt specifik ligjor që të trajtojë NOQ-të;
- Në disa ligje dhe akte nënligjore, si edhe në disa dokumente të tjera shtetërore për mjedisin, ekzistojnë hapësirat për trajtimin e ardhshëm të NOQ-ve në përputhje me kërkesat e Konventës;
- Përgatitja e kuadrit ligjor specifik për të mundësuar zbatimin e kërkesave të Konventës si pjesë e përpjekjeve të përgjithshme për të transpozuar dhe harmonizuar legjislacionin kombëtar me atë european në fushën e mbrojtjes së shëndetit të njeriut e të mjedisit;
- Hartimi dhe miratimi i çdonjërit prej akteve që do të përbëjnë paketën ligjore për NOQ-të, duhet të realizohet në përputhje me një program të detajuar të miratuar, i cili duhet të jetë afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë, duke u dhënë prioritet akteve me të nevojshëm, miratimi i të cilave lehtëson përgatitjen e të tjerave;
- Me qëllim që të përgatiten akte konkrete, duhet të ngrihen grupet përkatëse të punës, në përbërje të të cilave duhet të ketë juristë mjedisorë, teknikienë dhe anëtarë të OJF-ve të specializuara apo shoqatave të tjera të biznesit;

- Krahas Konventës së Stokholmit, paketa shtesë për NOQ-të që duhet të përgatitet dhe miratohet, do të shërbejë për plotësimin e kuadrit ligjor të nevojshëm për zbatimin e detyrimeve të Konventës;

Me qëllim që të rritet ndërgjegjësimi i publikut lidhur me paketën ligjore për menaxhimin e NOQ-ve, rekomandohet publikimi dhe diskutimi i saj me përfaqësues të administratës publike përgjegjëse për menaxhimin e NOQ-ve, si edhe me përfaqësues të të gjitha grupeve të tjera të interesuara.

Rrjeti Institucional

Nga pikëpamja institucionale, Konventa e Stokholmit prezanton një tërësi detyrimesh për vendet të cilat tashmë e kanë nënshkruar ose ratifikuar. Megjithëse nuk ka përcaktime për ngritje të organeve të reja apo përshkrime për poste pune specifike brenda organeve ekzistuese, detyrimet për vendet-palë janë të qarta dhe u takon atyre të ngrenë struktura sa më efektive për zbatimin e detyrimeve që rrjedhin prej saj.

Nga ana tjetër, ka një nevojë të shprehur për pjesëmarrje më të gjerë, jo vetëm nga strukturat shtetërore, por edhe nga shoqëria civile, OJF-të e specializuara, institucionet shkencore, universitetet dhe laboratorët, rrjetet e grumbullimit, vlerësimit, përpunimit dhe shpërndarjes së informacionit, etj. Në kuadër të zbatimit të detyrimeve të Konventës së Stokholmit, duhet bërë identifikimi dhe përfshirja institucioneve të lart-përmendur.

Me përcaktimin e fushave të zbatimit, Konventa gjithashtu kërkon krijimin e një skeme kombëtare për të menaxhuar deri në asgjësimin e sigurt në shkallë kombëtarë të ndotësve organike të qëndrueshëm. Në këtë skemë, janë parashikuar organet dhe strukturat konkrete që do të merren me:

- Përgatitjen, paraqitjen dhe miratimin e Planit Kombëtar të Zbatimit të Konventës së Stokholmit;
- Grumbullimin e informacionit për të njohur situatën përmes procesit të inventarizimit;
- Ndalimin e prodhimit dhe importimit të NOQ-ve;
- Miratimin e rregullave dhe procedurave për eksportimin dhe kalimin tranzit të NOQ-ve;
- Menaxhimin e NOQ-ve;
- Monitorimin e procesit të menaxhimit të NOQ-ve dhe atë të zbatimit të vetë Konventës, etj.

Mbi bazën e përcaktimit të detyrave për t'u kryer, del nevoja e harmonizimit dhe konsolidimit të rrjetit institucional, ku, organet qendrore dhe vendore, organet e kontrollit e të monitorimit, strukturat vendim-marrëse dhe ekzekutive, politikë-bërësit dhe bërthamat shkencore, duhen të gjithë të përfshihen me efektivitet.

Në këtë kontekst, janë identifikuar si aktuale çështjet e mëposhtme në lidhje me kuadrin institucional në Shqipëri:

- Vlerësimi kritik i organizmave dhe strukturave ekzistuese, si kapaciteti veprues më i rëndësishëm, për të gjetur lidhjen e secilës prej tyre me detyrimet që rrjedhin nga Konventa e Stokholmit;
- Rivlerësimi i detyrimeve konkrete që kanë institucionet përkatëse në lidhje me menaxhimin e NOQ-ve, në funksion edhe të detyrave, kompetencave dhe përgjegjësi të tyre kryesore;
- Hartimi i skemës së re institucionale, ku të përfshihen të gjitha strukturat dhe organet në qendër dhe në nivel vendor, përcaktimi i roleve, funksioneve, përgjegjësi, kompetencave dhe detyrave të çdonjërit prej tyre, i lidhjeve ndërmjet tyre dhe i rregullave të funksionimit të sistemit në tërësi;
- Përcaktimi i pikave të kontaktit dhe i pikave fokale në nivel kombëtar, lokal dhe/ose sektorial, të cilët, të gjithë së bashku, do të përbëjnë Rrjetin Kombëtar të NOQ-ve;

- Pikat e kontaktit dhe pikat fokale do të ngrenë skemën e komunikimit midis tyre, si edhe do të përgatisin programet operative për zbatimin e detyrave të tyre përkatëse;

Standardizimi dhe përgatitja e dokumenteve, regjistrave, inventarëve, etj. lidhur me NOQ-të, me qëllim që ato të kenë një format unik dhe standard; përcaktimi i rregullave dhe procedurave për administrimin e informacionit dhe ruajtjen e tij të sigurt në një qendër kombëtare të posaçme.

Problemet përparësore

- Nevoja e plotësimit dhe zbatimit të legjislacionit për kimikatet;
- Legjislacioni aktual nuk është plotësisht i harmonizuar me atë evropian;
- Nevoja për të rregulluar çështjet që lidhen me përdorimin e PCB-ve në sisteme të mbyllura, nxjerrjen e tyre nga përdorimi dhe asgjësimin e sigurt nga pikëpamja mjedisore;
- Zbatim i pamjaftueshëm i legjislacionit ekzistues;
- Nevoja për të ngritur një strukturë kombëtare për zbatimin e Konventës së Stokholmit (rrjet të pikave të kontaktit, pikave fokale).

Objektivat

- ➔ Plotësimi dhe harmonizimi i legjislacionit mjedisor me atë evropian;
- ➔ Përmirësimi i rrjetit institucional dhe ngritja e kapaciteteve në nivel qendror dhe vendor.

2.3 Vlerësimi i Gjendjes në lidhje me NOQ-të në Shqipëri

2.3.1 Pesticidet NOQ

Nga dymbëdhjetë kimikatet e renditura në Konventën e Stokholmit, nëntë janë pesticide NOQ: aldrin, dieldrin, DDT, endrin, mireks, toksafen, klordan, heksaklorbenzen dhe heptaklor.

Fillimisht në vendin tonë janë importuar dhe më vonë janë formuluar në Ndërmarrjen Kimike Durrës: DDT, heptaklor, aldrin, dieldrin, toksafen (melipaks), klordan, heksakloran dhe lindan i cili edhe është prodhuar në këtë Ndërmarrje.

Praktikisht prodhimi i pesticideve është ndërprerë në vitin 1990. Megjithatë, rreziku nga pesticidet ka qenë i dukshëm.

Pas vitit 1990 janë kryer disa inventarë nga projekte të ndryshme. Në fund të vitit 1993, kanë qenë 2.700 ton pesticide stok të trashëguara nga kooperativat dhe ndërmarrjet bujqësore. 465 ton e kësaj sasi ka qenë stok apo pothuajse e derdhur. Kjo sasi erdhi nga Gjermania Lindore, në vitet 1991 – 1992 si ndihmë dhe u ruajt kryesisht në Bajzë (Shkodër) dhe në stacionin hekurudhor Milot. Në fund të Tetorit 1994 këto pesticide nga Shqipëria u kthyen mbrapsht për në Gjermani.

Në të njëjtin vit, janë evidentuar të pranishme 1.500 ton pesticide, krahas 500 ton gjendje në Ndërmarrjen Kimike Durrës, (mbeturina të prodhimit të lindanit)

Në vitet 2000-2002 projekti PHARE largoi nga Shqipëria të gjitha pesticidet stok të depove të Sektorit të Bujqësisë dhe i asgjësoi ato në Gjermani.

Nga inventari i kryer në vitin 2005 në kuadrin e PKI të NOQ-ve ka rezultuar që në Shqipëri nuk ka pesticide të këtij grupi. Kontingjenti me rreth 3 ton DDT dhe heksakloran/lindan të cilat kanë qenë të pranishme në depot e Ministrisë së Shëndetësisë, janë riambalazhuar dhe larguar nga Shqipëria në muajin Korrik 2006, nga projekti i MMPAU: "Riambalazhimi dhe largimi nga Shqipëria i pesticideve dhe i kimikateve të tjera nga Bishti i Pallës", financuar nga qeveria Holandeze.

Problem tani është përcaktimi i kostos së ndotjeve eventuale nga përdorimi i mëparshëm i pesticideve NOQ.

Hyrje

Pas vitit 1990, pesticidet organike të qëndrueshme (heksalorbenzen, DDT, klordan, heptaklor, aldrin, dieldrin, endrin dhe toksafen) janë administruar me kujdes. MBUMK sistematikisht ka punuar për heqjen nga qarkullimi dhe ndalimin e importit të pesticideve NOQ. Në këtë kuadër është përmirësuar legjislacioni për përdorimin e Produkteve për Mbrojtjen e Bimëve (PMB) dhe me VKM është formuar Komisioni për Regjistrimin e Pesticideve. Importi dhe eksporti i pesticideve është nën kontroll. Komisioni gjithnjë ka punuar për ndalimin e përdorimit të NOQ-ve në bujqësi në përputhje me rekomandimet e organizmave ndërkombëtare.

Gjatë dekadës së fundit, nuk ka asnjë rast të përdorimit të NOQ-ve në bujqësi dhe Komisioni Shtetëror i Regjistrimit të Pesticideve nuk ka lejuar regjistrimin dhe importin e produkteve të tilla në bujqësi.

Ekzistojnë vetëm disa studime sporadike të këtyre produkteve në mjedis. Këto studime janë kryer në vendet që konsiderohen si pika të nxehta mjedisore dhe nuk ka ndonjë studim të plotë për situatën në vend në lidhje me ndotjet e tokës dhe ujit nga pesticidet NOQ. Në këtë kontekst, sugjerohet të planifikohet monitorimi i këtyre pesticideve kryesisht në ish – depot, hapësirën tokësore dhe ujore rreth tyre dhe, në raste të veçanta, kafshët shtëpiake dhe njerëzit.

Kërkesat e lidhura me Konventën e Stokholmit

Palët: [Neni 3, parag. 1]

(a) “ndalojnë dhe/ose marrin masat e nevojshme administrative dhe ligjore për të eliminuar”:

- (i) kimikatet e prodhuara dhe të përdorura në Aneksin A² dhe
- (ii) importimin dhe eksportimin e kimikateve në Aneksin A
 - *p.sh.*, tregti e kufizuar [shih paragrafin (2)]

(b) “kufizojnë prodhimin dhe përdorimin e kimikateve në Aneksin B³”

- Specifikimet për “qëllimet e pranimit” për këto kimikate

Palët: [Neni 6]

- Bëjnë strategjitë e zhvillimit dhe të implementimit për identifikimin e rezervave [parag. 1 (a)(i) dhe 1 (b)]
- menaxhojnë rezervat në mënyrë të sigurt, eficiente për mjedisin deri sa ato të konsiderohen si mbeturina [paragrafi 1 (c)]
 - *p.sh.*, mospërdorimi i tepricave nga Palët
 - nuk ka *specifikime për qëllime të pranueshme ose shkarkime*
 - nuk e aplikojnë tek rezervat që mund të eksportohen
 - Artikulli 3, parag. 2
- përgatisin strategjitë e identifikimit për [parag. 1 (a)(ii)]
 - produktet dhe artikujt në përdorim, dhe
 - mbeturinave
 - të cilat përbëhen, përmbajnë ose janë të kontaminuara me një NOQ në Aneksin A, B ose C
- punojnë për përgatitjen e strategjive për identifikimin e vendeve të ndotura prej NOQ-ve në Aneksin A, B ose C⁴ [parag. 1 (e)], dhe
- nëse është i mundur rehabilitimi, e bëjnë në mënyrë të sigurt për mjedisin

² aldrin, klordan, dieldrin, endrin, heptaklor, heksaklorobenzen, mireks, toksafene, poliklori bifenil (PCB)

³ DDT

⁴ PCDD/PCDF, heksaklorobenzen, PCB

Gjendja në Shqipëri

Mbrojtja e bimëve me kimikate.

Përdorimi i pesticideve në Shqipëri mbetet një proces i domosdoshëm për të siguruar rendimente të larta dhe prodhim të qëndrueshëm. Ky është një proces që kërkon vlerësimin e duhur për të bërë të mundur përdorimin e atyre pesticideve që plotësojnë parametrat e mësipërm por edhe që të jenë më pak të dëmshëm për njerëzit, për ndotjen e mjedisit dhe për vetë kulturat bujqësore

Pas viteve 70, në vendet e zhvilluara pati rritje tepër të madhe të prodhimit bujqësor, si rezultat i përdorimit të agrokimikateve dhe veçanërisht të pesticideve. Ato u konsideruan si mjeti më i shpejtë dhe më efektiv për të mbrojtur prodhimet bujqësore nga parazitët.

Megjithatë, mjaft pesticide do të konsideroheshin të dëmshme për mjedisin, për shkak të ndikimeve negative në florën, faunën dhe shëndetin e njerëzve.

Pesticidet në vendin tonë, prej shumë kohësh kanë zënë vendin kryesor për luftimin e parazitëve të bimëve në bujqësi. U fillua me pesticidet klororganike DDT, heptaklor, lindan etj., të cilat u përdorën për dezinfektimin e tokës, dezinfektimin e farërave dhe spërkatjen e shumë kulturave bujqësore kundër dëmtuesve të ndryshëm. Rreth viteve '67–'70 në vendin tonë, krahas prodhimeve me bazë bakri (oksiklorur bakri) dhe me bazë squfuri (polisulfuri i kalciumit), filloi puna për formulimin e pesticideve klororganike duke përdorur lëndë aktive importi. Pranë ish Ndërmarrjes Kimike në Durrës janë formuluar pesticidet: DDT, heptaklor, melipaks (toksafen) etj., dhe prodhuar heksakloran dhe lindan, të cilat nga Konventa e Stokholmit janë cilësuar si pesticide NOQ. Lëndët aktive për këto formulime janë importuar nga Kina, Rumania, Franca etj.

Duke studiuar krahas përparësive të klororganikëve edhe mangësitë e tyre, rezultoi që ato ishin shumë të qëndrueshme në mjedis. Ato akumulohen në yndyrat e organizmave të gjalla. Në vitin 1970 në SHBA u krijua Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit (EPA) dhe tre vjet më vonë ajo ndaloi përdorimin e DDT. Në vitin 1975 u ndaluan edhe përdorimi i aldrinës dhe dieldrinës. Fillimisht, në vitin 1974 u ndalua formulimi i DDT në ish Ndërmarrjen Kimike Durrës (mbas këtij viti pretendohet se nuk ka më import të kësaj lënde aktive, pra edhe formulim të DDT, por ka gjendje ekzistuese të formulimit nëpër depo e cila është përdorur gradualisht në të gjithë vendin).

Heqja e tyre nga përdorimi nuk njeh një vit të saktë për secilin, por një periudhë kohore, që kap vitet 1975 – 1980 (flitet për kufizime në përdorim) fillimisht të DDT, aldrinës, dieldrinës, heptaklorit, ndërsa toksafeni dhe lindani njohin vite të mëvonshme.

Duke parë që klororganikët kishin qëndrueshmëri dhe toksicitet të lartë po kështu edhe veti akumuluese, fillimisht u kufizua përdorimi i tyre për kulturat bujqësore dhe u lejua të përdoreshin për të dezinfektuar tokën. Prodhimi dhe përdorimi i pesticideve u orientua nga fosfororganikët. Në vitet 1988 – 1989 kemi dhe maksimumin e përdorimit të pesticideve në vendin tonë. Në atë periudhë llogariten të jenë përdorur rreth 85 formulime, në sasi rreth 16.500 ton, nga të cilat rreth 14.500 ton (15 formulime) prodhoheshin në vend, ndërsa pjesa tjetër janë importuar. Sipas llogaritjeve, përdorimi i pesticideve në Shqipëri asnjëherë nuk ka kaluar më shumë se 2 kg lëndë aktive për hektar.

Vitet 1990 - 1991 shënuan rënie të menjëhershme të përdorimit të pesticideve si rezultat i ndryshimeve sociale dhe ekonomike (shih Tabelën 4). Për këtë periudhë të dhënat nuk janë plotësisht të mjaftueshme për të bërë përgjithësime. Në këtë kohë nuk aplikoheshin asnjë procedurë për homologimin dhe regjistrimin e pesticideve.

Tabela 4: Përdorimi i pesticideve në Shqipëri, 1988-2000.

VITET	PesticideT	
	TON	L.A./HA
1988	16,500	2.0
1991 [‘]	1,585	0.68
1992 [*]	1,700	0.73
1993 ^{**}	790	0.34
1994 ^{**}	740	0.32
1995 ^{**}	520	0.22
2000	88	0.04

‘ – lëndë aktive

” – të dhëna të Ministrisë së Bujqësisë

* - të dhëna të Bankës Botërore, 1992.

** - Projekti Holandez “Për forcimin e Shërbimit të Mbrojtjes së Bimëve në Shqipëri” të dhëna të vitit, 1995.

Mbështetur në Ligjin Nr. 7662 datë, 19.01.1993 “Për Shërbimin e Mbrojtjes së Bimëve”, në të njëjtin vit, Këshilli i Ministrave ka aprovuar “Rregulloren e pesticideve që përdoren në bujqësi”.

Më vonë, me VKM Nr. 72 datë 15.02.2001 u miratua akti nënligjor “Për aprovimin e Rregulloreve të Përgjithshme për Mbrojtjen e Bimëve”. Kjo Paketë ligjore rregullon problemet e mbrojtjes së bimëve, në një masë të konsiderueshme, si dhe trajton edhe problemin e menaxhimit të pesticideve. Në përgjithësi kjo mbështetet në Direktivën e BE 91/414/EEC, në të cilën pesticidet trajtohen jo vetëm si produkte që mbrojnë bimët nga parazitët por edhe si mjete potenciale me pasoja në ndotjen e mjedisit

Bazat e kësaj Rregulloreje janë të lidhura me regjistrimin e pesticideve. Kjo është një procedurë që konsiston në vlerësimin agro-biologjik dhe mjedisor të këtyre produkteve.

Komisioni Shtetëror i Regjistrimit të Pesticideve administron në mënyrë korrekte regjistrimin e pesticideve dhe kryen vlerësimet përkatëse. Pas aprovimit të një pesticidi nga Komisioni Shtetëror ai është i garantuar për t'u përdorur në bujqësi.

Monitorimi pas procedurave të regjistrimit, që lidhet me problemet e ndotjes së mjedisit, është pika më e dobët në këtë fushë.

Problemet e pesticideve NOQ dhe ndotjet që ato mund të kenë shkaktuar kanë qenë dhe mbeten të hapura.

Mbetet gjithashtu i hapur dhe problemi i shkallës së ndotjes së vendit në të cilin u prodhuan dhe formuluan këto pesticide NOQ (ish-Ndërmarrja Kimike në Porto-Romano, Durrës) dhe vendet e magazinimit dhe ruajtjes së tyre.

Specialistët e Sektorit të Pesticideve në IMB Durrës në bashkëpunim me specialistët e Mbrojtjes së Bimëve në Ministrinë e Bujqësisë dhe Ushqimit kanë kryer disa inventarë. Qëllimi kryesor i këtyre inventarëve ka qenë identifikimi i sasive dhe llojeve të pesticideve të magazinuar për vite me radhë. Gjatë inventarëve të para është evidentuar sasia, llojet e pesticideve, tipat e formulimeve dhe janë marrë mostra të cilat janë analizuar pranë Laboratorit Analitik të Pesticideve në IMB Durrës.

Në vitet e mëvonshme sasia e tyre ka ardhur duke u reduktuar si pasojë e përdorimit të një pjese të tyre në bujqësi dhe asgjësimit të realizuar nga projekte të ndryshme.

Në vitet 2000-2002 projekti PHARE largoi nga Shqipëria të gjitha pesticidet stok të depove të Sektorit të Bujqësisë dhe i asgjësoi ato në Gjermani.

Në vitin 2005, specialistët e IMB Durrës kanë bërë inventarin e të gjitha ish magazinave të pesticideve, të importuara ose të formuluara në vend. Këto depo janë të lira nga stoqet e pesticideve por gjendja e këtyre depove mbetet problem lidhur me shkallën e ndotjes së tyre. Mjedis brenda tyre është i ndotur, ndërsa një pjesë e tyre janë të shkatërruara. Disa përdoren si depo pesticidesh, disa kanë ndërruar destinacion përdorimi. Pjesa më e madhe janë të papërdorshme dhe të boshatisura.

Problemet përparësore dhe objektivat për administrimin e pesticideve NOQ

Në Shqipëri nuk ka më pesticide NOQ. Sasia e fundit rreth 3 ton DDT dhe HCH/Lindan të cilat kanë qenë të pranishme në sektorin e shëndetësisë, janë larguar nga Shqipëria në Korrik 2006, në kuadrin e marrëveshjes midis Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Holandës për ripaketimin dhe largimin e kimikateve dhe pesticideve NOQ nga Bishti i Pallës.

Problemet përparësore të identifikuar gjatë inventarit të pesticideve NOQ, janë vendet e ndotura në ish depot e sektorit të bujqësisë, mbrojtjes dhe të shëndetësisë, po kështu edhe ndotja e mjedisit rreth tyre.

Menaxhimi dhe impakti i mbeturinave, në këto ish depo të magazinimit të pesticideve është krejt i panjohur ose i njohur në mënyrë të pjesshme. Në Shqipëri nuk mund të flitet për një infrastrukturë teknike për monitorimin e pesticideve NOQ, analizimin, kërkimin dhe zhvillimin.

Në vendet ku janë ruajtur këto pesticide NOQ ka ende të pranishme ndotje të akumuluar nëpër dysheme dhe mure si dhe të infiltuara në zonën përreth tyre. Identifikimi i efektit është një punë e ndërlikuar që kërkon pajisjet përkatëse dhe specialistë të kualifikuar dhe të trajnuar në fushën e pesticideve NOQ.

Rezultati i inventarit në nivel kombëtar në sektorët e mbrojtjes dhe të bujqësisë është që në Shqipëri nuk ka pesticide NOQ. Megjithatë, informacionet mbi sasi të përdorura për të mbrojtur bimët deri kur ato u ndaluan nga përdorimi në bujqësi, nuk janë të plota.

Për DDT dhe heksakloranin/lindanin, ka rezultuar një sasi e vogël e pranishme në depot e sektorit të shëndetësisë e cila, siç u përmend më lart, është larguar nga Shqipëria.

Problemet përparësore

- Përshtatja e legjislacionit në fuqi për përdorimin e pesticideve;
- Informacion jo sistematik rreth përdorimit në të kaluarën i DDT (dokumente rreth sasive të importuara dhe të përdorura të DDT në sektorin e shëndetësisë);
- Mungesa e studimit për nivelin aktual të ndotjeve në ish depot e magazinimit të pesticideve, po kështu edhe mjedisi rreth tyre;
- Autoritetet lokale kanë një informacion të pamjaftueshëm në lidhje me pesticidet NOQ (në veçanti në depot e vjetra);
- Stafi teknik ka një informacion të pamjaftueshëm në lidhje me pesticidet NOQ (ndotja e depove të vjetra dhe impakti i tyre në shëndet dhe mjedis);
- Mungesa e informacionit specifik në lidhje me pesticidet tek publiku në përgjithësi;
- Mungesa e një mbështetje financiare.

Objektivat

- ➔ Forcimi i kapacitetit të laboratorëve të IMB për monitorimin e pesticideve NOQ;
- ➔ Përcaktimi ndotjeve eventuale nga pesticidet NOQ në ish depot dhe në hapësirën përreth tyre;
- ➔ Zhvillimi i planit të rehabilitimit për vendet e ndotura nga pesticidet NOQ;
- ➔ Rritja e ndërgjegjësisë rreth këtyre vendeve të kontaminuara në lidhje me rrezikun shëndetësor tek njerëzit që jetojnë afër këtyre vendeve.

2.3.2 PCB-të

Hyrje

PCB-të janë kimikate organike sintetike, me veti të larta dielektrike, të padjegshme dhe të qëndrueshme ndaj shpërbërjes termike dhe kimike.

Në transformatorë dhe kondensatorë janë përdorur lëngje dielektrike me bazë bifenile të polikloruara (PCB-të) për shkak të vetive zjarrruduese dhe karakteristikave të tjera të tyre në përdorimin e pajisjeve elektrike, por në të njëjtën kohë këto produkte kanë dhe mjaft disavantazhe. Këto disavantazhe lidhen me natyrën helmuese të PCB-ve dhe rrezikun që ato sjellin për shëndetin e njerëzve dhe mjedisin.

PCB-të janë objekt i tri konventave ndërkombëtare që lidhen me trajtimin e mbetjeve të rrezikshme dhe konkretisht: Konventa e Bazelit, Konventa e Roterdamit dhe Konventa e Stokholmit. Këto konventa i trajtojnë problemet e PCB-ve duke iu referuar prodhimit, deklarimit, përdorimit, importimit, eksportimit, ruajtjes, transportit, monitorimit, nxjerrjes jashtë përdorimit dhe eliminimit të tyre.

Deri para pak vitesh, në Shqipëri nuk është punuar aq sa duhet për njohjen e PCB-ve dhe ndikimin e tyre në mjedis e në njerëz dhe, për rrjedhojë, nuk ekziston legjislacioni konkret në lidhje me PCB-të, përfshirë këtu edhe monitorimin e tyre.

Korporata Elektroenergjitike Shqiptare (KESH) është shoqëria e vetme furnizuese e energjisë në Shqipëri. Sot kjo kompani është ndarë në dy divizione: Divizioni i prodhimit dhe Divizioni i shpërndarjes, të cilat janë përgjegjëse për prodhimin, importin dhe shpërndarjen e energjisë. Divizioni i transmetimit është ndarë nga KESH dy vjet më parë dhe i është bashkuar OSTSH e cila është regjistruar në korrik 2004 si kompani e përbashkët me 100% aksione shtetërore.

Në të shkuarën KESH nuk ka pasur një strukturë të mirëfilltë mjedisore. Nuk ka pasur plane për menaxhimin e situatave emergjente, kanë munguar evidentimet e krijimit të mbetjeve dhe menaxhimit të tyre, nuk ka pasur procedura të brendshme për menaxhimin e mbetjeve, që të japin udhëzime për trajtimin e tyre, për përcaktimin e përgjegjësive dhe vendosjen e detyrave për evidentimin e ecursisë së krijimit të ndotjeve.

Niveli i ndërgjegjësimit të punonjësve të objekteve të KESH-it për rrezikun e PCB-ve është shumë i ulët, për shkak të mungesës së legjislacionit dhe procedurave për administrimin mjedisor të vajit me PCB.

Për të përmirësuar situatën ekzistuese mjedisore si dhe për të forcuar kapacitetet administruese mjedisore pak vjet më parë në KESH dhe OSTSH u krijua Njësia e Administrimit të Mjedisit (NjAM) për të zhvilluar kapacitetet e brendshme në lidhje me trajtimin e përgjegjësive mjedisore për shëndetin dhe sigurinë në punë në të gjithë objektet e KESH/OSTSH.

Për aq kohë sa të jetë shqetësues menaxhimi i PCB-ve, ne duhet të konsiderojmë në nivel kombëtar objektivat e përgjithshme të menaxhimit mjedisor, në veçanti menaxhimin e mbetjeve kimike dhe të rrezikshme, brenda kuadrit të konventave mjedisore përkatëse.

Kërkesat përkatëse të Konventës së Stokholmit:

Aneksi A kërkon që të gjitha Palët të ndërpresin menjëherë prodhimin e PCB-ve të reja (d.m.th., me hyrjen në fuqi të Konventës))

Të gjitha Palët që përfitojnë përjashtime të veçanta (Pjesa II) për PCB-të:

- të eliminojnë përdorimin e pajisjeve me PCB deri në vitin 2025:
 - të bëjnë përpjekje për identifikimin, etiketimin dhe nxjerrjen nga përdorimi të pajisjeve me përqendrim $> 10\%$ PCB dhe volum më të madh se 5 litra;
 - të bëjnë përpjekje për identifikimin, etiketimin dhe nxjerrjen nga përdorimi të pajisjeve me përqendrim $> 0,05\%$ PCB dhe volum me të madh se 5 litra;
 - të përpiqen të identifikojnë dhe heqin nga përdorimi pajisjet me përqendrim $> 0.005\%$ (50 ppm) PCB dhe volum me të madh se 0.05 litra ,
 - t'u japin përparësi pajisjeve me nivel të lartë përmbajtje PCB,
- të nxisin marrjen e masave për uljen e ekspozimit dhe rrezikut,
- të përdorin PCB-të vetëm në pajisjet e padëmtuara dhe që nuk pikojnë dhe vetëm në zonat ku rreziku i përhapjes në mjedis mund të minimizohet dhe rregullohet shpejt,
- të ndalohet përdorimi në ushqime dhe produkte ushqimore si dhe në zonat ku punohet me PCB,
- kur përdoren në zona të populluara (si shkolla, spitale, etj.)
 - të merren masat e nevojshme për mbrojtjen nga defektet elektrike të cilat mund të shkaktojnë zjarr,
 - të inspektohen rregullisht pajisjet për rrjedhje.
- të mos eksportojnë ose importojnë pajisje me PCB, me përjashtim të mbetjeve që kërkojnë Menaxhim të Qëndrueshëm Mjedisor (MQM).
- të mos rimbushen me vaj me më shumë se 0.005% PCB për t'u ripërdorur në pajisje të tjera, përveçse kur kërkohet mirëmbajtje dhe shërbim.
- të bëjnë përpjekje me vendosmëri që të arrijnë realizimin e MQM për mbetjet që përmbajnë $> 0.005\%$ PCB sa më shpejt që të jetë e mundur por jo më vonë se viti 2028.
- të përpiqen të identifikojnë pajisjet me $> 0.005\%$ PCB për një Administrim të Qëndrueshëm Mjedisor.
- të raportojnë në Konferencën e Palëve çdo 5 vjet për ecurinë në lidhje me eliminimin e PCB-ve [Neni 15]
Konferenca e Palëve do të shqyrtojë ecurinë në lidhje me arritjen e objektivave për vitet 2025 dhe 2028 në intervale 5 vjeçare, duke marrë në konsideratë raportet e Palëve.

Gjendja në Shqipëri

Direktivat e Bashkimit Evropian

Krahas konventave mjedisore të mësipërme, pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit me BE-në Shqipëria është në proces të përshtatjes së legjislacionit mjedisor sipas Planit Kombëtar për Përafrimin e Legjislacionit të miratuar nga Qeveria Shqiptare në maj të vitit 2005.

Në këtë kuadër, Direktivat më të rëndësishme të Bashkimit Evropian në lidhje me PCB-të janë si më poshtë:

- Rregulloret (KE) Nr. 850/2004 e Parlamentit dhe Këshillit Evropian e datës 29 prill 2004 për NOQ dhe Direktiva e amenduar 79/117/KE,

- Rregulloret (KE) Nr. 304/2003 e Parlamentit dhe Këshillit Evropian e datës 28 janar 2003 për problemet e eksportit dhe importit të kimikateve të rrezikshme,

- Direktiva e Këshillit, 96/59/KE e dt. 16 shtator 1996 për eliminimin e PCB-ve dhe PCT-ve.

Kuadri ligjor dhe institucional

Shqipëria është në proces përgatitjeje të legjislacionit për mbrojtjen e mjedisit. Po plotësohet dhe përmirësohet legjislacioni mjedisor në përputhje me direktivat përkatëse të Bashkimit Evropian.

Hë për hë, në vend nuk ekziston një legjislacion specifik në lidhje me PCB-të (për menaxhimin, trajtimin, monitorimin, nxjerrjen nga përdorimi dhe eliminimin e tyre). VKM Nr. 103, datë 31.3.2003 "Mbi monitorimin e mjedisit në Republikën e Shqipërisë" nuk parashikon detyrime për institucionet përkatëse që të monitorojnë praninë e PCB-ve në vajin e transformatorëve.

NjAM, bazuar në Sistemin e Menaxhimit të Mjedisit (SMM) ka përgatitur disa Plane Pune, siç janë "Plan-Veprimi për parandalimin e rrjedhjes të vajrave, kontrollin dhe masat zbutëse/eliminuese në lidhje me to për objektet e KESH-it", "Plan-Veprimi për menaxhimin e mbetjeve të rrezikshme", "Plan-Veprimi për përgatitjen dhe përballimin e situatave emergjente në objektet e KESH-it" dhe "Program për pajisjet mbrojtëse personale" për një menaxhim sa më të mirë të problemeve mjedisore në objektet energjetike, në përputhje me Politikën e tij mjedisore me qëllim kontrollin dhe/ose zbutjen e pasojave në rast rrjedhjeje vaji dhe për përmirësimin e situatës mjedisore në vend.

Inventari i transformatorëve

KESH dhe OSTSH u shërbejnë më shumë se 900.000 konsumatorëve në të gjithë territorin e vendit. KESH është krijuar në vitin 1957 dhe, më pas, në vitin 1995 është kthyer në shoqëri aksionare shtetërore, me 100 % vetëfinancim, ndërsa OSTSH u shkëput nga KESH dhe më 2004 u regjistrua si shoqëri e re me kapital të përbashkët (joint-stock), me 100% vetëfinancim.

KESH përbëhet nga dy divizione: Divizioni i Prodhimit dhe Divizioni i Shpërndarjes së energjisë, të cilët merren me menaxhimin dhe mbarëvajtjen e kësaj kompanie. Tashmë Divizioni i Transmetimit është shkëputur nga KESH-i dhe i ka kaluar Operatorit të ri të Sistemit të Transmetimit në Shqipëri (OSTSH).

Përpjekjet e para për të zbuluar praninë e PCB-ve në vajrat e transformatorëve janë bërë nga ECAT Tiranë. Pas kësaj pune u arrit në përfundimin se asnjëri nga vajrat e transformatorëve të analizuar nuk kalojnë normat e caktuara në udhëzuesit ndërkombëtare siç është Direktiva Zvicerane për Substancat e Rrezikshme në Mjedis.

Në vitin 2002 është kryer një auditim mjedisor nga një shoqëri e huaj në disa objekte të KESH-it, e cila ka dhënë disa rekomandime bazuar në problemet e identifikuara, ndër të tjera, për të testuar praninë e PCB-ve në gjithë vajrat e transformatorëve përjashtuar atë kinez.

Për shkak të mungesës së praktikave të mbajtjes së të dhënave dhe raportimeve formale, informacioni mbi objektet që eventualisht përmbajnë PCB, në të gjithë territorin e vendit është mjaft i ulët.

Përpjekja e parë për një inventar të PCB-ve në Shqipëri është inventari paraprak i realizuar në kuadër të projektit të NOQ-vë, mbështetur në numrin e përgjithshëm të transformatorëve në vend, vjetërsinë dhe tipin e transformatorëve dhe testimin e pjesshëm të tyre. Ai është përgatitur nga ekspertët e NjAM në KESH dhe ka pasur në qendër të vëmendjes transformatorët dhe kondensatorët.

NjAM në KESH/OST ka realizuar testimin për praninë e PCB-ve në vajrat e transformatorëve në rreth 57 objekte energjetike dhe janë testuar rreth 169 mostra vaji duke përdorur procedurat e përzgjedhjes.

Tabela 5: Të dhëna mbi transformatorët në KESH/Operatori i Sistemit të Transmetimit sipas Divizioneve

KESH/OSTSH	Numri i përgjithshëm i transformatorëve	Masa totale e vajt (litra)
Divizioni i Prodhimit	164	806 720
Operatori i Sistemit të Transmetimit	51	1 050 251
Divizioni i Shpërndarjes/Kabinat	11 181	3 383 969
Divizioni i Shpërndarjes/Nënstacionet	298	2 763 494
Totali	11 894	8 004 034

Tabela 6: Të dhëna mbi transformatorët në TEC dhe HEC-e të Divizionit të Prodhimit

KESH/ Divizioni i Prodhimit	Numri i përgjithshëm i transformatorëve	Masa totale e vajt (litra)
HEC Vau Dejës	9	196 460
HEC Fierzë	10	191 900
HEC Koman	5	146 500
HEC-et Lokale	8	22 980
HEC Ulzë	6	36 600
HEC Shkopet	5	24 640
TEC Fier	121	187 640
Totali	164	806 720

Prioritet u është dhënë fillimisht testimit të transformatorëve më të mëdhenj që kanë dhe sasi më të madhe vaji, kryesisht në Nënstacionet 400 kV dhe 220 kV. Këta transformatorë janë kryesisht prodhim i viteve të fundit. Gjithashtu, një tregues i rëndësishëm për përzgjedhjen e transformatorëve për t'u testuar është raporti në peshë $WR > 30 \%$, pra raporti i peshës së vajt me peshën totale të pajisjes. Për këtë janë shfrytëzuar të dhënat e siguruar nga inspektimet e bëra pothuaj në të gjitha objektet energjetike. Por, meqenëse mungojnë regjistrimet e lëvizjeve të

vajit si dhe monitorimi i tij për praninë e PCB-ve, nuk mund të jemi të sigurt për WR >30%, pasi kjo do të ishte e saktë vetëm nëse pajisja ka akoma brenda vetëm vajin fillestar.

Për këtë arsye janë testuar edhe transformatorë të vegjël të kabinave elektrike, transformatorë të reparteve ushtarake, etj. që u përkasin viteve të ndryshme të prodhimit duke filluar nga vitet '50, por shumica e transformatorëve të testuar janë prodhim i viteve '70.

Rezultatet tregojnë se 5.3 % e sasisë së vajit të analizuar mund të konsiderohet si e ndotur me PCB.

Ekspertët e grupit të punës kanë përdorur test-kitet e prodhuara nga kompania Deksil për testimin e përmbajtjes së PCB-ve në vajin e transformatorëve. Për shkak të numrit të kufizuar të mostrave të vajit të analizuar, rezultatet nuk mund të përgjithësohen në nivel kombëtar.

Tabela 7: Të dhëna mbi transformatorët e N/Stacioneve 110/35/ kVA ne 8 Zonat e Divizionit të Shpërndarjes

Kesh/zonat e divizionit të shpërndarjes	Numri i përgjithshëm i nënstacioneve	Numri i përgjithshëm i transformatorëve	Masa e përgjithshme e vajit (litra)
Durrës	12	24	293 324
Berat	23	35	330 250
Elbasan	27	49	471 640
Fier	18	30	212 520
Shkodër	14	32	240 330
Korçë	27	45	418 780
Burrel	24	42	360 730
Tiranë	16	41	435 920
Totali	161	298	2.763.494

Tabela 8: Të dhënat mbi transformatorët e kabinave të ndarë sipas 8 Zonave të Shpërndarjes së Divizionit të Shpërndarjes

KESH/Zonat e Divizionit të shpërndarjes	Numri i përgjithshëm i transformatorëve	Masa e përgjithshme e vajit (litra)
Durrës	1 064	283 620
Berat	1 044	319 990
Elbasan	1 200	169 440
Fier	1 338	333 130
Shkodër	1 896	539 310
Korçë	761	197 014
Burrel	1 333	775 870
Tiranë	2545	765 595
Totali	11 181	3 383 969

Tabela 9: Të dhëna mbi transformatorët e fuqisë kryesisht 220 kVA dhe 400 kVA të OSTSH

OSTSH/Nënstacionet	Numri i përgjithshëm i transformatorëve	Masa e përgjithshme e vajit (litra)
Burrel	4	49 445
Tiranë	12	279 576
Elbasan- 400 kVA	5	71 170
Elbasan-220 KV	6	85 050
Fier	6	284 100
Korçë-Zemblak	3	73 460
Durrës-Rrashbull	4	86 350
Shkodër/HEC Fierzë	9	39 000
Shkodër/HEC Vau i Dejës	2	82 100
Shkodër/HEC Koman	0	0
Totali	51	1 050 251

Metodika e Inventarit të PCB-ve

Metodika e inventarizimit të PCB-ve dhe rezultatet e arritura janë mbështetur në udhëzuesit ndërkombëtarë si dhe në informacionet më të vlefshme në vend. NjAM në KESH përzgjodhi një grup pune të përbërë nga ekspertë të NjAM dhe nga specialistë të objekteve të ndryshme të KESH/OST në të gjithë vendin për të përgatitur dhe përpunuar programin e inventarizimit të PCB-ve.


Meqenëse kanë munguar informacionet, evidentimet dhe regjistrimet, NjAM në KESH përgatiti një tabelë/pyetësor, të cilin e shpërndau në gjitha objektet e KESH/OST në të gjithë vendin. Ky pyetësor përmbledhë të gjithë informacionin e duhur mbi transformatorët /pajisjet që do t'i nënshtroheshin inventarizimit si: vitin dhe vendin e prodhimit, përmasat, peshën dhe kapacitetin, gjendjen aktuale të pajisjes, mirëmbajtjen e saj, gjendjen mjedisore të pajisjes në përdorim, ndikimi i saj në mjedis, të dhëna mbi vajin e pajisjes (pesha e vajit, emri tregtar i tij), etj.

Qëllimi kryesor i këtij Inventarizimi paraprak të PCB-ve është identifikimi i të gjitha pajisjeve elektrike që mund të përmbajnë vaj PCB ose vaj mineral të ndotur me PCB si dhe sasinë e mbetjeve me PCB për të përmbushur kërkesat e Konventës së Stokholmit, për të vlerësuar infrastrukturën ekzistuese në vend dhe për të vendosur prioritetet e duhura për proceset e mëtejshme.

Objekti i Inventarit të PCB-ve është identifikimi i të gjithë transformatorëve me PCB që janë në përdorim dhe/ose jashtë përdorimi, zbatimi i masave paraprake kryesisht në pajisjet me PCB në përdorim (ato që vazhdojnë të përdoren, që janë jashtë pune, që presin të asgjësohen), për të siguruar monitorimin e përputhjes teknike të të gjitha pajisjeve me PCB që janë në përdorim dhe për të siguruar ndjekjen e pajisjeve me PCB deri në fund të jetës së tyre.

Sipas Konventës së Stokholmit duhet të identifikohen, të etiketohen dhe të hiqen nga përdorimi pajisjet që përmbajnë më shumë se 10 % PCB (100 000 ppm) dhe vëllim më të madh se 5 litra, të identifikohen, etiketohen dhe të hiqen nga përdorimi pajisjet që përmbajnë më shumë se 0.05 % PCB (500 ppm) dhe vëllim më të madh se 5 litra, dhe të bëhen përpjekje që të identifikohen dhe të hiqen nga përdorimi pajisjet që përmbajnë më shumë se 0.005 % PCB (50 ppm) dhe vëllim më të madh se 0.05 litra.

Fig. 5: Skema e institucioneve të përfshira në procesin e inventarizimit të PCB-ve.



NJAM në KESH ka përpunuar një bazë të dhënash, një mjet menaxhimi i integruar për identifikimin e pajisjeve me PCB dhe të prodhuesve të PCB-ve, për të siguruar të dhëna të përmirësuara për MQM për pajisjet me PCB dhe për zbatimin e planit kombëtar të asgjësimit të PCB-ve.

Disa tregues të elementëve në këtë bazë të dhënash janë: burimet e informacionit, të dhëna mbi pajisjet me PCB, (identifikimi i pronarit dhe pajisjes, mirëmbajtja, siguria mjedisore, gjendja administrative e pajisjes) të dhëna statistikore dhe mjetet për identifikimin dhe ndjekjen teknike. Në këtë bazë të dhënash përfshihet edhe identifikimi i pronarit, klasifikimin e aktivitetit, rrezikshmërinë e lidhur me aktivitetin: shkolla, spitale, industrinë kimike dhe ushqimore si dhe vendndodhjen: zonë urbane, rurale, industriale, identifikimin e pajisjes (transformator, kondensator), mirëmbajtjen e pajisjes, sigurinë dhe ndikimin mjedisor, sistemi rregullator për pajisjet.

Përmbledhja e rezultateve të inventarit të transformatorëve

PCB-të nuk janë prodhuar kurrë në Shqipëri. Vaji i transformatorëve është importuar gjithmonë nga shtete të tjera të Europës ose Azisë. Transformatori më i vjetër në KESH është rus, i vitit 1950. Në të kaluarën furnizuesit kryesorë të Shqipërisë me transformatorë kanë qenë BRSS dhe Kina. Transformatorët e prodhuar në BRSS e kanë moshën rreth 50 vjet. Pjesa më e madhe e transformatorëve në Shqipëri janë kinezë, rusë, bullgarë, maqedonas dhe rumunë. Në vitet e fundit janë importuar shumë transformatorë nga Italia, Kroacia, Zvicra dhe Belgjika.

Deri tani nuk ka pasur kontroll në dogana dhe në Magazinën Qendrore në Shkozë, Durrës, për përmbajtjen e PCB-ve në pajisje dhe në vaj në lidhje me sasinë e vajit dhe prezencën e PCB-ve në të.

Vaji i transformatorëve është elementi kryesor në të gjitha objektet e KESH-it i cili mund të ndotë mjedisin përreth. KESH/OSTSH kanë në përdorim sasi shumë të mëdha të vajit mineral, rreth 8000 ton. Sasia e vajit në transformatorët e KESH/OSTSH shkon nga 70 kg deri në 102 ton për transformator.

Në objektet energjetike janë në përdorim shumë transformatorë të vjetër të prodhuar para vitit 1970, të cilët kanë krijuar ndotje të mjedisit veçanërisht në tokë dhe ujë për shkak të rrjedhjeve të vajit dhe pikimeve gjatë procesit të mirëmbajtjes ose për shkak të vjetërsisë së tyre. Pjesa më e madhe e transformatorëve janë vendosur në tokë ose mbi një bazament por nuk kanë rezervuar dytësor poshtë transformatorëve. Lehtësisht mund të shikohet toka e ndotur poshtë transformatorëve prandaj kërkohet ndjekja e problemit të ndotjes së tokës dhe ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësorë.

Mbështetur në të dhënat e siguruar nga pyetësi i inventarit paraprak të PCB-ve, numri i transformatorëve të të gjithë kapaciteteve në përdorim, të vendosur në të gjithë objektet e KESH/OST është rreth 12000 copë. Pjesa më e madhe e tyre (rreth 98%) janë transformatorë të shpërndarjes, me kapacitet të ulët, të vendosur në kabina të vogla elektrike që shërbejnë për furnizimin e konsumatorëve familjarë.

Rreth 50% e sasisë së përgjithshme të transformatorëve janë prodhuar para vitit 1990 (rreth 6000 copë) dhe vjetërsia mesatare e transformatorëve është shumë e madhe: 28 vjet. Rreth 98 % e transformatorëve janë transformatorë të vegjël të vendosur në kabina elektrike që i përkasin Divizionit të Shpërndarjes. Pjesa tjetër e transformatorëve është vendosur në nënstacionet e KESH/OST, 298 prej tyre i përkasin Divizionit të Shpërndarjes, 164 i përkasin Divizionit të Prodhimit dhe 51 i përkasin OSTSH.

Për shkak të mungesës së një programi sistematik të kontroll-monitorimit, asnjë laborator në Shqipëri nuk është në gjendje të analizojë praninë e PCB-ve në vaj ose tokë, prandaj dhe rezultatet paraprake janë mbështetur në rezultatet e marra me test-kite (Deksil).

Në kuadrin e projektit për përgatitjen e PKV për NOQ janë inspektuar rreth 57 objekte energjetike dhe janë analizuar rreth 169 mostra vaji. Rezultatet tregojnë që 5,3% e sasisë së analizuar mund të konsiderohet si e dyshuar me PCB (PCB>50 ppm).

Në qoftë së marrim rezultatet e arritura në transformatorët e analizuar dhe i shtrijmë në të gjithë sasinë e transformatorëve të prodhuar para vitit 1990, atëherë sasia e transformatorëve të ndotur me PCB mund të jetë:

Numri i transformatorëve të prodhuar para vitit 1990:	6 000 copë
Pesha mesatare e transformatorëve të Shpërndarjes:	1,5 ton
Përqindja e transformatorëve që priten të jenë të ndotur:	5,3 %
Numri i transformatorëve që priten të jenë të ndotur:	rreth 320
Pesha e përgjithshme e transformatorëve:	1100 ton
Pesha e përgjithshme e vajit:	300 ton
Pesha e përgjithshme e transformatorëve të thatë:	800 ton

Rreth 10% e transformatorëve e kanë RP-në (Raporti i peshës së vajit me peshën e transformatorit) >30% dhe nga analizat me test kite nuk kanë rezultuar me densitet pozitiv (me te madh se 1): këta transformatorë mund të konsiderohen si të rimbushur dhe të dyshuar për përmbajtje të PCB-ve.

Meqenëse më parë nuk ka ekzistuar asnjë kontroll për praninë e PCB-ve në vaj dhe në pajisje, për të ndaluar procesin e ndotjes së tërthortë kërkohet të ndërmerren veprime të menjëhershme për menaxhimin e PCB-ve.

Inventari Paraprak i PCB-ve nxori në pah mosekzistencën e mëparshme të normave (limiteve) dhe metodave për analizat e PCB-ve, nivelin e kufizuar të ndërgjegjësimit të punonjësve përmes menaxhimit të përgjegjësive në sektorin publik dhe atë privat, ndërgjegjësimin e ulët të punonjësve të zbuluar ndaj rrezikut të PCB-ve, nivelin e ulët të

informimit dhe të ndërgjegjësimit për PCB-të në të gjitha grupet e popullsisë, mungesën e informimit dhe ndërgjegjësimit të popullsisë në përgjithësi për rrezikun e mundshëm të PCB-ve (të vajrave të transformatorëve), mungesën e monitorimit të PCB-ve në ajër, tokë dhe ujërat sipërfaqësore e nëntokësore që mund të jenë ndotur me vaj që përmban PCB.

Kondensatorët

Funksioni kryesor i kondensatorëve është që të japin mbështetje dinamike për tensionin e sistemit sidomos gjatë stakimit të qarkut elektrik që ndodh menjëherë mbas defektit, për të siguruar reagimin dinamik më të mirë të mundshëm në kushtet e rrjetit elektrik me rezistencë rrjeti të ndryshueshme në zona të ndryshme të tij. Struktura e ndërtimit dhe ana funksionale e kondensatorëve garantojnë si nivel të ulët të zhurmave ashtu edhe interferencë të ulët magnetike, duke bërë që ndikimi i tyre në mjedis të jetë i kufizuar.

Numri i kondensatorëve në objektet e KESH/OSTSH është i kufizuar. Ata janë vendosur në N/Stacionin 220 kV në Fier (2x25 MVar), në N/Stacionet 110 kV në Lushnje dhe në Ballsh, (secili prej tyre është 25 MVar). Ata i përkasin OSTSH-se ndërsa dy Divizionet e tjerë nuk i përdorin kondensatorët.

Qëllimi i instalimit të kondensatorëve është të ruajnë stabilitetin dhe kapacitetin e transmetimit të energjisë në rrjet gjatë kushteve të ndryshme të tij. Kondensatorët përmbajnë sasi të vogël vaji dhe në trupin e tyre ka pak pika lidhëse, kështu që ata nuk kanë krijuar ndotje mjedisi përreth tyre. Sidoqoftë, NjAM do t'i ketë në konsideratë këta kondensatorë si burime të mundshëm ndotjeje dhe do të bëjë kujdes për marrjen e masave parandaluese për ndikimin e tyre në mjedis.

Në formë të përmbledhur në tabelat më poshtë jepen të dhëna mbi analizat e transformatorëve për përmbajtjen e PCB-ve dhe të dhëna të tjera të nxjerra në kuadër të këtij inventari.

Tabela 10: Të dhëna të përgjithshme për transformatorët objekt i inventarit

NUMRI I TRANSFORMATORËVE TË IDENTIFIKUAR)	544
Numri i transformatorëve të analizuar (prova me test-kit)	169
Numri i transformatorëve të analizuar (< 50 ppm)	160
Numri i transformatorëve të analizuar (> 50 ppm)	9
Përqindja e transformatorëve të ndotur me PCB në krahasim me numrin e transformatorëve të analizuar:	5,3 %

Pesha e përgjithshme e transformatorëve të analizuar, të dyshuar se janë të ndotur: 230 ton

Pesha e përgjithshme e vajit e transformatorëve të analizuar, të dyshuar se janë të ndotur: 57 ton

Pesha e përgjithshme e transformatorëve të thatë të analizuar, të dyshuar të jene të ndotur: 173 ton

Duhet theksuar se të dhënat e mësipërme janë mbështetur në testimet e vajit të transformatorëve në nënstacione dhe kabina elektrike vetëm me anën e test kiteve mbasi, hë për hë, në vend këto analiza nuk mund të bëhen me gaz kromatograf.

Rezultatet statistikore për shpërndarjen e rezultateve të transformatorëve të analizuar jepen në Tabelën 11

Tabela 11 : Shpërndarja e transformatorëve sipas kategorive

Transformatorë të prodhimit të energjisë	8 %
Transformatorë të transmetimit të energjisë	19 %
Transformatorë të shpërndarjes së energjisë	73 %
Përqindja e transformatorëve të shpërndarjes të ndotur me PCB	8%
Përqindja e transformatorëve të shpërndarjes pa PCB	92 %

Tabela 12: Vjetërsia e transformatorëve (nr. i transformatorëve të marrë në konsideratë për këto llogaritje: 488)

Vjetërsia mesatare e transformatorëve të inspektuar që e kanë vitin e prodhimit	28 vjet
Numri i transformatorëve mbi moshë (> 30 vjet):	218
Përqindja e transformatorëve mbi moshë	45 %

Fig. 6: Grafiku i vjetërsisë së transformatorëve





Fig. 7: Grafiku i vitit të prodhimit të transformatorëve



Shtirja e mbetjeve të pritshme me PCB të prodhuara para vitit 1990 që do të eliminohen, mbështetur në sasinë e ndotur me PCB prej 5,3% :

Numri i transformatorëve të prodhuar para vitit 1990: 6 000 copë
 Pesha mesatare e transformatorëve të shpërndarjes: 1,5 ton
 Përqindja e transformatorëve që priten të jenë të ndotur: 5,3 %
 Numri i transformatorëve që priten të jenë të ndotur: rreth 320

Tabela 13. Peshat e transformatorëve dhe e vajit

Pesha e përgjithshme e transformatorëve:	1100 ton
Pesha e përgjithshme e vajit:	300 ton
Pesha e përgjithshme e transformatorëve të tharë:	800 ton

Tabela 14. Variante teknike për trajtimin e transformatorëve me vaj PCB

Vaj mineral i ndotur me PCB	Deklorinim (shpërbërje kimike)
	Djegje në furrë çimentoje
Transformatorë të zbrazur	Proces me larje

Tabela 15. Variante teknike për trajtimin e transformatorëve me vaj PCB

Vaj mineral i ndotur me PCB	Djegje në temperatura të larta (eksport)
Transformatorët e zbrazur	Procesi i dekontaminimit me autoklavë (Eksport në BE)

Zonat e ndotura me PCB

Në disa objekte të KESH/OSTSH gjenden shumë transformatorë të vjetër në përdorim, të cilët janë prodhuar përpara viteve '70 dhe kanë krijuar ndotje të madhe në mjedis, veçanërisht në tokë dhe ndoshta në ujërat nëntokësore, për shkak të pikimeve dhe rrjedhjeve të vajrave gjatë procesit të mirëmbajtjes dhe për shkak të vjetërsisë. Pjesa më e madhe e tyre janë të vendosur direkt në tokë ose në mbështetëse statike, pra poshtë tyre nuk ka gropa betoni ose depozita sekondare. Mund të vihet re, lehtësisht në mënyrë vizuale, toka e kontaminuar poshtë transformatorëve, gjë që kërkon të kryhen investigime si në tokë ashtu edhe në ujërat nëntokësorë. Gjithsesi mund të konsiderohen mjedise mjaft të ndotur Reparti i Riparimit të Transformatorëve në Tiranë ku ndodhet edhe magazina qendrore për të gjithë transformatorët e dëmtuar që vijnë nga të gjitha rrethet e Shqipërisë dhe Reparti i Rigjenerimit të Vajit në Tiranë.

Reparti i Rigjenerimit të Vajit në Tiranë është një nga më të ndoturit në Shqipëri. Në këtë implant vjen për trajtim vaji që është zbrazur nga transformatorët e dëmtuar ose ka humbur cilësitë e tij dhe më pas mbetjet e nxjerra nga rigjenerimi shkarkohen pa u trajtuar në lumë ose në tokë. Megjithëse para pak vitesh është bërë një rikonstrukcion i këtij reparti, dyshemeja dhe muret rreth tubacioneve në këtë repart janë të ndotura me vaj. Në tokën rreth tij vihen re njolla të mëdha vaji, pra është një pikë e nxehtë ndotjeje që kërkon vëmendje të veçantë.

- Reparti i Riparimit të Transformatorëve në Tiranë, ku ndodhet edhe magazina qendrore për të gjithë transformatorët e dëmtuar që vijnë për riparim nga të gjithë objektet e KESH/OST është një tjetër vend i ndotur. Ky repart është në punë që prej 30 vjetësh dhe në të nuk janë kryer asnjëherë kontrolle për praninë e PCB-ve. Të gjitha bazamentet prej betoni janë të ndotura me vajin e transformatorëve dhe gjatë procesit të zbrazjes ose mbushjes së tyre me vaj mund të ndodhin rrjedhje vaji dhe të ndotet territori, për shkak të mosekzistencës së kushteve të nevojshme në vendin e punës. Transformatorët janë vendosur direkt në tokë të ndotur me vaj, në vende të hapura dhe të zbuluar ndaj shiut, erës dhe nxehtësisë. Në këto kushte, ekziston rreziku i rënies së zjarrit, për më tepër që reparti ndodhet në qytet shumë afër godinave të banimit.

Për vite të tëra kanë ndodhur shumë rrjedhje vaji për shkak të mungesës së trajnimit të personelit, mbushjes së papërshtatshme me vaj të depozitave të transformatorëve ose përdorimit të pajisjeve të vjetra për dërgimin e vajit në pajisje.

Problemet përparësore dhe objektivat për administrimin e PCB-ve

Problemet përparësore

- Mungesë legjislacioni specifik për PCB-të (administrimi, trajtimi, monitorimi, heqja nga përdorimi);
- Vendimi i Këshillit të Ministrave No. 103, dt. 31.3.2002, "Për Monitorimin e Mjedisit në Republikën e Shqipërisë" nuk përcakton institucionet që duhet të monitorojnë praninë e PCB-ve në vajrat e pajisjeve të ndryshme;
- Inventar jo i plotë i pajisjeve me PCB;

- Mungesë udhëzuesish të brendshëm për administrimin, trajtimin dhe heqjen nga përdorimi të pajisjeve të KESH-it që përmbajnë PCB;
- Shkallë e ulët ndërgjegjësimi të punonjësit potencialisht të ekspozuar ndaj PCB-ve;
- Nivel i ulët i informimit dhe i ndërgjegjësimit të publikut të gjerë për rreziqet potenciale nga PCB-të (në vajrat e transformatorëve);
- Mungesë monitorimi të ndotjes nga PCB-të në mjedise të ndryshme;
- Ndotje e mundshme e ajrit, tokës dhe ujërave sipërfaqësorë e nëntokësorë nga vajrat që përmbajnë PCB;

Objektivat

- ➔ Krijimi i kuadrit ligjor për administrimin, heqjen nga përdorimi dhe eliminimin e PCB-ve;
- ➔ Administrim, trajtim, eliminim dhe monitorim i sigurt i PCB-ve;
- ➔ Kontroll shëndetësor i grupeve përkatëse të popullsisë;
- ➔ Kontroll i rreziqeve mjedisore nga PCB-të;
- ➔ Monitorim i ndotjes nga PCB-të në vajrat e transformatorëve dhe në mjedise të veçanta;
- ➔ Rehabilitimi i vendeve të ndotura me PCB.

2.3.3 DDT

DDT filloi të përdoret masivisht në Luftën e II Botërore. Ajo përdorej për të luftuar sëmundjet që transmetohen me insekte dhe për të mbrojtur trupat. Ajo ishte veçanërisht efikase në mbrojtjen nga malaria, tifoja, ethet e verdha, verbimi i lumenjve dhe encefaliti. Malaria u eliminua afërsisht në vitet 1960. India, e cila përpara se të futej në përdorim DDT kishte mbi 75 milion raste të tilla, ka tashmë më pak se një milion që nga vitet 1962, dhe duke filluar prej vitit 1970 ka vetëm 200,000 raste. Organizata Botërore e Shëndetësisë vlerëson se janë shpëtuar miliona jetë njerëzish nga përdorimi i DDT.

Tashmë është pothuajse i ndaluar përdorimi i DDT në gati të gjitha vendet në bujqësi dhe një numër vendesh e kanë shtrirë këtë ndalim edhe në fushën e shëndetit publik. Sidoqoftë, në disa vende, ku vektori i malaries është ende i ndjeshëm, DDT përdoret për dezinfektimin e banesave, pra në mjediset e brendshme, në formë aerosoli.

Kapitulli që vijon përmbledh disa të dhëna për përdorimin e DDT dhe lindanit në të shkuarën në Shqipëri dhe i vlerëson ato në lidhje me kërkesat e Konventës së Stokholmit. Së fundi, evidentohen problemet prioritare dhe objektivat, si dhe propozohen disa hapa për të ardhmen.

Kërkesat e veçanta të Konventës së Stokholmit

Palët: [Artikulli 3, para. 1]

(b) "të ndalojnë prodhimin & përdorimin" e kimikateve të Aneksit B

- "për qëllime të pranueshme" të specifikuara për këto kimikate

Të gjitha Palët të eliminojnë prodhimin dhe përdorimin e DDT me përjashtim të atyre që njoftojnë Sekretariatit që kanë synimin të prodhojnë dhe/ose të përdorin DDT në programet për kontrollin e vektorëve ("për qëllime të pranueshme" në Aneksin B):

Palët duhet të përfshihen në një Regjistër të DDT specifik të hapur për publikun dhe që mbahet në Sekretariat.

Pala mund të tërhiqet nga regjistri i DDT në çdo kohë.

Prodhimi dhe/ose përdorimi duhet të bëhen në përputhje me rekomandimet dhe udhëzimet e OBSH-së, dhe vetëm në ato raste kur Pala nuk disponohen alternativa të tjera të sigurta, efektive dhe të përballueshme financiarisht

Gjendja në Shqipëri.

DDT-ja filloi të përdorej në Shqipëri në vitet 1946–1947 në luftën kundër vektorëve të malaries.

Shqipëria ka qenë një vend ku malaria ishte mjaft e përhapur dhe gjysma e popullsisë së atëhershme (në vitin 1959) është mbrojtur me anë të spërkatjes dy herë në vit të banesave me DDT, numri i të cilave arriti në mbi 100.000.

Në qytete është kryer fushata antilarva. Në zonat moçalore dhe kënetat është kryer spërkatja me avionë në intervale 10 – 15 ditore gjatë periudhës maj-tetor.

Në vitet 1946-1947 deri 1959-1960, sasi të mesatare vjetore të DDT dhe HCH për spërkatjen e banesave me metodën manuale si dhe përdorimit të avionit në sipërfaqet ujore, ku ka qenë shumë e përhapur mushkonja anofele, arritën 90-120 ton. Krahmasave bonifikuese, të diagnostikimit dhe të mjekimit masiv e parandalues, përdorimi i DDT në luftën kundër vektorëve të malaries vlerësohej i çmuar për shkak të efektit të lartë dhe të zgjatur, qoftë dhe me një apo dy spërkatje në vit të mureve të banesave.

DDT zakonisht kombinohet si më poshtë:

- DDT emulsion 25% për banesat në zona të largëta e pa rrugë dhe DDT teknik (tretje në vajguri) në zonat më të afërta me rrugë.

- DDT emulsion 25% me hollim 1:40 për spërkatjen me avion, nga 1 deri 3 mbushje në ditë me 1000 litra secila.

- Kombinime: 10 litra DDT emulsion 25% + 1 kg heksakloran + 10 lit. Flibol (SCHVIM 1:50) ose DDT 25% emulsion me flibol në pjesë të barabarta (1:1), nga e cila 1 lit hollonhet me 40 lit ujë.

DDT ka qenë mjaft i kërkuar nga popullata edhe për luftimin e insekteve të tjera si morrat, mizat, pleshtat e çimkat, që kishin pushtuar familjet e zonave të varfra të Shqipërisë të asaj kohe.

Viti 1967 konsiderohet si viti i çrrënjësjes së malaries në Shqipëri, çka u çertifikua zyrtarisht nga OBSH-ja pas kërkesës së shtetit shqiptar.

Sipas studiuesve dhe ekspertëve malariologë të vendit, DDT-ja nuk u përdor më pas vitit 1970. Në konsultimet e bëra ata deklarojnë se një rezervë prej 20-30 ton u mbajt nga Ministria e Shëndetësisë për dy arsye :

E para: Megjithëse ishte realizuar çrrënjësja e malaries, mund të priteshin shpërthime të mundshme nga raste të importuara;

E dyta: sepse kishte filluar rezistenca e mushkonjave anofeles, pas një përdorimi prej mbi 20 vjetësh.

Informacioni i mbledhur nga disa rrethe dëshmon se DDT dhe lindani janë përdorur deri 15 vjet më parë. Lindani është përdorur kryesisht kundër zgjebes dhe parazitëve. Përdorej kryesisht në pomada dhe emulsione 1% gjatë periudhës 1975 – 1985. Pas kësaj kohe u ndalua përdorimi i tij për shkak të rezistencës së parazitëve.

Ndonëse ndikimi i pesticideve në shëndetin publik ka qenë i njohur, në Shqipëri nuk ka pasur ndonjë sistem monitorimi ose mbledhje të dhënash për të përcaktuar këtë

ndikim. Kohët e fundit janë bërë disa përpjekje nga ISHP për të studiuar mbetjet e pesticideve në zinxhirin ushqimor dhe në gjakun e disa banorëve. Këto depistime janë kryer në një zonë të Porto-Romanos (pranë ish-uzinës së prodhimit të kimikateve).

Në gjakun e personave që jetojnë në rrethinat dhe në territorin e ish-fabrikës janë gjetur nivele të izomerive α dhe β të HCH-së, që shkojnë, përkatësisht, deri 0.0028 $\mu\text{g/ml}$ dhe nga 0.005 $\mu\text{g/ml}$ në 0.0915 $\mu\text{g/ml}$. Nivelet më të larta i kanë personat që jetojnë në territorin e ish-uzinës së përmendur më sipër. Vlerat e matura për izomerin γ ishin të krahasueshme me ato të provave të bardha. Në mostrat e analizuara vlerat e izomerit δ ishin të pakapshme.

Tabela 16: Rezultatet analitike të HCH në qumësht të krahasuara me mostrat e UNEP-it

Kampioni	α -HCH	β -HCH	γ -HCH (lindan)	δ -HCH	gjithsej HCH
	MG/KG DHJAMË				
KAMPIONI I UNEP	4.86	7.27	0.13	0.47	12.7
QUMËSHT (KAMPIONI I ISHP)	3.34	2.69	0.39	0.39	6.8

Burimi: Tafaj L. (2003): *Një zonë e ndotur me heksaklorocikloheksan në Shqipëri, Perspektiva e shëndetit mjedisor*, Forumi i VII Ndërkombëtar i HCH dhe Pesticideve, Kiev, Ukrainë, 5-7 qershor 2003.

Prania e niveleve të larta të izomereve β të HCH, krahasuar me izomerët e tjerë HCH mund të shpjegohet me aftësinë e këtyre izomereve për t'u vendosur dhe për të qëndruar më gjatë se të tjerët. Niveli i izomereve β të HCH, është dukshëm i ulët në personat që qëndrojnë larg fabrikës, deri në nivele të ulëta për personat që jetojnë në largësi 120 m në veri të fabrikës.

Dy kampione qumështi të marra në zonën e Porto-Romanos në kuadër të studimit të fizibilitetit të UNEP dhe në kuadër të një studimi të kryer nga ISHP, përmbanin nivele të larta të HCH.

Përqendrimi maksimal i lejuar për lindanin në yndyrën e qumështit është 0.2 mg/kg (në bazë të legjislacionit Gjerman). Nivelet e lartpërmendura të HCH të gjetura në qumësht e kalojnë 30-60 herë këtë përqendrimi maksimal të lejuar.

Përqendrimet e izomereve të HCH të gjetur në mostrat e qumështit në Porto Romano tejkalojnë dhjetëra herë rastet e literaturës të viteve '70, në periudhën kur filloi kufizimi i përdorimit të HCH.

Të dyja mostrat na japin idenë për nivelin e shkallës së ndotjes dhe për nivelet shumë të larta të HCH në qumështin e prodhuar në zonën e Porto Romanos, e cila është tregtuar edhe në zona të tjera të rrethit të Durrësit.

Përqendrimi i HCH i gjetur në qumësht na jep një ide të qartë që nuk mund të përdoret për konsum nga njerëzit mbasi përbën rrezik serioz për shëndetin publik.

Në tabelën 17 jepet situata në lidhje me NOQ-të në sektorin e shëndetësisë në dhjetor 2005 sipas inventarizimit të kryer në kuadër të projektit për përgatitjen e Planit Kombëtar të Veprimit për NOQ-të.

Sasitë e identifikuara të DDT dhe heksakloranit/lindanit janë hequr nga Shqipëria në kuadër të projektit të MMPAU, "Riambalazhimi dhe largimi nga Shqipëria i pesticideve dhe kimikateve të tjera nga Bishti i Pallës" i financuar nga Qeveria Holandeze. Ky largim u përfundua në muajin korrik 2006.

Tabela 17: Stoque të DDT e të Lindanit në magazinat e MSH

Nr	Rrethi	Vend-ndodhja	Sasia DDT (kg)	Sasia Lindan (kg)	Paketimi
1	Gjirokastrë	DKSHP	50 kg sol. 25 %	-	Fuçi
2	Durrës	DKSHP	200 kg sol. 25 %	24.2 kg (sol.10%)	Fuçi, shishe X 500 ml
3	Elbasan	DKSHP	100 kg sol. 25%	-	Fuçi
4	Lushnjë	DKSHP	1040 kg sol. 25%	200 (HCH)	Fuçi, thasë
5	Lezhë	DKSHP	-	704.6 (sol. 10%)	Shishe X 50 ml
6	Rezerva shtetërore	Lundër	108 kg sol. 25%	212 (pluhur)	Fuçi
	GJITHSEJ	6 vende	1948 kg sol 25%	1140 kg	Fuçi, shishe, thasë

Problemet përparësore dhe objektivat për administrimin e DDT.

Problemet prioritare që janë të lidhura me kontrollin dhe administrimin e ish-magazinave të DDT, kanë të bëjnë me mjedisin, tokën, kontaminimin e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore. Është e domosdoshme që laboratorët përkatës të pajisen me aparatura për të kryer analizat e kontrollit për ndotjen e krijuar në mjedis, tokë, ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore dhe, në të njëjtën kohë, të trajnohet stafi. Kështu mund të arrihet të bëhet analiza, vlerësimi i riskut dhe të përcaktohen ndërhyrjet e nevojshme e të sigurta për mbrojtjen e shëndetit të njerëzve dhe të mjedisit.

Problemet përparësore.

- Mungesë e kapaciteteve për studime analitike në lidhje me kontaminimin e ish-magazinave të DDT, si edhe të mjedisit rrethues;
- Mungesë ndërgjegjësimi për vendet e kontaminuara për sa u përket rreziqeve të mundshme në shëndet për popullatën që jeton në afërsi të këtyre vendeve .

Objektivat

- ➔ Forcimi i kapaciteteve të laboratorëve të IMB, ISHP, dhe LQU për monitorimin e DDT.
- ➔ Përcaktimi i kontaminimit eventual të ish-magazinave dhe zonave përreth tyre nga DDT;
- ➔ Rritja e ndërgjegjësimi për vendet e kontaminuara për sa u përket rreziqeve të mundshme në shëndet për popullatën që jeton në afërsi të këtyre vendeve.

2.3.4 NOQ-të e Prodhuara Jo-Qëllimisht

Hyrje

NOQ-të e prodhuar në mënyrë të paqëllimshme, siç përcaktohet në Konventën e Stokholmit, janë dibenzofuranet e polikloruara (PCDF) dhe dibenzo-p-dioksinat e polikloruara (PCDD) si dhe bifenilet e polikloruara (PCB), ku PCB-të janë formuara si nënprodukte.

Dibenzofuranet e polikloruara (PCDF) dhe dibenzo-p-dioksinat e polikloruara (PCDD) janë ndotësit mjedisor të zbuluar në pothuajse të gjithë komponentët e ekosistemit të globit në sasi gjurmësh. Përbërës të kësaj klase në veçanti kanë shkaktuar problemet kryesore mjedisore.

Ekzistojnë 75 lloje dioksinash (PCDD) dhe 135 lloje (PCDF) furanesh. Shtatë lloje dioksinash dhe 10 lloje furanesh janë përcaktuar si toksike.

Dioksinat janë ndër kimikatet më toksike të njohura nga njeriu, 10 herë më toksike se armët kimike (Zarin, Zaman, VX) ose toksinat natyrale (helmi i një lloji peshku, gjarpri), dhe 100 herë më toksike se striknina. Rrallëherë shkaktohen helmime akute, por dioksinat janë të qëndrueshme dhe bio-akumulohen te njeriu. Si pasojë, problemi kryesor janë efektet kronike.

Rreth 90% e PCDD dhe PCDF merren nga njeriu nëpërmjet zinxhirit ushqimor. Rrugë të tjera të rëndësishme të ekspozimit mund të jenë thithja nëpërmjet frymëmarrjes ose qëllitja e grimcave të ndotura.

PCDD/PCDF, në dallim nga kimikatet e tjera NOQ, si pesticidet e polikloruara, si psh DDT, asnjëherë nuk prodhohen në mënyrë të qëllimshme. NOQ-të aksidentale formohen nga nënproduktet e aktiviteteve të shumta industriale dhe më shumë nga proceset e djegies.

Të gjitha format e djegies, industriale dhe shtëpiake, mund të çlirojnë dioksina në qoftë se është i pranishëm klori, qoftë edhe në sasi të vogla (gjurmë):

- Djegia e mbeturinave (duke përfshirë mbetjet urbane, mjekësore dhe të rrezikshme).
- Djegia e lëndëve djegëse të ngurta dhe të lëngshme duke përfshirë qymyrin, naftën dhe drutë në impiante të mëdha, siç janë ato të prodhimit të energjisë elektrike dhe në sasi të vogël në sobat e ngrohjes dhe zjarret shtëpiake.
- Procese të tjera si djegje e mbeturinave të oborreve të shtëpive, zjarret e mëdha dhe zjarret aksidentale;
- Proceset industriale, duke përfshirë proceset termike, prodhimin e metaleve, uzinat e skorieve, furrat me hark elektrik dhe prodhimin e metaleve jo ferore;
- Proceset e prodhimit kimik. Prodhimi i pesticideve aromatike të polikloruara p.sh. 2,4,5-T dhe PCP; fenolet e kloruara; disa tretës të kloruar dhe vinil-kloruret;

Kërkesat përkatëse të Konventës së Stokholmit

Vendet palë duhet të marrin të paktën masat e më poshtme:

- përgatitjen e planit të veprimi;
- pakësimi i shkarkimeve ose eliminimi që në burim;
- zëvendësimi i materialeve, produkteve, proceseve;
- futjen e Teknikave më të Mira të Disponueshme (TMD) dhe të Praktikave më të Mira Mjedisore (PMM) për burimet e reja dhe ekzistuese.

- Plani i Veprimit për Ndotësit Organikë të Qëndrueshëm [Neni 5, para. (a)]

Çdo vend anëtar duhet të përgatisë një Plan Veprimi ose, kur vlerësohet e domosdoshme, Plan Rajonal, brenda dy vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Konvente për këtë vend, dhe, më pas, ta zbatojë këtë Plan si pjesë e planit të zbatimit të specifikuar në Nenin 7, i projektuar të identifikojë, karakterizojë dhe trajtojë shkarkimin e kimikateve të renditura në Aneksin C.

Plani i Veprimit duhet të përfshijë elementet e mëposhtëm:

- (i) Një vlerësim të shkarkimeve ekzistuese dhe atyre të parashikuara, duke përfshirë hartimin e inventarit në burim dhe vlerësimin e shkarkimeve, duke marrë në konsideratë kategoritë e burimeve të identifikuar në Aneksin C;
- (ii) Një vlerësim të efikasitetit të ligjeve dhe politikave të Vendeve Anëtare lidhur me menaxhimin e këtyre shkarkimeve;
- (iii) Strategjitë për të arritur detyrimet e këtij paragrafi, duke marrë në konsideratë vlerësimet në pikat (i) dhe (ii);
- (iv) Hapat për të promovuar edukimin duke trajnuar me qëllim ndërgjegjësimin për këto Strategji;

Një rishikim çdo 5 vjet të këtyre strategjive.

Një program për zbatimin e Planit të Veprimit, duke përfshirë aty strategjitë dhe masat;

Promovimi i zbatimit të masave të vlefshme, të mundshme dhe praktike që në mënyrë të shpejtë dhe të dukshme mund të pakësojnë nivelin e shkarkimeve ose eliminimin në burim.

Plani i Veprimit duhet të përgatitet brenda 2 vjetësh nga hyrja në fuqi dhe mund të jetë kombëtar ose rajonal, pjesë përbërëse e planit të përgjithshëm sipas Nenit 7.

Për burimet industriale të cilat Palët i kanë identifikuar si me potencial relativisht të lartë formimi dhe shkarkimi të NOQ-ve në mjedis (duke përfshirë ato të kategorive në Aneksin C Pjesa II), ato duhet:

për burimet e reja të sigurojnë këto veprime:

promovimin, dhe siç parashikohet për një plan veprimi, përdorimin e TMD [Neni 5, para. (d)]

faza për secilën prej kërkesave të TMD-s për burimet e reja në kategoritë e Aneksit C pjesa II, sa më shpejt që të jetë e mundur të praktikohet, por jo më vonë se 4 vjet pas hyrjes në fuqi

promovimi i përdorimit të PMM [Neni 5, para. (d)]

për burimet ekzistuese, promovimi i TMD dhe PMM [Neni 5 (e)]

Kjo përfshin:

Përdorimin e materialeve të modifikuara, prodhimeve dhe proceseve për të parandaluar formimin dhe shkarkimin në mjedis të kimikateve të renditura në Aneksin C, duke marrë në konsideratë udhëzimet e përgjithshme për masat për parandalimin dhe pakësimin e shkarkimeve në Aneksin C dhe udhëzimet që do të miratohen nga Konferenca e palëve.

Promovimi në përputhje me afatin kohor të zbatimit të këtij Plani Veprimi, do të kërkojë përdorimin e TMD për burimet e reja brenda kategorisë së burimeve të cilat një vend palë i ka identifikuar si të sigurt, me një vëmendje të veçantë në fillim për kategoritë e burimeve të identifikuar në Pjesën e II të Aneksit C. Në çdo rast, kërkesat për të përdorur TMM për burimet e reja të renditura në pjesën II të Aneksit duhet të realizohen sa më shpejt që të jetë praktike por jo më vonë se katër vjet nga hyrja në fuqi e kësaj Konvente për këtë Palë.

Gjatë zbatimit të TMD dhe PMM, palët duhet të marrin në konsideratë udhëzimet e përgjithshme për masat parandaluese dhe uljen e shkarkimeve në këtë Aneks dhe udhëzimet për TMD që do të miratohen nga Konferenca e Palëve.

Gjendja e NOQ-ve të paqëllimshme në Shqipëri

Inventari i parë i NOQ-ve të prodhuara në mënyrë të paqëllimshme në Shqipëri është bërë në përputhje me Manualin e UNEP për identifikimin dhe vlerësimin sasior të dioksinave dhe furaneve. Nismat orientohen drejt shkarkimeve dhe transferimeve të PCDD/PCDF në pesë ndarjet e mëposhtme: Ajri, Uji, Toka, Mbeturinat dhe Produktet .

Sipas inventarit janë 9 kategori të burimeve të NOQ-ve të paqëllimshme:

1. Mbetjet nga djegiet;
2. Prodhimi i materialeve metalike dhe jo metalike;
3. Prodhimi i energjisë dhe ngrohja/gatimi;
4. Prodhimi i mineraleve;
5. Transporti;
6. Djegiet e pakontrolluara;
7. Prodhimi i kimikateve dhe materialeve të konsumit;
8. Të ndryshme;
9. Mbulimi në tokë / eliminimi.

Të dhënat për inventarin janë mbledhur kryesisht nga burime zyrtare, si psh MMPAU (Raportet Mjedisore për vitet 2000-2002), INSTAT dhe ARM.

Në mungesë të burimeve zyrtare, u mbledhën të dhëna nga shoqëri private ose nga ekspertë që punojnë në këto industri. Në të gjitha rastet të dhënat e mbledhura janë rishikuar dhe verifikuar.

Si Faktorë të shkarkimeve janë përdorur ata që rekomandohen nga metodika e UNEP për kategorinë përkatëse dhe nënkategoritë e burimeve të PCDD/PCDF (te dhënat janë shprehur në gram toksik ekuivalent në vit: g.TEQ/Vit)

Në Tabelën 18 jepen sasi të PCDD/PCDF-ve të çliruara në Shqipëri për vitin 2004. Siç shihet djegia e pakontrolluar është burimi kryesor i shkarkimeve në ajër duke zënë rreth 73.54% të totalit.

Djegia e mbeturinave spitalore, është burimi tjetër më i madh i shkarkimeve, duke zënë rreth 23.8% të totalit kombëtar. Përqindja e kategorive të tjera mbetet e pandjeshme.

Diskutim për inventarin e shkarkimeve të NOQ-ve të paqëllimta

Në kapitullin më poshtë janë përshkruar rezultatet e inventarit të parë të NOQ-ve jo të qëllimshme në Shqipëri, duke identifikuar shqetësimet dhe problemet kryesore, si dhe objektivat dhe zgjedhjet e menaxhimit lidhur me to.

1. Mbeturinat spitalore

Shkarkimet në ajër nga djegia e mbeturinave spitalore llogariten në 23.8% të totalit të burimeve nga PCDD/PCDF.

Ka vetëm një incenerator (impiant djegieje) për mbetjet spitalore në Shqipëri. Ky incenerator është i instaluar në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”. Ai është parashikuar të përpunojë vetëm mbetjet jo-patologjike, por në praktikë mbetjet spitalore nuk ndahen përpara djegies.

Inceneratori ka një kapacitet 108 kg/h, por teknologjia nuk është e përshtatshme për të eliminuar çlirimin në mjedis të NOQ-ve, sepse temperatura është nën 1000 °C dhe inceneratori nuk ka sistem filtrash për të pastruar gazet që dalin nga djegia. Në qoftë se mbetjet spitalore digjen në kushte që nuk bazohen në TMD dhe PMM, kjo përbën një potencial të konsiderueshëm për çlirimin në ajër të PCDD dhe PCDF, në përqendrimet relativisht të larta.

Tabela 18: Shkarkimi i PCDD/PCDF në Shqipëri për vitin 2004

Kategoritë e burimeve	Shkarkimi vjetor, g TEQ/Vit				
	Ajri	Uji	Toka	Produkte	Mbetje
Djegia e mbeturinave spitalore	14	0	0	0	0.070
Prodhimi i metaleve ferore dhe jo ferore	0.935	0	2.91	0	0
Prodhimi i energjisë dhe ngrohja	0.000563	0	0	0	0.000111
Prodhimi i mineraleve	0.2577	0	0.150	0	0.00045
Transporti	0.3304245	0	0	0	0
Proceset e pakontrolluara të djegies	43.154463	0	0.0065204	0	0
Kimikate dhe materiale për konsum	0	0	0	0	0
Të ndryshme	0	0	0	0	0
Vend-depozitimet e mbeturinave	0	57.52910	0	0	0
Gjithsej	58.6781505	57.5291	3.0665204	0	0.070561

Nuk ka të dhëna të sakta për sasinë e mbeturinave spitalore të djegura në këtë incenerator por, nga analiza e Raportit të ISHP, rezulton se kapaciteti i shfrytëzuar i inceneratorit nuk është më shumë se 40%.

Pjesa kryesore e mbetjeve spitalore në qytete të ndryshme të Shqipërisë depozitohen direkt në vend-depozitime të pakontrolluara. Disa spitale ende përdorin praktikën e djegies në mjedis të hapur të mbetjeve spitalore. Shkarkimet nga këto burime të pakontrolluara nuk janë vlerësuar ende dhe, për rrjedhojë, nuk janë të përfshira në llogaritjet e inventarit. Çlirimet që figurojnë në inventar paraqesin vlerësimin minimal të mundshëm.

2. Prodhimi i metaleve ferore dhe jo ferore

Prodhimet metalore në Shqipëri konsistojnë në prodhimin e çelikut, hekurit për ndërtim dhe prodhimin e ferro-kromit.

Industria përfshin Kombinatin Metalurgjik, në Elbasan, që administrohet nga shoqëria turke "Kurum" dhe uzinat e ferrokromit në Elbasan dhe në Burrel që janë në pronësi të shoqërisë italiane "Darfo".

Operacionet që kryen "Kurum" konsistojnë në dy linja prodhimi, një që prodhon vetëm çelik të cilësisë së dytë dhe një tjetër që prodhon shufra çeliku për ndërtim. Prodhimi i kësaj uzine për vitin 2004 ishte 140 000 ton.

Nga uzinat që administron shoqëria "Darfo" vetëm linja e prodhimit të ferro-kromit në Elbasan është në funksionim me një kapacitet të prodhimit vjetor prej 40.000 ton.

PCDD/PCDF e çliruara në këto aktivitete janë rreth 1.6 % të shkarkimeve totale.

3. Prodhimi i energjisë dhe ngrohja

Prodhimi i energjisë, ngrohja dhe gatimi, llogarisin shkarkime shumë të paktë të NOQ-ve jo të qëllimshëm. Energjia elektrike dhe djegia e drurit, përbëjnë pothuajse burimet e vetme të energjisë që përdoret për nevoja shtëpiake.

Një nga arsyet e shkarkimeve të ulëta në këtë grup është fakti që nga 8 termocentrale të instaluar në Shqipëri, vetëm ai i Fierit është akoma në gjendje pune. Konsumi për nevoja shtëpiake pritet të rritet duke ndjekur rritjen e popullsisë. Zhvillimi ekonomik mund të ndryshojë traditën dhe të rrisë kërkesën për energji.

4. Përpunimi i mineraleve

Shkarkimet e NOQ-ve jo të qëllimshme vijnë edhe nga përpunimi i mineraleve, prodhimet e çimentos, gëlqeres, tullave dhe nga asfalto-betoni. Ka dy fabrika çimentoje në funksionim, një në Elbasan dhe një në Fushë-Krujë. Të dyja janë në pronësi dhe menaxhim privat. Në vitin 2004, prodhimi në Elbasan ishte 573.000 ton çimento dhe 153.000 ton klinker. Prodhimin e gëlqeres në Elbasan e ka filluar shoqëria private "Kurum". Në vitin 2004 ky prodhim ishte 15.000 ton. Për më tepër, janë shtuar shumë prodhuesit artizan të gëlqeres, por për ta nuk ka të dhëna të sakta për sasinë e prodhuar.

Prodhimi i tullave është shumë i përhapur në Shqipëri. Gjatë vitit 2004 në 14 fabrika u prodhuan në total rreth 431.000 ton tulla. Shkarkimet në ajër nga kjo industri nuk janë të mëdha, duke u llogaritur në më pak se 0.5% të shkarkimeve totale.

5. Transporti

Gjatë viteve të tranzicionit ekonomik, sektori i transportit në Shqipëri ka bërë ndryshime të shpejta.

Konsumi total i karburantit për Shqipërinë është 671.733 ton nga të cilat 480.876 ton janë përdorur vetëm në sektorin e transportit. Përveç kësaj, konsumi i benzinës llogaritet në 41.589 ton, ndërsa konsumi i gazoilit është 38.928 ton. Një arsye e konsumit të lartë të karburantit në Shqipëri është përqindja e lartë që zënë automjetet e përdorura.

Rritja e popullsisë, urbanizimi, dhe zgjerimi i infrastrukturës rrugore, zhvillimi ekonomik, etj do të çojnë në një rritje të kërkesës për energji në sektorin e transportit. Si pasojë, mund të pritet një rritje e çlirimit të NOQ-ve jo të qëllimshme nga sektori i transportit. Megjithatë, miratimi i legjislacionit përkatës mjedisor mund ta frenojë këtë prirje dhe me rritjen e të ardhurave do të kemi më pak ndotje nga automjetet e reja që do të zëvendësojnë të vjetrit.

Shkarkimet e sektorit të transportit kanë ndikim të kufizuar në sasinë gjithsej të NOQ-ve të pa qëllimshme që shkarkohen në ajër (5.63% e shkarkimeve gjithsej).

6. Proceset e djegieve të pakontrolluara

Kontribuesi kryesor i çlirimit të PCDD/PCDF në Shqipëri është kategoria e proceseve të djegieve të pakontrolluara, ku përfshihen mbeturinat të cilat digjen në mënyrë spontane ose të qëllimshme në mjedis të hapur. Kjo kategori përbën më shumë se 73.54 % të shkarkimeve gjithsej në ajër. Gjithashtu, kjo kategori është kontribuesi kryesor për shkarkimet në ujë të PCDD/PCDF duke zënë pothuajse 100 % të shkarkimeve.

Në kategorinë e proceseve të djegieve të pakontrolluara janë marrë në shqyrtim vetëm djegia e mbetjeve urbane dhe zjarret aksidentale.

Mbeturinat urbane

Mbeturinat urbane të krijuara në qytetet kryesore llogariten në 0,815 kg/ditë për person mesatarisht. Gjatë vitit 2004 mesatarja e prodhimit të mbetjeve urbane në Shqipëri ishte 410.922 ton nga të cilat rreth 43.000 ton janë djegur.

Sistemi i menaxhimit të mbetjeve në Shqipëri është i dobët dhe i pafinancuar për të kryer një menaxhim mjedisor të mbetjeve. Sistemet e grumbullimit, transportit dhe depozitimit nuk kanë burime financiare të mjaftueshme dhe nuk janë ngritur ende vend-depozitime sanitare. Mbetjet grumbullohen në damba të hapura të cilat janë të papërshtatshme për menaxhim mjedisor.

Mbetjet nuk ndahen përpara depozitimit përfundimtar. Për më tepër, grumbullimi i pjesshëm i tyre ka çuar në djegien e mbetjeve në oborret e shtëpive dhe në rrugë (dhe kontejner) me qëllim uljen e volumit. Gjithashtu, djegiet e pakontrolluara bëhen për të mbledhur më lehtë mbeturina që gjejnë treg shite si mbetjet metalike. Veprime të tilla kryhen edhe në sheshet e depozitimit të mbetjeve (që janë vend-depozitime të pakontrolluara).

Në Shqipëri ka vetëm një sistem të përgjithshëm të grumbullimit të mbetjeve urbane për qytetet e mëdha, ndërsa fshatrat nuk përfshihen në këtë sistem të grumbullimit të mbetjeve urbane. Nga mbetjet e grumbulluara, vetëm një pjesë shkon për t'u depozituar, për shkak të mungesë së fondeve dhe organizimit të paefektshëm nga strukturat lokale përgjegjëse.

Mosndarja e mbeturinave, shpërndarja dhe djegia e pakontrolluar renditet si një nga problemet më të rëndësishme mjedisore në vend. Janë bërë disa hapa të parë për të rregulluar situatën në kuadër të Strategjisë së Menaxhimit të Mbetjeve të Ngurta Urbane të Shqipërisë, e vitit 1997. Kjo strategji ka edhe një Plan Veprimi që trajton forcimin e kapaciteteve institucionale, legjislacionin, investimet dhe aktivitete të tjera ndërgjegjësuese. Një nga rezultatet është miratimi i ligjit për depozitim të mbetjeve urbane dhe ligjit për menaxhimin e mbetjeve urbane. Gjithashtu, në vitin 2005 filluan disa nisma të vogla për riciklimin dhe ndarjen e mbetjeve urbane. Tani për tani, riciklohen 4% e metaleve, 2% e plastikave dhe 1% letrës.

Zjarret në Pyje

Në vitin 2002, janë djegur rreth 54.6 hektarë pyje dhe 39.6 ha kullota. Drejtoria e Pyjeve ka forcuar masat përkatëse për pakësimin e zjarreve të pakontrolluara. Me zbatimin më rigoroz të legjislacionit dhe përmirësimet e mëtejshme në këtë drejtim, do të arrihet edhe pakësimi i zjarreve në pyje.

Problemët parësorë dhe objektivat për administrimin e NOQ-ve.

Problemët përparësorë

- Përmirësimi i kuadri ligjor dhe institucional për kontrollin efektiv të çlirimit të NOQ-ve prodhuar në mënyrë të paqëllimshme;
- Sistemi i dobët i administrimit të mbetjeve (sistemi i administrimit të papërshtatshëm dhe djegie e pakontrolluar e mbetjeve)
- Depozitimi i mbetjeve spitalore jashtë kriterëve mjedisore.
- Niveli i ulët ndërgjegjësimi për rrezikshmërinë lidhur me çlirimin e paqëllimshëm nga aktorët kryesorë dhe publiku në përgjithësi.

Kontribuesi kryesor i shkarkimeve të PCDD/PCDF në Shqipëri është kategoria e proceseve të djegieve të pakontrolluara, të cilat përfshijnë vend-depozitimet/dambat, zjarret dhe djegia në ambient të hapur e mbetjeve urbane. Kjo kategori llogaritet në

73.54% të shkarkimeve kombëtare në ajër. Kontribuesi më i rëndësishëm i shkarkimeve të PCDD/PCDF në ujë është depozitimi i mbetjeve urbane me 100% të shkarkimeve.

Për shkak të infrastrukturës së varfër, kapacitetit dhe rritjes së shpejtë të popullsisë, kjo kategori pritet të jetë ende dominuese në burimet e shkarkimeve në Shqipëri. Megjithatë, këtij problemi është duke iu dhënë përparësi për të arritur që të gjithë Shqiptarët të jenë të mbrojtur nga ekspozimi. Një nga faktorët më kritik është që mbeturinat depozitohen pjesërisht në zonat apo sheshet e depozitimit dhe që nuk ka një sistem të ndarjes së mbetjeve në vend-depozitim.

Sistemi i menaxhimit të mbetjeve spitalore nuk është funksional dhe do të kërkojë një rishikim total për minimizimin, ndarjen, mbledhjen dhe transportin për në vend-depozitim përfundimtar për pakësimin e dukshëm të çlirimeve të PCDD/PCDF nga këto aktivitete.

Niveli i aktiviteteve industriale në vend është i pakët dhe si pasojë shumë kategori burimesh të PCDD/PCDF, që normalisht lidhen me këtë sektor, pothuajse mungojnë, kështu që shkarkimet e PCDD/PCDF janë të pandjeshme. Ka një kapacitet të ulët të parandalimit të ndotjeve në sektorin industrial, megjithëse futja e TMD dhe PMM në këtë sektor do të ulë më tej shkarkimet e NOQ-ve si dhe do të ndihmojë në zbatimin e prodhimit të pastër.

Në përgjithësi ka një shkallë të ulët ndërgjegjësimi të publikut për problemet mjedisore dhe rrezikun për shëndetin që vijnë nga djegia në mjedis të hapur të mbetjeve dhe keq-menaxhimit të vend-depozitimeve. Për më tepër, autoritetet vendore dhe Organizatat Jo-Fitimprurëse (OJF) nuk janë të përfshira sa duhet në sensibilizimin e publikut për problemet e NOQ-ve.

Çlirimi i PCDD/PCDF nuk mund të ulet nëse palët e përfshira nuk kanë njohuritë e nevojshme. Veprimet e përbashkëta të këtyre palëve janë të nevojshme për të sjellë ndryshimet e kërkuara në mënyrën e të sjellurit. Njohuritë për shkarkimeve na japin mundësi të bëjmë një vlerësim të nevojave për veprim. Kjo duhet të përfshijë gatishmërinë për të angazhuar burimet e nevojshme për administrimin e efektshëm të shkarkimeve të PCDD/PCDF.

Objektivat për administrimin e shkarkimeve të NOQ-ve të paqëllimta

Përmirësimi i legjislacionit për parandalimin e ndotjes industriale, i cili duhet harmonizuar plotësisht me legjislacionin e Bashkimit Europian;

- ➔ Sigurimi i efektshmërisë së ligjit dhe i rregullave që lidhen me parandalimin e ndotjes industriale dhe administrimin e mbeturinave;
- ➔ Forcimi i kapaciteteve teknike dhe institucionale si dhe i infrastrukturës mjedisore për administrimin e mbeturinave, duke përfshirë dhe ato spitalore;
- ➔ Zbatimi i efektshëm i strategjisë së monitorimit dhe vlerësimit për parandalimin dhe reduktimin e shkarkimeve që aksidentalisht prodhojnë nënprodukte NOQ;
- ➔ Implementimi i një programi efektiv sensibilizimi për një administrim mjedisor të shëndetshëm të mbeturinave.

Për të arritur objektivat e mësipërme u identifikuan veprimet parësore si më poshtë:

1. Plotësimi i legjisllacionit dhe i rregulloreve për kontrollin dhe parandalimin e ndotjeve industriale, si dhe administrimin e mbeturinave;
2. Forcimi i kapacitetit (njerëzor dhe teknik) në institucionet përgjegjëse për administrimin e mbeturinave (në veçanti administrimin e vend-depozitimeve urbane dhe parandalimin e djegies në mjedis të hapur);
3. Zbatimi dhe zhvillimi i politikave për pakësimin e shkarkimeve të dioksinave nga administrimi i mbeturinave;
4. Futja në përdorim e TMD dhe PMM në sektorin industrial dhe djegien e mbeturinave spitalore;
5. Përgatitja dhe zbatimi në shkallë të gjerë (në të gjithë vendin) i administrimit të mbeturinave spitalore duke minimizuar kështu shkarkimet e paqëllimshme të NOQ-ve;
6. Rritja e ndërgjegjësimit të publikun të gjerë për praktikën e administrimit të mbeturinave;
7. Rishikim i rregullt i inventarit të shkarkimeve;

2.3.5 Mbeturinat e NOQ-ve dhe Vendet e Ndotura

Hyrje

Mbeturinat dhe vendet e ndotura (M&VN) me NOQ janë përshkruar si kategoria e 10. Në përputhje me metodikën e punës, janë evidentuar dhe inventarizuar M&VN-të potenciale në rajonet me aktivitet industrial, në magazinat e prodhimeve industriale dhe të pesticideve si dhe në vend-grumbullime dhe vend-depozitime të mbetjeve.

Sipas përkufizimit të tyre, M&VN-të mund të jenë vende të prodhimit të dikurshëm ose të tanishëm të produkteve me ndotje dioksinash (PCDD) dhe furanesh (PCDF). Ndotja mund të vijë nga depozitimi i produkteve, depozitimi i mbetjeve ose përdorimi i produktit a produkteve për një kohë të gjatë. Megjithatë përqendrimet e dioksinave dhe furaneve në M&VN-të mund të jenë shumë të larta, emisionet e sotme prej tyre mund të jenë të vogla ose edhe të papërfillshme.

Klasifikimi dhe vlerësimi i M&VN-ve është bërë nisur pikërisht nga përcaktimi i mësipërm. Kështu janë inventarizuar si M&VN vend-magazinimet e kimikateve-NOQ si dhe vend-grumbullimet dhe vend-depozitimet ku mund të gjenerohen NOQ si nënprodukte, siç mund të jenë vendet ku depozitohen mbetjet industriale dhe ato urbane. Po kështu janë inventarizuar si M&VN vendet ku mund të jetë i pranishëm aktiviteti i mundshëm i NOQ-ve si pasojë e prodhimit industrial, aktivitetit bujqësor ose mungesa e kujdesit të duhur gjatë përdorimit dhe trajtimit të vend-depozitimeve të mbetjeve

Kërkesat e posaçme të Konventës së Stokholmit:

Neni 6: vend-grumbullimet

- të zhvillojnë dhe të zbatojnë strategji për identifikimin e vend-grumbullimeve (paragrafi 1a(l) dhe 1b),
- të administrojnë stoqet në mënyrë të sigurt, të efektshme dhe të pranueshme për mjedisin, deri sa të gjykohej se ato janë mbeturina (paragrafi 1c)
 - *dmth* nuk mund të përdoren më nga askush

(nuk ka përjashtim të veçantë ose ndonjë qëllim të pranueshëm)

- nuk zbatohet për stoqet që mund të eksportohen

(me anë të Nenit 3, paragr. 2)

Neni 6: mbeturinat

Palët: [paragr. 1 (a)(ii)]

- hartojnë strategji për të përcaktuar
 - produktet dhe artikujt në përdorim, si dhe
 - mbeturinat që përbëhen, përmbajnë ose janë të ndotura me ndonjë NOQ të Aneksëve A, B ose C
- Palët: [paragr. 1 (d)]
- trajtojnë, grumbullojnë, transportojnë dhe ruajnë mbeturinat sipas një menaxhimi mjedisor
- eliminojnë mbeturinat
 - në mënyrë që përmbajtja e NOQ-së të shkatërrohet ose shndërrohet në mënyrë të paprapësueshme, ose
- kryejnë një menaxhim mjedisor
 - kur
 - shkatërrimi ose shndërrimi i paprapësueshëm nuk është zgjidhje e pëlqyeshme mjedisore, ose
 - përmbajtja e NOQ është “e ulët”, duke pasur parasysh rregullat e standardet ndërkombëtare etj.

Palët: [paragr. 1 (d)]

- nuk lejojnë operacione eliminimi që çojnë në rikuperimin, riqarkullimin, rehabilitimin, ripërdorimin e drejtpërdrejtë ose përdorime të tjera të NOQ-së
- nuk transportojnë mbeturina përmes kufijve ndërkombëtarë pa pasur parasysh rregullat, standardet dhe udhëzimet ndërkombëtare (p.sh., Konventa e Bazelit)

Zonat e ndotura:

Palët: [paragr. 1 (e)]

- përpiqen për të përgatitur strategji për përcaktimin e zonave të ndotura me NOQ të Aneksëve A, B ose C, si dhe
- nëse synohet të bëhet rehabilitim, ai të kryhet sipas një menaxhimi mjedisor

Shënim: Rehabilitimi nuk përfshihet në kërkesat e Konventës

Gjendja në Shqipëri

Aktivitet industriale para vitit 1990 në përgjithësi kanë qenë të orientuara nga shfrytëzimi i lëndëve të para minerare, kryesisht për pasurimin e tyre, dhe nga industritë metalurgjike përkatëse. Industria metalurgjike prodhonte gize, çelique, ferro-krom, bakër, hekur-nikel, nikel dhe kobalt. Aktivitetet e tjera industriale lidheshin me prodhimin e celulozës dhe letrës, lëkurës, qelqit, xhamit, përpunimin e drurit, etj. Një vend të rëndësishëm në prodhimet industriale zinin produktet e përpunimit të thjeshtë dhe të thellë të naftës që nxirrej në disa treva të vendit, kryesisht në Shqipërinë e Mesme.

Hë për hë, në Shqipëri nuk ka vend-depozitime të NOQ-ve, me përjashtim, mbase, të mbetjeve të katranit në uzinën e koksit në Elbasan. Më poshtë do të përqendrohemi vetëm në zonat apo vendet e ndotura ose potencialisht të ndotura nga NOQ-të.

Megjithëse pas viteve '90 uzinat kimike dhe metalurgjike në Shqipëri u mbyllën ose punuan me kapacitete të reduktuara, ndotja e shkaktuar prej tyre është ende „aktive“. Si aktivitete industriale me efekt të konsiderueshëm në ndotjen me NOQ mund të përmendim disa. Një prej tyre është uzina e sodës kaustike dhe PVC-së në Vlorë, e cila ka prodhuar një mori kimikatesh, ndër të cilat edhe PVC. Një tjetër burim i ndotjeve të

natyrës organike dhe klororganike kanë qenë fabrikat e plastmasit në Durrës dhe Lushnjë dhe veçanërisht ndërmarrja kimike në Durrës, të cilat u mbyllën në vitet e para pas ngjarjeve të viteve '90. Edhe fabrikat e përpunimit kimik të drurit (në këtë rast bëhet fjalë për katranin) në Fushë Arrëz, Elbasan dhe Laç mund të jenë vende të ndotura me NOQ. Po kështu, në Tiranë ndodhen dy impiante që administrohen nga KESH dhe që kryejnë riparimin e transformatorëve dhe rigjenerimin e vajit të transformatorëve. Të dy impiantet kanë mbi 30 vjet punë dhe teknologjia e përdorur si dhe masat për mbrojtjen e mjedisit kanë lënë shteg për ndotjen me vajra, ku nuk përjashtohet edhe ndotja me PCB, të territorit pranë dhe përreth tyre.

Ia vlen të përmendet fakti që në vitet e para pas vitit 1990, si rezultat i mbylljes së shumë aktiviteteve industriale dhe uljes të kapaciteteve prodhuese apo përpunuese në industrinë e mbetura, ndotja nga industria kimike u ul në mënyrë të konsiderueshme.

Kur flitet për NOQ-të nuk mund të lihet pa përmendur sektori i bujqësisë, në të cilin, për shumë vite, janë përdorur pesticide me përmbajtje të lartë të NOQ-ve. Edhe këtu, ndryshimet e ndodhura pas viteve '90 në sektorin e bujqësisë dhe në përdorimin e tokës bënë që edhe përdorimi i pesticideve të ulet dukshëm. Vlerësimi i fundit i bërë nga specialistët shqiptarë ka treguar se në vend nuk ka më stoqe me pesticide të tipit DDT: në vitet 2000-2002, në kuadrin e projektit PHARE, të gjitha stoqet e pesticideve që ndodheshin në magazinat e sektorëve të bujqësisë janë larguar në Gjermani ku edhe janë eliminuar. Mirëpo, specialistët mendojnë se edhe pas largimit të pesticideve ndotja e magazinave mbetet problem serioz. Kjo për arsye se mjedisi brenda këtyre objekteve është i ndotur dhe shumë prej tyre janë edhe të dëmtuara dhe ndërkaq një pjesë është përdorur për qëllime të tjera, pa bërë asnjë përpjekje për pastrimin apo rehabilitimin e tyre, duke bërë që ndotja të "konservohet".

Zona më e ndotur nga prodhimi dhe përpunimi i pesticideve në Shqipëri është Porto Romano. Në këtë vend gjate viteve '80 është prodhuar lindan për përdorim në bujqësi. Teknologjia e përdorur dhe mungesa e masave për mbrojtjen e mjedisit kanë shkaktuar ndotje të lartë të territorit përreth impianteve të prodhimit të heksakloran/lindanit. Prodhimi u ndërpre në vitin 1990 dhe më vonë mbetjet e izomerëve të heksakloranit në sasi rreth 300-400 ton u çuan në magazinat e Bishtit të Pallës. Besohet se edhe këtu territori brenda dhe përreth magazinave është i ndotur me mbetje të izomerëve të heksakloranit.

Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave e Republikës së Shqipërisë, me mbështetjen financiare të qeverisë Holandeze, në muajin korrik 2006, kreu largimin e këtyre mbeturinave nga Shqipëria për t'u asgjësuar në një nga vendet e BE-së, në kuadrin e projektit " Riambalazhimi dhe largimi nga Shqipëria i pesticideve dhe kimikateve të tjera nga Bishti i Pallës".

Në ish-uzinën e plastmasit në Lushnjë e cila, si shumë objekte industriale, pushoi së punuari në fillim të viteve 1990, janë ende të depozituara rreth 1700 ton kimikate, kryesisht organike. Në fakt kemi të bëjmë me një përzierje të kimikateve që janë përdorur në teknologji dhe që tani nuk mund të identifikohen, mbasi ambalazhet janë prishur dhe lëndët kimike janë përzier. Magazinat ku janë të depozituara janë dëmtuar dhe agjentët atmosferikë i kanë shpërndarë ato në territorin e ish-uzinës.

Nga autoritetet vendore është raportuar se në stacionin e trenit në Bajzë gjendet një sasi prej 200 ton pesticide NOQ, ndoshta një mbeturinë nga pesticidet e skaduara të importuara nga Gjermania Lindore në vitin 1991, të cilat mund të mos jenë kthyer mbrapsht me sasinë kryesore të tyre.

Megjithatë, në mënyrë të përmbledhur mund të thuhet se si rezultat i pakësimit si i aktiviteteve industriale ashtu edhe i përdorimit të pesticideve në bujqësi, ndotja me NOQ në vend është ulur në mënyrë të konsiderueshme. Këtë e vërteton më së miri përmirësimi i cilësisë së ujërave në mjaft prej lumenjve të vendit.

Në këtë kuadër, si objektiv afatshkurtër duhet konsideruar analiza e tokës në zonat potencialisht të ndotura me NOQ. Por përpara se të ndërmerret ky veprim duhet që për zonat potencialisht të ndotura me NOQ të përcaktohen prioritetet, mbështetur në mundësinë dhe rrezikshmërinë e ekspozimit ndaj tyre të njeriut dhe mjedisit.

Stoqet dhe vend-depozitimet e ndotura me NOQ

Këto kategori (që mund të konsiderohen edhe si pika të nxehta) ndryshojnë nga nëntë kategoritë e tjera sepse janë një mundësi për të qenë burim ndotjeje për të ardhmen. Tabela e mëposhtme paraqet një listë të vend-grumbullimeve dhe vend-depozitimeve që paraqesin aktivitet për sa i takon NOQ-ve, të klasifikuara edhe sipas nën-kategorive që u përkasin.

Tabela 19: Lista e stoqeve dhe e mbeturinave potencialisht aktive për sa u takon NOQ-ve (Kategoria 10)

Nr	FABRIKA/ VENDI/ ZONA	PËRSHKRIMI	Tipi i zonës së nxehtë		Nën-kategoritë e zonave të nxehta				
			Stoqe Mbeturina	Zona të ndotura	Zona prodhimi të lëndës së parë	Zona prodhimi fenolësh të	Zona formulimi fenolësh të	Zona përdorimi fenolësh të	Zona prodhimi e trajtimit lëndë
1.	Ish-uzina e plastmasit në Lushnje	Kimikate organike të skaduara	X	X					
2	Ish-uzina kokso-kimike në Elbasan	Përpunimi i qymyrit (nënprodukte të ndryshme, përfshi edhe ato fenolike)	X	X					
3	Stacioni trenit në Bajzë	Pesticide të skaduara	X						
4	Uzina kimike Durrës (Porto Romano)	Prodhimi i lindanit (gama-HCH) dhe i bikromatit të natriumit		X	X				
5	Ndërmarrja e Riparimit dhe Mbushjes së Transformatorëve në Tiranë	Përdorimi i vajit të ndotur me PCB		X					
6	Ndërmarrja e Rigjenerimit të Vajit të Transformatorëve	Përdorimi i vajit të ndotur me PCB		X					

Zonat e ndotura me NOQ

Në tabelën që vijon janë paraqitur zonat potencialisht të ndotura me NOQ, të klasifikuara edhe sipas nën-kategorive që u përkasin. Është fjala përsëri për kategorinë 10 sipas klasifikimit të paraqitur në metodikën e punës të rekomanduar nga UNEP.

Tabela 20: Zonat potencialisht të ndotura me NOQ (Kategoria 10)

Nr	Zonat e ndotura	Përshkrimi i zonës dhe burimit të ndotjes potenciale
1	Elbasan (zona e ish-uzinës kokso-kimike)	Zona më e ndotur e rajonit industrial të Elbasanit është ish-uzina kokso-kimike. Sipas dokumentacionit udhëzues të Konventës së Stokholmit, prodhimi i koksit për përdorim në industrinë metalurgjike shoqërohet me çlirim të NOQ-ve dhe konkretisht të dioksinave dhe furaneve. Uzina kokso-kimike në Elbasan ka punuar gjatë periudhës 1975-1991. Në territorin përreth saj ndodhen disa qindra ton dhera të përziera me materiale me bazë katrani. Në depozitat e katranit ka ende mbeturina të këtij materiali me përmbajtje NOQ. Mbetjet më të rrezikshme janë krijuar (madje një pjesë e vogël vazhdon të krijohet edhe sot) nga proceset e koksifikimit dhe të gazifikimit dhe nga uzina energjetike. Territori i ndotur është rreth 2,500 m².
2	Durrës (zona e Bisht-Pallës)	Territori i magazinave ku kanë qenë të depozituara në kushte jo të përshtatshme mbeturinat e lindanit dhe izomerët e HCH, krahas kimikateve të tjera të skaduara dhe jo të gjithë të etiketuar, dyshohet të jetë vend mjaft i ndotur me kimikate të grupit të NOQ-ve.
3	Vlorë (zona e ish-uzinës së sodë-PVC-së)	Për më se 20 vjet është prodhuar PVC dhe nuk disponohen analiza mbi përmbajtjen e përbërjeve klororganike, përfshirë NOQ-të, në territorin e ish-uzinës dhe përreth saj.
4	Durrës Porto-Romano (zona e ish-ndërmarrjes kimike)	Janë rreth 2 ha të ndotur me mbetje pesticidesh, kryesisht heksakloran dhe lindan. Analizat e kryera në kampionë toke kanë treguar praninë e izomerëve HCH në përqendrimet tepër të larta, nga 1,290 deri në 3,140 mg /kg për kampion dheu.
5	Elbasan, Laç, Fushë Arrëz (zona e ish-kombinatit të përpunimit të drurit)	Territori në të cilin bëhej trajtimi i drurit me katran dhe me kimikate të tjera.
6.	Ish-uzina e plastmasit në Lushnjë	Të depozituara rreth 1700 përzierje kimikatesh kryesisht organike dhe territori i uzinës i ndotur nga përhapja e këtyre kimikateve. Rrezik potencial për ndotjen e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore
7.	Stacioni i trenit në Bajzë-Shkodër	Në magazinat e stacionit të trenit ndodhen rreth 200 ton pesticide të skaduara të mbetura në këtë stacion që në fillim të viteve '90. Nuk disponohen të dhëna të sakta për llojet e pesticideve dhe për ndotjen e mjedisit përreth.

Problemet përparësore dhe objektivat për administrimin e NOQ-ve

Burimi kryesor i ndotjes nga NOQ-të, në kontekstin e zonave/territoreve të ndotura, janë vend-depozitimet e mbetjeve urbane, të cilat, siç është përmendur edhe në piken 2.3.4, në përgjithësi janë vendosur në vende jo të përshtatshme në aspektin gjeologjik dhe hidrologjik, por edhe pa teknologjinë për depozitimin mjedisor të tyre. Në të gjitha vend-depozitimet e mbetjeve urbane në qytetet kryesore të vendit është i pranishëm fenomeni i djegies së tyre, gjë që shoqërohet me çlirimin në ajër dhe kalimin në ujë të dioksinave dhe furaneve. Lidhur me sasitë dhe mënyrat e zgjidhjes së problemeve për pakësimin deri edhe eliminimin e këtyre NOQ-ve në vend-depozitimet urbane bëhet fjalë në pikat 2.3.4 dhe 3.3.4.

Industritë që kanë qenë aktive përpara viteve '90, një pjesë e të cilave vazhdojnë të punojnë edhe sot, vazhdojnë të ndotin mjedisin me mbeturinat e trashëguara nga koha kur këto industri ishin në punë si dhe me mbetjet që rezultojnë nga funksionimi i tanishëm i tyre. Këto janë konstatime të bëra mbi bazën e informacioneve nga literatura për shkarkimet në mjedis nga këto industri, pasi deri tani, për mungesë të fondeve dhe kapaciteteve për analizën e NOQ-ve të tilla si PCDD, PCDF dhe PCB, nuk janë kryer ende analiza për të përcaktuar përqendrimin e NOQ-ve dhe shtrirjen e tyre në ajër, tokë dhe ujëra sipërfaqësore dhe nëntokësore.

Konsiderohen gjithashtu si vende të ndotura me NOQ edhe shumica e magazinave të sektorit të bujqësisë, të cilat kanë pasur në inventar edhe pesticide NOQ.

Në të gjitha veprimtaritë e mësipërme është konstatuar një nivel i ulët informacioni për efektet në shëndet dhe në mjedis të NOQ-ve, si te punonjësit e sektorëve përkatës ashtu edhe te komuniteti pranë objekteve apo territoreve të ndotura me NOQ.

Në gjendjen ekzistuese të vendeve të ndotura apo që mund të identifikohen si të ndotura nga NOQ-të, ka ndikuar edhe mungesa në të kaluarën e legjislacionit kuadër për mbrojtjen e mjedisit dhe mungesa e tanishme e legjislacionit të posaçëm për NOQ-të. Këto mangësi të kuadrit ligjor mjedisor kanë ndikuar edhe në punën e pakët të institucioneve kërkimore në drejtim të studimit të ndotjes së mjedisit nga NOQ-të, në përgjithësi, dhe të vendeve eventualisht të ndotura nga kjo kategori kimikatesh, në veçanti. Rrjedhojë e kësaj gjendje është edhe mungesa e kapaciteteve, si në strukturat kërkimore, ashtu dhe në ato administrative.

Problemet përparësore

- Legjislacioni për parandalimin e ndotjes industriale dhe menaxhimin e vend-depozitimeve të mbetjeve nuk është i harmonizuar plotësisht me atë të BE;
- Menaxhimi në praktikë i vend-depozitimeve të mbetjeve nuk kryhet në përputhje me legjislacionin ekzistues përkatës;
- Zbatim i pamjaftueshëm i legjislacionit përkatës për mbrojtjen nga ndotja;
- Kapacitete të pamjaftueshme institucionale dhe teknike në dogana, në institucionet kërkimore dhe në autoritetet e inspektimit;
- Mungesë e ekspertëve të kualifikuar për monitorimin e NOQ-ve dhe trajtimin e mbetjeve industriale;
- Ndotje e tokës dhe ujërave nëntokësore për shkak të djegies së mbeturinave në vend-depozitimet urbane;
- Mungesë e mjeteve (laboratorë dhe njësi kontrolli) për zbatimin e legjislacionit në lidhje me kontrollin dhe parandalimin e ndotjes dhe menaxhimin e mbetjeve duke respektuar kërkesat mjedisore;
- Ndotje e ajrit, tokës dhe eventualisht edhe e ujërave nëntokësore në rajonet e Porto Romanos dhe të ish-uzinës së sodës kaustike dhe PVC-së në Vlorë për shkak të gjendjes në këto rajone të depozitimeve dhe mbeturinave të komponimeve të kloruara;
-

- Ndotje e ajrit, tokës dhe eventualisht edhe e ujërave nëntokësore në territorin pranë dhe përreth uzinës kokso-kimike të ish-kombinatit metalurgjik në Elbasan;
- Ndotje e ajrit, tokës dhe eventualisht edhe e ujërave nëntokësore në territorin e repartit të imprenjimit të lëndës drusore në ish-kombinatet e drurit në Elbasan, Laç dhe Fushë Arrëz;
- Ndotje e tokës dhe eventualisht e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore në uzinat e riparimit të transformatorëve dhe rigjenerimit të vajit të transformatorëve në Tiranë;
- Ndotje eventuale e tokës dhe ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore nga kimikatet e ish uzinës së plastmasit në Lushnje dhe në stacionin e trenit në Bajzë-Shkodër
- Ndotje e tokës në mjediset rreth ish-magazinave të pesticideve që kanë funksionuar në sistemin e bujqësisë;
- Sensibilizim shumë i pakët në mjaft grupe të popullatës për rrezikun që mbart çlirimi në mjedis i NOQ-ve;

Çështjet që kanë të bëjnë me aspektet institucionale dhe ato ligjore të administrimit siç duhet të zonave të ndotura përshkruhen në pikën 3.3.1. Çështjet teknike që kanë të bëjnë me menaxhimin e pesticideve dhe të vend-depozitimeve urbane trajtohen përkatësisht në pikat 3.3.2 dhe 3.3.4. Çështjet që kanë të bëjnë me sensibilizimin e publikut trajtohen në pikën 3.3.8.

Objektivat:

- Përmirësimi i praktikave shqiptare të administrimit të zonave të ndotura;
- Forcimi i kapaciteteve institucionale të autoriteteve vendore për administrimin e mbeturinave, duke respektuar kërkesat mjedisore;
- Rritja e kapaciteteve për depozitim dhe monitorimin e mbeturinave industriale;
- Forcimi i kapaciteteve institucionale dhe teknike në dogana, në institucionet kërkimore dhe në autoritetet inspektuese;
- Studimi i nivelit të ndotjes me NOQ të zonave të ndotura;
- Rehabilitimi gradual i zonave të ndotura;
- Përgatitja dhe zbatimi i programeve efektive të ndërgjegjësimit lidhur me administrimin e mbeturinave duke respektuar kërkesat mjedisore;

2.3.6 Ndërgjegjësimi dhe Informimi

Niveli aktual i informimit mjedisor në Shqipëri

Deri në vitet '90, në Shqipëri kishte një informim mjedisor shumë të varfër dhe ajo që bëhej, në më të shumtën e rasteve, ishte informim propagandistik. Koncepti i informimit, veçanërisht informimit mjedisor, është relativisht i ri.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë e vitit 1998, njeh të drejtën e secilit "për të qenë i informuar për gjendjen mjedisore dhe mbrojtjen e saj" dhe "për të marrë pjesë në vendim-marrje". Një hap tjetër në këtë drejtim ka qenë miratimi i udhëzimit "Për informimin mjedisor dhe mbështetjen e publikut me informim mjedisor", Nr. 7, datë 19.1.1998, nxjerrë nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit

Në këtë udhëzim përcaktohet lloji i informacionit që do të ofrojë kjo Agjenci dhe detyrimin për të garantuar të drejtën e çdo qytetari për të pasur informacion mjedisor, për t'u informuar në lidhje me aktivitetet që kanë ose mund të kenë ndikime negative në mjedis dhe në shëndetin e njeriut, si edhe për masat që merren për mbrojtjen e mjedisit, ku përfshihen masat administrative dhe programet për politikat dhe strategjitë e administrimit dhe ruajtjes së mjedisit, të hartuara për këtë qëllim.

Udhëzimi përcakton edhe se si duhet të paraqitet nga publiku kërkesa për informim dhe afatin maksimal për ofrimin e informacionit apo mohimin e kërkesës.

Një nga përparësitë e Strategjisë dhe Planit Kombëtar të Veprimit për Mjedisin është “zhvillimi i njohurive mjedisore dhe rritja e pjesëmarrjes publike në problemet e mjedisit”. Pjesëmarrja e shoqatave joqeveritare në problemet e mjedisit, siç parashikohet në Planin Kombëtar të Veprimit në Mjedis, kishte për qëllim rritjen e ndërgjegjësimit publik në çështjet mjedisore përmes mjeteve masive të komunikimit, seminareve dhe konferencave, si dhe përmes hartimit të politikave që mundësojnë pjesëmarrjen e publikut në marrjen e vendimeve dhe zhvillimin e standardeve mjedisore.

Një arritje e shënuar në fushën informimit dhe pjesëmarrjes së publikut ka qenë firmosja më 25 Qershor 1998, dhe ratifikimi, më 27 Qershor 2001, i Konventës së Arhusit “Për të drejtën e informimit dhe të vendimmarrjes së publikut dhe mbështetjen në gjykatë që gëzon publiku, në çështjet mjedisore”.

Informacioni mjedisor në pjesën më të madhe i jepet publikut nëpërmjet mjeteve elektronike dhe të shkruara të komunikimit, fletëpalosjeve, posterave, etj. Nga të gjitha gazetatat që dalin në Shqipëri, 8-10 gazetatat më kryesore të përditshme botojnë mesatarisht 5-6 artikuj dhe lajme mjedisore. Herë pas here, shpërndahet informacion mjedisor edhe përmes televizionit dhe radios. Artikujt mjedisor të gazetave, në përgjithësi, janë të orientuar nga lajmi dhe jo nga analiza e tyre. Ka një mungesë të gazetarisë investigative në fushën e mjedisit, e cila mund të jepte analiza më të hollësishme për çështjet e politikave mjedisore.

Megjithatë, qytetarët shqiptarë nuk janë të informuar mirë për marrëdhëniet midis mjedisit dhe shëndetit të njeriut, si dhe kostos mjedisore dhe zhvillimit ekonomik të vendit. Kjo vlen edhe për vendim-marrësit dhe politikë-bërësitt. Ka shumë nevojë për përmirësim të informimit dhe ndërgjegjësimit mjedisor në të gjitha nivelet e shoqërisë. Përveç kësaj, duhen marrë masa për nxitjen e të drejtës së publikut për të marrë informacion mjedisor.

Interesi i publikut për informacionin mjedisor është rritur gjatë këtyre të fundit. Krijimi i Qendrës së Informacionit Mjedor në MMPAU e ka rritur shërbimin informacionit publik për mjedisin nga viti në vit. Tani çdo muaj në MMPAU regjistrohen 4-5 kërkesa zyrtare për informacione të lidhura me probleme mjedisore dhe çdo ditë Qendra vizitohet nga 1-2 të interesuar për çështjet mjedisore, një numër i vogël ky. Megjithatë, tashmë, çdo individ ka të drejtën ligjore dhe procedura konkrete për të kërkuar informacionin e nevojshëm për çështjet mjedisore.

Kërkesat e posaçme të Konventës së Stokholmit

Neni 10. Informimi i publikut:

Palët brenda kapaciteteve që disponojnë:

sigurojnë mundësinë e publikut për të mësuar informacionet më të fundit [parag. 2]

- nxisin industrinë dhe profesionistët të promovojnë ofrimin e informacionit në nivel kombëtar dhe nivele të tjera [parag. 3]

Palët duhet:

- të përpiqen të ofrojnë informacion dhe të ngrenë qendra informacioni në nivel kombëtar dhe rajonal [parag. 4]
- të krijojnë mekanizma (si Regjistri i Shkarkimeve dhe Transferimeve), të mbledhin dhe shpërndajnë informacion për sasi të vjetore të NOQ-ve sipas Anekseve A, B dhe C, të shkarkuara apo asgjësuar gjatë një viti [parag.5]

Ndërgjegjësimi dhe Pjesëmarrja e publikut

Ndërgjegjësimi i publikut

Gjatë 5 vjetëve të fundit është rritur informacioni për publikun si rezultat i rritjes së veprimtarisë së shoqërisë civile, në përgjithësi, dhe aktiviteteve të OJF-ve mjedisore, në veçanti. Edhe mjetet masive të komunikimit, veçanërisht mjetet elektronike, nga viti në vit, e kanë rritur informacionin dhe programet e tjera mjedisore.

Është rritur numri i OJF-ve që veprojnë në fushën e mjedisit. Në vitin 1994 ishin vetëm 7 OJF mjedisore në tërë Shqipërinë, ndërsa në fund të vitit 2005 numri i tyre arriti në 79 OJF mjedisore. Për të formalizuar bashkëpunimin me OJF-të mjedisore, MMPAU ka nënshkruar me to një memorandum mirëkuptimi. Në shumë qytete të Shqipërisë, MMPAU dhe pushteti vendor kanë zhvilluar aktivitete në bashkëpunim me OJF-të lokale, veçanërisht në ditët kombëtare dhe ndërkombëtare mjedisore. E drejta e publikut për të marrë informacion mjedisor, është e sanksionuar në kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Në këtë kuadër, përmirësimi i ligjit “Për mbrojtjen e mjedisit”, në vitin 2001, siguroi më konkretisht të drejtën e të gjithëve për t’u informuar në fushën e mjedisit. Ndonëse mjetet e komunikimit e kanë rritur gjithnjë e më shumë vëmendjen ndaj temave problematike mjedisore, zhvillimet dhe arritjet në fushën e ndërgjegjësimit të publikut, të qenit i informuar dhe pjesëmarrja e tij në aktivitetet dhe politikat mjedisore ende mund të konsiderohen modeste. Një fushë tjetër e cila duhet mbështetur dhe nxitur janë edhe trajnimet e gazetarëve për të trajtuar më mirë dhe më shumë problemet mjedisore.

Pjesëmarrja e publikut

Zgjidhja e problemeve të lidhura me NOQ-të mund të ketë sukses me rritjen e pjesëmarrjes së publikut, në përgjithësi, dhe komuniteteve të interesuara, në veçanti. Përgatitja e PKV ka hedhur tashmë hapat për të mundësuar pjesëmarrjen e publikut në proceset e marrjes së vendimeve edhe për problemet që lidhen me zgjidhjen e qëndrueshme të menaxhimit të NOQ-ve.

Gjatë rishikimit të përgjegjëseve ekzistuese të agjencive shtetërore, duhet bërë kujdes që ato të mund të krijojnë marrëdhënie të rregullta me publikun, takime me grupet e interesit, paraqitje zyrtare në mjetet masive të komunikimit dhe shërbime konkrete. Ky objektiv mund të realizohet përmes trajnimeve të grupeve të ndryshme të lidhura me problemet e NOQ-ve, ndër të cilët edhe agjenci shtetërore, OJF, institucionet e edukimit, grupet e biznesit, konsumatorët, etj.

Shkëmbimi i informacionit

Shkëmbimi i informacionit lidhur me çështjen e NOQ-ve, është i rëndësishëm si për rritjen e ndërgjegjësimit ashtu edhe për përhapjen e njohurive të reja. Më të rëndësishme duhet të jenë aktivitetet ndërsektoriale dhe takimet midis disiplinave të ndryshme, takimet mes përfaqësuesve të brezave të ndryshëm, mbështetje për përdorimin e rrjeteve të nevojshme, informacion për gjendjen e mjedisit në çdo komunitet dhe në tërësi për tërë vendin. Mjeti më i rëndësishëm për shkëmbimin e informacionit duhet të jetë buletini informativ periodik i NOQ-ve, në formë të printuar ose në internet. Këtij qëllimi duhet t’i shërbejnë edhe konferencat dhe simpoziumet e grup-moshave të përziera dhe takimet midis aktorëve të ndërgjegjësimit për NOQ-të (inspektorët e mjedisit, studiuesit, përfaqësuesit e shoqërive me aktivitete që ndotin mjedisin, fizikanët dhe përfaqësuesit e agjencive përgjegjëse për administrimin e burimeve natyrore). Duhet të hartohen të dhëna vendore për burimet e NOQ-ve, të cilat duhet t’i vihen në dispozicion publikut.

Në planin ndërkombëtar, duhet shkëmbyer Informacion lidhur me zgjidhjen e çështjes së NOQ-ve edhe me partnerë të tjerë të konventës ndërmjet partneriteteve dypalëshe dhe shumëpalëshe, rrjeteve të NOQ-ve, konferencave, simpoziumeve, diskutimeve, dhënies së alternativave për NOQ-të, projekteve për zgjidhjen e problemeve të lidhura me NOQ-të.

Aktivitet kryesore që janë bërë në lidhje me NOQ-të në Shqipëri

Është kryer investigimi i medias së shkruar dhe asaj elektronike në lidhje me informacionin publik mbi ndikimin e NOQ-ve në shëndetin e njeriut dhe mjedisin në Shqipëri, si dhe janë analizuar pikat pozitive dhe negative të këtij informacioni.

Është ndjekur çdo hap i procesit të inventarizimit të grupeve të tjera, duke informuar vazhdimisht publikun nëpërmjet lajmeve dhe raporteve të botuara në gazetën “EkoLëvizja” dhe në disa gazeta të përditshme dhe stacione televizive. Në prill dhe maj të vitit 2005, janë botuar në gazetën “EkoLëvizja”, dy artikuj rreth NOQ-ve dhe ndikimit të tyre në shëndetin njerëzor dhe mjedis.

Janë shtypur dhe shpërndarë në disa qytete të Shqipërisë fletëpalosje rreth NOQ-ve. Është përgatitur një film dokumentar dhe një spot televiziv rreth NOQ-ve. Të dyja këto janë dhënë në televizionet kombëtare.

Vlerësim i NOQ-ve lidhur me ndërgjegjësimin e grupeve të veçanta të popullsisë

Grupe të veçanta popullatash në Shqipëri kanë nivele të ndryshme informacioni dhe ndërgjegjësimi për çështjen e NOQ-ve. Në përgjithësi, publiku e di që përdorimi i pesticideve shoqërohet me rreziqe, por nuk di pothuajse asgjë për ndikimet konkrete të grupit të kimikateve të NOQ-ve dhe të secilit kimikat në veçanti apo se si veprojnë ato në organizmat e gjalla. Përgatitja e fletëpalosjeve, filmave dokumentar dhe publikimi i spoteve publicitar për NOQ-të ka një ndikim të fuqishëm në informim/ndërgjegjësimin e publikut. Mënyra e publikimit të këtyre materialeve ndërgjegjëse, duke i përsëritur disa herë në mjetet e komunikimit, ka dhënë rezultate më të mira në ndërgjegjësim. Megjithatë informacioni dhe ndërgjegjësimi për NOQ-të, është akoma i mangët.

Problemet përparësore dhe objektivat e administrimit

Problemet përparësore

- Nivel i ulët i informacionit dhe ndërgjegjësimit, në gjithë grupet e popullatës për NOQ-të;
- Nivel i ulët ndërgjegjësimi për pasojat në shëndet dhe mjedis nga keqadministrimi i vend-depozitimeve të mbeturinave urbane;
- Nivel i ulët i ndërgjegjësimit për NOQ-të i subjekteve të interesuara të sektorëve publik dhe privat.

Objektivat

- Rritja e ndërgjegjësimit për NOQ-të te të gjithë subjektet e interesuara dhe publiku i gjerë.



2.3.7 Përcaktimi i popullatave dhe i mjediseve të prekura; vlerësimi i shkallës dhe përmasave të kërcënimeve të shëndetit publik dhe cilësisë së mjedisit; rrjedhojat sociale për punonjësit dhe komunitetin.

Në këtë kapitull jepet një vështrim i shpejtë për popullatat e zbuluara ndaj rrezikut të mundshëm të NOQ-ve.

Porto-Romano në Durrës, pranë Detit Adriatik, aty ku më parë ndodhej ish-Uzina Kimike, ka trashëguar një sasi lindani, që ishte lënë jashtë çdo kontrolli. Kjo Uzinë konsiderohej si zona me ndotje më të lartë me NOQ në vend.

Për shkak të afërsisë me detin dhe shpëlarjeve të vazhdueshme të tokës së ndotur me pesticide në stinët me shira, peshkatarët dhe familjet e tyre, por edhe blerësit e peshkut në zonën e Porto-Romanos, mund të kenë qenë të zbuluar për vite të tëra ndaj pesticideve NOQ. Të zbuluara mund të kenë qenë edhe familjet që konsumonin perime të rritura vetë në kopshtet private dhe qumësht nga lopët e kësaj zone, pasi për shkak të zinxhirit ushqimor, dozat e tyre të përditshme mund t'i kenë kapërcyer normat e lejueshme.

Uzina u mbyll që në fillim të viteve '90, kështu që qysh atëherë asnjë punonjës nuk ka qenë më i ekspozuar ndaj pesticideve NOQ. Gjatë funksionimit të Uzinës nuk është kryer monitorim për sëmundjet me origjinë nga mjedisi dhe siguria në punë. Për këtë arsye, nuk është trashëguar asnjë evidencë për ndonjë grup të ekspozuar ndaj NOQ-ve në punë. Monitorimi i shëndetit të këtyre punëtorëve nuk është bërë as në periudhën e tranzicionit, pas mbylljes së Uzinës.

Heksaklorani dhe lindani që ndodheshin në këtë zonë u ri-ambalazhuan dhe u larguan nga Porto-Romano që në 1997 (me mbështetjen e Qeverisë Italiane). Ato u depozituan në magazinat e Bishtit të Pallës, prej ku (me mbështetjen e Qeverisë Holandeze) në vitin 2006 u eksportuan përfundimisht në Gjermani për asgjësim përfundimtar në një impiant trajtimi mbetjesh të rrezikshme. Me bashkërendimin e brendshëm midis MMPAU dhe MSH, në kuadër të këtij projekti u eksportuan edhe mbetjet e fundit të pesticideve NOQ që kishin mbetur pa përdorur në disa Drejtori Rajonale të Shëndetit Publik (Gjirokastrë, Durrës, Elbasan, Lushnjë, Lezhë, Lundër).

Gjatë lëvizjeve demografike që shoqëruan periudhën e tranzicionit, një numër familjesh nga zonat Veri-Lindore të vendit u vendosën pranë (madje edhe brenda) rrënojave të Uzinës. Në vitin 2005, nga një grup mjekësh u krye një studim lidhur me sëmundjet me origjinë mjedisin dhe sigurinë në punë, me titull "Vlerësim shëndetësor i banorëve të zonave të nxehta industriale dhe urbane". Studimi u realizua përmes pyetësorëve dhe analizave me 100 nxënës shkollash të moshës 10-16 vjeç, periudhë kur ata kalojnë më shumë kohë jashtë banesës. Studimi raportoi këto rezultate: 49% e fëmijëve vuanin nga dhimbjet e kokës; 27% e tyre kishin marrje mendsh; 18% e tyre kishin rrufë dhe të ftohtë; 37% kishin dhimbje barku; mbi 20% kishin marrje mendsh dhe të vjella; 14% kishin skuqje të lëkurës; 18% kishin hemorragji nga hundët. Studimi vlerësoi se këto simptoma lidhen me praninë e pluhurit të lindanit në tokë. Veç kësaj, rreth 55% e popullsisë së ekzaminuar u vlerësua si hipertoniqe dhe hipotonike.

Katër familjeve që ishin vendosur ilegalisht në zonën më të rrezikshme të Porto Romanos iu kërkua të largoheshin që atje. Shpërngulja e tyre kushtoi 8.5 milionë Lekë dhe u mbështet nga MMPAU përmes buxhetit të shtetit 2005.

Megjithatë, toka në Porto Romano ka mbetur e kontaminuar me lindan dhe krom 6-valent. Pas përfundimit të studimit të fizibilitetit për rehabilitimin e zonës së nxehtë (2005), zona do t'i nënshtrohet rehabilitimit me mbështetje të Ambasadës Holandeze/Bankës Botërore përmes Programit të Menaxhimit të Zonës Bregdetare. Mbështetja përfshin rehabilitimin dhe punimet e shembjes së strukturave të ndotura, si dhe monitorimin hidrogeologjik të zonës.

Uzina Kimike në Porto Romano ka qenë prodhuesja e vetme e kimikateve NOQ në Shqipëri. Kjo e lehtëson mjaft situatën, kur bëhet fjalë për çështje sociale apo të punësimit që lidhen me ndalimin e prodhimit të NOQ. Pas saj, nuk lind nevoja të mbyllen ndërmarrje të tjera në të ardhmen, pra nuk do të shfaqen as probleme punësimi. Nga ana tjetër, kostot e rehabilitimit të zonës po mbulohen nga bashkësia e donatorëve dhe buxheti i shtetit, kështu që barra e tyre nuk do të rëndojë mbi komunitetin lokal.

Në këtë çast është e vështirë të bëhet vlerësimi i kostove që mund të duhet të përballojnë fermerët apo bizneset e tjera nga zëvendësimi i pesticideve apo produkteve NOQ me produkte të parrezikshme. Meqë ekonomia kombëtare (pra edhe sektori bujqësor) në të kaluarën mbështeteshin në pronën shtetërore, kostot e pesticideve mbuloheshin nga buxheti i shtetit, jo nga fermerët, ndërsa tani, në regjimin e ekonomisë së tregut, fermerët privatë duhet të përdorin burimet e tyre për blerjen e faktorëve të prodhimit (pra edhe të pesticideve). Nga ana tjetër, pesticidet NOQ janë ndaluar në Shqipëri që 10 vjet më parë, dhe pas kaq kohe është i vështirë të bëhet krahasimi, ndërkohë që ka ndryshuar edhe vlera e monedhës vendase, por edhe e atyre të huaja (për sa i takon importit të NOQ-ve).

Zona të reja me pesticide NOQ janë raportuar edhe pas mbylljes së projektit të Bishtit të Pallës. Nga autoritetet vendore është raportuar se në stacionin e trenit në Bajzë gjendet një sasi prej 200 ton pesticide, ndoshta një mbeturinë nga pesticidet e skaduara të importuara nga Gjermania Lindore në vitin 1991, të cilat mund të mos jenë kthyer mbrapsht në total.

Pas privatizimit të magazinave, në disa raste së bashku me pesticidet NOQ apo me mbetje me përmbajtje NOQ, subjektet private duhet të përballojnë kostot shumë të larta dhe ndonjëherë të papërballueshme të riambalazhimit, transportit dhe asgjësimit të mbetjeve. Një situatë e tillë mund të kapërcehet përmes bashkëpunimit dhe bashkë-financimit me shtetin dhe/ose donatorët ndërkombëtarë.

Ndërkohë, një problem serioz i vazhdueshëm, që lidhet me NOQ e paqëllimshme, mbetet i pazgjidhur derisa të ndërtohen vend-depozitime sanitare dhe të ndalohet efektivisht djegia e mbeturinave në fushat e plehrave apo në pikat e ndryshme të grumbullimit të tyre. Hë për hë, individët që gërmojnë mes plehrave dhe pastruesit e rrugëve, të cilët i vënë zjarrin plehrave për të ulur volumin e tyre, së bashku me familjet që jetojnë pranë zonave ku digjen plehra, janë një grup që është i zbuluar vazhdimisht ndaj dioksinave dhe furaneve (PCDD/PCDF).

Pa dyshim, ndërtimi i vend-depozitimeve sanitare do të kërkojë shumë investime në fillim dhe edhe taksa që duhen përballuar çdo vit nga popullata, por në një perspektivë afatgjatë, analiza kosto-përfitim pritet të peshojë më tepër nga përfitimet në mjedis dhe shëndet, së bashku me përfitimet nga mbrojtja prej kimikateve të Aneksit C të Konventës së Stokholmit.

Meqë NOQ e paqëllimshme çlirohen në çdo rast zjarri, zjarrfikësit janë grupi i popullatës së rrezikuar për shkak të ekspozimit të tyre të vazhdueshëm ndaj zjarrit dhe tymit që e shoqëron/pason atë, dhe, për pasojë, edhe ndaj dioksinave dhe furaneve (PCDD/PCDF).

Për shkak të detyrës mjaft specifike, punëtorët në stacionet e transformatorëve janë një tjetër grup i ekspozuar ndaj PCB-ve. Ky grup përfshin prodhuesit, riparuesit e transformatorëve dhe kontejnerëve të mbushur me PCB, rikuperuesit e vajrave, etj. Meqë në këto lloj aktiviteteve mund të ndodhin edhe aksidente dhe/ose ndotje të tokës nga vajrat e përdorur apo mbetje, ky grup mund të përfshijë edhe personelin e angazhuar me punimet e rehabilitimit të saj.

- ➔ Sipas vlerësimeve të mësipërme, zbatimi i Konventës së Stokholmit nuk pritet të rëndojë ekonomikisht mbi popullatën dhe nuk do të ketë impakte sociale negative mbi të.

3. STRATEGJIA DHE ELEMENTET E PLANIT KOMBËTAR TË VEPRIMIT

3.1 Deklaratë e politikave

Me qëllim që të përmbushen detyrimet që rrjedhin nga qenia palë në Konventën e Stokholmit, janë të nevojshme të ndërmerren aksionet në vijim:

- Përgatitja dhe zbatimi i Strategjisë dhe Planit të Veprimit për heqjen nga përdorimin dhe shkatërrimin e Ndotësve Organikë të Qëndrueshëm (NOQ).
- Hartimi, në përputhje me direktivat përkatëse të Bashkimit Evropian, i kuadrit ligjor për administrimin mjedisor të NOQ-ve, duke përfshirë normat e lejuara për NOQ-të në elementet e mjedisit, shkarkimet nga aktivitetet ekonomike, monitorimin dhe limitet në produktet ushqimore.
- Hartimi i një baze ligjore rregulatore për grumbullimin dhe ruajtjen e PCB-ve e të pajisjeve që përmbajnë PCB.
- Informimi nëpërmjet formave dhe mjeteve të ndryshme të komunikimit i institucioneve përgjegjëse qendrore dhe vendore, aktorëve industrialë, subjekteve të kontrollit, institucioneve arsimore dhe kërkimore, mjeteve të shkruara dhe elektronike të komunikimit, sindikatave dhe publikut, mbi rreziqet për shëndetin e njeriut dhe mjedisin, që burojnë nga ndotja prej NOQ-ve, në përgjithësi, dhe prej dioksinave e furaneve, në veçanti
- Përcaktimi i institucioneve për monitorimin e NOQ-ve në mjedis (ajër, ujë, tokë dhe mjediset biologjike) dhe përcaktimi i institucioneve përgjegjëse për kryerjen e monitorimit (marrjen e mostrave dhe të analizave përkatëse).
- Kryerjen e inventarit për burimet kryesore të ndotjes nga dioksinat/furanet dhe PCB-të që shkarkohen në mjedis dhe krijimi i bankës së të dhënave (regjistri i inventarit të NOQ-ve).
- Krijimi i një kadastrore për prodhimin, shpërndarjen, përdorimin, importin dhe eksportin e NOQ-ve dhe mbeturinave të ndotura me NOQ.
- Sigurimi i kontrollit nga institucionet përkatëse i ruajtjes, transportimit dhe shkatërrimit të NOQ-ve.
- Sigurimi nga buxheti i shtetit ose nga burime të tjera financiare i fondeve për kërkimin dhe zhvillimin në fushën e administrimit të NOQ-ve.
- Realizimi i çertifikimit të detyruar mbi përmbajtjen e NOQ-ve në produktet ushqimore dhe lëndët e para.
- Zhvillimi dhe zbatimi i teknologjive dhe prodhimeve të pastra për minimizimin e përdorimit dhe shkarkimit në mjedis të NOQ-ve.
- Zgjerimi dhe forcimi i bashkëpunimit, këmbimit të informacionit shkencor për administrimin e NOQ-ve dhe përdorimin e teknologjive më të mira të mundshme (TMM) dhe të praktikave më të mira mjedisore (PMM).

3.2 Strategjia e Zbatimit

Në këtë pjesë përshkruhen aksionet e parashikuara në PKV, për të përmbushur detyrimet e Konventës së Stokholmit, duke pasqyruar situatën specifike të vendit. Mbështetur në analizën e situatës në vend, kërkesat e Konventës së Stokholmit si dhe të traktateve të tjera ndërkombëtare dhe politikave kombëtare në këtë drejtim, në zbatim të prioriteteve dhe objektivave kombëtare për NOQ-të, janë identifikuar opsionet për forcimin institucional dhe rregullator, menaxhimin e NOQ-ve, aktivitetet për rritjen e ndërgjegjësimit dhe kërkimin dhe zhvillimin.

Zgjedhjet e propozuara do t'u nënshtrohen planeve të veçantë të veprimit. Çdo zgjedhje alternative shoqërohet me një përshkrim të shkurtër të arsyes për të cilën është zgjedhur ky opsion në përmbushje të kërkesave të Konventës së Stokholmit.

Strategjia e zbatimit, përmban informacionin mbi aktivitetet që lidhen me çdo zgjedhje të veçantë, afatet kohore të zbatimit, agjencitë përgjegjëse dhe mbështetëse për zbatimin dhe treguesit e suksesit.

Plani Kombëtar i Veprimit përmban aksionet dhe strategjitë që vijnë:

1. Plan Veprimi: Masat për Forcimin e Kuadrit Institucional dhe Rregullator;
2. Plan Veprimi: Pesticidet NOQ (përfshirë DDT-në);
3. Plan Veprimi: PCB-të dhe Pajisjet që Përmbajnë PCB;
4. Plan Veprimi: Nënproduktet NOQ të Prodhuara në Mënyrë Jo të Qëllimshme;
5. Plan Veprimi: Mbetjet dhe Zonat e Kontaminuara
6. Plan Veprimi: Ndërgjegjësimi Publik, Informimi, Shpërndarja e Informacionit, Trajnimi dhe Zhvillimi
7. Strategji: Monitorimi;
8. Strategji: Shkëmbimi i Informacionit dhe Raportimi

Strategjia për shkëmbimin e informacionit dhe raportimin ofron bazën për raportim në Konferencën e Palëve si dhe për vlerësimet dhe përditësimet e ardhme të PKV.

3.3 Strategjitë dhe Planet e Veprimit

3.3.1 Plani i Veprimit: Masat për Forcimin Institucional dhe Rregullator

Legjislacioni kombëtar në Shqipëri duhet të plotësohet me të gjitha aktet që sigurojnë pajtueshmërinë me Konventën e Stokholmit, dhe, në mënyrë të veçantë, lidhur me:

1. Importin, eksportin, prodhimin dhe përdorimin e kimikateve të Shtojcës A (pesticidet);
2. Trajtimin, nxjerrjen nga përdorimi (deri në vitin 2025) dhe eliminimin (deri në vitin 2028) të kimikateve të Aneksit A II (PCBve)⁵;
3. Minimizimin ose eliminimin e kimikateve të Aneksit C (nënprodukte të NOQ-ve të prodhuara jo qëllimisht);
4. Eliminimin e sigurt nga pikëpamja mjedisore të mbeturinave të NOQ-ve.

Veç sa më lart, duke pasur parasysh që Shqipëria është në procesin e futjes në BE, në hartimin e Planit të Veprimit është marrë në konsideratë fakti që i gjithë legjislacioni për mjedisin do të shkojë gradualisht drejt përshtatjes me direktivat përkatëse të BE-së (*acquis communautaire*).

⁵ Në pajtueshmëri me Direktivën 96/59/EC, artikujt që janë tani në përdorim duhet të nxirren nga përdorimi dhe të eliminohen brenda vitit 2010

Zgjedhjet alternative të administrimit

Mbi bazën e analizës së situatës ekzistuese dhe duke pasur parasysh dispozitat e Konventës së Stokholmit dhe të marrëveshjeve të tjera ndërkombëtare që lidhen me NOQ-të si edhe në përputhje me prioritetet dhe objektivat kombëtare për menaxhimin e NOQ-ve, janë identifikuar zgjedhjet alternative të mëposhtme për fuqizimin institucional dhe rregullator:

1. Përfshirja e monitorimit të NOQ-ve dhe në veçanti të PCB-ve si pjesë e Programit Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit;
2. Regjistrimi i pajisjeve dhe vajrave që përmbajnë PCB në sektorin e energjisë elektrike;
3. Përafrimi i legjislacionit vendas me atë evropian;
4. Ngritja e strukturës kombëtare për zbatimin e Konventës së Stokholmit

Në vijim përshkruhen më në hollësi zgjedhjet alternative të propozuara për realizimin e objektivave . Për secilin opsion, teksti shpjegues përshkruan arsyen e përzgjedhjes, strategjinë e zbatimit dhe koston e supozuar për zbatimin e atij opsioni.

Strategjia e Zbatimit

1. Përfshirja e monitorimit të NOQ-ve dhe në veçanti të PCB-ve si pjesë e Programit Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit

Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 103, datë 31.03.2002 "Për monitorimin e mjedisit në Republikën e Shqipërisë" nuk parashikon monitorimin e NOQ-ve (dukë përfshirë edhe PCB-të, të cilat janë veçanërisht problematike për Shqipërinë). Në këto kushte, rekomandohet të futet në Programin Kombëtar të Monitorimit monitorimi i përmbajtjes së tyre në ajrin e mjediseve të brendshme, ujin e pijshëm, ushqim, mjediset biologjike (në ujëra sipërfaqësore) dhe në llumrat e ujërave të zeza & të kompostove të mbetjeve të përdorura në tokat bujqësore.

	Aktivitetet	Periodha	Institucioni Përgjegjës/ Mbështetës	Rezultati i pritshëm	Buxheti i vlerësuar 000/Lekë	Burimi i financimit
0	1	2	3	4	5	6
1. Monitorimi i NOQ-ve (me fokus të veçantë PCB-të) të përfshihet në Programin Kombëtar të Monitorimit						
1.1	Përcaktimi i treguesve dhe i skemës së monitorimit të përmbajtjes së NOQ-ve në ajrin e mjediseve të brendshme	2008	MMPAU/Njësia e NOQ-ve	Treguesit dhe skema të përcaktuara	100	BSh
1.2	Përfshirja e monitorimit të treguesve të NOQ-ve në programin e monitorimit të ajrit	2009	ISHP	Treguesit të monitoruar	500	BSh
1.3	Përcaktimi i treguesve dhe i skemës së monitorimit të përmbajtjes së NOQ-ve në ujin e pijshëm	2008	MSH/Njësia e NOQ-ve	Treguesit dhe skema të përcaktuara	100	BSh
1.4	Përfshirja e monitorimit të treguesve të NOQ-ve në programin e monitorimit të ujit të pijshëm	2009	ISHP	Treguesit të monitoruar	500	BSh
1.5	Përcaktimi i treguesve dhe i skemës së	2008	MMPAU/Njësia	Treguesit dhe	100	BSh

	monitorimit të përmbajtjes së NOQ-ve në mjediset biologjike (në ujërat sipërfaqësore)		e NOQ-ve	skema të përcaktuara		
1.6	Përfshirja e monitorimit të treguesve të NOQ-ve në programin e monitorimit të mjediset biologjike (ujërat sipërfaqësore)	2009	IM	Treguesit të monitoruar	500	BSh
1.7	Përcaktimi i treguesve dhe i skemës së monitorimit të përmbajtjes së NOQ-ve në ushqime	2008	MBUMK/Njësia e NOQ-ve	Treguesit dhe skema të përcaktuara	100	BSh
1.8	Përfshirja e monitorimit të treguesve të NOQ-ve në programin e monitorimit të ushqimit	2009	MBUMK/IKV, IU MSH/ISHP	Treguesit të monitoruar	500	BSh
1.9	Përcaktimi i treguesve dhe i skemës së monitorimit të përmbajtjes së NOQ-ve në tokë	2008	MMPAU/Njësia e NOQ-ve	Treguesit dhe skema të përcaktuara	100	BSh
1.10	Përfshirja e monitorimit të treguesve të NOQ-ve në programin e monitorimit të tokës	2009	Instituti i Tokave Instituti i Mbrojtjes së Bimëve	Treguesit të monitoruar	500	BSh
1.11	Përcaktimi i treguesve dhe i skemës së monitorimit të përmbajtjes së NOQ-ve në llumrat e ujërave të zeza dhe të kompostos së mbetjeve për përdorim në tokat bujqësore	2008	MMPAU/Njësia e NOQ-ve	Treguesit dhe skema të përcaktuara	100	BSh
1.12	Përfshirja e monitorimit të treguesve të NOQ-ve në programin e monitorimit të llumrave të ujërave të zeza dhe të kompostos së mbetjeve për përdorim në tokat bujqësore	2009	IM	Treguesit të monitoruar	500	BSh
1.13	Përcaktimi i treguesve të PCB-ve, i skemës së monitorimit dhe i mjediseve për t'u monitoruar (materiale të lëngshme dhe pajisje që lidhen me sektorin e energjisë elektrike)	2008	KESH, IM, /Njësia e NOQ-ve	Treguesit dhe skema të përcaktuara	300	BSh
1.14	Përfshirja e treguesve të PCB-ve në programin e monitorimit dhe të kontrollit	2009	KESH	Treguesit të monitoruar	1000	BSh
	Shuma				4.900	

2. Regjistrimi i pajisjeve dhe i vajrave me përmbajtje të PCB-ve në sektorin elektrik

Siç është identifikuar, deri më tani në Shqipëri nuk është kryer ndonjë monitorim i pranisë së PCB-ve në vajrat e përdorura në sektorin e energjisë elektrike. Po ashtu mungon një inventar i rregullt dhe i plotë i pajisjeve me prani të PCB-ve të përdorura po në sektorin e energjisë elektrike. Tabela e mëposhtme ilustron masat e nevojshme për të realizuar sa më sipër.

	<i>Zgjedhja alternative / Aktivitetet</i>	Periudha	Institucion Përgjegjës/Mbështetës	Rezultati i pritshëm	Buxheti i vlerësuar, 000/Lekë	Burimi i financimit
0	1	2	3	4	5	6
2.	Regjistrimi i pajisjeve dhe monitorimi i vajrave të përdorura në sektorin e energjisë elektrike për praninë e PCB-ve					
2.1	Përcaktimi i treguesve për t'u monitoruar lidhur me praninë e PCB-ve në vajrat e përdorura në sektorin e energjisë elektrike	2008	METE	Treguesit të përcaktuar	100	KESH
2.2	Monitorimi i vajrave të përdorura në sektorin e energjisë elektrike për praninë në to të PCB-ve	2009	KESH	Treguesit të monitoruar	500	KESH
2.3	Regjistrimi i transformatorëve dhe kondensatorëve me përmbajtje të PCB-ve në zonat industriale (të atyre që janë në përdorim dhe të atyre që janë shndërruar në mbetje)	2009	METE - KESH	Regjistri i plotësuar	700	KESH
2.4	Regjistrimi i lëngjeve dielektrike të transformatorëve dhe kondensatorëve, me përmbajtje të PCB-ve (të përdorur për mirëmbajtje dhe si këmbyses)	2009	METE - KESH	Regjistri i plotësuar	700	KESH
	Shuma				2.000	

3. Përafrimi i legjislacionit vendas me atë Europian

Në Planin Kombëtar të Veprimit për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizimit Asocimit, në kapitujt e cilësisë së ajrit, kimikateve, mbetjeve të rrezikshme dhe aksidenteve industriale janë trajtuar edhe aktet që duhen hartuar lidhur me NOQ-të. Tabela e mëposhtme paraqet masat të parashikuara nga ky plan të plotësuara apo detajuara më tej me masat të nevojshme në kuadër të zbatimit të Konventës së Stokholmit.

Siç është përmendur edhe më lart, në Shqipëri nuk ekziston asnjë ligj apo akt i veçantë që t'u dedikohet posaçërisht NOQ-ve në përgjithësi apo PCB-ve në veçanti. Ndërkohë, në zbatim të Konventës së Stokholmit është e nevojshme të kryhet reforma legjislative për menaxhimin (inventarizimi, etiketimi, raportimi), dorëzimin (mirëmbajtja, transporti, asgjësimi) dhe nxjerrjen nga përdorimi të PCB-ve dhe të materialeve me prani të PCB-ve (pajisje dhe mbetje) dhe të ndalohej me çdo kusht importimi i PCB-ve të reja.

Prania e PCB-ve shoqërohet me risqe të njohura, të një shkalle relativisht të lartë për shëndetin, sigurinë dhe mjedisin. Pa një mekanizëm efektiv për regjistrimin, etiketimin dhe raportimin e PCB-ve, nuk ka as të dhëna të besueshme, të cilat do të shërbenin si bazë për të arritur në vendime apo për të hartuar politika për nxjerrjen e tyre nga përdorimi dhe për asgjësimin përfundimtar të tyre (brenda vitit 2025 për pajisjet, apo brenda vitit 2028 për mbetjet me përmbajtje të PCB-ve).

Në këto kushte bëhet i domosdoshëm hartimi i një ligji integral për NOQ-të. Ky ligj duhet të trajtojë në mënyrë të veçantë edhe PCB-të me qëllim që të rinovohet rregullisht inventari i tyre dhe gradualisht të nxirren nga përdorimi pajisjet me prani të PCB-ve dhe të asgjësohen në mënyrë të sigurt mbetjet që përmbajnë PCB. Ky ligj do të mbulojë të gjitha çështjet që lidhen me PCB-të apo kimikate të tjera NOQ: menaxhimin e tyre (inventarizimi, etiketimi, raportimi) gjatë kohës që janë akoma në përdorim, ndalimin e prodhimit dhe importit, dorëzimin (mirëmbajtja, transporti, asgjësimi), dhe nxjerrjen nga përdorimi të PCB-ve, kontrollin e import-eksportit dhe asgjësimit të kimikateve të Aneksëve A II dhe B III (përveç pesticideve), etj.

Megjithatë Shqipëria e ka ratifikuar Konventën e Bazelit "Mbi kontrollin e lëvizjeve ndërkufitare të mbetjeve të rrezikshme dhe asgjësimit të tyre", në kuadrin ligjor ekzistojnë boshllëqe, të cilat duhet të plotësohen me qëllim kontrollin e efektshëm të importit të këtyre mbetjeve/kimikateve të rrezikshme. Ndërkohë që importimi dhe përdorimi i pesticideve është rregulluar ligjërisht, për NOQ-të e tjera, veç

pesticideve, nuk ka mekanizma rregullatorë. Prandaj, prioritet duhet t'i jepet parandalimit të hyrjes në Shqipëri si kimikate të pastra të stoqeve të reja të NOQ-ve, të pajisjeve që përmbajnë NOQ dhe të mbetjeve me përmbajtje të NOQ-ve që mund të hyjnë për t'u përdorur si lëndë e parë.

Akti i mësipërm duhet shoqëruar me një sërë aktesh të tjera nën-ligjore si: hartimi i udhëzuesve dhe standardeve për menaxhimin/kontrollin e PCB-ve përgjatë gjithë ciklit të jetës së tyre; rregullore për eliminimin e sigurt të PCB-ve dhe mbeturinave me përmbajtje të PCB-ve në mbështetje të Ligjit "Për administrimin e mbetjeve të rrezikshme" Nr. 9537, datë 18.05.2006. *Udhëzuesit, standardet dhe rregulloret për PCB-të janë subjekt i Planit të Veprimit për PCB-të.*

Shqipëria ka aderuar në Konventën e Ajrit (LRTAP) me Ligjin Nr. 9425, datë 06.10.2005. Në vijim të tij janë planifikuar të nisin procedurat për aderim edhe në protokollet e hartuara në kuadër të kësaj Konvente, një prej të cilëve është edhe Protokollin i NOQ-ve.

	Aktivitetet	Perioda	Institucioni Përgjegjës/Mbështetës	Rezultati i pritshëm	Buxheti i vlerësuar, 000/Lekë	Burimi i financimit
0	1	2	3	4	5	6
3.	Përafrimi i legjislationit me atë Evropian					
3.1	Ndryshimi i VKM-së për monitorimin me kërkesat për pesticidet NOQ.	2009	MMPAU/Njësia e NOQ-ve	Vendimi i ri i ndryshuar	100	BSh
3.2	Hartimi dhe miratimi i ligjit për NOQ-të, mbështetur në 75/439/EC, 91/157/EC, 93/86/EEC, 98/101/EC, 2001/68/EC dhe Vendimin e Komisionit Evropian 96/59/EC për asgjësimin e PCB-ve/PCT-ve, etj.	2009	MMPAU/Njësia e NOQ-ve	Ligji i harmonizuar me direktivat e BE-së	2.000	BSh/donatorët
3.3	Hartimi dhe miratimi i një projekt-akti për lëndët aktive dhe NOQ-të, mbështetur në 79/117/EEC 83/131/EEC, 85/298/EEC, 86/214/EEC, 86/355/EEC, 89/365/EEC, 90/335/EEC, 90/533/EEC, 91/188/EEC, (EC) No 850/2004	2012	MMPAU/METE/MSH	Akti i harmonizuar	6.000	BSh/donatorët
3.4	Hartimi dhe miratimi i udhëzuesve dhe standardeve për menaxhimin/kontrollin e PCB-ve përgjatë gjithë ciklit të jetës së tyre	2010-2012	METE/KESH/Njësia e NOQ-ve	Udhëzuesit të gatshëm për zbatim	300	BSh
3.5	Hartimi dhe miratimi i akteve nënligjore për asgjësimin e sigurt të PCB-ve dhe mbetjeve me përmbajtje të PCB-ve në mbështetje të Ligjit "Për administrimin mjedisor të mbetjeve të rrezikshme" Nr. 9537, datë 18.05.2006	2012	MMPAU	Aktet nënligjore të gatshëm për zbatim	300	BSh

3.6	Hartimi dhe miratimi i ligjit "Për shkarkimet e substancave të rrezikshme", mbështetur në Direktivat 76/464/EEC, 82/176/EEC, 83/513/EEC, 84/156/EEC, 4/491/EEC, 86/280/EEC	2009	MMPAU	Ligji i harmonizuar	6.000	BSh/donatorët
3.7	Hartimi dhe miratimi i aktit për transportimin e mallrave të rrezikshme, mbështetur në Aktin Normativ 304/2003, Aktiv Normativ të Komisionit 1213/2003, Aktin Normativ të Komisionit 775/2004	2011	MMPAU/METE/MPPTT	Akti i harmonizuar	6.000	BSh/donatorët
3.8	Hartimi dhe miratimi i një Projekt-akti Për kufizimet e hedhjes në treg dhe përdorimin e lëndëve dhe preparateve të rrezikshme, mbështetur në 76/769/EEC, 79/663/EEC, 82/806/EEC, 82/828/EEC, 83/264/EEC, 85/467/EEC, 85/610/EEC, 89/678/EEC, 89/677/EEC, 91/173/EEC, 91/338/EEC, 91/339/EEC, 94/27/EC, 94/48/EC 94/60/EC, 97/16/EC 97/56/EC, 1999/43/EC 2001/41/EC, 2003/11/EC, 2003/34/EC, 2003/36/EC, 2003/53/EC	2009	MMPAU/METE	Akti i harmonizuar	6.000	BSh/donatorët
3.9	Hartimi dhe miratimi i një projekt-akti për klasifikimin dhe paketimin e lëndëve të rrezikshme, mbështetur në Direktivën 1999/45/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit datë 31 maj 1999, Direktivën e Komisionit 2001/60/EC, Direktivën e Komisionit 91/155/EEC, Direktivën e Komisionit 93/112/EC	2010	MMPAU/METE	Akti i harmonizuar	6.000	BSh/donatorët
3.10	Hartimi dhe miratimi i projektligjit për aderim në Protokollin e NOQ-ve në kuadër të Konventës së Ajrit (LRTAP)	2010	MMPAU	Dokumentet e aderimit të përgatitura	240	BSh
3.11	Përfshirja në kuadrin ligjor i elementëve që lidhen me Direktivën e IPPC-së (Direktiva 96/61/EC e ndryshuar nga Direktivat 2003/35/EC dhe 2003/87/EC, Direktiva Seveso II)	2009	MMPAU	Aktet të harmonizuara	6.000	BSh/donatorët

3.12	Hartimi dhe miratimi i akteve nënligjorë për përkufizimin dhe detyrimin e përdorimit të "Teknikave më të mira të mundshme-BAT" për industrinë më të rëndësishme në Shqipëri, p.sh. për rafineritë e naftës, prodhimin e çimentos, fonderitë, etj.	2010	MMPAU	Aktet të harmonizuara	6.000	BSh
3.13	Transpozimi i direktivave përkatëse që lidhen me përbërjet organike fluturuese (VOC).	2011	MMPAU	Aktet të harmonizuara	6.000	BSh/donatorët
	Shuma				50.940	

4. Ngritja dhe funksionimi i strukturës kombëtare për zbatimin e Konventës së Stokholmit

Në zbatim të Ligjit Nr. 9108, datë 17.07.2003 "Për substancat dhe preparatet kimike", nenit 10/8 të tij, "Këshilli i Ministrave miraton organizimin dhe strukturën e Zyrës së Regjistrimit të Kimikateve". Sipas të njëjtit ligj, "Ministri i Mjedisit miraton rregulloren e funksionimit të kësaj Zyre."

Duke marrë në konsideratë mungesën e burimeve për të krijuar struktura të reja brenda organeve shtetërore, është menduar që të përdoret Zyra e Regjistrimit të Kimikateve edhe si organizmi kombëtar për zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga qenia palë në Konventën e Stokholmit. Ajo që duhet siguruar lidhet me përfshirjen në detyrat dhe përgjegjësitë e Zyrës së Kimikateve edhe të detyrave dhe përgjegjësiqe që i përkasin administrimit të NOQ-ve. Sa më lart, duhet parashikuar në hartimin e projekt-vendimit të KM për krijimin e kësaj Zyre dhe në projekt-rregulloren e Ministrit të Mjedisit që do të përshkruajë mënyrën e funksionimit të Zyrës.

	<i>Zgjedhja alternative / Aktivitetet</i>	Periudha	Institucioni Përgjegjës/Mbështetës	Rezultati i pritshëm	Buxheti i vlerësuar, 000/Lekë	Burimi i financimit
0	1	2	3	4	5	6
4.	Ngritja e strukturës kombëtare për zbatimin e Konventës së Stokholmit					
4.1	Investim për hapjen e zyrës (qiraja e zyrës pajisjet, etj.)	2007	MMPAU	Zyra funksionale	2.200	BSh
4.2	Punësimi i 2 specialistëve funksionarë të zyrës	2007-2025	MMPAU	Personeli funksional	13.000	BSh
	Shuma				15.200	

3.3.2 Plani i Veprimit: Pesticidet NOQ

Në lidhje me përdorimin e pesticideve NOQ dhe DDT e lindan në shëndetësi, Konventa e Stokholmit përcakton objektivat e mëposhtme:

Të eliminohet prodhimi dhe përdorimi i të gjitha pesticideve NOQ;

Ndalimi i përdorimit të DDT dhe lindanit, me përjashtim të rasteve emergjente të miratuara nga Sekretariati Konventës me qëllim përdorimi të DDT në programet e kontrollit kundër sëmundjeve vektoriale.

Zgjedhjet alternative të administrimit

Në mbështetje të analizës së situatës në vend, duke marrë në konsideratë dispozitat e Konventës së Stokholmit, si edhe traktateve të tjera ndërkombëtare të lidhura me të, në vijim të prioriteteve kombëtare dhe objektivave për pesticidet NOQ, janë përcaktuar zgjedhjet alternative të mëposhtme të administrimit:

- 1 Përgatitja e një amendamenti të VKM për monitorimin dhe për shtrirjen e këtij të fundit që të mbulojë edhe pesticidet NOQ.
- 2 Kryerja e analizave të niveleve të pranishme të mbetjeve të pesticideve NOQ, në ish-depot dhe vendet e kontaminuara, duke përfshirë edhe vlerësimin e efektit të tyre;
- 3 Forcimi i kapacitetit njerëzor dhe teknik i laboratorit analitik në Institutin e Mbrojtjes së Bimëve;
- 4 Përgatitja e planit të veprimit për rehabilitimin e vendeve të kontaminuara nga pesticidet NOQ;
- 5 Rritja e ndërgjegjësimit të publikut në lidhje me rrezikun e mundshëm të vendeve të kontaminuara me NOQ.

Shënim: Zgjedhja alternative 1 do të përshkruhet në kapitullin për forcimin institucional dhe ligjor. Zgjedhja alternative 5 do të zbatohet në kuadrin e Planit të Veprimit për Ndërgjegjësimin e Publikut.

Në tekstin e mëposhtëm përshkruhen me hollësi mundësitë e propozuara për realizimin e objektivave. Për secilën zgjedhje alternative ka një tekst shpjegues për strategjinë e vënies në jetë të saj dhe për kostot përkatëse.

Strategjia e zbatimit

2. Kryerja e analizave për nivelet e pranishme të mbetjeve të pesticideve NOQ në ish-depot dhe vendet e ndotura, duke përfshirë edhe vlerësimin e rrezikut

Analizat e mbetjeve të pesticideve në përgjithësi, dhe veçanërisht për mbetjet e pesticideve NOQ, janë të vështira dhe nevojitet një staf profesional dhe pajisje. Janë bërë disa analiza në laboratorët e Fakultetit të Shkencave të Natyrës, të Institutit të Mbrojtjes së Bimëve dhe të Institutit të Shëndetit Publik. Në PKV është parashikuar të bëhen ndryshimet e nevojshme për të përfshirë edhe monitorimin e pesticideve NOQ në zona/teritore që janë eventualisht të ndotura nga kjo kategori e pesticideve, përfshirë lindanin. Për të realizuar monitorimin, në PKI është parashikuar edhe krijimi i laboratorëve profesionalë dhe stafi teknik dhe laboratorik i specializuar për pesticidet NOQ.

	Aktiviteti	Periudha	Institucioni përgjegjës/ mbështetës	Rezultati i pritsëm	Buxheti i vlerësuar në 000/Lekë	Burimet e fondeve
0	1	2	3	4	5	6
2.	Kryerja e analizave të niveleve të pranishme të mbetjeve të pesticideve NOQ në ish-depot dhe vendet e kontaminuara.					
2.1	Program për studimin analitik të niveleve ekzistuese të ndotjeve në ish-depot e pesticideve NOQ dhe në hapësirat rreth tyre.	2007-2008	MBUMK, MM, IMB, LQU, MSH	Programe të miratuara nga MMPAU dhe Universiteti	100	MBUMK
2.2	Rishikimi i metodikave për kompletimin me pajisjet e nevojshme laboratorike për kryerjen e analizave të pesticideve NOQ.	2007-2008	MBUMK, MSH, MM, ISHP, IMB, LQU	Sigurimi i metodikave dhe i pajisjeve	150	MBUMK
2.3	Kryerja e analizave për nivelet e pranishme të pesticideve NOQ në ish-depot dhe në tokën rreth e rrotull.	2007-2009	IMB, ISHP, LQU	Rezultatet e analizave	8.000	MBUMK , Donatorë
2.4	Analizat e riskut në ish depot e pesticideve dhe në hapësirat përreth.	2008-2011	MBUMK, MSH , MM, MMPAU, IMB, ISHP, LQU, IM	Konkluzionet dhe rekomandimet Raport për vlerësimin e rrezikut	4.000	MBUMK Donatorë
	Shuma				12.250	

3. Forcimi i kapacitetit njerëzor dhe teknik i laboratorit analitik pranë IMB

Në këtë aktivitet përfshihen pajisja e laboratorit për fazën përgatitore dhe analizuese; pajisjet për marrje e mostrave të tokës dhe të ujit. Ekstraktimi, purifikimi dhe përqendrimi i mostrave. Trajnimi i stafit të laboratorit për të analizuar mbetjet e pesticideve NOQ (trajnim për marrjen e mostrave të ujit dhe të tokës, në kushtet specifike të këtyre analizave, trajnim për përdorimin aparaturave speciale për analizat kimike të mbetjeve të pesticideve NOQ).

	Aktivitetet	Periudha	Institucioni mbështetës / përgjegjës	Rezultati i pritshëm	Buxheti i vlerësuar, 000/Lekë	Burimet e fondeve
0	1	2	3	4	5	6
3.	Forcimi i kapacitetit teknik dhe njerëzor i laboratorëve analitikë të Institutit të Mbrojtjes së Bimëve					
3.1	Pajisja e laboratorëve me aparatura për marrjen e mostrave dhe analizat e pesticideve NOQ.	2007 – 2008	MBUMK, MMPAU, IMB	Laboratorët e pajisur me aparatura	21.200	MBUMK Donatorë
3.2	Trajnimi i stafit të laboratorit për të analizuar pesticidet NOQ.	2007 - 2008	MBUMK, MMPAU, IMB	Staf i aftësuar për të kryer analizat e pesticideve NOQ.	2.000	MBUMK Donatorë
3.3	Trajnim për metodikën e vlerësimit të riskut për vendet e kontaminuara.	2008	MBUMK, MMPAU, IMB	Staf i trajnuar për interpretimin dhe vlerësimin e analizave të riskut	1.000	MBUMK Donatorë
	Shuma				24.200	

4. Përgatitja e planit të veprimit për rehabilitimin e vendeve të kontaminuara me pesticide NOQ

Aktivitetet e këtij plani përmbajnë :Studim i hollësishëm i vendeve të kontaminuara, për evidentimin e përmbajtjes së pesticideve NOQ; përgatitja dhe programimi i aktiviteteve për dekontaminimin dhe rehabilitimin e vendeve të cilat rezultojnë të ndotura.

	Aktivitetet	Periudha	Institucioni mbështetës / përgjegjës	Rezultati i pritshëm	Buxheti i vlerësuar, 000/Lekë	Burimet e fondeve
0	1		3	4	5	6
4	Përgatitja e planit të veprimit për rehabilitimin e vendeve të ndotura nga pesticidet NOQ					
4.1	Përgatitja e Planit të veprimit për rehabilitimin e vendeve të ndotura.	2010-2011	IMB, ISHP, LQA, IM	Plani i Veprimit i miratuar	1.000	MBUMK
4.2	Rehabilitimi i vendeve të cilat rezultojnë si të ndotura.	2012-2018	MMPAU, MBUMK, MSH, MM, PV, SP	Zbatimi Planit të Veprimit	N A	MBUMK Donatorë
	Shuma				1.000	

3.3.3 Plani i Veprimit: PCB-të dhe Pajisjet që Përmbajnë PCB

Konventa e Stokholmit përcakton objektivin e mëposhtëm që lidhet me PCB-të dhe pajisjet që i përmbajnë ato:

Të merren masa të efektshme për t'i nxjerrë jashtë përdorimit këto pajisje deri në vitin 2025 dhe të punohet për të arritur administrimin e qëndrueshëm mjedisor për mbeturinat që përmbajnë PCB, të shumtën deri në vitin 2028.

Zgjedhje alternative administrimi

Në mbështetje të analizës së situatës mjedisore të vendit dhe duke marrë në konsideratë kushtet e Konventës së Stokholmit si dhe politikat kombëtare dhe ndërkombëtare përkatëse, në vijim të prioritetëve dhe objektivave për menaxhimin e NOQ-ve, janë identifikuar disa mundësi menaxhimi, si më poshtë:

- 1 Të hartohet dhe të zbatohet një rregullore në lidhje me administrimin, trajtimin, monitorimin, heqjen nga përdorimi dhe eliminimin e vajit e pajisjeve të ndotura me PCB;
- 2 Të hartohet dhe të zbatohet një udhëzues i brendshëm i KESH-it për administrimin, trajtimin dhe heqjen nga përdorimi të transformatorëve të ndotur me PCB;
- 3 Të trajnohen punonjësit përgjegjës për trajtimin dhe mirëmbajtjen e transformatorëve;
- 4 Krijimi i kapaciteteve laboratorike për kryerjen e analizave për praninë e PCB-ve në vajrat e transformatorëve;
- 5 Zbatimi i veprimtarive për rritjen e ndërgjegjësimit të publikut, puna e të cilëve lidhet me praninë e PCB-ve;
- 6 Rehabilitimi gradual i vendeve të ndotura me PCB;
- 7 Eliminimi i vajit mineral të ndotur me PCB
- 8 Hartimi dhe zbatimi i një programi kombëtar për monitorimin e PCB-ve.

Shënim: Zgjedhja alternative 1 është përfshirë në Planin e Veprimit për Forcimin Institucional dhe Ligjor. Zgjedhja 5 është përfshirë në Planin e Veprimit për Ndërgjegjësimin e Publikut.

Në vijim përshkruhen me hollësi zgjedhjet alternative të propozuara për realizimin e objektivave. Për secilën zgjedhje jepet një tekst shpjegues që përshkruan aktivitetin, kohën e zbatimit dhe kostot e parashikuara për zbatimin e tij.

Strategjia e zbatimit

2. Të hartohet dhe zbatohet një udhëzues i brendshëm i KESH-it mbi menaxhimin, trajtimin dhe nxjerrjen nga përdorimi të transformatorëve të ndotur me PCB.

KESH disponon një "Rregullore për sigurinë dhe përdorimin teknik të pajisjeve dhe instalimeve elektrike" të përgatitur nga Inspektorati i Pajisjeve dhe Instalimeve Elektrike dhe të miratuar nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës. Gjithashtu një dokument tjetër i rëndësishëm i përgatitur në kuadrin e Normës Europiane EN 50110-1 dhe që shërben si rregullore e brendshme e KESH-it është Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë dhe Shëndetit.

Në bazë të problemeve specifike që karakterizojnë sektorët e energjetikës në këtë kuadër, janë përgatitur udhëzues dhe procedura të brendshme në lidhje me mirëmbajtjen e pajisjeve elektrike dhe që ndihmojnë në zbatimin sa më mirë të këtyre dokumenteve të rëndësishëm.

Për shkak të mungesës deri tani të informacionit për PCB-të, nivelit të ulët të ndërgjegjësimit për njohjen dhe rrezikun e tyre në njerëz dhe mjedis, në Shqipëri nuk ekziston ndonjë udhëzues për menaxhimin, trajtimin dhe nxjerrjen nga përdorimi të transformatorëve të ndotur me PCB.

Në Shqipëri, pjesa më e madhe e mbeturinave të pritur me PCB mendohet të jenë vajra të ndotura me PCB (jo vaj PCB). Është shumë e rëndësishme të përgatiten udhëzues dhe procedura me qëllim ndalimin e ndotjes së mëtejshme të pajisjeve gjatë procesit të mirëmbajtjes së tyre. Gjithashtu, është shumë e rëndësishme vendosja si kriter përparësor në këto rregullore; nxjerrja jashtë përdorimit e transformatorëve të ndotur me PCB që janë më të vjetër sesa limitet e vendosura.

	Aktivitetet	Periudha	Institucionet Përgjegjëse/mbështetëse	Rezultati i pritshëm	Buxheti i vlerësuar, 000/Lekë	Burimet e fondeve
0	1	2	3	4	5	6
2.	Të hartohet dhe zbatohet një udhëzues i brendshëm i KESH-it për administrimin, trajtimin dhe heqjen nga përdorimi të transformatorëve.					
2.1	Studimi i akteve normative ndërkombëtare, Konventës së UNEP-it dhe Bazelit dhe legjislacionit të Bashkimit European	2007	KESH	Përvetësimi i dokumenteve ndërkombëtare	50	KESH
2.2	Hartimi i udhëzuesit të brendshëm për largimin e pajisjeve me vaj PCB, materialeve PCB dhe tokës së ndotur me PCB	2007	KESH	Udhëzuesit në fuqi	420	Donatorë KESH
2.3	Hartimi i udhëzuesit të brendshëm për nxjerrjen jashtë përdorimit të pajisjeve të ndotura	2007	KESH	Udhëzuesit në fuqi	420	Donatorë KESH
2.4	Zbatimi i udhëzuesit të brendshëm për largimin e vajit PCB dhe tokës të ndotur	2008-2011	KESH dhe të gjithë subjektet që kanë lidhje me problemin e PCB-ve	Vajrat dhe dherat e ndotura të larguara nga objektet/vendet e kontaminuara	1.000	KESH
2.5	Zbatimi i udhëzuesit të brendshëm për nxjerrjen jashtë përdorimit të pajisjeve të ndotura	2008-2011	KESH dhe të gjithë subjektet që kanë lidhje me problemin e PCB-ve	Pajisjet e ndotura të depozituara në vende të posaçme	1.000	KESH
2.6	Rishikimi dhe përmirësimi i udhëzuesit të brendshëm	2008-2020	KESH	Udhëzues i përmirësuar	650	KESH
	Shuma				3.540	

3. Të trajnohen punonjësit përgjegjës për trajtimin dhe mirëmbajtjen e transformatorëve

Trajnimi në fushën e PCB-ve është i nevojshëm për përfaqësuesit e të gjithë grupeve të punonjësve dhe profesionistëve veprimtaria dhe puna e të cilëve ka lidhje me problemet e PCB-ve dhe për personat e aftë për shpërndarjen e informacionit në publikun e gjerë, siç janë autoritetet publike lokale dhe qendrore, trupa pedagogjike e shkollave dhe universiteteve, edukatorët e kopshteve të fëmijëve, personeli drejtues në industri, OJF-të dhe institucionet për ngritje profesionale, drejtuesit e partive politike, organizatat për zhvillimin social dhe ekonomik, etj.

Për shkak të arsyeve të lart-përmendura, në Shqipëri kanë munguar trajnimet e posaçme me punonjësit që janë përgjegjës për transformatorët me PCB, të cilët janë në përdorim ose në poqes ruajtje, për mirëmbajtjen dhe trajtimin e tyre.

Përgatitja e manualeve të trajnimit, shpjegimi i mekanizmit të ndotjes me vaj, mekanizmit i ndotjes tërthore, metodika e përcaktimit të PCB-ve, specifikimet e kiteve të analizave, kurset e trajnimit për të gjitha ndërmarrjet elektrike, përgatitja e një regjistri (ku përfshihen identifikimi i PCB-ve, etiketimi, vlerësimi i pajisjeve të ndotura dhe menaxhimi i sigurt i tyre dhe raportimi) dhe konsultimet me sipërmarrësit janë detyrat kryesore për zbatimin e këtij varianti të menaxhimit.

Procesi i trajnimit mund të përfshijë jo vetëm informacionin e gjerë për PCB-të dhe ndikimin e tyre por edhe praktikën dhe teknikat për zgjerimin e informacionit lidhur me PCB-të, referime për burime shtesë informacioni, metoda të veçanta për mbledhjen e të dhënave dhe transferimin e informacionit dhe aftësimin për përfshirjen e shqetësimeve lidhur me PCB-të në organet vendim-marrëse, në nivele përkatëse.

	Aktivitetet	Periodha	Institucionet Përgjegjëse/ mbështetëse	Rezultati i pritshëm	Buxheti i vlerësuar, 000/Lekë	Burimet e fondeve
0	1	2	3	4	5	6
3.	Të trajnohen punonjësit përgjegjës për trajtimin dhe mirëmbajtjen e transformatorëve					
3.1	Studimi i dokumenteve të trajnimit	2008	KESH, personeli përgjegjës për trajnimet	Zotërimi i programit të trajnimit nga drejtuesit	310	KESH
3.2	Përgatitja e trajnimeve specifike për brigadën e mirëmbajtjes së transformatorëve	2008	KESH	Kualifikimi i brigadës së mirëmbajtjes	340	KESH Donatoret
3.3	Përgatitja e trajnimeve specifike për punonjësit përgjegjës për transformatorët	2008	KESH	Kualifikimi i punonjësve	340	KESH Donatoret
3.4	Zbatimi praktik i trajnimit	2009-2011	KESH	administrim mjedisor i transformatorëve	1.000	KESH
3.5	Përmirësimi i procedurave të trajnimit	2009-2010	KESH	Rritja e kapaciteteve të drejtuesve	120	KESH
	Shuma				2.110	

4 Krijimi i kapaciteteve laboratorike për kryerjen e analizave për praninë e PCB-ve në vajin e transformatorëve

Në Shqipëri funksionojnë disa laboratorë që janë në varësi të institucioneve shtetërore dhe disa prej tyre i përkasin sektorit privat të cilët punojnë për qëllime dhe parametra specifike.

Megjithatë, asnjë nga këta laboratorë në Shqipëri, hë për hë, nuk ka si objekt pune analizën e PCB-ve as kur ato ndodhen në produkte as në formën e mbetjeve, pra në Shqipëri nuk ekzistojnë laboratorë që të kryejnë analizat e PCB-ve. Përpara disa vjetësh, në Shqipëri janë analizuar PCB-të në vaj dhe në dhera në disa qendra shkencore por jo në laboratorë të akredituar. Tani, analizat e PCB-ve nuk mund të kryhen për shkak të mungesës kapaciteteve teknike dhe profesionale.

Në këtë situatë është i nevojshëm përmirësimi dhe akreditimi i laboratorëve ekzistues dhe/ose ngritja e njësive të reja analitike të profilizuara për analizën e PCB-ve. Identifikimi i kërkesave laboratorike, specifikimi dhe blerja e pajisjeve, furnizimi me reagjentë dhe standarde si dhe trajnimi i stafit janë aktivitetet më të rëndësishme për realizimin e këtij variant menaxhimi.

	Aktivitetet	Periudha	Institucionet Përgjegjëse/mbështetëse	Rezultati i pritshëm	Buxheti i vlerësuar, 000/Lekë	Burimet e fondeve
0	1	2	3	4	5	6
4.	Krijimi i kapaciteteve laboratorike për kryerjen e analizave për praninë e PCB-ve në vajin e transformatorëve					
4.1	Identifikimi i laboratorëve	2007	Ministria e Mjedisit, KESH	Caktimi i lab. Për analiza të PCB-s	120	KESH
4.2	Blerja e pajisjeve për analizat e PCB-ve	2007- 2008	Donatorët ndërkombëtarë, Qeveria Shqiptare, KESH	Sigurimi i Pajisjeve	6.130	KESH, Donatorët
4.3	Trajnimi i personelit	2008	Donatorë ndërkombëtarë	Personel i kualifikuar	520	KESH, Donatorë
4.4	Akreditimi i laboratorëve dhe vlerësimi i performancës së tyre	2009	KESH, MMPAU	Laboratorë të akredituara	200	KESH
	Shuma				6.970	

5. Rehabilitimi gradual i mjediseve të ndotura me PCB

Në Shqipëri, njohuritë mbi rrezikshmërinë e shkaktuar nga PCB-të janë fillestare dhe shumë prej njerëzve, ndër ta edhe zyrtarë, nuk kanë pasur njohuri për to deri në vitin 2005 kur filloi projekti për PKV për NOQ-të. Nuk u është kushtuar vëmendje rrjedhjeve ose pikimeve të vajit të transformatorëve të ndotur me PCB (në përdorim, në rezervë, për riparim dhe për eliminim) dhe transformatorëve të tjerë që kanë pësuar zjarr. Deri tani nuk është përgatitur asnjë informacion për mjediset e ndotura me PCB. Gjithsesi ka disa zona kryesore që mund të konsiderohen si mjedise të ndotura, siç janë Reparti i Riparimit të Transformatorëve dhe Reparti i Trajtimit të Vajit në Tiranë, transformatorët që pikojnë dhe transformatorët e djegur, por shkalla dhe rrezikshmëria e kësaj ndotjeje nuk mund të vlerësohen deri në kryerjen e studimeve të hollësishme.

Për vite të tëra kanë ndodhur shumë rrjedhje vaji për shkak të mungesës së trajnimit të personelit, mbushjes së papërshtatshme me vaj të depozitave të transformatorëve ose përdorimit të pajisjeve të vjetra.

Në Shqipëri vazhdojnë të jenë në përdorim shumë transformatorë të vjetër, të cilët janë prodhuar përpara viteve '70 dhe kanë krijuar ndotje të madhe në mjedis, veçanërisht në tokë dhe në ujërat nëntokësorë, për shkak të pikimeve dhe rrjedhjeve të vajrave gjatë procesit të mirëmbajtjes ose moshës së tyre të vjetër.

Lipset të përmirësohet niveli i përgatitjes për menaxhimin e mjediseve të ndotura. Duhet përgatitur metodika për vlerësimin e rrezikut për mjediset e ndotura, duke marrë në konsideratë karakteristikat e dheut, popullsinë dhe faunën e zonës, shpërndarjen e popullsisë në zona të tjera natyrore dhe rrezikun helmues dhe mjedisor të PCB-ve.

Përgatitja dhe përshtatja e strategjisë për trajtimin dhe eliminimin e pajisjeve dhe mbetjeve të ndotura me PCB, përgatitja dhe krijimi i mekanizmave kontrollues, bashkëveprimi i grupeve të inspektimit përgjegjës për trajtimin dhe eliminimin e pajisjeve në përdorim, përgatitja e strategjisë për ndikimin pozitiv në bizneset që kanë përgjegjësi dhe rol aktiv për këto zona, përgatitja e procedurave për punime teknologjike dhe teknike dhe masat rregulluese do të ofrojnë një mbështetje të mirë për procesin e rehabilitimit gradual të mjediseve të ndotura me PCB.

Masat rehabilituese të specifikuar për mjediset e ndotura me PCB (Reparti i riparimit dhe vendi ku janë të vendosur transformatorët) konsistojnë në largimin e të gjithë materialeve të ndotur, vendosjen e tyre në depozita metalike dhe transportimin e tyre në një vend grumbullimi të përkohshëm deri në eliminimin përfundimtar të tyre.

Reparti i riparimit të transformatorëve është në punë që prej 30 vjetësh dhe në të nuk janë kryer asnjëherë kontrole për praninë e PCB-ve. Në repart vijnë për riparim transformatorë nga të gjithë objektet e KESH/OST, të gjitha bazamentet prej betoni janë të ndotura me vajin e transformatorëve dhe transformatorët e përdorur ruhen jashtë ndërtesës, të vendosur direkt në tokë dhe të ekspozuar në shi. Duhet të përgatitet një studim fizibiliteti për një vend grumbullimi të përkohshëm të materialeve të ndotur me PCB dhe më pas të merren masa për zbatimin e këtij studimi.

Duhet të përgatiten gjithashtu strategji për dekontaminimin e zonave të ndotura nëpërmjet zbatimit të projekteve që sigurojnë përmirësimin e kushteve mjedisore dhe ndikojnë pozitivisht në shëndetin e njerëzve.

Mbledhja e të dhënave paraprake për mjediset shumë të ndotura është siguruar nga informacioni mjedisor i ardhur nga objektet e KESH-it në të gjithë vendin. Të dhënat e mbledhura duhet të rishikohen dhe të përmirësohen nëse është e nevojshme ose kurdo që të bëhet rehabilitimi/zgjerimi i objekteve.

	Aktivitetet	Periudha	Institucionet Përgjegjëse/ mbështetëse	Rezultati i pritsëm	Buxheti i vlerësuar , 000/Lekë	Burimet e fondeve
0	1	2	3	4	5	6
5.	Rehabilitimi gradual i vendeve të ndotura me PCB					
5.1	Studimi i plotë i vendeve të ndotura me PCB në të gjithë territorin e vendit	2007-2008	KESH/MM	Njohja me nivelet e ndotjes dhe shtrirjen e tyre	680	KESH, MM, SP
5.2	Largimi i pajisjeve me PCB	2009-2020	KESH/MM	Përmirësi mi gradual i situatës	32.000	KESH, MM, SP, Donatore t
5.3	Largimi i dherave të ndotura me PCB	2009-2018	KESH/MM	Tokë e pastër	19.600	KESH, MM, SP Donatore t
5.4	Trajtimi përfundimtar i tokës së ndotur me PCB	2012-2019	KESH/MM	Tokë e pastër në objekt	5.500	KESH, MM, SP, Donatore t
5.5	Asgjesimi gradual i pasijeve te ndotura me PCB	2009-2018	KESH/MM	Pajisje pa PCB	84.000	KESH, MM, SP, Donatore
	Shuma				141.780	

6. Eliminimi i vajit mineral të ndotur me PCB

Direktiva e Këshillit Europian për eliminimin e bifenileve të polikloruara dhe trifenileve të polikloruara (PCB-ve dhe PCT-ve) është ajo me numër 96/59/KE e datës 16 shtator 1996.

Shqipëria ka një magazinë për ruajtjen e vajit mineral të transformatorëve. Në përgjithësi, si praktikë, vaji lubrifikant i përdorur nuk hidhet, por shitet për qëllime të tjera, siç është përdorimi si lëndë djegëse dytësore ose rafinuese për përdorime lokale.

Ndryshe nga vajrat lubrifikantë, vajrat dielektrike që përmbajnë PCB ose nuk përmbajnë PCB, zbrazen dhe pastaj ruhen në depozita metalike dhe përgjithësisht mbahen në reparte ose magazina. Këto vajra ripërdoren si vaj shtesë për rimbushjen e transformatorëve të tjerë mbasi janë pastruar.

Sidoqoftë, meqenëse në Shqipëri aktualisht nuk ekzistojnë reparte për grumbullimin ose trajtimin e mbetjeve, është e nevojshme të merret në konsideratë ndërtimi i objekteve të tillë në të ardhmen të cilët:

- Do të ndalonin rrezikimin e mëtejshëm të shëndetit të njerëzve, kafshëve dhe mjedisit të shkaktuar nga rrjedhjet e vajit të ndotur me PCB, mungesën e administrimit dhe shpërdorimet.
- Do të siguronin administrimin e qëndrueshëm dhe të sigurt mjedisor të NOQ-ve në përputhje me Konventën e Stokholmit dhe lëvizjet ndërkombëtare.
- Do të ndihmonin në procesin e mëtejshëm të eliminimit dhe/ose trajtimit të lëndëve të rrezikshme duke përfshirë PCB-të dhe pajisjet e ndotura me PCB.

Si rrjedhim, Shqipëria duhet të ketë reparte dhe depozita ruajtjeje të përshtatshme për vajrat dielektrikë të ndotur me PCB të zbrazur përkohësisht nga transformatorët në riparim. Më tej, MMPAU ,duke e përqendruar vëmendjen veçanërisht në menaxhimin e transformatorëve të ndotur me PCB përpara se ato të dalin jashtë përdorimit, duhet të ofrojë udhëzues teknikë për një menaxhim të sigurt mjedisor si në sektorin publik dhe në atë privat.

Për më tepër, duhet të caktohen mjedise ruajtjeje të përkohshme ose të përhershme për të mbajtur PCB-të dhe transformatorët e dyshuar si të ndotur me PCB të cilët nuk janë përdorur për një kohë të gjatë. Këto mjedise duhet të jenë të sistemuara larg zonave të ndjeshme siç janë shkollat, spitalet, dyqanet, qendrat e banuara etj. dhe duhet të pajisen gjithashtu me fikës zjarri dhe me mjete të tjera të emergjencës.

Ministria e Mjedisit duhet t'i kushtojë vëmendje ndërtimit të reparteve të ruajtjes dhe/ose eliminimit për të mbajtur larg nga mjetet e tjera dhe zonat e ndjeshme vajrat dielektrikë me PCB.

Direktiva e Këshillit Europian mbi eliminimin e PCB-ve thekson se Shtetet Anëtare duhet të marrin masat e nevojshme për të siguruar që:

- Janë eliminuar PCB-të e përdorura;
- Janë pastruar nga ndotja ose eliminuar PCB-të dhe pajisjet që përmbajnë PCB.

Pajisjet dhe PCB-të që përfshihen në inventarë duhet të trajtohen ose të eliminohen deri në vitin 2010.

Shtetet Anëtare duhet të ndalojnë :

- ndarjen e PCB-ve nga lëndët e tjera për qëllim ripërdorimin e PCB-ve;
- mbushjen e transformatorëve me PCB.

Shtetet Anëtare duhet të marrin masat e nevojshme për të siguruar që:

- PCB-të, PCB-të e përdorura dhe pajisjet që përmbajnë PCB që janë pjesë e inventarit, të dërgohen në sipërmarrës të licensuar dhe në të njëjtën kohë të kujdesen që janë marrë të gjitha masat e nevojshme për të mënjanuar rrezikun e zjarrit;
- Të ndalohet djegia e PCB-ve ose PCB-të e përdorura në mjetet lundruese;
- Të gjithë sipërmarrësit e përfshirë në pastrimin nga ndotja ose/dhe eliminimin e PCB-ve, PCB-ve të përdorura dhe/ose të pajisjeve që përmbajnë PCB të jenë pajisur me leje;
- transformatorët që përmbajnë PCB më shumë se 0.05 % në peshës të pastrohen nga ndotja sipas kushteve të specifikuara në Direktivë

Duke iu referuar Direktivës 75/442/KE Komisioni:

- duhet të caktojë metodat referencë të matjeve për të përcaktuar përmbajtjen e PCB-ve në materialet e ndotur;
- mund të caktojë standarde teknike për metoda të tjera të eliminimit të PCB-ve;
- duhet të përgatisë një listë me emrat e prodhimit të kondensatorëve, rezistencave dhe bobinave të induksionit që përmbajnë PCB;
- të përcaktojë, nqs është e nevojshme lëndë të tjera më pak të rrezikshme, zëvendësuese të PCB-ve.

Shtetet Anëtare brenda tre vjetëve mbas miratimit të kësaj Direktive, duhet të hartojnë:

- plane për pastrimin nga ndotja dhe/ose eliminimin e pajisjeve të inventarizuara dhe PCB që përmbajnë ato;
- plane për grumbullimin dhe më pas eliminimin e mëtejshëm të pajisjeve që nuk janë subjekt i inventarit.

Për Shqipërinë, një nga variantet e përshtatshme për trajtimin e pajisjeve me vaj me PCB është eksportimi i mbetjeve me PCB në impiante jashtë vendit tonë. (sasia e pajisjeve me vaj me PCB është relativisht e ulët për të justifikuar investimet për instalime kaq specifike ose pajisje të lëvizshme).

	Aktivitetet	Periudha	Institucionet Përgjegjëse/mbështetëse	Rezultati i pritshëm	Buxheti i vlerësuar , 000/Lekë	Burimet e fondeve
0	1	2	3	4	5	6
6.	Eliminimi i vajit mineral të ndotur me PCB					
6.1	Studimi i plotë i gjithë sasisë së vajit mineral me PCB për të gjithë pajisjet	2007-2008	KESH/MM	Inventar i plotë i PCB-ve	680	KESH MM
6.2	Zbrazja e vajit mineral me PCB nga pajisjet	2009-2018	KESH/MM	Përmirësimi gradual i situatës	61.750	KESH MM Donatoret
6.3	Depozitimi i vajit mineral me PCB	2009-2018	KESH/MM	Jo më vaj të ndotur me PCB	10.000	KESH MM Donatoret
6.4	Trajtimi përfundimtar i vajit mineral të ndotur me PCB	2012-2020	KESH/MM	Vaj i pastër nga PCB	14.600	KESH MM Donatoret
	Shuma				87.030	

7. Hartimi dhe zbatimi i një plani kombëtar për monitorimin e PCB-ve.

Hë për hë, në Shqipëri nuk ekziston një sistem për monitorimin e PCB-ve. Burimet e mundshme të PCB-ve dhe ndikimi i tyre në popullatë duhet të konfirmohet gjatë zbatimit të Planit Kombëtar të Veprimit. Për shkak të mungesës së pajisjeve laboratorike dhe mungesës së stafit të trajnuar për këtë qëllim, kërkimet në fushën e PCB-ve në Shqipëri janë akoma në hapat e parë.

Megjithëse ka disa raste të shkëputura studimesh mbi praninë e PCB-ve në mjedis dhe shëndetin e njerëzve, duhet të ndërmerren analiza sistematike dhe të plota për të krijuar një pamje të përgjithshme kombëtare mbi mjedisin dhe shëndetin e njerëzve.

Programi i monitorimit të PCB-ve duhet të konsistojë në kontrollin e rregullt të PCB-ve në tokë, ujë dhe ajër, në të gjitha materialet që qarkullojnë nëpër objekte si dhe në dogana për rastet e eksportit dhe importit.

Në hartimin dhe zbatimin e programit kombëtar të monitorimit të PCB-ve do të ndihmojnë krijimi i një rrjeti bashkëpunimi, shkëmbimi i të dhënave dhe informacioneve ndërmjet institucioneve shkencore të përfshira në aktivitete kërkimore për PCB-të, hartimi i programit të monitorimit, identifikimi i përgjegjësive monitoruese dhe laboratorëve analitikë, zhvillimi i sistemit të informimit për procedimin e monitorimit dhe rezultateve, blerja e pajisjeve për marrjen dhe analizën e mostrave, procesi i trajnimit të personave përgjegjës për monitorimin dhe analizat dhe sistemi i kontrollit të cilësisë, .

	Aktivitetet	Periudha	Institucionet Përgjegjëse/mbështetëse	Rezultati i pritshëm	Buxheti i vlerësuar 000/Lekë	Burimet e fondeve
0	1	2	3	4	5	6
7.	Hartimi dhe zbatimi i programit kombëtar për monitorimin e PCB-ve					
7.1	Studimi i kuadrit ligjor	2007	MMPAU/KESH/MM	Njohja e legjislacionit	280	KESH MM
7.2	Hartimi i programit kombëtar për monitorimin e PCB-ve	2008-2009	MMPAU/KESH/MM	Programi i monitorimit	865	KESH MM Donatorët
7.3	Miratimi i programit kombëtar për monitorimin e PCB-ve	2010	BSh, KESH, MMPAU	Miratimi i programit të monitorimit	60	KESH MM
7.4	Zbatimi i programit kombëtar për monitorimin e PCB-ve	2011-2020	BSh /KESH/MMPAU	Zbatim i suksesshëm	13.300	KESH MM, SP
	Shuma				14.505	

3.3.4 Plani i Veprimit: Nën-produktet NOQ të Prodhuara Jo-Qëllimisht

Lidhur me prodhimin e paqëllimshëm të nënprodukteve NOQ Konventa e Stokholmit përcakton objektivat e mëposhtëm:

Vazhdimin e minimizimit dhe, ku është e mundshme, eliminimin përfundimtar, të shkarkimeve totale të NOQ-ve të prodhuara në mënyrë të paqëllimshme;

Aktivitete të mundshme administrimi

Mbështetur në analizat bazë të gjendjes, duke marrë në konsideratë detyrimet e Konventës së Stokholmit, politikat kombëtare si dhe traktate të tjera ndërkombëtare dhe, duke ndjekur objektivat dhe prioritetet kombëtare për menaxhimin e NOQ-ve, më poshtë paraqiten aktivitetet më të rëndësishme të menaxhimit:

1. Plotësimi i akteve ligjore dhe nënligjore që lidhen me kontrollin dhe parandalimin e ndotjeve industriale, si dhe me administrimin e mbeturinave;
2. Forcimi i kapaciteteve (njerëzore dhe teknike) për institucionet përgjegjëse për administrimin e mbeturinave (në veçanti administrimi i vend-depozitimeve dhe parandalimi i djegies në mjedis të hapur i mbetjeve të ngurta urbane);
3. Përgatitja e politikave dhe masave zbatuese për pakësimin e shkarkimeve të dioksinave nga administrimin e mbeturinave;
4. Futja e Teknikave Me të Mira (TMM) & Praktikave më të Mira Mjedisore (PMM) në sektorin industrial;
5. Përgatitja dhe implementimi në shkallë të gjerë, në të gjithë vendin, i programeve të administrimit mjedisor të mbeturinave mjekësore duke minimizuar kështu shkarkimet e paqëllimshme të NOQ-ve;

6. Rritja e ndërgjegjësimit për publikun e gjerë për praktikën e pastrës të administrimit të mbeturinave.
7. Përditësimi i rregullt i inventarit të shkarkimeve.

Shënim: Aktiviteti 1 i administrimit përfshihet në PV për Forcimin Institucional dhe Ligjor. Aktiviteti 6 përfshihet në PV për Ndërgjegjësimin e Publikut.

Strategjia e zbatimit

2. Forcimi i kapaciteteve (njerëzore dhe teknike) në institucionet përgjegjëse për administrimin e mbeturinave.

Burimi më i madh i shkarkimit të PCDD/PCDF në ajër janë zjarret në vend-depozitimet e mbetjeve të ngurta urbane dhe djegia, e qëllimshme ose jo, në mjedis të hapur e tyre. Për pakësimin e këtyre shkarkimeve nevojitet të ngrihet një sistem efikas menaxhimi. Ky sistem duhet të përfshijë, në veçanti, përmirësimin e vend-depozitimeve ekzistuese dhe një sistem të përshtatshëm grumbullimi dhe transporti.

Krahas infrastrukturës së nevojshme, shumë i kufizuar është edhe kapaciteti në institucione mjedisore qendrore dhe institucione të tjera përgjegjëse për të zbatuar kontroll të gjerë kombëtar dhe parandalim efektiv të ndotjes. Inspektorati nuk ka kapacitete të mjaftueshme në personel, trajnim dhe pajisje.

Menaxherët e njësive që janë ngarkuar të kryejnë administrimin e mbeturinave në pushtetin vendor, dukshëm nuk kanë trajnimin e duhur. Veç kësaj, shumica e supervisorëve të grumbullimit dhe depozitimit nuk kanë trajnimin e duhur për shëndetin publik dhe mjedisin ose menaxhimin e mbetjeve. Për rrjedhojë, ka nevojë për trajnim profesional për menaxhimin e mbetjeve, në veçanti në nivel vendor.

Për sa u theksua më sipër, fokusi kryesor i këtij plani veprimi është forcimi i kapaciteteve.

	Aktivitetet	Viti	Institucionet përgjegjëse/mbështetëse	Rezultati i pritshëm	Buxheti i vlerësuar 000/Lekë	Burimi i financimit
0	1	2	3	4	5	6
2	Forcimi i kapaciteteve (njerëzore dhe teknike) në Institucionet përgjegjëse për menaxhimin e mbetjeve.					
2.1	Vlerësimi i kapacitetit të bashkive për të mënjanuar shkarkimet e dioksinave nga menaxhimi i mbetjeve.	2007	PV	Vlerësimi i situatës	2.500	PV Donatorë
2.2.1	Fuqizimi me burime të tjera shtesë në strukturat eksistuese të bashkisë për menaxhimin e mbetjeve.	2008	PV	Rekrutime të reja në punë në Bashki	5.000	PV
2.2.2	Ngritjen e një strukture në bashkitë e vogla për menaxhimin e mbetjeve.	2009	PV	Të gjitha bashkitë kanë njësi të menaxhimit të mbetjeve /80 % e bashkive brenda vitit 2009	5.000	PV

2.3	Trajnimi dhe forcimi i kapaciteteve të përgjegjësve lokal për menaxhimin e mbetjeve.	2008-2009	MMPAU, MPPTT	Pakësim i çlirimit të dioksinës	7.500	PV Donatorë
2.3.1	Trajnimi i strukturës ekzistuese / dhe të atyre që do të krijohen të reja në bashki për administrimin e mbeturinave dhe specifikisht për djegien e hapur të mbeturinave urbane sipas PMM	2008-2009	MMPAU, MPPTT	70 % e bashkive për 2009 do të kenë strukturat trajnuese	6.500	PV Donatorë
2.3.2	Trajnim për ndarjen, riciklimin e mbetjeve që mblidhen në pikën e grumbullimit dhe vend-depozitimin pa djegie siç tregohet në PMM.	2008	MMPAU, MPPTT	Numër iniciativash për grumbullimin përzgjedhës të mbetjeve, etj.	4.000	PV Donatorë
2.3.3	Trajnim për zyrtarët vendorë për legjislacionin përkatës të BE-së lidhur me menaxhimin e mbetjeve	2007	MMPAU, MPPTT	90 % e bashkive do të trajnohen deri në 2009	3.000	MMPAU, PV, Donatorë
	Shuma				33.500	

3. Përgatitja e politikave dhe zbatimi i masave për pakësimin e shkarkimeve të dioksinave nga menaxhimi i mbetjeve

Një nga mangësitë organizative për pakësimin e shkarkimeve të PCDD/PCDF nga veprimtaria e menaxhimit të mbetjeve është mospasja e një politike të qartë dhe bashkërendimi midis autoriteteve të ndryshme dhe sektorit privat. Pas hartimit të një strategjie të përgjithshme për mbetjet pas viteve 1990, nuk është ndërmarrë pothuaj asnjë veprim i parashikuar.

Zbatimi i Strategjisë së administrimit të mbeturinave duhet të ndihmojë në drejtim të pakësimit të shkarkimeve të PCDD/PCDF. Në plotësim të kësaj strategjie të gjerë kombëtare, duhet të bëhen dhe zbatohen Plane Lokale Veprimi për menaxhimin e mbetjeve.

Dialogu politik dhe koordinimi, si dhe futja e instrumenteve ekonomik për të nxitur ndarjen e mbetjeve dhe riciklimin do të çojnë në ngritjen e bazës për veprim gjithëpërfshirës për minimizimin e çlirimit të PCDD/PCDF. Është e domosdoshme që aktivitetet të cilat tashmë kanë filluar zbatimin e ndarjes, ripërdorimit dhe riciklimit në Tiranë, të mbështeten me qëllim të futjes së skemave të tilla në qytete të tjera të mëdha.

Për më tepër, janë përcaktuar sisteme të menaxhimit efektiv për t'u zbatuar në vend-depozitimet e Sharrës dhe të Korçës. Në këto sisteme përfshihen:

Grumbullimi, transporti dhe depozitimi i përshtatshëm i mbetjeve të ngurta urbane nga autoritetet lokale për t'u dhënë mundësinë të ngrenë një sistem shërbimi të efektshëm e të besueshëm, paralelisht me përmirësimin e këtyre vend-depozitimeve me standardet e përshtatshme inxhinierike dhe praktikave të administrimit mjedisor.

	Aktivitetet	Koha	Institucioni përgjegjës mbështetës	Rezultati i pritshëm	Buxheti i vlerësuar 000/Lekë	Burimi i financimi t
0	1	2	3	4	5	6
3.1	Përgatitja e një plani veprimi për pakësimin e shkarkimeve të dioksinave dhe furaneve nga menaxhimi i mbetjeve mbështetur në PMM					
	Zbatimi i Planit Lokal të Veprimit për pakësimin e shkarkimeve të dioksinave dhe furaneve nga menaxhimi i mbetjeve	2008-2009	Bashkitë, MPPTT, MMPAU	Pakësimi i shkarkimeve të dioksinës	30.000.000	PV, Donatorë
	Zgjerimi i iniciativave që kanë filluar ndarjen, riciklimin dhe ripërdorimin e mbetjeve që shkojnë në pikën e grumbullimit dhe vend-depozitime pa i djegur.	2007-2009	Bashkitë, MPPTT, MMPAU	Ndarja, riciklimi dhe ripërdorimi në 3 qytete dhe vend-depozitime	50.000.000	PV, Donatorë
3.2	Koordinimi i strategjisë së menaxhimit të mbetjeve për të siguruar përfshirjen e problemeve të dioksinës.	2007	Bashkitë, MPPTT, MMPAU	Organizim takimesh	-----	MMPAU MPPTT, PV
	Vendosja e dialogut midis pushtetit vendor dhe atij qendror për menaxhimin e mbetjeve urbane dhe në veçanti djegien e pakontrolluar të mbetjeve	2007	MPPTT, MMPAU Bashkitë	Organizimi i tavolinave të diskutimit (seminare pune)	-----	MMPAU MPPTT, PV
	Zhvillimi i instrumenteve ekonomike me qëllim rritjen e riciklimin të plastikave, metalit, letrës dhe pakësimin e mbetjeve që janë burim i çlirimit të dioksinave.	2007-2008	MPPTT, MMPAU Bashkitë	Futja e instrumenteve të reja ekonomike	2.500	– MPPTT, MF, MMPAU
3.3	Hartimi i projektit për përmirësimin e vend-depozitimit të pakontrolluar të Sharrës duke çuar në minimizimin e zjarreve të qëllimta ose të paqëllimta.	2008-2010	MPPTT, MMPAU, Bashkia e Tiranës Qeveria Italiane	Ulje në 80% e zjarreve	50.000	Bashkia Tiranës, Qeveria Italiane
	Zbatimi i projektit për përmirësimin e vend-depozitimit të Sharrës duke çuar kështu në minimizimin e dioksinave që shoqërojnë ujërat shpëlarës të vend-depozitimit.	2008-2010	MPPTT, MMPAU, Bashkia e Tiranës Qeveria Italiane	Pakësim 75% e ujërave kullues	450.000	Bashkia Tiranës, Qeveria Italiane
3.4	Zbatimi i projektit për përmirësimin e menaxhimit të mbetjeve urbane në Prefekturën e Korçës	2007-2010	MMPAU, SIDA, PV	Pakësim në 85% të zjarreve	30.000	Bashkia Korçë, Qeveria Suedeze
	Zbatimi i projektit për përmirësimin e vend-depozitimit të Korçës duke çuar në minimizimin e dioksinave	2007-2010	MMPAU SIDA, PV	Zvogëlim me 85% i ujërave kullues	100.000	Bashkia Korçës, Donatorë

	shkarkohen ne ajer dhe shoqërojnë ujërat shpëlarës të vend-depozitimit.					
3.5	Projektimi dhe ndërtimi i një vend-depozitimi sanitar për mbeturinat urbane, Bushat, Shkodër	2007-2010	MMPAU, MPPTT, PV	Eliminimi i shkarkimeve të dioksinave dhe furaneve	500.000	PV, Qeveria Italiane
3.6	Projektimi dhe ndërtimi i një vend-depozitimi sanitar për mbeturinat urbane, Himarë, Sarandë	2007-2010	MMPAU, MPPTT, PV	Eliminimi i shkarkimeve të dioksinave dhe furaneve	200.000	PV, Banka Botërore
	Shuma				1.412.500	

4. Vënia në jetë e Teknikave më të Mira të Mundshme (TMM) dhe Praktikave më të Mira Mjedisore (PMM) në sektorin industrial, sipas Konventës së Stokholmit

Ndonëse industria kontribuon vetëm pak në totalin e shkarkimeve të PCDD/PCDF në Shqipëri, futja në përdorim e Teknikave më të Mira të Mundshme dhe e Praktikave më të Mira Mjedisore (TMM dhe PMM) është e rëndësishme për dy arsye.

Së pari, Konventa e Stokholmit synon minimizimin e shkarkimeve dhe përdorimin e TMM-ve dhe PMM-ve për ta orientuar industrinë në drejtim të realizimit të këtyre qëllimeve. Së dyti, dhe më e rëndësishme për partnerët industrial, është fakti që TMM dhe PMM janë një hap përpara në përpjekjet e përgjithshme për prodhime të pastra. Përfitimet nga zbatimi i masave për prodhime të pastra shkon përtej problemeve të NOQ-ve, mbasi përfshin një gamë të gjerë lëndësh të dëmshme dhe të rrezikshme që shkarkohen në mjedis.

Për më tepër, për partnerët industrial futja e teknologjive për prodhime të pastra do të çojë në përdorimin sa më të paktë të kontributeve të prodhimit, si për lëndët e para ashtu dhe për energjinë. Përvoja ka treguar që masat e prodhimit të pastër ndihmojnë në drejtim të një cilësie më të lartë prodhimi duke i bërë shoqëritë më konkurruese në treg.

Futja e TMM dhe PMM në sektorin industrial pritet të udhëhiqet nga sektori privat për shkak të financimeve dhe kërkesave ligjore. Autoritetet do të kenë një rol bashkërendues për punën e industrisë si dhe të ofrojnë informacion dhe trajnime për mënyrat e futjes së TMM dhe PMM në aktivitetet industriale. Futja e TMM dhe PMM për NOQ-të në përgjithësi në të gjitha procedurat e licencimit në industrinë dhe në Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis do të përbëjë momentin e zbatimit praktik të planit të veprimit.

	Aktivitetet	Koha	Institucionet përgjegjës/ mbështetëse	Rezultati i pritshëm	Buxheti i vlerësuar 000/Lekë	Burimet e Financimit
0	1	2	3	4	5	6
	Përhapje e informacionit lidhur me TMM dhe PMM në sektorin industrial, sipas Konventës së Stokholmit					
4.1	Përhapje e informacionit lidhur me TMM dhe PMM sipas udhëzimeve të Konventës së Stokholmit dhe BE, BREFs	2007-2008	METE& MMPAU/ EU	Deri në 2009; 70 % e bashkive ta kenë këtë material	3.000	MMPAU, METE, Donatorë
4.2	Bashkërendimi i nismave sektoriale për futjen e TMM / Prodhimit të Pastër për të pakësuar maksimalisht çlirimet e dioksinave	2008-2010	METE& MMPAU SP	TMM dhe PPM do të futen në sektorët kryesorë	5.000	SP, Donatorë
4.2.1.	Prodhimi i Pastër në industrinë e ferro-kromit	2008-2012	METE& MMPAU,SP	TMM dhe PPM do të futen në sektorin e ferro-kromit	30.000	SP
4.2.2.	Prodhimi i pastër në Industrinë e çelikut	2008-2010	METE& MMPAU, SP	TMM dhe PPM do të futen në sektorin e çelikut	20.000	SP
4.2.3.	Prodhimi i Pastër specifikisht i orientuar në kontrollin e temperaturës dhe si rezultat edhe të çlirimit të dioksinave në industrinë e çimentos	2008-2010	METE& MMPAU, SP	TMM dhe PPM duke përfshirë kontrollin e temperaturës do të futen në sektorin e çimentos	5.000	SP
4.3	Krijimi i njohurive dhe kapaciteteve për vetë-monitorimin e çlirimit të NOQ	2008-2012	METE& MMPAU, SP	Furnizimi me pajisje dhe trajnimi për vetë-monitorimin e çlirimeve të NOQ	10.000	SP, Donatorë
4.3.1.	Trajnim për marrjen e mostrave për kryerjen e analizave për shkarkimet industriale	2009	METE& MMPAU, SP	Trajnim për marrjen e mostrave e kryerjen e analizave të dioksinës nga subjekte private dhe institucione kërkimore	5.000	SP
4.3.2.	Kryerja e vetëmonitorimit të çlirimit të dioksinave	2010-2012	SP, MMPAU	Trajnim për kryerjen e vetëmonitorimit të çlirimeve të		SP MMPAU

				dioksinave nga subjekte private dhe institucione kërkimore	10.000	
	Shuma				88.000	

5. Përgatitja dhe zbatimi në të gjithë vendin i një plani administrimi të mbeturinave spitalore duke minimizuar shkarkimet e NOQ të paqëllimshme.

Kontributi i djegies së mbeturinave spitalore përbën 25% të shkarkimeve të PCDD dhe PCDF në Shqipëri. Duhet theksuar që këtu pasqyrohen vetëm të dhënat nga i vetmi incenerator i djegies së mbetjeve spitalore në funksionim në Tiranë. Mbetjet e tjera spitalore në spitale dhe klinika të tjera të vendit digjen pjesërisht qoftë në vend-depozitime të pakontrolluara ose djegie në mjedis të hapur nga spitalet. Kjo çon në shkarkime të mëdha të NOQ të paqëllimshme si dhe në rreziqe të tjera që lidhen me manipulimin dhe depozitimin e mbetjeve infektuese.

Me qëllim përmirësimin e gjendjes dhe pakësimin e shkarkimeve të PCDD/PCDF, duhet zbatuar një sistem menaxhimi i mbetjeve spitalore, i shtrirë në të gjithë vendin. Kjo ndërhyrje do të kërkojë një kuadër të fortë ligjor për të siguruar që të gjitha spitalet dhe klinikat të organizojnë menaxhimin e mbetjeve të tyre në mënyrë të sigurt mjedisore. Hapa të mëtejshëm në sistemin e menaxhimit të mbetjeve spitalore janë ndarja dhe minimizimi i sasisë së mbetjeve dhe manipulimi i tyre duke filluar nga grumbullimi, transporti dhe depozitimi final. Alternativa të tjera të mundshme janë sterilizimi, trajtimi me mikrovalë, hidroliza alkaline ose trajtimi biologjik, secila e ndjekur nga metoda e vend-depozitimit sanitar.

Plani i Veprimit i Mbetjeve spitalore është i kompletuar me masat plotësuese për optimizimin e punës edhe në aspektet e mbrojtjes së mjedisit dhe shëndetit për të vetmin incenerator që ekziston për djegiet e mbetjeve spitalore në Qendrën Universitare “Nënë Tereza” në Tiranë.

	Aktivitetet	Koha	Institucioni përgjegjës/mbështetës	Rezultati i pritshëm	Buxheti i vlerësuar 000/Lekë	Burimet e financimit
0	1	2	3	4	5	6
5.1	Hartimi i një Strategjie Kombëtare për administrimin e mbeturinave spitalore duke përfshirë veprime të kuadrit rregullator, mbledhja, transporti, trajtimi dhe depozitimi përfundimtar i mbeturinave.					
5.1.1	Planifikimi dhe zgjedhja e teknologjisë së depozitimit përfundimtar dhe përzgjedhja e vendeve.	2008	MSH & MMPAU	Përcaktimi i rolit të teknologjive të depozitimit në fund të 2008	4.000	Donatorët
5.2	Futja në përdorim e administrimit të pastër të mbeturinave, duke përfshirë minimizimin e mbeturinave veçanërisht të dioksinave dhe ndarjen e mbeturinave në të gjitha spitalet dhe klinikat në përputhje me TMM & PMM	2007-2009	MSH&MMPAU	Informimi i subjekteve të interesuara mbi TMM dhe PMM	500	MSH, MMPAU
5.2.1.	Nxjerrja e udhëzimeve dhe kryerja e trajnimeve në të gjitha spitalet dhe klinikat për minimizimin e mbetjeve dhe ndarjen si dhe mundësitë e depozitimit përfundimtar.	2007-2008	MMPAU dhe MSH	Manuale të përgatitura në fund të vitit 2007 dhe kryerja e trajnimeve në spitale dhe klinika për minimizimin dhe selektimin si dhe opsionet e depozitimit përfundimtar.	5.000	MMPAU, MSH, Donatorët
5.2.2.	Zbatimi i skemave të ndarjes dhe minimizimit të mbetjeve në të gjithë spitalet dhe klinikat	2008-09	MMPAU dhe MSH	Në fund të 2008 skemat e minimizimit dhe të ndarjes të jenë futur në 50 % të të gjithë spitaleve	20.000	MSH Donatorët

				dhe klinikave		
5.3.	Futja e skemës së minimizimit dhe ndarjes në QSU “NënëTereza” dhe optimizimi i përdorimit të inceneratorit ekzistues në QSU “Nënë Tereza”.	2008	MMPAU dhe MSH	Pakësimi 50% i shkarkimeve të dioksinave dhe furaneve	4.000	MSH, Donator ë
5.3.1.	Përmirësimi i praktikave të funksionimit të inceneratorit në QSU “Nënë Tereza”, me qëllim minimizimin e shkarkimit të dioksinave.	2007	MMPAU dhe MSH	Përgatitja e udhëzuesit 2007	130.000	MSH, Donator ë
5.3.2.	Trajnimi i operatorëve të inceneratorit te QS “NënëTereza” me udhëzues të përshtatshëm.	2007	MMPAU dhe MSH	Deri në fund të 2007 të gjithë teknikët do të trajnohen për të përmirësuar mënyrën e përdorimit.	500	MSH Donator ë
5.4	Projektimi dhe ndërtimi i njësive për depozitim përfundimtar	2009-2011	MMPAU dhe MSH	Deri në fund të 2011 të ndërtohet një njësi për depozitimin përfundimtar	100.000	MSH Donator ë
5.4.1.	Instalimi në shkallë kombëtare i sistemit të mbledhjes dhe transportit për mbetjet spitalore të pasistemuara në klinika dhe spitale.	2010	MMPAU dhe MSH	Vendosja në funksionim në nivel kombëtar e sistemit të transportit dhe mbledhjes	10.000	MSH
5.5.1	Rikonstruksioni i inceneratorit të QSU “Nënë Tereza”	2012	M.SH	Shkarkimi 90% i shkarkimeve të dioksinave dhe furaneve	13.000	MSH, Donator ë
	Shuma				287.000	

6. Përditësimi sistematik i inventarit të emisioneve

Gjatë inventarit të parë u identifikuan vetëm kategoritë kryesore të burimeve të shkarkimeve në Shqipëri. Është shumë e rëndësishme të monitorohet çdo ndryshim të kategoritë e burimeve ekzistuese me qëllim që të gjykojmë mbi efektivitetin e masave të marra. Kjo mund të arrihet nëpërmjet Rregullave që lejojnë administrimin e shkarkimeve mjedisore. Inventari duhet të përditësohet çdo 5 vjet.

	Aktivitetet	Koha	Institucionet përgjegjëse / mbështetëse	Rezultati i pritshëm	Buxheti i vlerësuar 000/Lekë	Burimet e financimit
0	1	2	3	4	5	6
Përditësimi sistematik i inventarit të emisioneve çdo pesë vjet.						
6.1	Hartimi i një skemë raportimi, sipas legjislacionit, për kapacitetin e prodhimit/matjen e shkarkimeve të dioksinave nga burimi të cilat kanë lidhje me këto shkarkime dhe integrimin e kësaj skeme në Raportin Kombëtar Mjedisor.	2007	MMPAU-MPPTT, METE	Të jetë në përputhje me Konventën e Stokholmit	600	MSH
6.2	Dërgimi i inventarit të përditësuar të shkarkimeve në Konferencën e Vendeve Palë të Konventës së Stokholmit.	2011	MMPAU	Të jetë në përputhje me Konventën e Stokholmit	300	MSH
	Shuma				900	

3.3.5 Plani i Veprimit: Mbeturinat NOQ dhe Vendet e Ndotura

Në lidhje me vend-depozitimet dhe zonat e ndotura me NOQ, Konventa e Stokholmit vendos për palët nënshkruese objektivat e mëposhtëm:

Përpjekje për identifikimin e stokeve, vend-depozitimeve dhe zonave të ndotura me NOQ.

Administrimi i stokeve dhe vend-depozitimeve që përbëhen ose përmbajnë NOQ të klasifikuara në Aneksat A dhe B të Konventës dhe administrimi i mbeturinave, duke përfshirë edhe produkte ose artikujt që kthehen në mbeturina, që përbëhen, përmbajnë ose janë të ndotura me NOQ të klasifikuara në Aneksat A, B dhe C të Konventës, të bëhet në mënyrë të tillë, që të mbrohet shëndeti i njerëzve dhe mjedisi.

Aktivitetet e administrimit

Mbështetur në analizën e gjendjes, në detyrimet që burojnë nga Konventa e Stokholmit, në marrëveshjet përkatëse ndërkombëtare dhe politikat kombëtare, në përparësitë kombëtare dhe objektivat lidhur me administrimin e NOQ-ve dhe duke marrë parasysh problemet përparësore dhe objektivat, u identifikuan veprimet administruese që vijnë:

- Forcimi e kapaciteteve për administrimin e NOQ-ve në:
 - institucionet përgjegjëse qendrore dhe vendore (doganat, qendrat kërkimore, inspektorati i mjedisit dhe agjencitë rajonale të mjedisit),
 - institucionet përgjegjëse për analizat e monitorimit dhe
 - institucionet përgjegjëse për administrimin e mbeturinave duke respektuar kërkesat mjedisore;
- Studimi i terrenit, përcaktimi i prioritetëve, hartimi i projekteve rehabilituese për zonat potencialisht të ndotura me NOQ;

Në këtë kapitull përshkruhen veprimet që duhen ndërmarrë për të përmbushur detyrimet që burojnë nga Konventa e Stokholmit lidhur me zonat e ndotura. Mbështetur në analizën e gjendjes së vendit, në detyrimet që burojnë nga Konventa e Stokholmit, marrëveshjet përkatëse ndërkombëtare dhe politikat kombëtare dhe duke pasur parasysh prioritetet kombëtare dhe objektivat lidhur me NOQ-të, u identifikuan veprimet administruese për:

forcimin institucional dhe rregullator

ngritjen e kapaciteteve për administruese e zonave të ndotura me NOQ

kërkimin dhe zhvillimin

aktivitetet për rritjen e sensibilizimit

Aktivitetet që lidhen me veprimin e parë përshkruhen në kapitullin për planin e veprimit: Masat për forcimin institucional dhe rregullator.

Veprimet që propozohen për arritjen e objektivave janë subjekt i planeve të veçanta të veprimit dhe do të përshkruhen këtu më poshtë. Një shënim sqarues përshkruan përse është zgjedhur aktiviteti në fjalë, mundësia që ofron aktiviteti për të përmbushur kërkesat e Konventës së Stokholmit, strategjia për zbatimin e tij dhe kostoja e zbatimit.

Në kapitullin *vlërësimi i nevojave për burime* përshkruhen nevojat për njerëz, investime kapitale dhe kostoja operative për aktivitetet e parashikuara, duke pasur parasysh edhe afatet kohore. Strategjia do të përmbajë informacion mbi aktivitetet që lidhen me veprimet e mësipërme administruese.

Strategjia e zbatimit

Strategjia do të përmbajë informacion mbi aktivitetet që lidhen me veprimet e mësipërme administruese.

1. Forcimi i kapaciteteve për administrimin e NOQ-ve në institucionet dhe subjektet e interesuara

Shkalla relativisht e ulët e informacionit për ndotjen e mjedisit nga NOQ-të në përgjithësi dhe për zonat e ndotura nga NOQ-të në veçanti, kanë krijuar një boshllëk lidhur me problemin në fjalë në institucionet qendrore, vendore, kërkimore dhe monitoruese. Në mungesën e informacionit për shkallën e ndotjes dhe nivelin e shtrirjes së zonave të ndotura nga këto kimikate kanë ndikuar në mënyrë të ndjeshme mungesat në legjislacion për këtë kategori ndotësish dhe kostot e larta që bartin në vetvete analizat kimike të ndotësve NOQ, në veçanti të dioksinave dhe furaneve.

Në planin e veprimit lidhur me forcimin e kapaciteteve është parashikuar një paketë trajnimesh që do të përgatisë specialistët e institucioneve përkatëse me njohuritë e nevojshme, duke filluar që nga parandalimi i prodhimit dhe importimit të përbërjeve/artikujve me përmbajtje NOQ deri në mënyrat e marrjes së kampioneve, analizave përkatëse, studimit, vlerësimit dhe administrimit të zonave të ndotura.

	Veprimtaria	Afati	Institucioni(et) Përgjegjës	Rezultati i pritshtëm	Buxheti i vlerësuar 000/Lekë	Burimi i fondeve
0	1	2	3	4	5	6
1.	Forcimi i kapaciteteve për administrimin e NOQ-ve në institucionet dhe subjektet e interesuara					
1.1	Vlerësimi i mangësive në kapacitetet institucionale dhe teknike të PV, SD, ISHM dhe ARM-ve	2007	MMPAU, METE, MPPTT, PV	Evidentimi i nevojave për udhëzime, trajnime dhe mjete	1.250	MMPAU Min. e linjes
1.2	Trajnimi i IM, ISHP, IMB, IT, LQU, për monitorimin	2007–2008	MMPAU, METE, MPPTT, MSH	Ekspertë të kualifikuar për identifikimin dhe monitorimin e NOQ-ve	5.300	Minist. E linjes, Donatorë
1.3	Trajnimi i ISHM, ARM, PV, SP për administrimin	2008-2009	MMPAU, METE, MPPTT	Menaxhimi praktik i mbetjeve në përputhje me legjislacionin	3.300	Minist. E linjes, Donatorë
1.4	Trajnime në vlerësimin e tokës dhe terrenit e ndotur	2008	MMPAU, METE, MPPTT, MSH	Njohje me teknikat për vlerësimin e tokës dhe terrenit	8.800	Minist. E linjes, Donatorë, SP
1.5	Sigurimi i pajisjeve për marrje kampionesh dhe analiza për testimin e NOQ-ve në mjedis	2009-2010	MMPAU, METE, KESH, MSH	Laborator i pajisur mirë për monitorimin e cilësisë së ujit, ajrit dhe tokës	20.430	Minist. E linjes, Donatorë, SP.
1.6	Trajnimi i strukturave të ARM-ve për zbatimin e legjislacionit lidhur me parandalimin e ndotjes	2009-2010	MMPAU,	Ekspertë të kualifikuar për zbatimin e legjislacionit	4.400	MMPAU, Donatorët
1.7	Forcimi i kapaciteteve institucionale dhe teknike të bashkive dhe komunave për menaxhimin e mbetjeve duke respektuar kërkesat mjedisore	2009-2012	MMPAU, PV	Krijimi pranë bashkive dhe komunave i sektorit të kualifikuar për menaxhimin e mbetjeve	4.400	MMPAU MPPTT SP
	Shuma				47.880	

2. Studimi i terrenit, përcaktimi i prioriteteve, hartimi i projekteve rehabilitues për zonat potencialisht të ndotura me NOQ

Në Shqipëri, zonat potencialisht të ndotura me NOQ janë përgjithësisht uzinat dhe fabrikat e braktisura ose stoqet e mëdha të mbetjeve industriale dhe dambat.

Disa nga këto objekte apo territore janë privatizuar dhe pronarët e rinj e kanë ndryshuar destinacionin e tyre pa bërë kurrfarë rehabilitimi të terrenit dhe objektit, duke bërë që ndërhyrja në këto objekte apo terrene sot të jetë shumë e vështirë, për të mos thënë e pamundur. Ndërkaq shumica e këtyre objekteve dhe terreneve mbeten edhe sot në pritje për t'u rehabilituar.

Janë të paktën tri zona që duket se kanë nevojë urgjente të rehabilitohen për shkak të ndotjes nga NOQ-të. Këto janë:

1. Në Durrës: terreni në ish-uzinën kimike në Porto-Romano. Një sipërfaqe prej rreth 2 ha është e ndotur me disa lloje kimikatesh midis të cilave edhe NOQ-të. Ndër të tjera atje është prodhuar heksakloran dhe lindan dhe janë bërë shumë formulime pesticidesh. Zona është klasifikuar si pikë e nxehtë.
2. Në Vlorë: terreni në ish-uzinën e sodës kaustike dhe PVC-së. Janë rreth 20 ha të ndotura me merkur dhe produkte të kloruara, mes të cilave eventualisht edhe NOQ-të.
3. Në Elbasan: terreni pranë dhe përreth uzinës kokso-kimike në ish-kombinatit metalurgjik, i cili është mjaft i ndotur me katran, bitume dhe kimikate të tjera të rrezikshme.
4. Në Lushnjë: Në territorin e ish uzinës së plastmasit ndodhen disa qindra ton kimikate të paidentifikuara dhe të përziera me njëra tjetrën dhe materiale inerte. Nuk përjashtohet mundësia që ndërmjet tyre të ketë edhe kimikate të grupit të NOQ-ve. Asnjë studim deri më sot nuk është ndërmarrë për të njohur natyrën e këtyre kimikateve dhe potencialin e rrezikut.
5. Në Bajzë: Rreth 200 ton pesticide të skaduara janë të depozituara që nga viti 1991, ndërmjet të cilëve edhe lindani

Për rehabilitimi e zonave 1 dhe 2 është punuar dhe po punohet me financime nga Qeveria dhe mbështetjen e donatorëve të huaj. Zonat e tjera duhet të jenë objekt studimi për të njohur potencialet ndotëse të këtyre zonave, shtrirjen e tyre dhe masat përkatëse për dekontaminim.

Rehabilitimi i zonave të ndotura

Procesi i rehabilitimit të një zone (rajon-teren-objekt) të ndotur përbëhet nga disa etapa, që janë:

- 1) studimi i zonës;
- 2) marrja e mostrave dhe analiza e tyre;
- 3) përpunimi i të dhënave të analizës dhe përcaktimi i teknologjisë së rehabilitimit;
- 4) përllogaritjet e kostos dhe i afateve dhe
- 5) hartimi i projekteve rehabilituese

	Përshkrimi i aktivitetit	afati	Institucioni përgjegjës / mbështetës	Rezultati i pritsëm	Buxheti i vlerësuar 000/Lekë	Burimi i fondeve
0	1	2	3	4	5	6
2.	Studimi i terrenit, përcaktimi i prioriteteve, hartimi projekteve rehabilitues për zonat potencialisht të ndotura me NOQ					
2.1	Studimi i përqendrimit të NOQ-ve në zonat që mund të jetë të ndotura	2008	MMPAU, PV, MSH, MBUMK	Njohja me nivelin e ndotjes dhe identifikimi i çështjeve që duhen zgjidhur	30.000	Ministr. Përkates ePV, SP, Donatorët
2.2	Mbështetur në përfundimet e mësipërme bëhet vlerësimi i detajuar i zonave, për zonat më të ndotura (prioritare)	2008 - 2009	MMPAU, MBUMK, MSH	Ngritja e PIU-ut dhe kryerja e analizave të nevojshme për përcaktimin e konturit të zonës së ndotur dhe thellësinë e penetrimit të ndotjes	32.900	Ministr. Përkates ePV, SP, Donatorët
2.3	Njohja me metodat e ndryshme që përdoren për rehabilitimin e zonave të ndotura	2008- 2009	MMPAU, MBUMK, MSH	Njohja e pjesëmarrësve e me metodat dhe praktikatat e rehabilitimit	4.400	Ministr. Përkates eSP, Donatorët
2.4	Hartimi projekteve të rehabilitimit për zonat më të ndotura (prioritare)	2010	MMPAU, MBUMK, MSH	Përpunimi i të dhënave, vlerësimi i përafërt i kostos dhe i afateve për projektet e rehabilitimit	22.000	Ministr. Përkates ePV, SP, Donatorët
SHUMA :					89.300	

3.3.6 Plani i Veprimit: Ndërgjegjësimi i Publikut, Përhapja e Informacionit dhe Trajnimi

Në lidhje me shpërndarjen e informacionit dhe rritjen e ndërgjegjësimit Konventa e Stokholmit shtron këto objektiva:

Publiku të lejohet të marrë informacion përkatës për NOQ-të, të rritet ndërgjegjësimi i përgjithshëm lidhur me NOQ-të.

Aktivitetet administrimi

Mbështetur në analizën e situatës në Shqipëri, detyrimet që rrjedhin nga qenia Palë në Konventën e Stokholmit dhe politikat kombëtare për menaxhimin e NOQ-ve, në vijim të prioriteteve dhe objektivave kombëtare, janë identifikuar këto variante për rritjen e ndërgjegjësimit, shpërndarjen e informacionit dhe trajnimet:

1. Rritja e informimit dhe ndërgjegjësimit në komunitetet ku ka NOQ të pranishme, duke i sensibilizuar mbi efektet e tyre në shëndetin e njeriut dhe në mjedis;
2. Rritja e kapaciteteve të OJF-ve mjedisore, për ndërgjegjësimin e publikut dhe shpërndarjen e informacionit mjedisor ;
3. Angazhimi i OJF-ve në shpërndarjen e informacionit, sensibilizimin dhe fushatat ndërgjegjëse

Faktori potencial në reduktimin e prodhimit dhe të përdorimit të NOQ-ve, është sensibilizimi dhe ndërgjegjësimi i publikut. Publiku ka nevojë të informohet rreth burimeve të NOQ-ve dhe mënyrës së ndikimit të këtyre kimikateve në shëndetin e njeriut dhe në mjedis. Shkarkimet e NOQ-ve nuk mund të ulen pa njohuritë e kërkuara të vendim-marrësve, veprimet e përbashkëta të cilëve janë të domosdoshme për të sjellë ndryshimet e duhura në sjelljet e njerëzve. Njohuritë për shkarkimet e NOQ-ve do të çojnë në nevojën e një vlerësimi më të mirë të nevojës për veprim. Rritja e informimit/ndërgjegjësimit lidhur me NOQ-të është një proces i vazhdueshëm. Vetëm në këtë mënyrë është e mundur të mbahet në efikasitet kontrolli i rrezikut ndaj shëndetit të publikut dhe mjedisit i NOQ-ve.

Inventarizimi i shpërndarjes së NOQ-ve në Shqipëri tregoi se këto kimikate janë të pranishme në një sasi të rrezikshme vetëm në disa zona të veçanta të vendit. Do të ishte mjaft i efektshëm një program fushatash publike për informimin dhe ndërgjegjësimin e publikut të veçantë të këtyre zonave.

Aktivitetet ndërgjegjëse dhe informuese në komunitetin lokal të prekur nga NOQ-të janë planifikuar me një kohëzgjatje mesatare (10 vjeçare) për arsye se problemi i rrezikut në këto zona do të vijë duke u zvogëluar në sajë të angazhimeve për t'i pastruar dhe sepse një periudhë e tillë kohe informimi dhe ndërgjegjësimi është e mjaftueshme për të marrë masa në ruajtjen dhe pastrimin e territoreve të ndotur për mbrojtjen e shëndetit të banorëve dhe mjedisit.

	Aktivitetet	Afati kohor	Organizata përgjegjëse	Rezultatet e pritshme	Buxheti i vlerësuar 000/Lekë	Burimet e fondeve
0	1	2	3	4	5	6
1.	Rritja e informacionit dhe ndërgjegjësimi në komunitetet lokale ku NOQ të pranishme, lidhur me efektin e tyre në shëndetin publik dhe mjedisor					
1.1	Zhvillimi i takimeve në terren dhe fushatë sensibilizimi me përfshirjen e komunitetet pranë zonave të ndotura me NOQ.	2007-2012	OJF-të , Institucionet Kërkimore, MMPAU,PV	Rritja e ndërgjegjësimi t të komunitetit	5.000	MMPAU Minis. përktesë Donatorë OJF-të
1.2	Fushatë ndërgjegjëse për ndotjen e ajrit nga NOQ me prejardhje nga djegiet e mbeturinave urbane.	2007-2015	OJF-të Instituti i Mjedisit, PV	Ndërgjegjësim i qytetarëve	3.000	MMPAU Minis. përktesë Donatorë OJF-të
1.3	Fushatë ndërgjegjëse në zonat industriale mbi ndotjen e tokës, ujit dhe ajrit me PCB-t.	2007-2020	OJF-të	Ndërgjegjësim i vendim-marrësve, biznesmenëve komunitetit dhe publikut të gjerë	3.000	MMPAU Minis. përktesë Donatorë OJF-të
1.4	Fushatë në zonat industriale për NOQ-të e paqëllimshme	2007-2020	OJF-të	Rritja e ndërgjegjësimi t të banorëve pranë këtyre zonave	3.000	MMPAU Minis. përktesë Donatorë OJF-të
	Shuma				14.000	

2. Rritja e kapaciteteve të OJF-ve mjedisore, për ndërgjegjësimin e publikut dhe shpërndarjen e informacionit mjedisor

Në Shqipëri ka rreth 80 organizata mjedisore. Duke përjashtuar ndonjë OJF të specializuar në ndotjen kimike, të gjitha të tjerët kanë një mungesë informacioni dhe formimi për çështjet e NOQ-ve. Për këtë arsye trajnimet e tyre është pjesë e qenësishme e Planit Kombëtar mbi NOQ-et.

Roli i medias është shumë i rëndësishëm për informimin e publikut dhe ndërgjegjësimi në përgjithësi për problemet mjedisore dhe po kështu për ato probleme që lidhen me NOQ-të. Mjetet elektronike të komunikimit janë shumë të pranishme në shtëpitë e shqiptarëve, ndërsa gazetatat nuk arrijnë të shpërndahen në të gjithë territorin e vendit. Sipas disa testeve, shqiptarët shohin mesatarisht 5 orë në ditë televizion. Programet televizive me ndikimin më të fuqishëm në informim dhe edukim, janë filmat dokumentarë. Trajnimi i gazetarëve në çështjet mjedisore dhe veçanërisht për NOQ-të, është shumë i rëndësishëm për realizimin e objektivave të Planit Kombëtar mbi NOQ-të.

Trajnimi në fushën e komunikimit mund të realizohet përmes kurseve me kohë të shkurtër. Materialet mund të shoqërohen nga një manual për komunikimin kombëtar të shkëmbimit të informacionit në çështjet e lidhura me NOQ

Grafiku kohor i aktiviteteve:

	Aktivitetet	Afati kohor	Organizata përgjegjëse	Rezultati i pritshëm	Buxheti i vlerësuar 000/Lekë	Burimet e fondeve
0	1	2	3	4	5	6
2.	Rritja e kapaciteteve të OJF-ve mjedisore, për ndërgjegjësimin e publikut dhe shpërndarjen e informacionit mjedisor ;					
2.1	Aktivitete trajnuese me OJF-të mjedisore për njohjen dhe ndikimin negative të NOQ-ve te njerëzit dhe në mjedis.	2007-2025	OJF-të MMPAU	Rritja e ndërgjegjëimit të shoqatave	2.000	MMPAU Minis. përkthëse Donatorë OJF-të
2.2	Trajnimi i gazetarëve dhe këmbim përvoja me kolegë/shoqata nga vendet fqinje.	2007-2025	OJF-të	Gazetarë më profesionistë në fushën e NOQ-ve dhe mbrojtjes së shëndetit	2.000	MMPAU Minis. përkthëse Donatorë OJF-të
2.3	Hapja e hapësirës në internet për NOQ-të dhe mbajtja e kësaj hapësire	2007-2027	MMPAU, OJF-të	Hapësirë efektive në internet për problemin e NOQ-ve	8.000	MMPAU Minis. përkthëse Donatorë OJF-të
	Shuma				12.000	

3. Angazhimi i OJF-ve në shpërndarjen e informacionit, sensibilizimin dhe fushatat ndërgjegjëse

Qytetarët shqiptar në përgjithësi nuk janë ose janë shumë pak të informuar rreth rrezikut në shëndet nga ndotja e mjedisit, marrëdhënieve midis mjedisit dhe shëndetit të njerëzve, dhe përfitimeve për ekonominë dhe shoqërinë në tërësi nga një mjedis i pastër. Kjo tregon nevojën e madhe për përmirësimin e ndërgjegjëimit mjedisor në të gjitha nivelet e shoqërisë.

Për të mundur marrjen e informacionit mjedisor nga qytetarët dhe për ta bërë sa më atraktiv këtë informacion, duhet që ai t'i përcillet publikut me një shumëllojshmëri formash dhe mjetesh. Në këtë kuadër, plani parashikon aktivitete që do të mundësojnë përcjelljen e informacionit mbi efektet e NOQ-ve në shëndetin e njeriut dhe mjedisin rrethues, në formë të thjeshta dhe të kuptueshme duke përdorur të gjitha mjetet e komunikimit masiv.

	Aktivitetet	Afati kohor	Organizata përgjegjëse	Rezultati i pritshëm	Buxheti i vlerësuar 000/Lekë	Burimet e fondeve
0	1	2	3	4	5	6
3	Angazhimi i OJF-ve në shpërndarjen e informacionit, sensibilizimin dhe fushatat ndërgjegjësuese					
3.1	Publikimi i rregullt i artikujve dhe lajmeve rreth NOQ-ve në median elektronike lokale dhe kombëtare.	2007 – 2025	OJF-të , Masmedia, MMPAU	Ndërgjegjësimi i publikut të gjerë	5.000.000	MMPAU Minis. përkthëse Donatorë OJF-të
3.2	Përgatitja e broshurave lidhur me NOQ që kanë ndikim në shëndetin e njerëzve dhe mjedis	2007-2020	OJF-të	Rritja e ndërgjegjësi mit të publikut	2.500	MMPAU Minis. përkthëse Donatorë OJF-të
3.3	Përgatitja dhe shpërndarja e posterave rreth NOQ	2007-2020	MMPAU, OJF-të	Ndërgjegjësimi i publikut në përgjithësi	1.500	MMPAU Minis. përkthëse Donatorë OJF-të
3.4	Konferenca shtypi periodike rreth gjendjes së NOQ-ve dhe rrezikut të tyre.	2007-2025	OJF-të MMPAU Institucionet kërkimore	Ndërgjegjësimi publikut në përgjithësi dhe politikane	2.000	MMPAU Minis. përkthëse Donatorë OJF-të
3.5	Përgatitja e dokumentareve dhe spoteve në TV lokale dhe kombëtare lidhur me ndikimin e NOQ-ve në shëndetin e njeriut (Në çdo 2 vjet një spot të ri)	2007-2025	OJF-të , Masmedia OJF-të,	Ndërgjegjësimi publikut në përgjithësi	4.500	MMPAU Minis. përkthëse Donatorë OJF-të
	Shuma				15.500	

3.3.7 Strategjia e Monitorimit dhe e Kërkimit Shkencor

Kimikatat që bëjnë pjesë në grupin e NOQ-ve dallohen për veti të larta toksike jo vetëm në drejtim të shëndetit të njeriut por në një kontekst më të gjerë të mjedisit rrethues në përgjithësi. Qëndrueshmëria e tyre e lartë ndaj shpërbërjes në kohë dhe si rrjedhojë prania e tyre në çdo pjesë të globit, krahas vetisë për t'u përqendruar në indet dhjamore të qenieve të gjalla, duke përfshirë organizmin e njeriut, shtrojnë nevojën e ndërmarrjes së masave të nevojshme për të realizuar monitorimin e kimikateve të grupit të NOQ-ve si dhe studimet tekniko-shkencore për mënyrat më efektive teknike dhe ekonomike për heqjen nga përdorimi, asgjësimin e kësaj kategorie të kimikateve të rrezikshme si dhe rehabilitimin e zonave të ndotura nga këto kimikate (neni 11 i Konventës).

Në Programin e monitorimit të elementeve dhe faktorëve të mjedisit (VKM Nr. 103, dt. 31.3.2002) nuk është parashikuar monitorimi i NOQ-ve në përgjithësi apo kimikateve të veçanta që bëjnë pjesë në grupin e NOQ-ve. Kërkesat e Konventës së Stokholmit dhe situata e konstatuar mbas kryerjes së inventarit paraprak të NOQ-ve në Shqipëri, diktojnë domosdoshmërinë e programimit të masave ligjore, institucionale dhe teknike për të realizuar monitorimin e kësaj kategorie të kimikateve.

Monitorimi do të mundësojë njohjen e saktë të gjendjes, lidhur me përmbajtjen e NOQ-ve në mjedise të ndryshme, kontributin e aktiviteteve të ndryshme socio-ekonomike në ndotjen e mjedisit nga kjo kategori e kimikateve të rrezikshme, prirjen në kohë të kimikateve të grupit të NOQ-ve, hartimin e një inventari të saktë të gjithë shkarkimeve në mjedis të NOQ-ve, kryerjen e analizave të rrezikut dhe mbi këto të dhëna përcaktimin e masave përkatëse për përmirësimin e gjendjes dhe plotësimin e standardeve mjedisore.

Në kapitujt më sipër dhe në veçanti në Planet e Veprimit për kategoritë e ndryshme të NOQ-ve janë parashikuar edhe masat përkatëse që lidhen me monitorimin dhe kryesisht në ato mjedise që konsiderohen të kontaminuara nga përdorimi ose depozitimi i NOQ-ve, siç janë; DDT, lindani, HCH, PCB, dioksinat dhe furanet. Ky monitorim do të shtrihet në vendet ku janë depozituar këto kimikate, territoret pranë tyre, ujërat sipërfaqësore, nëntokësore dhe ajrin përreth, në kafshët shtëpiake pranë këtyre territoreve të ndotura, si dhe në komunitetet e njerëzve që jetojnë pranë zonave të kontaminuara. Mbi bazën e gjetjeve nga zbatimi i programit të monitorimit për NOQ-të, ai do të përditësohet duke shtuar ose hequr zona a mjedise dhe kimikate NOQ, në varësi të rezultateve të monitorimit, për të qenë gjithmonë pasqyrë reale e situatës së NOQ-ve në Shqipëri.

Spektri i monitorimit është i gjerë dhe përfshin analiza kimike në mjedise dhe frekuencë të ndryshme. Një ndërmarrje e tillë kërkon pa dyshim kapacitetet e nevojshme profesionale, bazën materiale në përputhje me nivelin e cilësisë së analizave dhe të dyja së bashku mbështetjen e nevojshme financiare për sigurimin e aparaturave të përshtatshme, trajnimin e stafëve përkatës dhe mbulimin e kostove që kërkon programi i monitorimit të NOQ-ve.

Edhe në këtë aspekt, Shqipëria ka mundësi të kufizuar financiare për t'i përmbushur me forcat e veta të gjitha kërkesat që do të kërkojë realizimi i programit të monitorimit. Edhe në këtë drejtim do të jetë e nevojshme mbështetja nga donatorët.

NOQ-të, efektet e tyre në shëndetin e njeriut dhe mënyrat e ndërlikuara për pakësimin ose eliminimin e tyre, janë probleme relativisht të reja dhe që janë zhvilluar me ritme të shpejta si rrjedhojë e zbulimeve lidhur me efektet e këtyre kimikateve në shëndetin e njeriut dhe në mjedis. Në këto kushte, veprimtaritë lidhur me kërkimin dhe monitorimin janë sfida që kërkojnë angazhime serioze të burimeve njerëzore dhe financiare. Për ta bërë sa më të efektshëm përdorimin e këtyre burimeve janë të domosdoshme studimet dhe kërkimet në këtë fushë.

Aktualisht kapacitetet e kërimit për të gjitha aspektet që lidhen me inventarët e shkarkimeve të NOQ-ve dhe teknologjitë për pakësimin ose eliminimin e tyre janë të kufizuara. Janë kryer vetëm disa studime sporadike në Fakultetin e Shkencave të Natyrës në Universitetin e Tiranës, në Institutin e Shëndetit Publik pranë Ministrisë së Shëndetësisë, ECAT Tirana, dhe UNEP lidhur me përmbajtjen e PCB-ve në lagunën e Karavastasë dhe në territoret e ndotura të ish-uzinës ku prodhohej HCH/lindani përpara vitit 1990, si dhe në qumështin e gjirit të nënave në po këtë zonë.

Teknologjitë më të Mira të Disponueshme si dhe Praktikrat më të Mira Mjedisore janë ende shumë pak të njohura në komunitet e ndër specialistët që punojnë në institutet kërkimore dhe në ndërmarrjet prodhuese.

Në të ardhmen, mbi bazën e të dhënave të monitorimit dhe të inventarëve përkatës e të plotë të kimikateve NOQ, si dhe të zonave të ndotura, të cilat janë përshkruar në Planet e Veprimit të aktiviteteve përkatëse, do të planifikohen dhe kryhen studime e projekte për të eliminuar praninë e tyre në territorin e Shqipërisë dhe rehabilitimin e zonave të ndotura nga NOQ-të. Vënia në jetë e këtyre projekteve do të bëhet e mundur në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga Konventa e Stokholmit dhe ato që do të përcaktojnë Planin Kombëtar për NOQ-të.

Autoriteti qendror për mbrojtjen e mjedisit në Shqipëri në bashkëpunim me ministrinë përkatëse duhet të bashkërendojnë punën kërkimore dhe monitoruese në nivel vendi.

3.3.8 Strategjia për Shkëmbimin e Informacionit dhe Raportimi

Qëllimet strategjike dhe prioritetet

Qëllimi kryesor strategjik i shkëmbimit të informacionit është që të mundësojë shkëmbimin e informacionit për prodhimin, përdorimin dhe çlirimin e komponimeve të NOQ-ve dhe alternativave të tyre, duke përfshirë informacionin për vetitë e tyre të dëmshme dhe për kostot sociale dhe financiare që mund të sjellin ato.

Shtetet Palë të Konventës së Stokholmit mund ta shkëmbejnë këtë informacion me kontakte të drejtpërdrejta ndërmjet tyre ose nëpërmjet Sekretariatit të Konventës. Për të arritur këtë qëllim duhet përcaktuar një pikë fokale kombëtare, e cila të veprojë si ndërlidhës ndërmjet Konventës dhe të gjitha palëve vendase të interesuara që do të marrin pjesë në shkëmbimin e informacionit në nivelet ndërkombëtare dhe lokale.

Është e rëndësishme të theksohet që informacioni i shkëmbyer për shëndetin e njeriut dhe sigurinë dhe për ndikimin në mjedis nuk do të trajtohet si konfidencial për qëllimet e Konventës. Për informacion tjetër shtetet palë do të bien dakord për konfidencialitetin e tyre.

Udhëzues për politikën e shkëmbimit të informacionit

Strategjia për shkëmbimin e informacionit do të bazohet për:

- shkëmbimin e informacionit ndërkombëtar, dhe
- shkëmbimin e informacionit kombëtar.

Shkëmbimi i informacionit ndërkombëtar përmbledh informacionin e shkëmbyer midis shteteve palë të Konventës, organizatave ndërkombëtare dhe forumeve. Shkëmbimi i informacionit në nivel kombëtar bëhet në kohën e duhur midis të gjitha palëve të interesuara për problemet e NOQ-ve (ministrinë, agjencitë, OJF-të, shoqatat profesionale, etj.).

Organizimi i pikës fokale kombëtare për shkëmbimin e informacionit

Pikë Fokale për Konventën e Stokholmit është Ministria e Mjedisit, e Pyjeve dhe e Administrimit të Ujërave. Ajo do të luajë rolin e pikës fokale për shkëmbimin e informacionit, si dhe do të jetë përgjegjëse për zbatimin e këtij programi, për çështjet administrative dhe problemet teknike. Për këtë qëllim, pranë kësaj ministrie do të ngrihet Zyra e Regjistrimit të Kimikateve e cila do të mbulojë edhe problematikën e Ndotësve Organikë të Qëndrueshëm.

Komunikimi ndërmjet institucioneve të interesuara do të organizohet sipas skemës më poshtë.

Figura 8. Skema e Komunikimit




Tabela 21: Detyrimet e Raportimit për Konventën e Stokholmit dhe strategjia e shkëmbimit të informacionit dhe raportimit në Shqipëri

Detyrimet e Konventës	Përshkrimi i Kërkesës	Periodiciteti	Institucioni Përgjegjës
Neni 5, nën-paragrafi (a) Masat për të zvogëluar ose eliminuar shkarkimet nga prodhimet e paqëllimta	Kërkon që secila palë të hartojë një plan veprimi, ose atje ku është me vend një plan rajonal a nënrajonal, kurse më pas ta zbatojë atë si pjesë e planit të vet kombëtar të zbatimit të specifikuar në nenin 7, i cili është hartuar për të identifikuar, përshkruar dhe trajtuar shkarkimin e kimikateve të përfshira në Aneksin C të Konventës.	Brenda dy vjetësh që nga data e hyrjes në fuqi të Konventës për atë palë.	MMPAU, METE, MPPTT
Neni 5, nën-paragrafi (a) (v): Masat për të zvogëluar ose eliminuar shkarkimet nga prodhimet e paqëllimta	Duhet të kryhet rishikimi i atyre strategjive zbatuese për hartimin e planit të veprimit në lidhje me përcaktimin, përshkrimin dhe trajtimin e çështjeve lidhur me prodhimin e paqëllimtë të NOQ-ve të përfshira në Aneksin C.	Çdo pesë vjet	MMPAU, Ministrinë e linjës
Neni 7: Planet e zbatimit	Kërkon nga secila Palë të hartojë e të përpiqet të zbatojë një plan veprimi dhe t'ia përcjellë atë Konferencës së Palëve, si dhe kërkon që secila Palë ta rishikojë e ta përditësojë planin e vet periodikisht dhe sipas mënyrës që do të përcaktohet në një vendim të konferencës së Palëve.	Përcjellja te Konferenca e Palëve brenda dy vjetësh nga data në të cilën Konventa hyn në fuqi për atë Palë.	KM, MMPAU
Neni 15: Raportimi	Secila Palë duhet t'i raportojë Konferencës së Palëve lidhur me masat që ka marrë për të zbatuar dispozitat e Konventës, si dhe për efektshmërinë e këtyre masave në arrijtjen e objektivave të Konventës. Secila Palë duhet t'ia paraqesë Sekretariatit: (a) Të dhëna statistikore për sasinë e përgjithshme të prodhimit, importit dhe eksportit të secilit kimikat të përfshirë në Aneksin A dhe Aneksin B, ose një vlerësim të arsyeshëm për këto të dhëna, si dhe (b) Në një masë të praktikueshme, një listë të Shteteve nga të cilat ka importuar secilën prej këtyre substancave si dhe të Shteteve të të cilat ka eksportuar secilën nga këto substanca.	Do të vendoset nga Konferenca e Palëve.	MMPAU, MF, INSTAT
Aneksi A, Pjesa II nën-paragrafi (g)	Kërkon nga secila Palë që të paraqesë çdo pesë vjet një raport për ecurinë lidhur me eliminimin e bifenileve të polikloruara dhe t'ia përcjellë atë Konferencës së Palëve në përputhje me Nenin 15.	Çdo 5 vjet	MMPAU, METE, KESH
Aneksi B, Pjesa II, paragrafi 4	Secila Palë që përdor DDT duhet t'ia paraqesë Sekretariatit informacion për sasinë e përdorur, kushtet e këtij përdorimi dhe lidhjen me strategjinë e asaj Pale për trajtimin e sëmundjeve, sipas një formati që do të përcaktohet nga Konferenca e Palëve në konsultim me Organizatën Botërore të Shëndetësisë.	Çdo 3 vjet	MMPAU, MSH, MBUMK

Detyrimet e Konventës	Përshkrimi i Kërkesës	Periodiciteti	Institucioni Përgjegjës
Neni 4, paragrafi 6	Një Palë që kërkon zgjatjen e një përjashtimi të veçantë duhet t'i paraqesë Sekretariatit një raport ku të argumentohet nevoja në vazhdim për regjistrimin e atij përjashtimi .	Përpara përfund. të afatit të përjashtimit të veçantë (5 vjet pas hyrjes në fuqi të KS për atë NOQ).	MMPAU

3.4 Propozime dhe Përparësitë lidhur me ngritjen e Kapaciteteve

Duhet forcuar kapacitetet dhe aftësitë ekzistuese për administrimin e NOQ-ve në Shqipëri, në mënyrë që të arrihen objektivat e PKV-së. Më poshtë, për çdonjërin nga fushat përparësore përkatëse, theksohen nevojat përparësore për ngritjen e kapaciteteve në mbështetje të përmbushjes së kërkesave të Konventës.

1. Krijimi i një Njësie për NOQ-të pranë MMPAU me qëllim që:

- Të ndjekë zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga Konventa e Stokholmit dhe politikave që lidhen me NOQ-të në përgjithësi.
- Të bëjë koordinimin e aktiviteteve që kryhen nga ministritë që trajtojnë problemet e NOQ-ve dhe sigurimin e këmbimit të informacionit.
- Të ndjekë plotësimin e legjislacionit mjedisor në përshtatje me Direktivat e BE për NOQ-të.
- Të ndjekë zbatimin e praktikave të konsultimit me institucionet dhe ekspertët përkatës në ndërmarrjen e aktiviteteve që lidhen me heqjen nga përdorimi, shkatërrimin e NOQ-ve dhe rehabilitimin e zonave të ndotura.
- Të bëjë vlerësimin e projekteve që lidhen me problemet e NOQ-ve.

2. Përcaktimi nga Këshilli i Ministrave i institucioneve që do të zbatojnë programin e monitorimit të NOQ-ve me qëllim realizimin e detyrave që lidhen me zbatimin e Konventës së Stokholmit.

3. Sigurimin nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe e Energjetikës të kapaciteteve teknike për administrimin e PCB-ve, zëvendësimin e vajrave me përmbajtje PCB, pajisjeve që përmbajnë këto vajra dhe eliminimin mjedisor të tyre.

4. Hartimi nga ministrit përkatëse dhe MMPAU të procedurave për ruajtjen e sigurt të NOQ-ve (kryesisht vajra të ndotura me PCB) dhe pajisjet mbajtëse të NOQ-ve deri në asgjësimin e tyre përfundimtar.

5. Përgatitja e studimeve dhe projekteve për asgjësimin e NOQ-ve ose materialeve të ndotura me NOQ.

6. Organizmi nga subjektet e interesuara të trajnimeve dhe seminareve për grupe të ndryshme të interesit mbi problemet e monitorimit, kontrollit, ruajtjes së sigurt, asgjësimit të NOQ-ve.

7. Ndërgjegjësimi i publikut lidhur me ndikimin e NOQ-ve në shëndetin e njeriut dhe mjedisin.

3.5 Përmbledhje e veprimtarive dhe mjetet e nevojshme financiare për realizimin e PKV-së

Buxheti total i nevojshëm për zbatimin e PKV parashikohet të jetë 2.367.005.000 lekë i ndarë si më poshtë:

1.329.095.000 lekë për periudhën afat-shkurtër 2007-2009

918.740.000 lekë për periudhën afat-mesme 2010-2015

119.170.000lekë për periudhën afat-gjatë 2016-2027

Në tabelën e mëposhtme jepet në mënyrë të përmbledhur buxheti i nevojshëm për veprimtaritë kryesore që parashikon Plani Kombëtar i Veprimit.

VII.	Masat për Forcimin e Kuadrit Institucional dhe Rregullator	Buxheti afat-shkurter. 000/Lekë	Buxheti afat-mesem 000/Lekë	Buxheti afat-gjate 000/Lekë	Buxheti total 000/Lekë
	1. Përfshirja e monitorimit të NOQ-ve dhe në veçanti të PCB-ve si pjesë e Progrmit Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit	4.900	---	---	4.900
	2. Regjistrimi i pajisjeve dhe i vajrave me përmbajtje të PCB-ve në sektorin elektrik	2.000	---	---	2.000
	3. Perafrimi i legjislacionit me atë të BE-së	20.100	30.840	---	50.940
	4. Ngritja dhe funksionimi i strukturës kombëtare për zbatimin e Konventës së Stokholmit	4.150	3.900	7.150	15.200
	Totali I	31.150	34.740	7.150	73.040
VIII.	Pesticidet NOQ (përfshirë DDT-n);				
	1. Përgatitja e një amendamenti të VKM për monitorimin për shtrirjen e këtij të fundit edhe në pesticidet NOQ	---	---	---	Eshte perfshire ne I.1
	2. Kryerja e analizave për nivelet e pranishme të mbetjeve të pesticideve NOQ në ish depot dhe vendet e ndotura, duke përfshirë edhe vlerësimin e rrezikut	10.250	2.000	---	12.250
	3. Forcimi i kapacitetit njerëzor dhe teknik i laboratorit analitik në IMB	24.200	---	---	24.200
	4. Përgatitja e planit të veprimit për reabilitimin e vendeve të kontaminuara me pesticide NOQ	---	1.000	---	1.000
	Totali II	34.450	3.000	---	37.450

IX.	PCB-t dhe Paisjet që Përmbajnë PCB-t				
	1. Të hartohet dhe të zbatohet një rregullore në lidhje me administrimin, trajtimin, monitorimin, heqjen nga përdorimi dhe eliminimin e vajit e të pajisjeve të ndotura me PCB	---	---	---	Eshte perfshire ne l.4
	2. Të hartohet dhe të zbatohet një udhëzues i brendshëm i KESH-it për administrimin, trajtimin dhe heqjen nga përdorimi të transformatorëve të ndotur me PCB	2.190	1.100	250	3.540
	3. Të trajnohen punonjësit përgjegjës për trajtimin dhe mirëmbajtjen e transformatorëve	1.330	780	---	2.110
	4. Krijimi i kapaciteteve laboratorike për kryerjen e analizave për praninë e PCB-ve në vajrat e transformatorëve	6.970	---	---	6.970
	5. Rehabilitimi gradual i vendeve të ndotura me PCB	12.640	73.960	55.180	141.780
	6. Eliminimi i vajit mineral të ndotur me PCB	7480	46.640	32.910	87.030
	7. Hartimi dhe zbatimi i një programi kombëtar për monitorimin e PCB-ve	1.145	6.710	6.650	14.505
	Totali III	31.755	129.190	94.990	255.935
X.	Nënproduktet NOQ të Prodhuara në Mënyrë Jo të Qëllimshme				
	1. Kompletimi i legjislacionit dhe i rregulloreve që lidhen me kontrollin dhe parandalimin e ndotjeve industriale, si dhe me administrimin e mbeturinave	---	---	---	Eshte perfshire ne l.4
	2. Forcimi i kapaciteteve (njerëzore dhe teknike) për institucionet përgjegjëse për administrimin e mbeturinave (në veçanti administrimi i venddepozitimeve dhe parandalimi i djegies në mjedis të hapur mbetjeve të ngurta urbane)	33.500	---	---	33.500
	3. Zhvillimi politikave dhe veprimeve zbatuese për pakësimin e shkarkimeve të dioksinave nga administrimin i mbeturinave	985.000	427.500	---	1.412.500
	4. Futja e Teknikave Me të Mira (TMM) & Praktikave më të Mira Mjedisore (PMM) në sektorin industrial	38.000	50.000	---	88.000
	5. Zhvillimi dhe implementimi në shkallë të gjerë, në të gjithë vëndin, i administrimit mjdisor të mbeturinave	67.000	220.000	---	287.000

	mjekësore duke minimizuar kështu shkarkimet e paqëllimshme të NOQ-ve				
	6. Përditësimi sistematik i inventarit të shkarkimeve	600	300	---	900
	Totali IV	1.124.100	697.800	---	1.821.900
XI.	Mbeturinat dhe Zonat e Kontaminuara				
	1. Forcimi e kapaciteteve për administrimin e NOQ-ve	31.950	15.930	---	47.880
	2. Studimi i terrenit, percaktii i prioriteteve, hartimi i projekteve rehabilituese për zonat potencialisht të ndotura me NOQ	67.300	22.000	---	89.300
	Totali V	99.250	37.930	---	137.180
XII.	Ndërgjegjësimi Publik, Informimi, Shpërndarja e Informacionit, Trajnimi dhe Zhvillimi				
	1. Rritja e informimit dhe ndërgjegjësimin në komunitetet ku janë prezente NOQ-et, duke i sensibilizuar mbi efektet e tyre në shëndetin e njeriut dhe në mjedis	4.100	7.500	2.400	14.000
	2. Rritja e kapaciteteve të OJF-ve mjedisore, për ndërgjegjësimin e publikut dhe shpërndarjen e informacionit mjedisor	1.800	3.600	6.600	12.000
	3. Angazhimi i OJF-ve në shpërndarjen e informacionit, sensibilizimin dhe fushatat ndërgjegjësusese	2.490	4.980	8.030	15.500
	Totali VI	8.390	16.080	17.030	41.500
	TOTALI I PËRGJITHSHËM	1.329.095	918.740	119.170	2.367.005

ANEKS

Portofol me projekt-propozime

Profil Projekti Nr. 1

1. Titulli i Projektit	Studim analitik për nivelin ekzistues të ndotjeve në ish depot e pesticideve NOQ, dhe në hapësirat përreth tyre.
2. Agjencia Implementuese	MBUMK, MSH ,
3. Agjencia bashkëpunuese	MMPAU, IMB, ISHP
4. Kohëzgjatja	2007 – 2010
5. Vendi	Në ish-depot e ndryshme në Durrës, Fier, Tiranë, Fushë-Krujë , Lushnje, Elbasan, Gjirokastrë, etj
6. Informacion shpjegues	Ish-depot janë në kushte tejet të këqija, mundësia e ndotjes së tokës dhe ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore. Këto mjedise janë krejtësisht jashtë kontrollit.
7. Qëllimi i Projektit	Të njohim efektin dhe të ulim rrezikun për njerëzit.
8. Justifikimi i Projektit	Është shumë e rëndësishme për vendin tonë që njerëzit të dinë dhe të menaxhojnë riskun e pesticideve NOQ
9. Qëllimi i Projektit dhe Objektivat	Përcaktimi i niveleve të ndotjes nga NOQ-të në ish-depot , vlerësimi i riskut Parandalimi i ekspozimit të mëtejshëm të popullsisë nga pesticidet NOQ
10. Përfituesit	Komuniteti i banorëve që jetojnë pranë këtyre magazinave dhe mjedisi
11. Aktivitetet	Studim mbi nivelin ekzistues të ndotjeve
	Kryerja e analizave për nivelin e pranishëm të pesticideve NOQ në depot dhe në tokën përreth
	Vlerësimi i riskut dhe rekomandimet përkatëse
12. Kosto	150.000 Euro
13. Donator	Qeveria Shqiptare
14. Agjencitë e tjera Kontribuese	Qeveria Holandeze, Zvicrane etj.
15. Vendndodhja e projektit	Durrës dhe Tirane

Profil Projekti Nr. 2

1 Titulli i Projektit	Studimi i Fizibilitetit për Repartin e Riparimit të Transformatorëve
2 Agjencitë zbatuese	KESH
3 Agjencitë bashkëpunuese	Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjisë; Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave
4 Kohëzgjatja	12 muaj
5. Vendi	Reparti i Riparimit të Transformatorëve në Tiranë
6. Prezantimi i Projektit	Në Repartin e Riparimit të Transformatorëve vijnë për riparim transformatorë nga të gjithë Objektet e KESH-it. Reparti funksionon për një periudhë 30 vjeçare pa aplikuar asnjë kontroll mbi PCB-të. Në Shqipëri njohuritë mbi rrezikun e PCB-ve janë relativisht fillestare dhe shumë njerëz përfshirë këtu edhe zyrtarë nuk i njihnin ato deri kur filloi Projekti mbi Përgatitjen e PCV-ve në vitin 2005. Nuk u është kushtuar vëmendja e duhur pikimeve apo rrjedhjeve të PCB-ve nga transformatorët gjatë procesit të prerjes ose riparimit të tyre, nuk përdoren depozita mbledhëse në rast rreziku të pikimit të vajrave. Të gjitha sipërfaqet e betonta në këtë Repart janë të ndotura nga vaji i transformatorëve si dhe në dyshtemenë e betonit kalon një kanal i kablllove elektrikë. Rreth 50 % e sasisë së përgjithshme të transformatorëve janë prodhuar para vitit 1990 (rreth 6,000 copë) dhe moshë mesatare e transformatorëve është shumë e vjetër: 28 vjet. Meqenëse nuk ekzistojnë konceptet lidhur me rrezikshmërinë e PCB-ve, vaji dielektrik i përdorur dhe i përzier është përdorur për të rimbushur transformatorët e riparuar. Transformatorët e përdorur ruhen në ambient të hapur jashtë ndërtesës direkt në tokë dhe të ekspozuar ndaj shiut. Në këto kushte ekziston rreziku i rënies së zjarrit, për më tepër që Reparti ndodhet në një zonë urbane shumë afër godinave të banimit.
7. Arsyeja e Projektit	Të përzgjedhë alternativën më të mirë: Rregullimin e Repartit ekzistues (Dekontaminimin dhe Rehabilitimin e ndërtesës dhe jashtë saj), ose Ndërtimin e Repartit të ri.
8. Justifikimi i Projektit	Meqenëse Reparti ekzistues është qendra e vetme në të gjithë vendin ku riparohen transformatorë që prej 30 vjetësh pa asnjë kontroll për PCB-të, mjedisi jashtë dhe brenda Repartit është shumë i ndotur duke ndikuar kështu në shëndetin e njerëzve dhe në gjithë mjedisin përreth. Projekti do të sigurojë një Menaxhim të Qëndrueshëm Mjedisor për cilëndo nga alternativat, qoftë për Repartin ekzistues të Riparimit të Transformatorëve ose për ndërtimin e Repartit të ri. Ky Projekt do të përgatisë një VNM mbi PCB-të në Repartin ekzistues dhe zonën e populluar afër Repartit, si dhe për variantin e dytë me qëllim që të sigurojë se ky projekt do të jetë i besueshëm si nga ana shoqërore ashtu dhe nga ana ekonomike. Zbatimi i këtij projekti do të përmirësojë rrënjësisht situatën mjedisore të këtij Reparti duke rritur nivelin e ndërgjegjësimit të punonjësve mbi rrezikshmërinë e PCB-ve në shëndetin e tyre dhe në mjedis.

9 Qëllimi i Projektit dhe Objektivat	Të përgatisë studim të plotë fizibiliteti mbi nivelin e ndotjes në Repartin ekzistues dhe zonën e populluar afër tij. Gjithashtu të përcaktojë koston gjatë proceseve dhe fazave të ndryshme duke përfshirë dekontaminimin dhe rehabilitimin e Repartit dhe jashtë tij. Të përgatisë studim të plotë fisibiliteti për Repartin e ri të Riparimit të Transformatorëve në një vend tjetër, duke përfshirë koston e dekontaminimit të Repartit ekzistues dhe atë të ndërtimit të Repartit të ri. Ky projekt gjithashtu do të japë mundësinë për të krahasuar këto dy alternativa për të përzgjedhur më të mirën ndërmjet tyre, atë me paraqitje më të mirë mjedisore dhe me kosto më të ulët. Të përzgjedhë alternativën më të mirë për vendin e riparimit të transformatorëve pa ndonjë ndikim në shëndetin e njerëzve dhe në mjedis.
10 Përfituesit	Punonjësit e Repartit të Riparimit të Transformatorëve, popullsia që jeton afër këtij Reparti, KESH/OST.
11 Aktivitetet	a- Seminar trajnimi për të gjithë sipërmarrësit e PCB-ve: NjAM, Ministria e Mjedisit, Përgjegjësit e Objekteve. Qëllimi i seminarit është që të tregojë dhe të qartësojë më tej cilësitë ndotëse të PCB-ve: Burimet e ndotjes, Identifikimin e ndotjes, Variantet teknikë për rregullimin (Biodegradimin, Larjen me tretës, Djegjen në furra, Desorbimin termik, Distilimin e PCB-ve në temperaturë të ulët). Është e rëndësishme t'u jepet punëtorëve një informacion i drejtë që ata të ndërgjegjësohen për rrezikshmërinë e PCB-ve në shëndetin e tyre dhe në mjedis. b- në Repart 1. Të kryhet marrja e mostrave dhe analiza për të gjithë transformatorët që ndodhen në Repart. Gjithashtu të përcaktohet niveli i PCB-ve në betonin e ndërtesës dhe në tokë jashtë ndërtesës në mënyrë që të përcaktohet thellësia e ndotjes. 2. Të kryhen analiza me përzgjedhje në mostra toke gjatë proceseve të ndryshme (të biodegradimit, procesit të larjes me tretës) në thellësi të ndryshme. 3. Vlerësim i plotë i ndotjes në ndërtesë dhe jashtë saj. 3. Të kryhet studim i plotë i fisibilitetit për Repartin ekzistues duke përfshirë rregullimin (dekontaminimin dhe rehabilitimin) e ndërtesës dhe rregullimin e mjedisit jashtë (varianti teknik dhe kosto e rregullimit) 4. Të kryhet studim i plotë i fisibilitetit për dekontaminimin e Repartit dhe mjedisve të tij dhe ndërtimin e Repartit të ri. Masat rregulluese konsistojnë në largimin e gjithë materialeve të ndotura dhe sistemimin e tyre në depozita metalike, transportimin e tyre në Objekte për ruajtjen e përkohshme deri në eliminimin e tyre përfundimtar. 5. Përcaktimi i koston për ndërtimin e Repartit të ri (duhet dekontaminimi i vendit dhe ndërtimi i Repartit të ri) dhe i koston për Repartin ekzistues që do të rehabilitohet (gjatë fazave dhe proceseve të ndryshme që kërkon dekontaminimin dhe rehabilitimin i tij brenda dhe jashtë) dhe krahasimi i këtyre dy kostove për të përzgjedhur atë më të ultën.
12 Kosto e vlerësuar	350 000 EURO
13 Donatorët kryesorë	Banka Botërore, GTZ, SAEFL, Banka Europiane e Investimeve, SECO, GEF, BERZH.
14 Agjenci të tjera kontribuese	Qeveria Shqiptare, KESH
15 Vendndodhja e projektit	Reparti i Riparimit të Transformatorëve në Tiranë

Profil Projekti Nr.3:

1. Titulli i Projektit	Rehabilitimi i Mjedisëve të ndotura me PCB (i Repartit të Riparimit të Transformatorëve)
2 .Agjencitë zbatuese	KESH
3 .Agjencitë bashkëpunuese	Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjisë, Instituti i Shëndetit Publik, Fakulteti e Shkencave të Natyrës dhe kompani private.
4 .Kohëzgjatja	24 muaj
5 .Vendi	Reparti i Riparimit të Transformatorëve në Tiranë
6 .Prezantimi i Projektit	Në Repartin e Riparimit të Transformatorëve vijnë për riparim transformatorë nga të gjithë Objektet e KESH-it. Reparti funksionon që prej 30 vjetësh e deri tani pa aplikuar asnjë kontroll mbi PCB-të. Në Shqipëri njohuritë mbi rrezikun e PCB-ve janë relativisht fillestare dhe shumë njerëz përfshirë këtu edhe zyrtarë nuk i njohin ato deri kur filloi Projekti mbi Përgatitjen e PCB-ve në vitin 2005. Nuk u është kushtuar vëmendja e duhur pikimeve apo rrjedhjeve të PCB-ve nga transformatorët gjatë procesit të pritjes ose riparimit të tyre, nuk përdoren depozita mbledhëse në rast rreziku të pikimit të vajrave. Të gjitha sipërfaqet e betonit në këtë Repart janë të ndotura nga vaji i transformatorëve si dhe në dyshtemenë e betonit kalon një kanal i kabllave elektrikë. Rreth 50 % e sasisë së përgjithshme të transformatorëve janë prodhuar para vitit 1990 (rreth 6,000 copë) dhe moshë mesatare e transformatorëve është shumë e vjetër: 28 vjet. Megjithatë nuk ekzistojnë konceptet lidhur me rrezikshmërinë e PCB-ve, vaji dielektrik i përdorur dhe i përzier është përdorur për të rimbushur transformatorët e riparuar. Transformatorët e përdorur ruhen në ambient të hapur jashtë ndërtesës direkt në tokë dhe të ekspozuar ndaj shiut. Në këto kushte ekziston rreziku i rënies së zjarrit, për më tepër që Reparti ndodhet në një zonë urbane shumë afër godinave të banimit.
7. Arsyeja e Projektit	Procesi i rregullimit (i dekontaminimit dhe i rehabilitimit) të Repartit dhe mjedisëve rreth tij do të kryhet në përputhje me MQM. Më qëllim për të rritur ndërgjegjësimin e të gjithë punonjësve dhe punëtorëve të ekspozuar ndaj PCB-ve dhe me ndihmën e ekspertëve mjedisorë të KESH/OST do të merren masat e duhura siç janë zhvillimi i disa programeve të edukimit dhe seminareve të trajnimit në lidhje me rrezikshmërinë e PCB-ve dhe ndikimin e tyre në shëndetin e njeriut dhe në mjedis.
8. Justifikimi i Projektit	Sigurimi i një MQM për rregullimin e këtij mjedisi të ndotur. Ky Projekt do të përmirësojë rrënjësisht situatën mjedisorë të këtij Reparti duke rritur nivelin e ndërgjegjësimit të punonjësve mbi rrezikshmërinë e PCB-ve në shëndetin e tyre dhe në mjedis. Zbatimi i këtij projekti do të mbulojë testimin për PCB të të gjithë transformatorëve në Repart, përcaktimin e PCB-ve në betone dhe në tokë gjatë proceseve të ndryshme. Ky Projekt do të përgatisë një VNM mbi PCB-të në Repartin ekzistues dhe zonën e populluar afër Repartit, me qëllim që të sigurojë se ky projekt do të jetë i besueshëm si nga ana shoqërore ashtu dhe nga ana ekonomike.
9. Qëllimi i Projektit dhe Objektivat	Përmirësimi i situatës mjedisore. Të gjithë punonjësit të ndërgjegjësohen për rrezikshmërinë e PCB-ve në shëndetin e tyre dhe mjedis.
	Përmirësimi i problemeve lidhur me ndikimin e PCB-ve në Repart dhe zonën përreth.

10. Përfituesit	Punonjësit e Repartit të Riparimit të Transformatorëve, popullsia që jeton afër këtij Reparti, KESH/OST.
11 Aktivitetet	a– Seminar trajnimi për të gjithë subjektet e interesuara:NjAM, MMPAU, KESH, METE, Përgjegjësit e Objekteve. Qëllimi i seminarit është që të tregojë dhe të qartësojë më tej vetitë ndotëse të PCB-ve: Burimet e ndotjes, Identifikimin e ndotjes, Variantet teknike për rregullimin (Biodegradimin, Larjen me tretës, Djegjen në furra, Desorbimin termik, Distilimin e PCB-ve në temperaturë të ulët). Përdorimin e Mjeteve Mbrojtëse Personale si masa mbrojtëse ndaj PCB-ve. Është e rëndësishme t'u jepet punëtorëve një informacion i drejtë që ata të ndërgjegjësohen për rrezikshmërinë e PCB-ve në shëndetin e tyre dhe në mjedisin përreth. b- Rregullimi i Repartit dhe mjedisit 1. Masat rregulluese konsistojnë në largimin e të gjitha materialeve të ndotura në ndërtesë dhe jashtë saj (duke përfshirë vajin, dheun, betonin, transformatorët dhe materialet e tjera të ndotura), sistemimin e tyre në depozita metalike dhe transportimin e tyre në Objektivin e ruajtjes së përkohshme deri në eliminimin përfundimtar të tyre. Depozitat metalike do të etiketohen me tabela ngjyrë të verdhë që tregojnë praninë e mbetjeve të rrezikshme. Për të vendosur teknologjinë e dekontaminimit kërkohet të kryhen disa teste paraprake. 2. Rehabilitimi i ndërtesës dhe i mjediseve përreth do të përfshijë zonën e pranimit (të peshimit, marrjes së mostrave), zonën e riparimit, zonën e tharjes së transformatorëve, dhomat e dusheve, banjat, dhomat e veshjeve.....
12. Kosto e vlerësuar	300 000 EURO
13. Donatorët kryesorë	Banka Botërore, GTZ, SAEFL, Banka Europiane e Investimeve, SECO, GEF, BERZH
14. Agjenci të tjera kontribuese	Qeveria Shqiptare, KESH
15. Vendndodhja e projektit	Reparti i Riparimit të Transformatorëve në Tiranë

Profil Projekti Nr. 4

1 Titulli i Projektit	Analizat e PCB-ve
2 Agjencitë zbatuese	KESH/OST, MM
3 Agjencitë bashkëpunuese	METE, MMPAU.
4 Kohëzgjatja	18 muaj
5 Vendi	Tirana
6 Prezantimi i Projektit	Në Shqipëri funksionojnë disa laboratorë që u përkasin Institucioneve shtetërore dhe më pak sektorit privat, në të cilët kryhen analiza specifike për qëllime të ndryshme. Sidoqoftë, aktualisht asnjë nga këta laboratorë nuk është i fokusuar në analizën e PCB-ve qoftë si përbërës në produkte ose në formën e mbetjeve, pra në Shqipëri nuk funksionojnë laboratorë që të kryejnë analizat e PCB-ve. Para pak vitesh në Shqipëri janë analizuar PCB-të në vaj dhe në tokë në laboratorë shkencorë por jo të akredituar. Por aktualisht analizat e PCB-ve nuk mund të kryhen për shkak të mungesës së reagentëve ose të metodikave analitike të kohës si dhe për mungesë të stafit të përgatitur.
7 Arsyeja e Projektit	Të zgjerohet dhe propagandohet informacioni dhe njohuritë mbi rrezikshmërinë e PCB-ve dhe pasojat e tyre. Të krijohen dhe forcohen stafe laboratorikë të përgatitur analizimin e PCB-ve. Të merret në konsideratë dhe të vlerësohet një mjedis i sigurt dhe mbrojtja personale nga ndikimi i PCB-ve.
8 Justifikimi i Projektit	Ky projekt synon të përmirësojë nivelin e përgatitjes së stafit laboratorik që punon me analizat e PCB-ve. Zbatimi i këtij projekti do të mbulojë të gjitha proceset për përmirësimin e nivelit të aftësisë së stafit laboratorik dhe ngritjen e cilësisë së analizimit të PCB-ve në vaj, tokë dhe mbetjet e ngurta me qëllim për të marrë të dhëna të plota mbi përmbajtjen e PCB-ve në pajisjet elektrike.
9 Qëllimi i Projektit dhe Objektivat	Të ngrejë nivelin e punës dhe të akreditojë laboratorët ekzistues dhe/ose të krijojë laboratorë të rinj analitikë të specializuar për analizat e PCB-ve. Të arrihet cilësi e lartë në analizimin e PCB-ve. Analizimi kërkon pajisje dhe materiale analizuese të veçanta dhe duhet të kryhet nga persona të përgatitur në përdorimin e tyre. Të arrihet një ndarje e plotë ndërmjet pajisjeve elektrike dhe materialeve në përdorim me PCB dhe pa PCB, në mënyrë që mirëmbajtja e tyre dhe nxjerrja jashtë përdorimit të kryhen në përputhje me MQM.
10 Përfituesit	Objektet e KESH/OST, Objektet elektrike të Ushtrisë, Sektori privat.
11 Aktivitetet	Aktivitetet më të rëndësishme të këtij projekti janë identifikimi i kërkesave laboratorike, specifikimi dhe blerja e pajisjeve, reagentëve dhe standardeve për konsum dhe trajnimi i stafit. Akreditimi i laboratorëve të aftë të kryejnë analiza dhe të japin rezultate të sakta në nivelin e kërkuar. Kryerja e analizave të PCB-ve në vaj, tokë, pjesët e ngurta të pajisjeve në të gjithë Objektet e KESH/OST, Sektorit të Mbrojtjes dhe në sektorin privat.
12 Kosto e vlerësuar	120 000 EURO
13 Donatorët kryesorë	Banka Botërore, Banka Europiane e Investimeve, BERZH, GEF
14 Agjenci të tjera kontribuese	Qeveria Shqiptare, KESH, GTZ
15 Vendndodhja e projektit	Tirana

Profil Projekti 5:

1 Titulli i Projektit	Mbledhja, transportimi dhe ruajtja e përkohshme e vajit dhe pajisjeve të ndotura me PCB
2 Agjencitë zbatuese	KESH/OST
3 Agjencitë bashkëpunuese	MMPAU, METE, MM, Kompani private
4 Kohëzgjatja	24 muaj
5 Vendi	Në të gjithë vendin
6 Prezantimi i Projektit	Deri para pak vitesh në KESH/OST nuk ka pasur ndonjë strukturë institucionale për të ndjekur problemet mjedisore, nuk janë mbajtur regjistrime mbi prodhimin dhe menaxhimin e mbetjeve, nuk janë përgatitur procedura të brendshme për menaxhimin e mbetjeve që të ndihmonin në përgatitjen e udhëzimeve për trajtimin e mbetjeve, për të vendosur përgjegjësitë për menaxhimin e mbetjeve dhe për të vendosur detyrat për regjistrimin e prodhimit të mbetjeve. Niveli i ndërgjegjësimit të punonjësve në Objektet e KESH-it për njohjen e ndikimit të PCB-ve është shumë i ulët. Deri tani të gjitha mbetjet shkarkohen në tokë ose në lumë pa asnjë lloj trajtimi duke krijuar ndotje mjedisore në tokë, ujërat sipërfaqësorë dhe ndofta ujërat nëntokësorë duke ndikuar në shëndetin e njerëzve, kafshëve dhe në të gjithë mjedisin përreth. Në Shqipëri nuk ka ndonjë Objekt që të shërbejë për ruajtjen e përkohshme të mbetjeve. Për më tepër, nuk ka ndonjë Objekt ku të trajtohen këto mbetje. Në Objektet e KESH-it janë në përdorim shumë transformatorë të vjetër të prodhuar para vitit 1970 që kanë krijuar ndotje mjedisore sidomos në tokë dhe ujëra nëntokësorë për shkak të rrjedhjeve dhe pikimeve të vajit gjatë procesit të mirëmbajtjes ose vjetërsisë së tyre. Pjesa më e madhe e transformatorëve është e vendosur direkt në tokë ose në bazament mbajtës por nuk ka depozita dytësore poshtë transformatorëve, lehtësisht mund të shikosh tokën e ndotur poshtë transformatorëve, kështu që është e nevojshme të bëhet një menaxhim i sigurt dhe investigime mbi ndotjen e tokës dhe ujërave nëntokësorë.
7 Arsyeja e Projektit	Trajnimi për menaxhimin e PCB-ve i punonjësve mjedisorë shtetërorë, i ekspertëve mjedisorë të KESH/OST dhe i punonjësve të ndërmarrjeve që ndikohen nga prania e PCB-ve. Menaxhimi sa më i mirë i mbetjeve kimike dhe të rrezikshme, brenda kuadrit të konventave mjedisore përkatëse dhe legjislacionit shqiptar për mbrojtjen e mjedisit.
8 Justifikimi i Projektit	Projekti do të japë koncepte praktike të MQM dhe teknologji në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga Konventa e Stokholmit lidhur me menaxhimin e PCB-ve.
9 Qëllimi i Projektit dhe Objektivat	Të merren masa efektive për grumbullimin, transportimin, ruajtjen e përkohshme të vajit PCB dhe të pajisjeve të ndotura në bazë të Konventës së Stokholmit lidhur me kimikatet e rrezikshme. Të arrihet një MQM për mbetjet që përmbajnë PCB.
10 Përfituesit	Objektet e KESH/OST, MM, popullsia që jeton pranë zonave të ndotura, kafshët, flora dhe fauna.

11 Aktivitetet	Aplikimi i një MQM në Objektet energjetike, repartet, nën-stacionet elektrikë, magazinat, transformatorët dhe gjithë pajisjet e tjera në përdorim, të ndotura me PCB. Nxiti e marrjes së masave për të ulur ekspozimin dhe rrezikimin prej PCB-ve. Inspektimi i rregullt i rrjedhjes së pajisjeve. Identifikimi i vendeve të ndotura për të përzgjedhur dhe dhënë prioritet atyre që kërkojnë MQM. Etikëtimi me ngjyrë të verdhë i të gjithë pajisjeve dhe depozitave të ndotura që janë në pritje të procesit të mëtejshëm. Hartimi i strategjisë për pakësimin gradual të pajisjeve elektrike dhe materialeve të tjera që përmbajnë dhe/ose janë të ndotura me PCB. Hegja nga përdorimi sipas kërkesave teknike bazuar në MQM dhe rekomandimet e Konventës së Stokholmit e pajisjeve dhe mbetjeve me PCB. Transportimi dhe ruajtja e pajisjeve dhe mbetjeve me PCB në përputhje me MQM dhe rregulloret në fuqi. Ndërmarrja e gjithë masave të duhura për mbrojtjen nga difektet elektrikë që mund të përfundojnë me zjarr. Të bëhen të gjitha përpjekjet për të arritur një MQM të mbetjeve që përmbajnë PCB. Dhënie prioriteti maksimal menaxhimit të pajisjeve me nivel të lartë PCB. Zhvilimi i aktiviteteve ndërgjegjësuëse më të gjithë punonjësit pjesëmarrës në këtë projekt për përdorimin e pajisjeve mbrojtëse personale.
12 Kosto e vlerësuar	350 000 EURO
13 Donatorët kryesorë	GEF, GTZ, BE, Banka Botërore, BERZH, BEI, SAEFL (Agjencia Zvicerane për Mjedisin, Pyjet dhe Tokat)
14 Agjenci të tjera kontribuese	Qeveria Shqiptare, KESH, MM
15 Vendndodhja e Projektit	Në të gjithë objektet energjetike të prekura nga PCB-të.

Profil Projekti Nr. 6

1 Titulli i Projektit	Sistemi i plotë i kontrollit dhe monitorimit të PCB-ve
2 Agjencitë zbatuese	KESH/OST,
3 Agjencitë bashkëpunuese	MMPAU, METE, MM, Doganat,
4 Kohëzgjatja	12 muaj
5 Vend	Tiranë, Durrës
6 Prezantimi i Projektit	Në Shqipëri nuk ka një sistem për monitorimin e PCB-ve dhe mbetjeve të tyre. Kërkimet shkencore në fushën e PCB-ve në Republikën e Shqipërisë janë në fillimet e tyre për shkak të pamjaftueshmërisë së pajisjeve në laboratorë dhe mungesës së stafit të përgatitur. Megjithatë janë kryer pak studime të shkëputura mbi praninë e PCB-ve në mjedis dhe në shëndetin e njeriut.
7 Arsyeja e Projektit	Do të ndërmerren analiza të gjithanshme dhe sistematike për të dhënë një pamje të plotë mbi mjedisin dhe shëndetin e popullatës në të gjithë vendin. Krijimi i një rrjeti për bashkëpunim, shkëmbim i të dhënave dhe informacionit ndërmjet institucioneve shkencore të përfshirë në aktivitete kërkimore mbi PCB-të, hartimi i programit të monitorimit, identifikimi i përgjegjësive monitoruese dhe laboratorëve analitikë, zhvillimi i sistemit të informimit për procesin e monitorimit dhe dhënies së rezultateve, blerja e pajisjeve për marrjen e mostrave dhe analizën e PCB-ve dhe procesi i trajnimit të personave përgjegjës për monitorimin dhe analizimin e PCB-ve, sistemi i përparuar i sigurisë së cilësisë dhe i kontrollit të cilësisë në laboratorët shqiptarë do të jenë shumë të dobishme për hartimin dhe zbatimin e programit kombëtar të monitorimit të PCB-ve.
8 Justifikimi i Projektit	Sistemi i kontrollit dhe i monitorimit të PCB-ve do të sigurojë që në Shqipëri të mos hyjnë më materiale të pakontrolluara që mund të përmbajnë PCB si dhe të gjithë materialet dhe pajisjet që dyshohen të jenë të ndotur me PCB do të nxirren jashtë përdorimit dhe do të eliminohen sipas rregullave ndërkombëtare, për të siguruar shëndetin e popullsisë dhe mjedis të pastër. Shqipëria e ka të nevojshme ta ketë këtë sistem të kontrollit dhe monitorimit të PCB-ve sepse deri tani askush nuk e di nëse pajisjet tona dhe mjedisi janë të ndotur me PCB apo jo, duhet të ketë nën kontroll të gjitha pajisjet elektrike dhe vajrat që hyjnë në vend, për një kontroll të mirë të të gjitha lëvizjeve të pajisjeve dhe vajrave ndërmjet Objekteve të ndryshëm për të shmangur ndotjen e mëtejshme të tyre.
9 Qëllimi i Projektit dhe Objektivat	Qëllimi i këtij projekti është të hartojë dhe zbatojë sistemin e kontrollit dhe monitorimit të PCB-ve. Programi i monitorimit të PCB-ve konsiston në kontrollin sistematik të PCB-ve në materialet e lëngëta dhe pajisjet e ngurta për të gjitha pajisjet që hyjnë e dalin në çdo Objekt dhe në pikat doganore ku kryhet eksporti dhe importi i tyre.
	Të zbatohet një sistem i plotë i monitorimit të PCB-ve në Shqipëri: i materialeve me PCB që importohen dhe lëvizin ndërmjet çdo Objekti, pra në materialet e lëngëta dhe pajisjet e ngurta të ndotura me PCB me qëllim shmangien e përzierjes së vajrave të ndotur me vajrat e pandotur.
10 Përfituesit	Magazinat e KESH/OST, Reparti i Riparimit të Transformatorëve, Reparti i Trajtimit të Vajrave, Doganat e shtetit, të gjithë nënstacionet elektrike dhe Reparti i riciklimit të pjesëve metalike.

11 Aktivitetet	- Sistemi i kontrollit dhe monitorimit të PCB-ve do të kontrollojë të gjitha materialet e importuara të cilat mund të përmbajnë PCB: Vaj mineral për transformatorë Transformatorë "Vaji i përdorur" Kondensatorë
	- Kontrolli do të ushtrohet në të gjithë pajisjet elektrike dhe materialet që lëvizin nga njëri Objekt në tjetrin: Magazinave të KESH/OST, MM dhe doganave të shtetit Magazinave të KESH/OST dhe Repartit të Riparimit të Transformatorëve Repartit të Riparimit të Transformatorëve dhe Repartit të Trajtimit të Vajrave Gjithë nën-stacioneve elektrike dhe Repartit të Riparimit të Transformatorëve.
	- Kontrolli i dokumentacionit të transportimit të mbetjeve të rrezikshme ndërmjet: KESH/OST dhe Reparteve të Ruajtjes së Përkohshme KESH/OST dhe Repartit të Riparimit të Transformatorëve KESH/OST dhe Repartit të Trajtimit të Vajit KESH/OST dhe Repartit të Riciklimit të Pjesëve të Ngurta KESH/OST dhe Reparteve të Djegies Repartit të Riparimit të Transformatorëve dhe Repartit të Trajtimit të Vajit Objekteve dhe Reparteve të Ruajtjes së Përkohshme Reparteve të Ruajtjes së Përkohshme dhe Furrave të djegies
	Organizimi i një seminari trajnimi nga ana e një eksperti të fushës përkatëse për të shpjeguar mekanizmin e ndotjes me vaj dhe të ndotjes së materialeve porozë me vaj, mekanizmin e ndotjes së tërthortë, metodologjinë e përcaktimit të PCB-ve etj, me pjesëmarrjen e stafit të KESH/OST, NjAM, punonjësve të doganave, të Ministrisë së Mjedisit etj.
12 Kosto e vlerësuar	250 000 EURO
13 Donatorët kryesorë	GEF, GTZ, Bashkimi Europian, SAEFL, Banka Botërore, SECO
14 Agjenci të tjera kontribuese	Qeveria Shqiptare, KESH,MM
15 Vendndodhja e Projektit	Tiranë dhe Durrës

Profil Projekti Nr 7

1- Titulli i Projektit	Rregullorja për PCB-të
2- Agjencitë Zbatuese	KESH/OST
3- Agjencitë Bashkëpunuese	MMPAU, METE, MM
4- Kohëzgjatja	12 muaj
5- Vendi	Tiranë
6- Prezantimi i Projektit	Shqipëria është në proces hartimi të legjislacionit në lidhje me mbrojtjen e mjedisit. Legjislacioni mjedisor po plotësohet dhe përmirësohet në përputhje me direktivat e BE. Në të kaluarën, Shqipëria nuk ka pasur shumë mundësi për evidentimin e ndotjeve me PCB dhe ndikimin e tyre në mjedis dhe në njerëz si dhe nuk ka pasur sistem monitorimi të PCB-ve në vend. Aktualisht, nuk ka legjislacion specifik në lidhje me aktet dhe rregulloret drejtuar problemeve të PCB-ve (menaxhimin, ruajtjen, monitorimin, nxjerrjen jashtë përdorimit dhe eliminimin) dhe sistemin e monitorimit të tyre në vend. Vendimi KM Nr. 103, datë 31.3.2002 për "Monitorimin e mjedisit në Republikën e Shqipërisë" nuk përcakton detyrat që duhet të ketë KESH-i apo ndërmarrjet që varen prej tij, për monitorimin e PCB-ve në vajrat që përmblajnë pajisjet në objekte të ndryshme të KESH-it. Gjithashtu, nuk janë bërë inspektime në lidhje me këtë problem sepse legjislacioni përkatës nuk i mbulon aspektet mbi PCB dhe pajisjet e ndotura me PCB. Vendimi KM Nr. 103, datë 31.3.2002 për "Monitorimin e mjedisit në Republikën e Shqipërisë" nuk përcakton detyrat se cili nga institucionet duhet të monitorojë prezencën e PCB-ve në vajin e pajisjeve në objekte të ndryshme. Kërkesat mjedisore siç janë, kontrolli i ujit të ndotur dhe i mbetjeve të ngurta të ndotura me PCB, nuk ekzistojnë, nuk janë mbajtur regjistrime mbi prodhimin dhe menaxhimin e ndotjes. Për shkak të mungesës së legjislacionit dhe procedurave për administrimin mjedisor të PCB-ve, ndikimi dhe rreziku në shëndetin e njerëzve dhe mjedis do vazhdojë të jetë prezent. Gjithsesi, ekzistojnë masa të përgjithshme të cilat shërbejnë për menaxhimin e substancave kimike dhe mbetjeve të rrezikshme duke përfshirë dhe PCB-të. Gjenden instrumente ligjore të caktuara në dekrete Qeveritare, siç është ligji bazë për mjedisin me nr. 8934 "Ligji mbi mbrojtjen e mjedisit", Ligji Nr. 9263, datë 29.7.2004 për "Ratifikimin e Konventës së Stokholmit për Ndotësit Organikë të Qëndrueshëm", Ligji Nr. 9108, datë 17.7.2003 për "Substancat dhe Preparatet Kimike" i cili rregullon administrimin e substancave dhe preparateve kimike për të mbrojtur jetën e njerëzve dhe mjedisin nga rreziqet që mund të shkaktojnë këto lëndë të rrezikshme, Vendim i KM Nr. 824, datë 11.12.2003 për "Klasifikimin, ambalazhimin, etiketimin dhe ruajtjen e substancave dhe preparateve të rrezikshëm" i cili detyron palët të raportojnë për burimet e ndotjes dhe substancat kimike që janë objekt i Konventës. NjAM në KESH, mbështetur në Sistemin e Menaxhimit të Mjedisit (SMM) ka zhvilluar disa plan-veprime siç janë "Plan Veprimi për parandalimin e rrjedhjes së vajrave, kontrollin dhe masat zbutëse/eliminuese ndaj tyre në objektet e KESH-it", "Plan-Veprimi për menaxhimin e mbetjeve të rrezikshme", "Plan-Veprimi mbi përgatitjen për përballimin e situatave emergjente në objektet e KESH-it", dhe "Program për pajisjet mbrojtëse personale" për një menaxhim më të mirë të problemeve mjedisore në N/stacione, HEC-e dhe TEC, në përputhje me Politikat Mjedisore, me qëllim kontrollin dhe/ose zbutjen e ndikimeve në mjedis për shkak të rrjedhjeve të vajit, për të përmirësuar situatën mjedisore.
7- Arsyeja e Projektit	Për shkak të mungesës së legjislacionit në lidhje me menaxhimin e PCB-ve, si pasojë e nivelit të ulët të informimit dhe ndërgjegjësimit mbi PCB-të për të gjithë grupet e popullsisë, veçanërisht punonjësit e ekspozuar potencialisht ndaj PCB-ve në sektorin shtetëror dhe atë privat, kërkohet menjëherë të hartohet dhe të zbatohet Rregullore për PCB-të në përputhje me Konventën e Stokholmit, Bazelit dhe Roterdamit, gjithashtu dhe me legjislacionin Shqiptar. Ajo do të ketë ndikim pozitiv jo vetëm në ndërgjegjësimin e publikut për rrezikun e PCB-ve në shëndetin e tyre dhe në mjedis por gjithashtu në menaxhimin e PCB-ve dhe mbetjeve me PCB, në bashkëpunim me Objekte të ndryshme për menaxhimin e ruajtjes së të dhënave dhe raportimin përfundimtar, shkëmbimin e informacionit ndërmjet institucioneve

	të përfshira për analizën e PCB-ve, sistemin e monitorimit për kontrollin e PCB-ve, etj. Publiku më i ekspozuar potencialisht siç janë punëtorët dhe punonjësit që punojnë në Objekte energjetike, impiante dhe magazina që preken nga ndikimi i PCB-ve në shëndetin e tyre, duhet të mbrohen nga ligjet dhe instrumentet ligjore përkatëse siç është Rregullorja për menaxhimin e PCB-ve që çlirohen. Gjithashtu sipas strukturës së Rregullores do të përpunohen udhëzues përkatës dhe programe pune si dhe do të organizohen seminare për të rritur ndërgjegjësimin e punonjësve mbi rreziqet e PCB-ve.
8- Justifikimi i Projektit	Hartimi i Rregullores për PCB-të do të siguronte një dokument shumë të rëndësishëm për MQM për PCB, në përputhje me kërkesat sipas Konventës së Stokholmit. Kjo Rregullore do të jetë një mbështetje e mirë për përcaktimin e prioritetëve për menaxhimin e PCB-ve, në përgatitjen e udhëzuesve ndërkombëtar, procedurave të menaxhimit të mbetjeve ndërkombëtare të cilat do të siguronin udhëzime për ruajtjen, grumbullimin, transportin dhe eliminimin e mbetjeve, programe dhe plan-veprime që ndihmojnë në vendosjen e përgjegjësisë për menaxhimin e mbetjeve dhe përcaktimin e detyrave për regjistrimin e prodhimit të mbetjeve. Për shkak të mungesës së legjislacionit në lidhje me menaxhimin e PCB-ve dhe situatës së tanishme mjedisore, kërkohet menjëherë të hartohet dhe të zbatohet Rregullore për PCB në përputhje me Konventën e Stokholmit, Bazelit dhe Roterdamit, gjithashtu dhe me legjislacionin Shqiptar.
9- Qëllimet e Projektit	Të hartohet dhe të zbatohet Rregullore në lidhje me menaxhimin, ruajtjen, nxjerrjen nga përdorimi dhe eliminimin e vajit dhe mbetjeve të ndotura me PCB. Menaxhim të mirë nga pikëpamja mjedisore i PCB-ve deri në fund të jetës së transformatorëve.
10- Objektivat	Zbatimi i rregullores specifike për PCB-të. Sistemimi i pajisjeve dhe aksesoreve/pjesëve elektrike në përdorim dhe jashtë përdorimit që përmbajnë dhe/ose janë të ndotur me PCB për qëllim të MQM.
11- Përfutjesit	Punonjësit e KESH/OST, sektori privat dhe shtetëror që kanë lidhje me PCB-të, popullsia e prekur nga rreziku i PCB-ve.
12- Aktivitetet	Krijimi i një grupi pune ligjor dhe teknik duke përfshirë të gjithë sipërmarrësit e PCB-ve nga Ministria e Mjedisit, Ministria e Energjisë, Tregtisë dhe Ekonomisë, KESH/OST, Kompanitë private, Agjencitë Mjedisore & Zhvillim, OJQ. Studimi i legjislacionit ekzistues Shqiptar dhe Rregulloreve ndërkombëtare, UNEP-it dhe Konventës së Bazelit, legjislacionit të KE në lidhje me menaxhimin e PCB-ve për zhvillimin e Rregullores. Organizimi i takimeve në vend më qëllim marrjen në konsideratë të sugjerimeve që kanë punonjësit në lidhje me kushtet e tyre të punës.
13- Buxheti i vlerësuar	50 000 USD
14- Donatorët kryesorë	Banka Botërore, GTZ, SAEFL, Banka Europiane e Investimeve, SECO, GEF, BERZH, Qeveria Shqiptare, KESH
15- Vendndodhja e projektit	Nuk aplikohet

Profil Projekti Nr. 8

1- Titulli i Projektit	Inventari i hollësishëm i PCB-ve
2- Agjencitë Zbatuese	KESH/OST, MM
3- Agjencitë Bashkëpunuese	MMPAU, METE, shoqëritë private
4- Kohëzgjatja	24 muaj
5- Vendi	Tiranë
6- Prezantimi i Projektit	Në të kaluarën në Shqipëri, nuk janë bërë përpjekje për evidentimin e ndotjes nga PCB-të dhe ndikimin e tyre në mjedis dhe shëndetin e njerëzve. Inventari paraprak i PCB-ve, i cili ka filluar të hartohet në Qershor 2005, është përgatitur nga Njësia e Menaxhimit të Mjedisit në KESH (Korporata Elektroenergjitike Shqiptare - Kompania e vetme furnizuese energjetike në Shqipëri, e cila u shërben më shumë se 900.000 konsumatorëve të ndodhur në të gjithë territorin e vendit) dhe është fokusuar kryesisht në transformatorët dhe kondensatorët e objekteve të KESH/OST dhe Reparteve Ushtarak. Metoda e inventarit është mbështetur në udhëzuesit rekomandues ndërkombëtar dhe në informacionin më të mirë të vlefshëm në Shqipëri. Qëllimi kryesor i këtij inventari ishte identifikimi i të gjitha pajisjeve elektrike që mund të përmbajnë vaj me PCB ose vaj mineral të ndotur me PCB si dhe sasinë e mbetjeve me PCB, me qëllim plotësimin e kërkesave të Konventës së Stokholmit për përcaktimin e udhëzuesve ekzistues në vend dhe për vendosjen e përparësive për proceset e tjera. Për shkak të mungesës së informacionit dhe evidencave të vlefshme në vend, NjAM ka përgatitur dhe shpërndarë në të gjithë objektet e KESH/OST një pyetësor i cili kërkon të gjithë informacionin e nevojshëm rreth transformatorëve/pajisjeve që duhet të inventarizohen, siç janë viti dhe vendi i prodhimit, përmasat, pesha dhe kapaciteti, statusi, mirëmbajtja, gjendja mjedisore gjatë përdorimit, ndikimi në mjedis, të dhëna për vajin e pajisjes (pesha e vajit, emri në treg i vajit) etj. Inventari paraprak ka identifikuar kryesisht problemet që lidhen me PCB-të: PCB-të nuk janë prodhuar kurrë në Shqipëri. Vaji i transformatorëve është importuar gjithmonë nga shtete të tjera të Europës ose Azisë. Transformatori më i vjetër në KESH/OST është rus, prodhuar në vitin 1950. Në të kaluarën furnizuesit kryesorë të Shqipërisë me transformatorë kanë qenë BRSS dhe Kina. Transformatorët e prodhuar në BS janë të moshës rreth 50 vjet. Pjesa më e madhe e transformatorëve në Shqipëri janë kinezë, rusë, bullgarë, maqedonas dhe rumunë. Gjatë viteve të fundit janë importuar shumë transformatorë nga Italia, Kroacia, Zvicra dhe Belgjika. Deri tani, në dogana dhe në magazinën qendrore në Shkozë - Durrës nuk ka pasur kontroll në lidhje me sasinë e vajit dhe praninë e PCB-ve në të. Për arsye ekonomike, Shqipëria gjithashtu ka importuar transformatorë të përdorur (të dorës së dytë) që mund të kenë qenë të rimbushur ose janë rimbushur herë pas herë me vaj në Repartin e Riparimit, por për shkak të mungesës së informacionit, analizat dhe evidencat e mbajtura nuk janë të vlefshme. Në Objektet Energjetike janë në përdorim shumë transformatorë të vjetër të prodhuar para vitit 1970, të cilët kanë krijuar ndotje në mjedis veçanërisht në tokë dhe ujëra nëntokësorë për shkak të rrjedhjeve dhe pikimeve të vajit gjatë procesit të mirëmbajtjes ose për shkak të moshës së tyre të vjetër. Pjesa më e madhe e transformatorëve janë të vendosur direkt në tokë ose në mbështetëse statike, por jo në depozita dytësore poshtë transformatorëve. Mund të vihet re, lehtësisht në mënyrë vizuale, toka e ndotur poshtë transformatorëve, gjë që kërkon të zbatohen investigime për ndotjen si në tokë ashtu edhe në ujërat nëntokësorë. Mbështetur në të dhënat e siguruar nga pyetësori i inventarit paraprak i PCB-ve, numri i transformatorëve të vendosur në objektet energjetike është rreth 12 000 copë për të gjithë kapacitetet në përdorim dhe përmban një sasi të vajit mineral, rreth 8200 ton. Sasia e vajit në transformatorë shkon nga 70 kg deri në 102 ton. Pjesa më e madhe e tyre (rreth 98%) janë transformatorë të shpërndarjes, me kapacitet të ulët, të

	vendosur në kabina të vogla elektrike dhe janë përdorur për furnizimin e konsumatorëve familjarë. Rreth 50% e sasisë së përgjithshme të transformatorëve janë prodhuar para vitit 1990 (rreth 6.000 copë) dhe gjatë inspektimeve është vënë re se vjetërsia mesatare e transformatorëve me vitin e prodhimit është shumë e vjetër 28 vjet. Përqindja e transformatorëve mbi moshë (>30 vjet) është rreth 45 %. Një pjesë e transformatorëve e kanë WR >30% dhe nga testimi i tyre nuk kanë rezultuar me densitet pozitiv: këta transformatorë mund të konsiderohen si të rimbushur dhe të dyshuar me PCB. Inventari paraprak i PCB-ve nxori në pah mos ekzistencën e standardeve (limiteve) dhe metodave për analizat e PCB-ve, nivel të ulët të informimit dhe të ndërgjegjësimit mbi PCB-të në të gjithë grupet e popullsisë, mungesë të informimit dhe ndërgjegjësimit të popullsisë në përgjithësi mbi rrezikun potencial të PCB-ve (e vajit të transformatorëve), nivel të kufizuar të ndërgjegjësimit të punonjësve në menaxhimin e përgjegjësive si në sektorin publik dhe atë privat, ndërgjegjësimin e ulët të punonjësve të ekspozuar potencialisht ndaj PCB-ve, mungesën e monitorimit të ndotjeve me PCB në variante të ndryshme si dhe në ajër, tokë dhe ujëra tokësorë e nëntokësorë të ndotur me vaj me PCB. Për shkak të mungesës së reagentëve, procedurave analitike të përmirësuara në vend dhe mungesës së stafit të duhur të trajnuar, analizat e PCB-ve në Shqipëri nuk janë të vlefshme, ato bëhen duke përdorur Test-Kite të prodhuar nga Kompania Deksil për testimin e vajit të transformatorëve. Për shkak të numrit të kufizuar të mostrave për testimin e vajit, rezultatet nuk mund të përgjithësohen në nivel kombëtar. Gjithsesi, Inventari paraprak i PCB-ve paraqet : Sasi të vogël të transformatorëve me vaj PCB, Pjesa më e madhe e tyre janë transformatorë me vaj mineral, Rreth 5,3 % e të gjithë transformatorëve të testuar dhe 8 % e transformatorëve të shpërndarjes janë të ndotur me PCB (PCB > 50 ppm), Numri i transformatorëve të ndotur mund të jetë rreth 320, Të dhënat statistikore janë mbështetur në testimin e transformatorëve (janë inspektuar rreth 57 objekte energjetike dhe janë testuar rreth 169
7- Arsyeja e Projektit	Procedura e inventarit të PCB-ve realizohet në përputhje me metodikën e inventarit paraprak. Inventari i PCB-ve është një metodë e domosdoshme për të rritur kujdesin mbi shëndetin dhe cilësinë e mjedisit në zonat ku administrohen në veçanti transformatorë dhe kondensatorë në të gjithë territorin e vendit. Inventari i PCB-ve është një metodë që nxit dhe pranon përpjekjet e sipërmarrësit për të ulur dhe eliminuar përdorimin e transformatorëve me PCB nga inventarët dhe burimet e tjera, si dhe si mjet për ndjekjen e zhvillimeve të shëndetshme dhe mjedisore, zhvillon bazën për vendim-marrjet e mëtejshme dhe bashkëpunimet ndërmjet Ministrisë, organizatave përkatëse, punonjësve dhe sipërmarrësve.
8- Justifikimi i Projektit	Përputhje me detyrimet e Konventës së Stokholmit në lidhje me inventarin. Sigurim të MQM mbi PCB-të nëpërmjet plotësimit të projektit duke siguruar shtrirje të gjerë kombëtare mjedisore dhe teknike. PCB-të janë subjekt i tri konventave ndërkombëtare që lidhen me trajtimin e mbetjeve të rrezikshme dhe konkretisht: Konventën e Bazelit, Roterdamit dhe të Stokholmit. Këto konventa i trajtojnë problemet e PCB-ve duke iu referuar prodhimit, deklarimit, përdorimit, importimit, eksportimit, ruajtjes, transportit, monitorimit, nxjerrjes jashtë përdorimit dhe eliminimit të tyre. Projekti do të përqendrohet në disa aspekte të Inventarit Përfundimtar të PVB-ve. Ky projekt do të saktësojë gjithashtu të dhënat dhe do të plotësojë informacionin mbi gjendjen e situatës së PCB-ve në Shqipëri, duke siguruar informacion të saktë për një periudhë kohe të gjatë të menaxhimit të MQM për pajisjet dhe mbetjet me PCB.

9- Qëllimet e Projektit	Plotësimi i informacionit mbi gjendjen e situatës së PCB-ve në Shqipëri Sigurimi i një baze të fortë për MQM e PCB-ve dhe mbetjeve me PCB.
10- Objektivat	Vlerësimi i sasisë së PCB-ve në Shqipëri Identifikimi i përdoruesve të PCB-ve Identifikimi i të gjithë transformatorëve me PCB të cilët janë në përdorim dhe/ose jashtë përdorimit, për të zbatuar metodat paraprake të instalimit të PCB-ve që përdoren (ruajtja gjatë përdorimit, nxjerrja nga përdorimi dhe eliminimi), për të siguruar monitorim në përputhje me teknikën e instalimeve të PCB-ve që përdoren dhe për të siguruar ecurinë e të gjithë instalimeve të PCB-ve deri në fund të jetës së tyre. Të dhëna teknike në lidhje me pajisjet dhe materialet me PCB Probleme të MQM në lidhje me PCB-të.
11- Përfituesit	Sipërmarrësit energjetikë, industria private dhe shtetërore si dhe sektorët e shërbimit.
12- Aktivitetet	Studim i raportit të inventarit paraprak dhe krijimi i grupit për përgatitjen e inventarit. Grupi do të jetë përgjegjës për: Hedhjen e të dhënave ekzistuese në bazën të dhënave Zgjedhjen e sasisë së mostrave Trajnimin e njerëzve që kërkohen për të përgatitur inventarin. Identifikimi i mjeteve dhe pajisjeve ndihmëse për inventarin dhe zhvillimi i një plan inventari. Grupi do të jetë përgjegjës për: Formulimin e Inventarit Të dhënat në bazën e të dhënave Përgatitjen e pajisjeve për inventar (GPS, pajisjet për marrje mostre, pajisjet mbrojtëse) Përgatitja dhe zhvillimi i bazës kombëtare të të dhënave dhe informacioni për pajisjet dhe mjetet elektrike në përdorim që përmbajnë dhe/ose janë të ndotura me PCB. Grupi do të jetë përgjegjës për: Hedhjen e të dhënave në bazën e të dhënave Evidentimin e problemeve në raportin teknik dhe dërgimin e raportit tek autoritetet, mos-dëmtimin e etiketave për ndotjet me PCB Organizimin e seminareve me sipërmarrësit e energjisë. Realizimi i Inventarit përfundimtar (duke përfshirë realizimin e inventarit, inspektimin në vend, marrjen e mostrës, testimin, klasifikimin, etiketimin, regjistrimin, dërgimin në laborator për analiza, bazën e të dhënave dhe raportin teknik, etj.) i vajit, pajisjeve elektrike dhe mbetjeve që përmbajnë dhe/ose janë të ndotura me PCB. Grupi do të jetë përgjegjës për: Realizimin e inspektimit në terren Mbledhjen e të dhënave Plotësimin e formës së inventarit Marrjen e mostrës Testimin në vend (testi i densitetit, test-kite) Etiketimin dhe regjistrimin Analizën me GC Raportin teknik
13- Buxheti i vlerësuar	250,000 EURO
14- Donatorët kryesorë	Bashkimi Europian, Banka Botërore, GTZ, SAEFL, Banka Europiane e Investimeve, SECO, GEF, BERZH, Qeveria Shqiptare.
15- Vendndodhja e projektit	Tirane. KESH/Njësia e Administrimit

Profil Projekti Nr 9

1- Titulli i Projektit	Eliminimi i vajit mineral të ndotur me PCB
2- Agjencitë Zbatuese	KESH/OST, MM
3- Agjencitë Bashkëpunuese	MMPAU, METE, shoqëritë Private
4- Kohëzgjatja	18 muaj
5- Vendi	Tiranë
6- Prezantimi i Projektit	Në të kaluarën në Shqipëri, nuk janë bërë përpjekje për evidentimin e ndotjes nga PCB-të dhe ndikimin e tyre në mjedis dhe shëndetin e njerëzve. Deri tani nuk ka legjislacion specifik në lidhje me menaxhimin e PCB-ve, nuk janë mbajtur evidenca mbi prodhimin dhe menaxhimin e mbetjeve, nuk ka plan për menaxhimin e mbetjeve me PCB, nuk ka procedura kombëtare për menaxhimin e mbetjeve që mund të jepnin udhëzime për ruajtjen e tyre, përcaktimin e përgjegjësive për menaxhimin e ndotjeve dhe vendosjen e detyrave për regjistrimin e prodhimit të ndotjeve të krijuara. Niveli i ndërgjegjësimit të punonjësve në objektet energjetikë mbi njohuritë për ndikimin e PCB-ve është i ulët. Deri tani të gjitha mbetjet janë shkarkuar në tokë ose në lumë pa asnjë trajtim, duke krijuar ndotje në mjedis veçanërisht në tokë, ujëra sipërfaqësore dhe nëntokësore duke ndikuar në shëndetin e njerëzve, kafshëve dhe mjedisin përreth. Në Shqipëri, nuk ka akoma një vend të vlefshëm për grumbullimin e përkohshëm të mbetjeve. Gjithashtu nuk ekziston një Impiant për trajtimin e mbetjeve. Në Objektet Energjetike janë në përdorim shumë transformatorë të vjetër të prodhuar përpara 1970 që kanë krijuar ndotje në mjedis veçanërisht në tokë dhe ujëra nëntokësore për shkak të rrjedhjeve dhe pikimeve të vajit gjatë procesit të mirëmbajtjes ose për shkak të moshës së tyre të vjetër. Pjesa më e madhe e transformatorëve janë të vendosur direkt në tokë ose në mbështetëse statike, por jo në depozita sekondare poshtë transformatorëve, mund të vihet re, lehtësisht në mënyrë vizuale toka e ndotur poshtë transformatorëve, gjë që kërkon të zbatohen investigime për ndotjen si në tokë ashtu edhe në ujërat nëntokësore dhe për një menaxhim të sigurt. Shqipëria ka një repart grumbullimi për vajin e transformatorëve. Në përgjithësi, si praktikë pune, vaji lubrifikant i përdorur nuk hidhet por shitet për qëllime të tjera përfshirë përdorimin si lëndë djegëse dytësore ose rafinim për përdorime lokale. Në Shqipëri nuk është projektuar akoma një impiant për eliminimin e ndotjeve me PCB. Si përfundim themi se nuk ekziston një vend i përshtatshëm për grumbullimin dhe eliminimin e lëngjeve dielektrikë dhe mbetjeve me PCB.
7- Arsyeja e Projektit	Informacion i përshtatshëm dhe të dhëna për vajin mineral të ndotur me PCB dhe për mbetjet me PCB. MQM i procesit të eliminimit të mbeturinave me PCB. Strategji për trajtimin dhe eliminimin e mbetjeve me PCB.
8- Justifikimi i Projektit	Projekti do të ndërmarrë vlerësimin në lidhje me të dhënat e mbledhura dhe këshillimet me palët e tjera përkatëse mbi përmirësimin e administrimit të vajit mineral të ndotur me PCB, të mbeturinave me PCB dhe të impianteve të eliminimit. Mundësi kontrolli për përmirësimin e vendeve të grumbullimit dhe instalimit të impianteve për MQM. Produkti përfundimtar është strategjia e hollësishme për eliminimin e vajit mineral të ndotur me PCB dhe të mbetjeve me PCB. Konceptet e MQM do të aplikohen gjatë kohës së zbatimit të këtij projekti.
9- Qëllimet e Projektit	Menaxhim i mirë nga pikëpamja mjedisore për procesin e eliminimit të vajit mineral të ndotur me PCB dhe të mbetjeve me PCB. Aspekti ekonomik i menaxhimit të PCB-ve.
10- Objektivat	Zhvillimi i strategjisë për trajtimin dhe eliminimin e vajit mineral të ndotur me PCB dhe mbetjeve me PCB. Zhvillimi i MQM për procesin e eliminimit të PCB-ve.
11- Përfituesit	Sipërmarrësit energjetikë, sektori privat dhe ai publik, popullsia e prekur nga prania e PCB-ve.

12- Aktivitetet	Zhvillimi i strategjisë për eliminimin e vajit mineral të ndotur me PCB dhe mbetjeve me PCB në përputhje me kërkesat e MQM Kryerja e vlerësimit (tani dhe në të ardhmen) për mundësitë e: Ndërtimit të impiantit të eliminimit në vend ose Transportin e mbetjeve me PCB në impiant të eliminimit jashtë vendit. Për këtë: Duhet krijuar grupe pune për hartimin e strategjisë për trajtimin dhe eliminimin e mbetjeve me PCB. Duhet trajnuar specialistët dhe punëtorët për MQM e vajit mineral të ndotur me PCB dhe mbetjet me PCB veçanërisht në procesin e eliminimit sipas MQM. Duhet marrë masa për të siguruar informacionin dhe të dhënat e nevojshme mbi vajin mineral të ndotur me PCB dhe mbetjet me PCB. Duhet identifikuar vendet për grumbullimin e përkohshëm dhe repartet për ruajtjen e vajit mineral të ndotur me PCB dhe mbetjeve me PCB sipas MQM. Duhet organizuar mekanizma financiarë për të vlerësuar koston e projektit, etj.
13- Buxheti i vlerësuar	150 000 EURO
14- Donatorët kryesorë	Bashkimi Europian, Banka Botërore, GTZ, SAEFL, Banka Europiane e Investimeve, SECO, GEF, BERZH, Qeveria Shqiptare, KFW.
15- Vendndodhja e projektit	Tiranë

Profil Projekti Nr. 10

1- Titulli i Projektit	Ndërgjegjësimi për problemet lidhur me PCB-të
2- Agjencitë Zbatuese	MMPAU
3- Agjencitë Bashkëpunuese	KESH/OST, MM, Mas-Media, OJF-Ekolëvizja
4- Kohëzgjatja	18 muaj
5- Vendi	Shqipëria
6- Prezantimi i Projektit	Publiku i prekur nuk ka njohuri/ndërgjegjësim mbi problemet që lidhen me ndikimin e PCB-ve në shëndetin e njerëzve dhe mjedis. Kjo për arsye se Shqipëria nuk ka ekspertizë mbi PCB-të dhe rrezikshmërinë që lidhet me to. Në të njëjtën kohë, Shqipëria ka gjithashtu mungesë të ligjeve dhe udhëzuesve për menaxhimin e PCB-ve. Punonjësit dhe punëtorët e ekspozuar të cilët punojnë në reparte, magazinën e transformatorëve dhe objektet energjetike janë të pandërgjegjshëm mbi rrezikun e PCB-ve. Mungesa e ndërgjegjësimit për publikun e prekur në lidhje me rrezikun e PCB-ve është tepër e rrezikshme. Autoriteti kompetent shqiptar ka gjithashtu mungesë të mundësive për mirëmbajtjen dhe menaxhimin e transformatorëve në përdorim (në rast pikimesh, rrjedhjesh). Stafi teknik si dhe punëtorët punojnë në kushte të vështira për shkak të mungesës së pajisjeve mbrojtëse personale dhe nuk janë të ndërgjegjësuar për rrezikun që shkaktohet nga PCB-të. Në përgjithësi, publiku i ekspozuar nuk ka pasur njohuri mbi këto çështje. Nuk është përhapur as edhe një informacion i kufizuar për ndërgjegjësimin e publikut. Mungesa e përmirësimit të komunikimit me shoqërinë nëpërmjet krijimit të një strukture komunikimi lidhet me mungesën mbi njohuritë dhe metodat e komunikimit në stafin qendror dhe publikut lokal, autoritetet, agjencitë mjedisore dhe të mbrojtjes së mjedisit, OJQ, shoqëritë publike, institutet kërkimore, universitetet.
7- Arsyeja e Projektit	Do të përgatitet manuali mbi problemet e rrezikut të PCB-ve dhe sigurinë e personelit. Do të sigurohet dhe forcohet kapaciteti i punonjësve elektrik puna e të cilëve mund të shoqërohet me problemet e PCB-ve. Sigurohen dhe përhapen gjerësisht njohuritë mbi informacionin ndaj rrezikut të PCB-ve. Janë marrë në konsideratë mbrojtja personale dhe siguria e mjedisit nga ndikimi i PCB-ve. Është siguruar dhe forcuar kapaciteti i laboratorit për analizën e PCB-ve. Do të rritet në nivel më të lartë menaxhimi në lidhje me përgatitjen e rregullores për PCB-të, rregullores për mbrojtjen e shëndetit, programe trajnimi për rrezikun e PCB-ve dhe rritjen e ndërgjegjësimit sipas udhëzuesve për përdorimin e sigurt të PCB-ve si nga sektorët shtetëror dhe ata privat.
8- Justifikimi i Projektit	Ky projekt synon të jetë në përputhje me detyrimin e konventës së Stokholmit me qëllim mbrojtjen e shëndetit të publikut dhe mjedisit nga ndikimi i PCB-ve. Një qëllim tjetër i këtij projekti është rritja e ndërgjegjësimit për PCB-të dhe paraqitja e veprimit për ndalimin e rritjes së ndikimit të tyre nëpërmjet hartuesve të politikave në qeveri. Vendimet janë në fund të fundit një përgjegjësi politike, por mundësia e realizimit të zgjedhjes më të mirë të gjetur është kur përhapen gjerësisht njohuritë mbi problemet e PCB-ve. Kjo është kërkesa e përgjithshme për ndërgjegjësimin ndaj tyre të sipërmarrësve. Duhet të sigurohet edukimi mbi ndërgjegjësimin e problemit të PCB-ve për publikun, punëtorët dhe menaxherët profesionist. Zgjerimi i mjeteve të komunikimit mund të përfshijë të gjithë teknikat e komunikimit duke filluar me prezantimin dhe mesazhet në mjetet masive të komunikimit, takimet e përgjithshme me komunitetet, dialogët bashkëveprues, mikro-seminaret ndërmjet kolegëve të të njëjtit profesion dhe atyre të ndryshëm dhe duke përfunduar me përgatitjen dhe prezantimin e informacionit në kanalet ekzistuese të komunikimit për secilin komunitet

	siç janë takimet profesionale, objektet kulturore, radio lokale, mbledhje me grupet e interesuara dhe të tjera aktivitete dhe media të miratuara. Ndërgjegjësimi për të gjithë organizatat (OJQ), Dhomën e Tregtisë dhe Industrisë, sindikatat, TV, radio, universitetet, gazetatat, kompanitë private mjedisore do të ndihmojnë për ndërgjegjësimin e të gjithë publikut të prekur në lidhje me rrezikshmërinë e substancave PCB që ndikojnë në shëndetin e njerëzve, kafshëve dhe në mjedis.
9- Qëllimet e Projektit	Të rrisë ndërgjegjësimin e publikut veçanërisht të punonjësve që preken direkt nga rreziku i PCB-ve nëpërmjet zbatimit të veprimtarive në përputhje me Konventën e Stokholmit.
10- Objektivat	Përmirësimin e problemeve të PCB-ve që ndikojnë në njerëz dhe mjedis për të gjithë sipërmarrësit energjetikë.
11- Përfituesit	Sipërmarrësit energjetikë, sektori publik dhe privat.
12- Aktivitetet	Identifikimi i fushave të informimit dhe ndërgjegjësimin për të siguruar sipërmarrësit përfshin: Burimet kryesore të PCB-ve Rregullore në lidhje me eliminimin e përdorimit të PCB-ve Metodologjia e vlerësimit të rrezikut Shëndeti dhe siguria Masat paraprake që kërkohen kur pajisjet që përmbajnë PCB priten Masat paraprake që nevojiten për larjen e pajisjeve për të larguar PCB-të Ruajtja e lëngjeve dhe e pajisjeve të ndotura me PCB Vaji i ndotur me PCB Identifikimi i llojit të ftohjes Densiteti i lëngut në transformatorë Masat paraprake për shëndetin Mirëmbajtja e transformatorëve me PCB Përcaktimi i mënyrës së ekzekutimit Testet elektrike Testet kimike Riklasifikimi i transformatorëve Rimbushja e transformatorëve Lista kontrolluese për vendimin e rimbushjes Karakteristikat e kërkuara për zëvendësimin e vajrave me PCB Masat kontrolluese për rimbushje Veprimi që duhet të merret në rast aksidenti të shkaktuar nga defekti elektrik ose zjarri Raste toksikologjike nga PCB-të Boshatisja e transformatorëve me PCB Pajisjet mbrojtëse personale Pikimet nga transformatorët Masat parandaluese që duhet të merren në rast rrezik ndotje Masat që duhet të merren në rast aksidenti «të papritur» Masat që duhet të merren në rast evitimi të aksidentit «të pritshëm» Ventilimi Pajisjet mbrojtëse frymëmarrëse Monitorimi i mjedisit Emergjencat nga pikimet e rrjedhjet dhe pajisjet mbrojtëse (në depozitat e ruajtjes) Trajtim teknik për ruajtjen dhe çmontimin e pajisjeve që përmbajnë PCB Zhvillimi i materialeve mbi problemet dhe reklamimin e PCB-ve Organizimi i seminareve për të gjithë sipërmarrësit. Organizimi i trajnimeve mbi menaxhimin e PCB-ve në lidhje me problemet në nivel kombëtar dhe lokal.

	Media vepruese për informim & ndërgjegjësim.
13- Buxheti i vlerësuar	150,000 EURO
14- Donatorët kryesorë	Bashkimi European, Banka Botërore, GTZ, SAEFL, Banka Europiane e Investimeve, SECO, GEF, BERZH, Qeveria Shqiptare, KESH, MMPAU, METE
15- Vendndodhja e projektit	Tirane

Profil Projekti Nr. 11

1- Titulli i Projektit	Analiza social-ekonomike mbi PCB-të
2- Agjencitë Zbatuese	MMPAU
3- Agjencitë Bashkëpunuese	KESH/OST, METE, MM.
4- Kohëzgjatja	24 muaj
5- Vendi	Tiranë
6- Prezantimi i Projektit	Shqipëria përballët me shumë probleme në lidhje me menaxhimin dhe detyrimet ekonomike për ruajtjen e transformatorëve mbi moshë që janë akoma në përdorim pa mirëmbajtjen e duhur dhe me rrezik të madh për mjedisin. Projekti kërkon të zhvillojë vlerësime afatgjate bashkëvepruese mbi aspektin social-ekonomik në Shqipëri nëpërmjet paraqitjes së të dhënave të duhura të mbledhura dhe të shkëmbyera, zhvillimin dhe zbatimin e teknikave të duhura vlerësuese. Në të kaluarën në Shqipëri, nuk janë bërë përpjekje për evidentimin e ndotjes nga PCB-të dhe ndikimin e tyre në mjedis dhe shëndetin e njerëzve. Nuk janë mbajtur evidenca mbi prodhimin dhe menaxhimin e mbetjeve, nuk ka pasur procedura për menaxhimin e mbetjeve që të paraqisnin udhëzime për ruajtjen e tyre, përcaktimin e përgjegjësive për menaxhimin e ndotjeve dhe vendosjen e detyrave për regjistrimin e prodhimit të ndotjeve të krijuara. Niveli i ndërgjegjësimit të punonjësve në objektet energjetike mbi njohuritë për ndikimin e PCB-ve është mjaft i ulët. Deri tani të gjitha mbetjet janë shkarkuar në tokë ose në lumë pa ndonjë trajtim, duke krijuar ndotje mjedisore në tokë, ujëra sipërfaqësore dhe nëntokësore që ndikojnë në shëndetin e njerëzve, kafshë dhe mjedisin përreth. Në Shqipëri nuk ka ndonjë vend grumbullimi të përkohshëm për mbetjet apo impiant për eliminimin e tyre. Në Objektet Energjetike janë në përdorim shumë transformatorë të vjetër të prodhuar para vitit 1970, të cilët kanë krijuar ndotje në mjedis veçanërisht në tokë dhe ujëra nëntokësore për shkak të rrjedhjeve dhe pikimeve të vajit gjatë procesit të mirëmbajtjes ose për shkak të moshës së tyre të vjetër. Pjesa më e madhe e transformatorëve janë të vendosur direkt në tokë ose në mbështetëse statike, por jo në depozita sekondare poshtë transformatorëve. Rreth 50% e sasisë së përgjithshme të transformatorëve janë prodhuar para vitit 1990 (rreth 6.000 copë) dhe gjatë inspektimeve është vënë re se mosha mesatare e transformatorëve është shumë e vjetër 28 vjet. Ky projekt-vlerësimi do të zbatohet kryesisht duke u mbështetur në eksperiencën e viteve të fundit të marrë gjatë MQM për pajisjet në përdorim, në veçanti gjatë përgatitjes së raport-inventarit për PCB-të dhe nxjerrjes së përfundimeve kryesore. Do të zgjidhet metoda e vlerësimit socio-ekonomik të PCB-ve për të harmonizuar mënyrat më të efektshme me informacionin dhe njohuritë relativisht të pamjaftueshme të vlefshme për sipërmarrësit e veçantë në Shqipëri.
7- Arsyeja e Projektit	Identifikimi i rregullt i elementëve kryesorë për rrezikun e PCB-ve, duke u dhënë rëndësi problemeve potenciale në lidhje me kategoritë që ka Shqipëria, rëndësinë e përdorimit të PCB-ve, menaxhimin social-ekonomik si një të tërë dhe sigurimin e informacionit bazë për MQM e PCB-ve deri në fund të jetës së transformatorëve.
8- Justifikimi i Projektit	Vlerësimi social-ekonomik për PCB-te është një element i rëndësishëm për hartuesit e vendimeve. Ai i ndihmon ata për të vlerësuar koston sociale dhe ekonomike dhe përfitimin nga ruajtja e transformatorëve mbi moshë që janë në përdorim dhe jashtë pune në Shqipëri. Ky projekt vlerësimi mund të përmirësojë situatën e pajisjeve me PCB për përfitimet social dhe ekonomike të MQM. Projekti do të vlerësojë mundësitë e menaxhimit të PCB-ve sipas analizës së kostos/përfitimit social-ekonomik më qëllim për të siguruar që zbatimi i Konventës së Stokholm-it në Shqipëri të realizohet në mënyrë sociale dhe ekonomike.
9- Qëllimet e Projektit	Menaxhimi i mirë nga pikëpamja mjedisore e PCB-ve deri në fund të jetës së transformatorëve

	Aspekti ekonomik për menaxhimin e PCB-ve
10- Objektivat	Krijimi i mjeteve vendim-marrëse për vlerësimin social-ekonomik të përdorimit të pajisjeve me PCB në lidhje me ciklin e jetës.
11- Përfituesit	Sipërmarrësit energjetik Sektori industrial, sektori privat dhe ai shtetëror.
12- Aktivitetet	Faza 1: Faza pilot e vlerësimit Formimi i një grupi pune nga sipërmarrësit Plani i projektit pilot për vlerësimin e rrezikut Vlerësimi i vendit Problemet e vlerësimit të rrezikut Konkluzioni i seminarit me sipërmarrësit (problemet ligjore, problemet teknike, problemet financiare: mekanizmat financiar) Faza 2: Vlerësimi i plotë Formimi i një grupi pune të sipërmarrësve Zhvillimi i planit për vlerësimin e plotë të rrezikut Përcaktimi për vlerësimin e plotë të vendit Identifikimi i problemeve për vlerësimin e plotë të rrezikut Organizimi i seminareve kombëtarë përfundimtarë me sipërmarrësit (problemet ligjore, problemet teknike, problemet financiare)
13- Buxheti i vlerësuar	200,000 EURO
14- Donatorët kryesorë	Bashkimi Europian, Banka Botërore, GTZ, SAEFL, Banka Europiane e Investimeve, SECO, GEF, BERZH, Qeveria Shqiptare, KESH, MMPAU, METE.
15- Vendndodhja e projektit	Instituti i Mjedisit, Tirane

Profili projekti Nr. 12

1. Titulli i Projektit	Ndarja dhe minimizimi i mbetjeve në Qendrën Spitalore Universitare (QSU) "Nënë Tereza" dhe optimizimi i operacioneve në inceneratorin e vetëm ekzistues në funksionim.
2. Agjencia Implementuese	Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza"
3. Agjenci bashkëvepruese	Ministria e Shëndetësisë – Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave
4. Periudha e zbatimit	2008-2009
5. Vendndodhja	Tiranë
6. Përshkrim i shkurtër	Për pjekjet për menaxhimin e mbetjeve spitalore tashmë kanë filluar në Shqipëri. Udhëzimet e para për këtë kanë dalë dhe ndarja e mbetjeve ka filluar të aplikohet në disa spitale pilot. Këto eksperiencia do të zhvillohen më tepër dhe do të bëhen realitet në QSU "Nënë Tereza", qendra spitalore më e madhe e të gjithë vendit. Në këtë qendër spitalore universitare është në funksionim i vetmi incenerator për mbetjet spitalore. Kushtet e shfrytëzimit dhe sasia e mbetjeve nuk janë optimale për minimizimin e shkarkimeve të dioksinave.
7. Qëllimi i Projektit	Projekti synon minimizimin e shkarkimeve të dioksinave nga mbetjet spitalore duke reduktuar tipin dhe sasinë mbetjeve të djegura. Veç kësaj inceneratori ekzistues do të përmirësohet teknikisht dhe do të optimizojë funksionimin e tij. Kushtet optimale të shfrytëzimit do të arrihen nëpërmjet futjes së një procedure sistematike për vënien në punë, ngarkimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen. Kjo ka të bëjë me futjen në përdorim të Praktikave më të Mira Mjedisore (PMM) ashtu siç kërkohet nga Konventa e Stokholmit për menaxhimin e mbetjeve spitalore. Personeli i QSU "Nënë Tereza" është i kualifikuar mirë për punën që kryen. Pra, spitali është ideal për zbatimin e skemës së përmirësuar të menaxhimit të mbetjeve përpara se të shtrihet në të gjithë vendin. Veç kësaj rajoni i Tiranës ka një sistem të grumbullimit të mbetjeve urbane që funksionon mirë (ndonëse depozitimi përfundimtar duhet përmirësuar) duke na dhënë një tjetër rrugë të mundshme për depozitim për mbetjet duke mos aplikuar djegjen.
8. Justifikimi i Projektit	Minimumi i pranueshëm shëndetësor i shkarkimeve të dioksinës nga depozitimi i mbetjeve është 14 g I-TEQ/a ose afërsisht 24% e totalit të emisioneve me origjinë nga djegiet në incenerator. 90 % e mbetjeve spitalore janë pjesë e zakonshme e mbetjeve urbane të ngurta, të cilat nuk duhet të digjen dukë bërë kështu të mundur që të kemi shkarkime të NOQ në mjedis. Ndarja dhe minimizimi i mbetjeve do të ulë më tej sasinë e mbetjeve spitalore që shkojnë për depozitim përfundimtar. Për më tepër disa nga mbetjet mund të ripërdoren ose riciklohen.
9. Qëllimi i Projektit dhe Objektivat	Të ulë shkarkimet e dioksinave dhe të furaneve nga mbetjet.
10. Përfutuesit	Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Ministria e Shëndetësisë
11. Aktivitetet e parashikuara	Studimi i Skemës aktuale të menaxhimit të mbetjeve spitalore dhe funksionimi i inceneratorit. Hartimi i një skeme të përshtatshme të ndarjes dhe minimizimit të mbetjeve për çdo pavijon dhe godinë spitalore. Optimizimi i shfrytëzimit të inceneratorit dhe hartimi i një manuali për shfrytëzimin e tij. Zbatimi i skemës së ndarjes dhe minimizimit të mbetjeve në Qendrën Spitalore Universitare "Nënë Tereza". Trajnimi i operatorëve dhe teknikëve të inceneratorit dhe vendosja në praktikë e procedurave të reja të përdorimit dhe shfrytëzimit të inceneratorit.
12. Kostoja e vlerësuar	55 000 US\$
13. Donatorë të mundshëm	Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Ministria e Shëndetësisë,
14. Agjenci të tjera kontribuese	MMPAU, Donatore të huaj
15. Harta e vendosjes së projektit	Tiranë

Profili projekti Nr. 13

1. Titulli i projektit	Përmirësimi i inceneratorit të Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”
2. Agjencia Implementuese	Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”
3. Agjenci bashkëvepruese	Ministria e Shëndetësisë – Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave.
4. Periudha e zbatimit	2008-2009
5. Vendndodhja	Tiranë
6. Përshkrimi i shkurtër	Në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza” operon i vetmi incenerator për djegjen e mbetjeve spitalore. Megjithatë kushtet e shfrytëzimit të inceneratorit nuk janë të përshtatshme për minimizimin e shkarkimit të dioksinave në mjedis. Inceneratori nuk ka të instaluar sistem të kontrollit të ndotjes së ajrit (SKNA) në oxhakun e shkarkimit të gazrave në atmosferë. Kështu që inceneratori nuk mund të quhet se operon me TMM siç parashikohet në Konventën e Stokholmit dhe shkarkimet në atmosferë të dioksinave janë relativisht më të larta në krahasim me inceneratorët modern të djegies së mbeturinave spitalore.
7. Qëllimi i projektit	Projekti synon të minimizojë shkarkimet në atmosferë të dioksinave nga djegia e mbetjeve spitalore në QSU “Nënë Tereza”, nëpërmjet përmirësimit të mënyrës së shfrytëzimit të inceneratorit të kësaj qendre spitalore, gjë e cila përputhet edhe me përcaktimet e bëra në Konventën e Stokholmit për Teknikat më të Mira të Mundshme (TMM). Nëpërmjet përmirësimit që do t'i bëhet shfrytëzimit të inceneratorit, faktori i shkarkimeve në ajër mund të ulet nga 40,000 µg TEQ/t në 5,25 µg TEQ/t duke bërë një ulje gati 90%.
8. Justifikimi i projektit	Shumë nga të dhënat zyrtare (në letra) për sasi të shkarkimeve në atmosferë të dioksinave nga mbetjet spitalore vijnë vetëm nga djegiet në të vetmin incenerator ekzistues. Nëpërmjet përmirësimit të shfrytëzimit që do t'i bëhet këtij inceneratori, mund të arrihet një ulje e konsiderueshme e shkarkimeve në atmosferë të dioksinave.
9. Qëllimi i Projektit dhe Objektivat	Të ulë shkarkimet në atmosferë të dioksinave dhe furaneve nga djegia e mbetjeve spitalore.
10. Përfituesit	Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Ministria e Shëndetësisë
11. Aktivitetet e parashikuara	Kryerja e një studimi fizibilitetit për përmirësimin e shfrytëzimit të inceneratorit ekzistues në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”. Vendosja e pajisjeve dhe programeve kompjuterike të kërkuara shtesë për të arritur kushtet e shfrytëzimit të përcaktuara në Konventën e Stokholmit për Teknikat më të Mira të Mundshme (TMM). Prokurimi dhe instalimi i Sistemit të Kontrollit të Ndotjes së Ajrit (SKNA) Optimizimi i shfrytëzimit të inceneratorit dhe trajnimi i stafit teknik për përdorimin e sistemit të ri të përmirësuar.
12. Kosto e vlerësuar	1,500,000 US\$
13. Donatorët e mundshëm	Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Ministria e Shëndetësisë
14. Agjenci të tjera kontribuese	Donator ndërkombëtar, Donator dypalësh
15. Vendndodhja e projektit	Tiranë

Profil Projekti Nr. 14

1. Titulli i Projektit	Projektimi dhe ndërtimi i një vend-depozitimi përfundimtar për Mbetjet Spitalore në Shqipëri.
2. Agjencia Implementuese	Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave.
3. Agjenci bashkëvepruese	Shoqëri private të kujdesit shëndetësor dhe të administrimit të mbetjeve.
4. Periudha e zbatimit	2009-2010
5. Vendndodhja	Tiranë
6. Përshkrim i shkurtër	Ka vetëm një njësi të depozitimit përfundimtar të mbetjeve spitalore në Shqipëri. Spitalet dhe klinikat e tjera në të gjithë vendin i hedhin mbetjet e tyre së bashku me mbetjet urbane ose i djegin në mënyrë të paautorizuar (djegie në mjedis të hapur). Janë në përdorim disa autoklave të vogla për sterilizimin e mbetjeve. Hedhja apo djegia është e ndaluar në legjislacionin shqiptar por spitalet dhe klinikat nuk kanë alternativa të tjera për menaxhimin e mbetjeve të tyre spitalore kryesisht për shkak të situatës së vështirë financiare të tyre.
7. Qëllimi i Projektit	Situata e administrimit të mbetjeve spitalore në Shqipëri është e papërshtatshme dhe ka një mundësi të madhe të përhapjes së sëmundjeve infektive duke shtuar kështu edhe shkarkimet në atmosferë të niveleve të larta të dioksinave nga djegia e pakontrolluar e mbetjeve spitalore. Duhet të ngrihet një skemë për mbledhjen, transportin dhe depozitimin e mbetjeve spitalore. Të gjitha autoritetet dhe njësitë e kujdesit shëndetësor në vend duhet të ftohen të bëhen pjesë e skemës e cila me disa njësi qendrore të depozitimit të mbetjeve, mund të plotësohet me njësi të vogla të cilat do të kujdesen për mospërhapjen e mbetjeve infektuese në spitalet kryesore.
8. Justifikimi i projektit	Minimumi i përcaktuar i emisionit të dioksinave nga depozitimi i mbetjeve, për shëndetin e njeriut është 14 g I-TEQ/a ose afërsisht 24% e totalit të shkarkimeve. Aktualisht është e vështirë të bëhet një vlerësim i detajuar rreth djegies së pakontrolluar dhe të paautorizuar në klinikat dhe spitalet në të gjithë vendin. Nëpërmjet sistemit të mbledhjes, transportit dhe depozitimit të mbeturinave mund të bëhet një pakësim në rreth 1 g I-TEQ/a të shkarkimeve. Pakësimi i risqeve në shëndetin e publikut nga sëmundjet infektive do të jetë një prej arritjeve në efektet anësore të menaxhimit të pastër të mbetjeve spitalore.
9. Qëllimi i projektit dhe Objektivat	Ulja e shkarkimeve në atmosferë të dioksinave dhe furaneve përmes përmirësimit të operacioneve të mbledhjes, transportit dhe depozitimit përfundimtar të tyre.
10. Përfituesit	Ministria e Shëndetësisë, spitalet dhe klinikat private.
11. Aktivitetet	Studimi i operacioneve që kryhen me mbetjet spitalore në klinikat dhe spitalet në të gjithë vendin.
	Përgatitja e një plani për sistem efikas për mbledhjen dhe depozitimin e mbetjeve spitalore.
	Marrja e miratimit nga aktorët kryesorë në këtë fushë për planin e grumbullimit dhe të depozitimit të mbetjeve spitalore.
	Blerja dhe instalimi i njësive shtesë të trajtimit të mbetjeve spitalore.
	Vënia në zbatim e sistemit të grumbullimit dhe transportit të mbetjeve spitalore.
	Kalimi i operacioneve të shfrytëzimit tek njësitë e zgjedhura.
12. Kosto e vlerësuar	1,300,000 US \$
13. Donatorët e mundshëm	Ministria e Shëndetësisë, shoqëritë private të kujdesit shëndetësor
14. Agjenci të tjera kontribuese	GEF (Fondi Botëror për Mjedisin), BE, SIDA, Qeveria Holandeze,
15. Vendndodhja e zbatimit të projektit	Tiranë dhe në të gjithë rrethet e vendit.

Profili Projekti Nr. 15

1. Titulli i Projektit	Projekt pilot për ndarjen, riciklimin dhe ripërdorimin e materialeve pa djegien e mbeturinave.
2. Agjencia zbatuese	Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave –Ministria e Brendshme)
3. Agjenci bashkëvepruese	Bashkia e Sarandës dhe Bashki të tjera.
4. Periudha e zbatimit	2009-2011
5. Vendndodhja	Sarandë dhe 2 qytete të tjera në Shqipëri
6. Përshkrim i shkurtër	Aktiviteti më i madh që kontribuon në shkarkimin në mjedis të NOQ, dioksinave, është djegia e pakontrolluar e mbetjeve. Shumë nga këto djegie ndodhin (qëllimisht ose jo) në pikat e grumbullimit me qëllim ndarjen e mbetjeve të vlefshme nga grumbulli i madh i tyre, siç janë metalet. Djegia e qëllimshme e mbetjeve ndodh për disa arsye edhe në vend-depozitimet e bashkive. Qëllimi i projektit është të aplikojë ndarjen në burim të mbetjeve dhe në pikën e grumbullimit dhe në vend-depozitime, kështu që djegia dhe çlirimi në atmosferë të dioksinave mund të reduktohet Projekti do të zbatohet në qytete të vogla të zgjedhura të Shqipërisë. Një nga këto, është qyteti i Sarandës, me një potencial të lartë për zhvillimin e turizmit. Menaxhimi i mbetjeve të ngurta urbane dhe djegia e tyre është një nga problemet kryesore të bashkive.
7. Qëllimi i Projektit	Djegia e pakontrolluar e mbetjeve të ngurta urbane është përgjegjëse për afërsisht për 75% të shkarkimeve të dioksinave në Shqipëri. Djegia e mbeturinave bëhet si qëllimisht ashtu dhe aksidentalisht. Djegia aksidentale ndodh kryesisht për shkak të gjendjes dhe shfrytëzimit shumë të keq të vend-depozitimeve të mbetjeve urbane. Projekti do të fokusohet tek djegia e qëllimshme e mbetjeve të ngurta urbane që behet për të marrë materiale që më pas shiten, kryesisht metale. Kjo do të arrihet nëpërmjet ndarjes në burim dhe në pikën e depozitimit si dhe krijimit të mundësisë për ndarje dhe në pikën fundore të depozitimit të mbetjeve.
8. Justifikimi i Projektit	Projekti do të reduktojë ndjeshëm shkarkimet në atmosferë nga djegia e mbetjeve të ngurta urbane në bashkinë ku do të zbatohet. Kjo do të ulë ndjeshëm çlirimin e dioksinave si dhe probleme të tjera që vijnë nga djegia e pakontrolluar e mbetjeve urbane. Gjithashtu, do të arrihet përmirësimi i higjienës dhe pamjes vizuale të mjedisit në bashkitë pilot ku do të zbatohet projekti. Veç kësaj, do të përmirësohet edhe heqja e plehrave në komunitet dhe do të zvogëlohet dëmtimi i mjedisit. Është parashikuar që futja e kësaj skeme mund të riaplikohet lehtë edhe në shumë bashki të tjera në të gjithë Shqipërinë.
9. Qëllimi i projektit dhe objektivat	Të ulë shkarkimet e dioksinave dhe të furaneve nga menaxhimi i keq i mbetjeve urbane nëpërmjet futjes së skemave të ndarjes dhe riciklimit. Të ulë rrezikun e shëndetit të njeriut nga ndarja e mbetjeve dhe aktivitetet e heqjes së plehrave. Të krijojë mundësi për zhvillimin ekonomik nëpërmjet përmirësimit të kushteve lokale mjedisore.
10. Përfituesit	Komuniteti i banorëve të Sarandës dhe bashkitë e tjera. Njerëzit e varfër që punojnë për heqjen e plehrave.
11. Aktivitetet	Studimi i situatës aktuale me ndarjen e mbeturinave dhe riciklimin, në shtëpi, në pikën e grumbullimit dhe në vend-depozitim përfundimtar.

	Hartimi i një skeme të seleksionimit dhe mbledhjes së mbetjeve të ndara. Organizimi dhe planifikimi i përzgjedhjes së mbeturinave dhe ndarja e mbeturinave me vlerë për t'u përdorur nga grumbulli i madh i mbeturinave në vend-depozitimin përfundimtar.
	Zbatimi i grumbullimit në pikën e grumbullimit të përcaktuar të Bashkisë.
12. Kosto e vlerësuar	500,000 US\$
13. Donatorë të mundshëm	QSH, Bashkitë, Ministria e Brendshme
14. Agjenci të tjera kontribuuese	GEF- Fondi për Mjedisin Global, Donatore dypalësh
15. Vendi i zbatimit të Projektit	Saranda dhe bashki të tjera.

Projekti Nr. 16

1. Titulli i projektit	Ngritja e kapaciteteve për menaxhimin e NOQ-ve në institucionet dhe subjektet e interesuara
2 Agjencia zbatuese	MMPAU
3 Agjencia bashkëpunuese	METE, MBUMK, KESH, MM
4 Kohëzgjatja	5 vjet
5 Ku do të zbatohet	bashkitë, komunat,
6 Formimi profesional	nëpunës, staf teknik dhe supervisorë nga MMPAU, SM, PV, ARM,
7 Arsyeimi për projektin	Nevoja për përgatitjen e specialistëve në subjektet përgjegjës për njohjen e situatës në zonat e konsideruara si vende potencialisht të dyshuara si të ndotura nga NOQ-të.
8 Argumentimi i projektit	1. njohuri të pakta tek pjesa më e madhe e popullatës për rreziqet që mbart çlirimi i NOQ-ve 2. mungesa e ekspertëve të kualifikuar për identifikimin dhe monitorimin e NOQ-ve 3. mungesa e ekspertëve të kualifikuar për trajtimin e mbetjeve industriale 4. mungesa e njohurive lidhur me vlerësimin e tokës dhe të terrenit për ndotje 5. mungesa e kapaciteteve teknike për identifikimin, kontrollin dhe monitorimin e ajrit, tokës dhe ujërave nëntokësore në zonat e ndotura 6. zbatimi i pamjaftueshëm i legjislacionit për parandalimin e ndotjes 7. mungesa e përfshirjes së pushtetit vendor në çështjet që lidhen me ndotjen nga NOQ-të dhe veçanërisht me menaxhimin e mbetjeve.
9 Synimi dhe objektivat e projektit	1. vlerësimi i mangësive në kapacitetet institucionale dhe teknike të PV, IM dhe ARM 2. trajnimi i IM&ICW dhe i IWT&M 3. njohja me teknikat për vlerësimin e tokës dhe të terrenit 4. sigurimi i një laboratorit të pajisur mirë për monitorimin e cilësisë së ujit, ajrit dhe tokës 5. sigurimi në ARM i ekspertëve të kualifikuar për zbatimin e legjislacionit lidhur me parandalimin e ndotjes 6. krijimi pranë bashkive dhe komunave të sektorëve të kualifikuar për menaxhimin e mbetjeve
10 Përfituesit	Bashkitë, Komunat, SP, ARM

11 Aktivitetet që parashikon projekti	1. takim dyditor për evidentimin e nevojave për udhëzues, trajnime dhe mjete (2 ekspertë nga BE + përfaqësues nga subjektet e interesuara) dhe dy seminare pune (2 ekspertë nga BE + pjesëmarrës nga të gjitha subjektet dhe institucionet e interesuara) 2.1. tri seanca trajnimi për grupin IM&ICW (3 ekspertë nga BE + pjesëmarrës nga LG, LA, REA, IE dhe PE) 2.2. tri seanca trajnimi për grupin IWT&M (3 ekspertë nga BE + pjesëmarrës nga LG, LA, REA, IE dhe PE) 3. tetë seanca trajnimi për stafin teknik të RC dhe të strukturave të REA (8 ekspertë nga BE + pjesëmarrës të interesuar nga RC dhe strukturat e REA) 4. sigurimi i laboratorit të monitorimit të cilësisë së ajrit, tokës dhe ujit, instalimi, kalibrimi dhe trajnimi i personelit përkatës (1 muaj, 2 specialistë për trajnim jashtë shtetit) 5. katër seanca trajnimi për strukturat e REA lidhur me zbatimin e legjislacionit për parandalimin e ndotjes (2 ekspertë të BE + përfaqësues nga të gjitha REA) 6. katër seanca trajnimi për forcimin e kapaciteteve institucionale dhe teknike të bashkive dhe komunave për ESWM (2 ekspertë të BE + përfaqësues nga bashkitë dhe komunat prioritare)
12 Vlerësimi i përafërt i kostos	478,800 \$
13 Donatorët potencialë	BE, GEF, BB (250,000 \$)
14 Kontribues të tjerë	MMPAU, RC, SM (150,000 \$)
	Donatorë privatë dhe pjesëmarrës nga OJF-të (78,800 \$)
15 Vend-zbatimi i projektit	Tiranë, Durrës, Vlorë

Profil Projekti Nr. 17

1. Titulli i projektit	Studimi i terrenit, përcaktimi i prioriteteve, zhvillimi i planit rehabilitues për zonat potencialisht të ndotura me NOQ
2 Agjencia zbatuese	MMPAU
3 Agjencia bashkëpunuese	METE, MBUMK, SP
4 Afati	2 vjet
5 Ku do të zbatohet	Në zonat që gjykoen potencialisht të kontaminuara
6 Formimi profesional	kimistë, inxhinierë, gjeologë, petrokimistë, staf teknik, specialistë të universitetit dhe të RC-ve
7 Arsytimi për projektin	Njohja e sakte e kufijve të ndotjes nga NOQ-t, në vendet e kontaminuara; ne toke, ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore dhe hartimi i projekteve për rehabilitimin e tyre
8 Argumentimi i projektit	Ndotja e ajrit, tokës dhe probablisht edhe e ujërave nëntokësore në uzinën e plastikes në Lushnje dhe depot e stacionit të trenit në Bajze-Shkodër; Ndotja e ajrit, tokës dhe probablisht edhe e urave nëntokësore në territorin pranë dhe përreth uzinës kokso-kimike të ish-kombinatit metalurgjik në Elbasan; Ndotja e ajrit, tokës dhe probablisht edhe e urave nëntokësore në territorin e repartit të imprenjimit të lëndës drusore në ish-kombininat e përpunimit të drurit në Elbasan; Ndotja e tokës dhe urave nëntokësore për shkak të djegies së mbetjeve në vend-depozitimet urbane.
9 Synimi dhe objektivat e projektit	1. njohja me nivelin e ndotjes dhe identifikimi i çështjeve që duhen zgjidhur; 2. mbështetur në përfundimet që do të arrihen në aktivitetin e parë bëhet vlerësimi i detajuar i zonave, për zonat më të ndotura (prioritare); 3. njohja me metodat e ndryshme që përdoren për rehabilitimin e zonave të ndotura; 4. zhvillimi i planeve të rehabilitimit për zonat më të ndotura (prioritare)
10 Përfituesit	komuniteti që jeton pranë zonave të ndotura dhe zhvillimi i atyre rajoneve, LG, PE dhe turizmi

11 Aktivitetet që parashikon projekti	1. studimi i përqendrimit të NOQ-ve në zonat që mendohet se janë të ndotura me NOQ (8 zona, 4 (1+3) mostrime dhe analiza për secilën zonë) 2.1. ngritja dhe funksionimi i PIU 2.2. kryerja e analizave të nevojshme për përcaktimin e konturit të zonës së ndotur dhe thellësinë e penetrimit të ndotjes 3 organizimi i katër seminareve për trajnimin e pjesëmarrësve lidhur me metodat dhe praktikën e rehabilitimit (4 ekspertë të BE për teknikat që përdoren në rehabilitimin e territoreve dhe objekteve të ndotura me NOQ dhe për ESWM + pjesëmarrës nga subjektet e interesuara drejtpërdrejtë) 4. përpunimi i të dhënave, vlerësimi i përafërt i kostos dhe i afateve për projektet e rehabilitimit
12 Vlerësimi i përafërt i kostos	893,000 \$
13 Donatorët potencialë	GEF, WB, JICA (600,000 \$)
14 Kontribues të tjerë	MEFWA, RC, SM (200,000 \$)
	Donatorë privatë (93,000 \$)
15 Vend-zbatimi i projektit	Elbasan, Tiranë, Lushnje, Bajze

Profil Projekti 18

1. Titulli i Projektit	Ndërgjegjësimi i publikut për rrezikun që shkaktajnë në shëndetin e njeriut kimikatet NOQ që dalin nga djegia e plehrave urbane.
2. Agjencia zbatuese	Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të ujërave, Ministria e Qeverisjes vendore, Qendra e Grupimit të Shoqatave Mjedisore "Ekolëvizja"
3. Agjenci bashkëvepruese	Bashkitë e pesë qyteteve më të mëdha të Shqipërisë, Shoqatat mjedisore lokale
4. Kohëzgjatja	2008-2011
5. Zona e zbatimit	Në pesë qytetet kryesore të Shqipërisë
6. Situata	Aktiviteti më i madh që ndikon në krijimin e paqëllimshëm të NOQ-ve, është djegia e mbeturinave urbane në qytetet e mëdha urbane dhe përreth tyre. Nga djegia e pakontrolluar e këtyre mbeturinave krijohet dioksinat, furanet dhe NOQ-e të tjerë. Shumica e këtyre gjegjeve ndodh që në pikat e grumbullimit në qytet nga persona që duan të ndajnë nga grumbulli hedhurinat metalike, ose nga që plehrat rrinë për një kohë të gjatë pa u tërhequr nga ndërmarrja e pastrimit. Por djegie të vazhdueshme të plehrave ka dhe në vend-depozitimet e grumbullimit kryesor jashtë qytetit. Projekti synon të informojë dhe ndërgjegjësojë publikun dhe drejtuesit lokal të pesë qyteteve kryesore të Shqipërisë rreth rrezikut dhe pasojave për shëndetin që vijnë nga gazet NOQ që çlirohen nga djegia e plehrave urbane. Projekti do të zbatohet në pesë qytetet më të mëdhenj të vendit ku administrimi i mbeturinave urbane nuk është në kushtet e kërkuara dhe është identifikuar djegia e pakontrolluar e plehrave urbane .
7. Shpjegimi i Projektit	Djegia e pakontrolluar e mbeturinave urbane të bashkive çliron rreth 75% të të gjithë çlirimeve të dioksinës në Shqipëri . Djegia e plehrave ndodh qëllimisht dhe në mënyrë të paqëllimtë. Djegia vetvetiu ndodh dhe në vendet e grumbullimit të mbeturinave në periferi të qyteteve si rezultat e çlirimit të biogazit në brendësi të tyre kur ato ndodhen në ajër, të pambuluara me dhe. Projekti do t'i drejtohet kryesisht publikut të gjerë por do të punohet dhe me grupe të veçantë të prekur dhe me drejtuesit lokal. Në bashkëpunim me bashkitë e qyteteve, mediat lokale dhe shoqatat mjedisore, Projekti do të informojë dhe ndërgjegjësojë në mënyrë të vazhdueshme për rreziqet që lindin për njeriun nga çlirimi i NOQ-ve gjatë djegies së mbeturinave urbane.
8. Justifikimi i Projektit	Informimi dhe ndërgjegjësimi i publikut në tërësi dhe i grupeve të veçanta që janë direkt të rrezikuar nga NOQ-të që dalin nga djegia e plehrave, ka një rëndësi të madhe për mbrojtjen e shëndetit të popullsisë së gjerë. Publiku i përgjithshëm në përgjithësi është pak i ndërgjegjësuar mbi rrezikun e NOQ-ve. Plani i veprimit në informim/ndërgjegjësimin e tyre duhet të jetë i drejtuar tek ata qartë, direkt, me një gjuhë të thjeshtë, me shembuj dhe raste të dokumentuara, me mjete audiovizive, (filma, foto, animacione) .Disa nga NOQ-të si furanet, dhe dioksinat pothuajse nuk njihen dhe nuk ndjehen nga publiku i gjerë si kimikatet më të rrezikshme për shëndetin e tyre, ata nuk janë të bindur se ato shkaktajnë sëmundje dhe pasoja vdekjeprurëse për njeriun. Projekti do të krijojë këtë ndjeshmëri të publiku i gjere.

9. Qëllimi Kryesor dhe Objektivi i Projektit	Të ulë dhe eliminojë çlirimin në ajër të dioksinave dhe furaneve nga keqadministrimi dhe djegia e mbeturinave urbane në 5 qytetet më të mëdha të Shqipërisë. Të mbrojë shëndetin e popullsisë të këtyre zonave në tërësi
10. Përfituesit	Komunitetet e 5 zonave urbane më të mëdha të Shqipërisë si dhe grupet e njerëzve që jetojnë direkt në afërsi të pikave të grumbullimit të plehrave.
11. Aktivitetet	-Informim dhe ndërgjegjësim i vazhdueshëm i publikut të gjerë të këtyre zonave të përzgjedhura nëpërmjet mediave lokale , elektronike dhe të shkruara mbi rrezikun që sjellin djegiet e plehrave të qytetit dhe ato të grumbulluara rreth tij. -Fushata ndërgjegjëse direkt në zonat e banuara përreth pikave të grumbullit të mbetjeve urbane të 5 qyteteve të përzgjedhur. -Përgatitja dhe shpërndarja e posterave, broshurave, fletëpalosjeve dhe materialeve të tjera ndërgjegjëse mbi NOQ-të -Përgatitja e dokumentarëve dhe animacione shpjegues mbi dukuritë e djegies së plehrave dhe çlirimin e NOQ-ve, rrezikun që shkaktojnë ato në trupin e njeriut -Informim dhe ndërgjegjësim me fëmijët në shkollë
12. Kostoja	100.000 USD
13. Donatorët potencial	Bashkitë e Qyteteve, Ministria e Mjedisit, Ministria e qeverisjes Lokale, Biznesi lokal.
14. Agjenci të tjera kontribuese	Shoqatat mjedisore lokale, donatorë të huaj
15. Harta e projektit	Tirana, Durrës, Shkoder, Vlora, Saranda

Abonimet vjetore mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 267 468
Çmimi i abonimit për Fletoret Zyrtare 2006 është 18 000 lekë.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

- 1. KUSHTETUTA E SHQIPËRISË**
- 2. KODET E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR**
- 3. REGJISTRAT E NOTERISË**
- 4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI:**

1. PËR PROKURIMIN PUBLIK (2006).....	1500
2. PËR NËPUNËSIN CIVIL (2005)	600
3. PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllim I-rë dhe vëllimi i II-të-2006).....	1300
4. PËRMBLEDHËSE LEGJISLACIONI NË FUSHËN E ARSIMIT.....	500

Botime të reja

1 TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I).....	1000
2 TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II).....	500
3 TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I).....	1000
4 TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II).....	500
5 PËRMBLEDHJE MARRËVESHJESH NDERKOMBËTARE NË FUSHËN E DREJTËSISË.....	1000
6 PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR PUSHTETIN VENDOR.....	800
7 PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NDËRTIMET.....	500
8 PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË (2000-2006).....	1000
...	
9 PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SHOQERITË TREGTARE.....	500

Doli nga shtypi më 9.1.2007

Tirazhi: 4000 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja “Ilar”
Tiranë, 2007

Çmimi 200 lekë